

Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të  
Sektorit Publik

**Volumi III**

## VOLUMI III - PËRMBAJTJA

---

|                                             | Faqe |
|---------------------------------------------|------|
| SNKSP 39 – Përfitimet e Punonjësve .....    | 1037 |
| SNKSP 40—Kombinimet e Sektorit Publik ..... | 1092 |
| SNKSP 41—Instrumentet Financiare.....       | 1138 |
| SNKSP 42—Përfitimet Sociale .....           | 1207 |
| FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA .....      | 1217 |

## **SNKSP 39 – PËRFITIMET E PUNONJËSVE**

### **Shënime të Mirënjohjes**

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) është hartuar kryesisht nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 19, *Përfitimet e Punonjësve* publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ekstrakte nga SNK 19 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze, dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Customer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: [publications@ifrs.org](mailto:publications@ifrs.org)

Internet: [www.ifrs.org](http://www.ifrs.org)

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

**SNKSP 39 – PËRFITIMET E PUNONJËSVE****Historia e SNKSP**

*Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e publikuara deri në 31 janar, 2019.*

SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve* u publikua në korrik 2016.

Që atëherë, SNKSP 39 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

*Përmirësime të SNKSP-ve 2018 (botuar në tetor 2018)*

**Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 39**

| Paragrafi i Ndikuar          | Si u Ndikua | Ndikuar Nga                        |
|------------------------------|-------------|------------------------------------|
| 59                           | U Ndryshua  | Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018 |
| 101                          | U Ndryshua  | Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018 |
| 103A                         | I Ri        | Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018 |
| 122                          | U Ndryshua  | Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018 |
| Titulli para paragrafit 124A | I Ri        | Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018 |
| 124A                         | I Ri        | Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018 |
| 125                          | U Ndryshua  | Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018 |
| 125A                         | I Ri        | Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018 |

PËRFITIMET E PUNONJËSVE

| Paragrafi i Ndikuar | Si u Ndikua | Ndikuar Nga                           |
|---------------------|-------------|---------------------------------------|
| 127                 | U Ndryshua  | Përmirësime të<br>SNKSP-ve Tetor 2018 |
| 128                 | U Ndryshua  | Përmirësime të<br>SNKSP-ve Tetor 2018 |
| 159                 | U Ndryshua  | Përmirësime të<br>SNKSP-ve Tetor 2018 |
| 176A                | I Ri        | Përmirësime të<br>SNKSP-ve Tetor 2018 |

## SNKSP 39 – PËRFITIMET E PUNONJËSVE

### PËRMBAJTJA

|                                                                                                                                        | Paragrafi |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Objektivi.....                                                                                                                         | 1         |
| Objekti .....                                                                                                                          | 2–7       |
| Përkufizime.....                                                                                                                       | 8         |
| Përfitimet Afatshkurtra të Punonjësve.....                                                                                             | 9–25      |
| Njohja dhe Matja .....                                                                                                                 | 11–24     |
| Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.....                                                                                                | 25        |
| Përfitimet Pas Punësimit—Dallimi ndërmjet Planeve (Skemave) me Kontribute të Përcaktuara dhe Skemave me Përfitime të Përcaktuara ..... | 26–51     |
| Skemat me Shumë Punëdhënës .....                                                                                                       | 32–39     |
| Skemat me Përfitime të Përcaktuara që Ndajnë Rreziqet ndërmjet Njësive nën Kontrollin e Përbashkët .....                               | 40–43     |
| Skemat Shtetërore .....                                                                                                                | 44–47     |
| Përfitimet e Siguruara .....                                                                                                           | 48–51     |
| Përfitimet Pas Punësimit—Skemat me Kontribute të Përcaktuara ....                                                                      | 52–56     |
| Njohja dhe Matja .....                                                                                                                 | 53–54     |
| Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.....                                                                                                | 55–56     |
| Përfitimet Pas Punësimit—Skemat me Përfitime të Përcaktuara .....                                                                      | 57–154    |
| Njohja dhe Matja .....                                                                                                                 | 58–67     |
| Njohja dhe Matja – Vlera Aktuale e Detyrimeve për Skemat me Përfitime të Përcaktuara dhe Kostoja Aktuale e Shërbimit .....             | 68 – 100  |
| Kostoja e Shërbimit të Kaluar dhe Fitimet e Humbjet në Shlyerje .....                                                                  | 101–114   |
| Njohja dhe Matja—Aktivet e Skemës .....                                                                                                | 115–121   |
| Komponentët e Kostos për Skemat me Përfitime të Përcaktuara .....                                                                      | 122–132   |
| Paraqitja.....                                                                                                                         | 133–136   |

---

## PËRFITIMET E PUNONJËSVE

---

|                                                   |         |
|---------------------------------------------------|---------|
| Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.....           | 137–154 |
| Përfitime të Tjera Afatgjata të Punonjësve.....   | 155–161 |
| Njohja dhe Matja .....                            | 158–160 |
| Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.....           | 161     |
| Përfitimet e Përfundimit të Punësimit.....        | 162–174 |
| Njohja.....                                       | 168–171 |
| Matja .....                                       | 172–173 |
| Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.....           | 174     |
| Dispozitat Kalimtare .....                        | 175     |
| Data Efektive.....                                | 176–177 |
| Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 25 (2008)..... | 178     |

---

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 39, *Përfitimet e Punonjësve*, është përcaktuar në paragrafët 1–178. Të gjithë paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 39 duhet të lexohet në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit në mungesë të udhëzimeve të qarta.



## Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë kontabilitetin dhe paraqitjen e informacioneve shpjegues për përfitimet e punonjësve. Standardi kërkon që një njësi të njohë:
  - (a) Një detyrim kur një punonjës ka dhënë shërbim në këmbim të përfitimeve të punonjësve që duhet të paguhet në të ardhmen; dhe
  - (b) Një shpenzim kur njësia konsumon përfitimet ekonomike ose potencialin e shërbimit që vjen nga shërbimi i dhënë nga një punonjës në këmbim të përfitimeve të punonjësve.

## Objekti

2. **Ky Standard do të zbatohet nga një punëdhënës në kontabilitetin për të gjithë përfitimet e punonjësve, përveç transaksioneve të bazuara në aksione (shih standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që merret me transaksionet e bazuara në aksione).**
3. Ky Standard nuk trajton raportimin nga skemat e përfitimeve të pensionit të punonjësve (shih standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton skemat e përfitimeve të pensionit të punonjësve). Ky Standard nuk trajton përfitimet e dhëna nga programet e përbëra të sigurimeve shoqërore që nuk janë vlera në këmbim të shërbimit të kryer nga punonjësit ose punonjësit e mëparshëm të njësisë të sektorit publik.
4. Përfitimet e punonjësve për të cilat zbatohet ky Standard përfshijnë përfitimet e dhëna:
  - (a) Sipas skemave formale ose marrëveshjeve të tjera formale ndërmjet një njësie dhe punonjësve individualë, grupeve të punonjësve, ose përfaqësuesve të tyre;
  - (b) Sipas kërkesave legjislative, ose nëpërmjet marrëveshjeve të industrisë, sipas të cilave njësisë u kërkohet të kontribuojnë në skema kombëtare, shtetërore, industriale ose të tjera me shumë punëdhënës, ose kur njësisë u kërkohet të kontribuojnë në programin e përbërë të sigurimeve shoqërore; ose
  - (c) Nga ato praktika joformale që krijojnë një detyrim konstruktiv. Praktikrat joformale krijojnë një detyrim konstruktiv ku njësia nuk ka alternativë reale përveç pagesës së përfitimeve të punonjësve. Një shembull i një detyrimi konstruktiv është kur një ndryshim në praktikrat informale të njësisë do të shkaktonte dëme të papranueshme në marrëdhënien e saj me punonjësit.

5. Përfitimet e punonjësve përfshijnë:
- (a) Përfitimet afatshkurtra të punonjësve, të tilla si në vijim, nëse pritet të shlyhen plotësisht përpara dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës së raportimit në të cilën punonjësit kryejnë shërbimet përkatëse:
    - (i) Pagat për orë, pagat vjetore dhe kontributet e sigurimeve shoqërore;
    - (ii) Pushimi vjetor i paguar dhe pushimi mjekësor i paguar;
    - (iii) Ndarja e fitimeve dhe bonuset; dhe
    - (iv) Përfitimet jomonetare (të tillë si kujdesi mjekësor, strehimi, makinat dhe të mirat ose shërbimet falas ose të subvencionuara) për punonjësit aktualë;
  - (b) Përfitimet pas punësimit, si p.sh.:
    - (i) Përfitimet e pensionit (p.sh., pensionet dhe pagesat e vetme në momentin e daljes në pension); dhe
    - (ii) Përfitime të tjera pas punësimit, si sigurimi i jetës pas punësimit dhe kujdesi mjekësor pas punësimit;
  - (c) Përfitime të tjera afatgjata të punonjësve, si:
    - (i) Pagesa për mungesa afatgjatë, si p.sh. pushim i përfituar si rezultat i shërbim të gjatë ose pushim fund-javor;
    - (ii) Përfitime për përvjetorë të veçantë ose përfitime të tjerë të shërbimit afatgjatë; dhe
    - (iii) Përfitimet afatgjatë për shkak të aftësisë së kufizuar; dhe
  - (d) Përfitimet nga përfundimi i marrëdhënies së punësimit.
6. Përfitimet e punonjësve përfshijnë përfitimet që u jepen punonjësve ose personave në ngarkim të tyre, dhe mund të shlyhen me pagesa (ose ofrimi i të mirave ose shërbimeve) që u jepen drejtpërdrejt punonjësve, bashkëshortëve, fëmijëve, ose personave të tjerë në ngarkim, ose të tjerëve, si p.sh. si kompanive të sigurimeve.
7. Një punonjës mund t'i japë shërbime një njësie me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, të përhershme, rastësore ose të përkohshme. Për qëllimin e këtij Standardi, punonjësit përfshijnë personelin drejtues kryesor, siç përcaktohet në SNKSP 20, *Dhënia e Informacioneve për Palët e Lidhura*.

## Përkufizime

8. **Termet e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e**

specifikuara:

## **Përkufizimet e Përfitimeve të Punonjësve**

**Përfitimet e punonjësve** janë të gjitha format e shumës që jepen nga një njësi në këmbim të shërbimit të dhënë nga punonjësit ose në përfundim të punësimit.

**Përfitimet afatshkurtra të punonjësve** janë përfitime të punonjësve (të ndryshëm nga përfitimet e përfundimit të punësimit) që duhet të shlyhen plotësisht përpara dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës së raportimit në të cilën punonjësit kryejnë shërbimin përkatës.

**Përfitimet pas punësimit** janë përfitime të punonjësve (të ndryshëm nga përfitimet e përfundimit të punësimit dhe përfitimeve afatshkurtra të punonjësve) të cilët janë të pagueshëm pas përfundimit të punësimit.

**Përfitimet e tjera afatgjata të punonjësve** janë të gjithë përfitimet e punonjësve të ndryshëm nga përfitimet afatshkurtra të punonjësve, përfitimeve pas punësimit dhe përfitimeve nga përfundimi i punësimit.

**Përfitimet e përfundimit të punësimit** janë përfitime të punonjësve të dhënë në këmbim të përfundimit të punësimit të një punonjësi si rezultat i:

- (a) Vendimit të një njësie për t'i dhënë fund punësimit të një punonjësi përpara datës normale të daljes në pension; ose
- (b) Vendimit të një punonjësi për të pranuar një ofertë përfitimesh në këmbim të përfundimit të punësimit.

Përkufizime që Lidhen me Klasifikimin e Skemave  
(Fondeve/Planeve)

**Skemat e përfitimeve pas punësimit** janë marrëveshje formale ose joformale sipas të cilave një njësi jep përfitime pas punësimit për një ose më shumë punonjës.

**Skemat me kontribute të përcaktuara** janë skema përfitimesh pas punësimit sipas të cilëve një njësi paguan kontribute fikse në një njësi të veçantë (një fond) dhe nuk do të ketë asnjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar kontribute të mëtejshme nëse fondi nuk ka aktive të mjaftueshme për të paguar të gjithë përfitimet e punonjësve që lidhen me shërbimin e punonjësve në periudhat aktuale dhe ato të mëparshme.

**Skemat me përfitime të përcaktuara** janë skema të përfitimeve pas

punësimi, të ndryshme nga skemat me kontribute të përcaktuara.

**Skemat me shumë punëdhënës** janë skema të kontributeve të përcaktuara (të ndryshme nga skemat shtetërore) ose skema të përfitimeve të përcaktuara (të ndryshme nga skemat shtetërore) që:

- (a) Bashkojnë aktivet e kontribuar nga njësi të ndryshme që nuk janë nën kontroll të përbashkët; dhe
- (b) Përdorin ato aktive për të dhënë përfitime për punonjësit e më shumë se një njësie, mbi bazën që nivelet e kontributeve dhe përfitimeve përcaktohen pa marrë parasysh identitetin e njësisë që punëson punonjësit.

**Skemat shtetërore** janë skema të përcaktuar me legjislacion që funksionojnë sikur të jenë skema me shumë punëdhënës për të gjitha njësitë në kategoritë ekonomike të përcaktuara në legjislacion.

Përkufizime që Lidhen me Detyrimin (Aktivin) Neto të Skemës me Përfitim të Përcaktuar

**Detyrimi (aktivi) neto i përfitimeve të përcaktuara** është deficieti ose suficiti, i rregulluar për ndonjë efekt që kufizon aktivin neto të përfitimeve të përcaktuara në vlerën kufirit të sipërm të aktivit.

**Deficiti ose suficiti** është:

- (a) Vlera aktuale e detyrimit të përfitimeve të përcaktuara minus
- (b) Vlerën e drejtë të aktiveve të skemës (nëse ka).

**Kufiri i sipërm i aktivit** është vlera aktuale e çdo përfitimi ekonomik të disponueshëm në formën e shlyerjeve nga skema ose reduktimeve në kontributet e ardhshme në skemë.

**Vlera aktuale e një detyrimi të skemës me përfitime të përcaktuara** është vlera aktuale, (pa zbritur ndonjë aktiv të skemës) e pagesave të ardhshme të pritshme që kërkohen për të shlyer detyrimin që rezulton nga shërbimi i punonjësit në periudhat aktuale dhe ato të mëparshme.

**Aktivët e skemës përfshijnë:**

- (a) Aktivët e mbajtur nga një fond afatgjatë i përfitimeve të punonjësve; dhe
- (b) Policat kualifikuese të sigurimit.

**Aktivët e mbajtur nga një fond afatgjatë i përfitimeve të punonjësve** janë aktive (të ndryshëm nga instrumentet financiare të patransferueshëm të emtuar nga njësia raportuese) që:

- (a) Mbahen nga një njësi (një fond) që është ligjërish e ndarë nga njësia raportuese dhe ekzistojnë vetëm për të paguar ose financiar përfitimet e punonjësve; dhe
- (b) Janë të disponueshëm për t'u përdorur vetëm për të paguar ose financiar përfitimet e punonjësve, nuk janë të disponueshëm për vetë kreditorët e njësisë raportuese (madje as në rast falimentimi) dhe nuk mund t'i kthehen njësisë raportuese, përveç nëse:
  - (i) Aktivet e mbetura të fondit janë të mjaftueshëm për të përmbushur të gjithë detyrimet e lidhur me to të përfitimeve të punonjësve të skemës ose të njësisë ekonomike raportuese; ose
  - (ii) Aktivet i kthehen njësisë raportuese për të rimbursuar atë për përfitimet e punonjësve të paguara më parë.

Një policë sigurimi kualifikuese është një policë sigurimi e dhënë nga një sigurues që nuk është palë e ndërlidhur (siç përcaktohet në SNKSP 20) e njësisë raportuese, nëse të ardhurat e skemës:

- (a) Mund të përdoren vetëm për të paguar ose financiar përfitimet e punonjësve sipas një skeme përfitimesh të përcaktuara; dhe
- (b) Nuk janë të disponueshëm për kreditorët e vetë njësisë raportuese (madje edhe në rast falimentimi) dhe nuk mund t'i paguhen njësisë raportuese, përveç nëse:
  - (i) Të ardhurat përfaqësojnë aktive të tepërta që nuk nevojiten që skema të përmbushë të gjithë detyrimet e përfitimeve të punonjësve të lidhura me to; ose
  - (ii) Të ardhurat i kthehen njësisë raportuese për të rimbursuar atë për përfitimet e punonjësve të paguara më parë.

Përkufizime që Lidhen me Koston e Përfitimeve të Përcaktuara

Kostoja e shërbimit përfshin:

- (a) Koston e shërbimit aktual, e cila është rritja në vlerën aktuale të detyrimit të përfitimeve të përcaktuara që rezulton nga shërbimi i punonjësve në periudhën aktuale;
- (b) Kostoja e shërbimit të kaluar, e cila është ndryshimi në vlerën aktuale të detyrimit të përfitimeve të përcaktuara për shërbimin e punonjësve në periudhat e mëparshme, që

rezultojnë nga një ndryshim i skemës (hyrja ose tërheqja ose ndryshimet në një skemë me përfitime të përcaktuara) ose një reduktim (një reduktim i ndjeshëm nga njësia në numrin e punonjësve të mbuluar nga një skemë); dhe

- (c) Çdo fitim ose humbje nga shlyerja.

**Interesi neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara** është ndryshimi gjatë periudhës në detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara që krijohet nga kalimi i kohës.

**Rimatjet e detyrimit (aktivit) neto të përfitimeve të përcaktuara** përbëhen nga:

- (a) Fitimet dhe humbjet aktuariale;
- (b) Fitimi nga aktivet e skemës, duke përjashtuar shumat e përfshira në interesin neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara; dhe
- (c) Çdo ndryshim në efektin e kufirit të sipërm të aktivit, duke përjashtuar shumat e përfshira në interesin neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara.

**Fitimet dhe humbjet aktuariale** janë ndryshime në vlerën aktuale të detyrimit të përfitimeve të përcaktuara që rezultojnë nga:

- (a) Rregullimet e eksperiencës (efektet e diferencave midis supozimeve të mëparshme aktuariale dhe asaj që ka ndodhur në të vërtetë); dhe
- (b) Efektet e ndryshimeve në supozimet aktuariale.

**Fitimi nga aktivet e skemës** është interesi, dividendët ose shpërndarjet e ngjashme dhe të ardhurat e tjera që vijnë nga aktivet e skemës, së bashku me fitimet ose humbjet e realizuara dhe të përcaktuara nga aktivet e skemës, minus:

- (a) Çdo kosto të menaxhimit të aktiveve të skemës; dhe
- (b) Çdo taksë të pagueshme nga vetë skema, të ndryshme nga taksat e përfshirë në supozimet aktuariale të përdorura për të matur vlerën aktuale të detyrimit të përfitimit të përcaktuar.

**Një shlyerje** është një transaksion që eliminon të gjithë detyrimet e mëtejshme ligjore ose konstruktive për një pjesë ose të gjitha përfitimet e dhëna sipas një skeme përfitimesh të përcaktuara, i ndryshëm nga pagesa e përfitimeve për, ose në emër të, punonjësve që përcaktohet në kushtet e skemës dhe përfshihet në supozimet aktuariale.

## Përfitimet Afatshkurtra të Punonjësve

9. Përfitimet afatshkurtra të punonjësve përfshijnë zëra të tillë si më poshtë, nëse ata pritet të shlyhen plotësisht përpara dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës së raportimit në të cilën punonjësit kryejnë shërbimet përkatëse:
- (a) Paga, shtesat mbi pagën, dhe kontributet e sigurimeve shoqërore;
  - (b) Pushimi vjetor i paguar dhe raportet mjekësore të paguara;
  - (c) Pjesëmarrja në ndarjen e fitimeve dhe shpërblimeve (bonuseve); dhe
  - (d) Përfitimet jomonetare (të tillë si kujdesi mjekësor, strehimi, makinat dhe të mirat ose shërbimet falas ose të subvencionuara) për punonjësit aktualë.
10. Nuk është e nevojshme që një njësi të riklasifikojë një përfitim afatshkurtër të punonjësve nëse pritshmëritë e njësisë për kohën e shlyerjes ndryshojnë përkohësisht. Megjithatë, nëse karakteristikat e përfitimit ndryshojnë (siç është një ndryshim nga një përfitim që nuk akumulohet në një përfitim që akumulohet) ose nëse një ndryshim në pritshmëritë e kohës së shlyerjes nuk është i përkohshëm, atëherë njësia konsideron nëse përfitimi ende përmbush përkufizimin e përfitimeve afatshkurtra të punonjësve.

## Njohja dhe Matja

### *Përfitimet Afatshkurtra të Punonjësve në Tërësi*

11. **Kur një punonjës ka kryer shërbim për një njësi gjatë një periudhe kontabël, njësia do të njohë shumën e paskontuar të përfitimeve afatshkurtra të punonjësve që pritet të paguhen në këmbim të atij shërbimi:**
- (a) **Si detyrim (shpenzim i akumuluar), pas zbritjes së çdo shume të paguar më parë. Nëse shuma e paguar më parë tejkalon shumën e pazbritur të përfitimeve, një njësi do ta njohë atë tepriçë si një aktiv (shpenzim i parapaguar) në masën që parapagimi do të çojë, për shembull, në një reduktim të pagesave të ardhshme ose një rimbursim monetar.**
  - (b) **Si shpenzim, përveç rastit kur një Standard tjetër kërkon ose lejon përfshirjen e përfitimeve në koston e një aktivi (shih, për shembull, SNKSP 12, *Inventarët*, dhe SNKSP 17, *Ndërtesa, Makineri, dhe Pajisje*).**
12. **Paragrafët 13, 16 dhe 19 shpjegojnë se si një njësi do të zbatojë paragrafin 11 për përfitimet afatshkurtra të punonjësve në formën e**

**pagesave për mungesa në punë, dhe skemave të ndarjes së fitimit dhe të shpërblimeve.**

*Mungesat Afatshkurtra me Pagesë*

13. **Një njësi do të njohë koston e pritshme të përfitimeve afatshkurtra të punonjësve në formën e pagesave për mungesa në punë sipas paragrafit 11 si më poshtë:**
  - (a) **Në rastin e mungesave të pagueshme që akumulohen, kur punonjësit kryejnë shërbime që rritin të drejtën e tyre për mungesa të ardhshme me pagesë; dhe**
  - (b) **Në rastin e mungesave të pagueshme që nuk akumulohen, kur ndodhin mungesat.**
14. Një njësi mund të paguajë punonjësit për mungesë për arsye të ndryshme, duke përfshirë pushimet, sëmundjen dhe aftësinë e kufizuar afatshkurtër, leje lindje, kohën në shërbim në juri, dhe shërbimin ushtarak. E drejta e pagesës për mungesa ndahet në dy kategori:
  - (a) Akumuluese; dhe
  - (b) Joakumuluese.
15. Mungesat e akumuluar me pagesë janë ato që barten në të ardhmen dhe mund të përdoren në periudhat e ardhshme nëse e drejta e periudhës aktuale nuk përdoret plotësisht. Mungesat e pagueshme që akumulohen mund të jenë ose të garantuara (me fjalë të tjera, punonjësit kanë të drejtë për një pagesë në para për të drejtën e papërdorur kur largohen nga njësia) ose të paguarantuar (kur punonjësit nuk kanë të drejtë për një pagesë në para për të drejtën e papërdorur pas largimit). Një detyrim lind kur punonjësit kryejnë shërbime që rrisin të drejtën e tyre për mungesat e ardhshme me pagesë. Detyrimi ekziston dhe njihet, edhe nëse mungesat e pagueshme janë të paguarantuar, megjithëse mundësia që punonjësit mund të largohen përpara se të përdorin një të drejtë të akumuluar të paguarantuar ndikon në matjen e atij detyrimi.
16. **Një njësi do të masë koston e pritshme të mungesave të pagueshme të akumuluar si shumën shtesë që njësia pret të paguajë si rezultat i të drejtës së papërdorur që ka akumuluar në fund të periudhës së raportimit.**
17. Metoda e specifikuar në paragrafin e mëparshëm mat detyrimin në shumën e pagesave shtesë që pritet të krijohen vetëm nga fakti se përfitimi akumulohet. Në shumë raste, një njësi mund të mos ketë nevojë të bëjë llogaritje të detajuara për të vlerësuar se nuk ka ndonjë detyrim material për mungesat e pagueshme të papërdorura. Për shembull, një detyrim për pushim mjekësor ka gjasa të jetë material vetëm nëse



ekziston një mirëkuptim formal ose joformal se pushimi mjekësor i paguar i papërdorur mund të merret si pushim vjetor me pagesë.

18. Mungesat e pagueshme që nuk akumulohen nuk barten në të ardhmen; ato skadojnë nëse e drejta e periudhës aktuale nuk përdoret plotësisht dhe nuk u japin punonjësve të drejtën për një pagesë monetare për të drejtën e papërdorur pas largimit nga njësia. Ky është zakonisht rasti për pagesën për arsye mjekësore (në masën që e drejta e kaluar e papërdorur nuk rrit të drejtën e ardhshme), lejen e lindjes, dhe mungesat e pagueshme për shërbimin e jurisë ose shërbimin ushtarak. Një njësi nuk njuh ndonjë detyrim ose shpenzim deri në kohën e mungesës, sepse shërbimi i punonjësit nuk rrit shumën e përfitimit.

*Pjesëmarrja në Skemat e Ndarjes së Fitimit dhe Bonuseve*

19. **Një njësi do të njohë koston e pritshme të ndarjes së fitimit dhe pagesës së bonuseve sipas paragrafit 11 kur, dhe vetëm kur:**

- (a) **Njësia ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të bërë pagesa të tilla si rezultat i ngjarjeve të kaluara; dhe**
- (b) **Mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i detyrimit.**

**Një detyrim aktual ekziston kur, dhe vetëm kur, njësia nuk ka alternativë tjetër reale përveçse të bëjë pagesat.**

20. Në sektorin publik, disa njësi kanë skema bonusi që lidhen me objektivat e dhënies së shërbimeve ose me aspekte të performancës financiare. Sipas skemave të tilla, punonjësit marrin shuma të caktuara, në varësi të vlerësimit të kontributit të tyre në arritjen e objektivave të njësisë ose të një segmenti të njësisë. Në disa raste, skema të tilla mund të jenë për grupe punonjësish, si për shembull kur performanca vlerësohet për të gjithë ose disa punonjës në një segment të caktuar, dhe jo në baza individuale. Për shkak të objektivave të njësive të sektorit publik, skemat e ndarjes së fitimit janë shumë më pak të zakonshme në sektorin publik sesa për njësitë ekonomike të orientuara drejt fitimit. Megjithatë, ato ka gjasa të jenë një aspekt i shpërblimit të punonjësve në segmente të njësive të sektorit publik që operojnë në baza komerciale. Disa njësi të sektorit publik mund të mos operojnë skema të ndarjes së fitimeve, por mund të vlerësojnë performancën kundrejt masave të bazuara financiarisht si gjenerimi i flukseve të të ardhurave dhe arritja e objektivave buxhetore. Disa skema bonusi mund të përfshijnë pagesa për të gjithë punonjësit që kanë kryer shërbime punësimi në një periudhë raportimi, edhe pse ata mund të jenë larguar nga njësia përpara përfundimit të periudhës së raportimit. Megjithatë, sipas skemave të tjera të bonusit, punonjësit marrin pagesa vetëm nëse qëndrojnë me njësinë për një periudhë të specifikuar, për shembull, një kërkesë që punonjësit të kryejnë shërbime për të gjithë periudhën e raportimit. Skema të tillë

krijojnë një detyrim konstruktiv pasi punonjësit kryejnë shërbime që rritin shumën për t'u paguar nëse ata qëndrojnë në shërbim deri në fund të periudhës së specifikuar. Matja e këtyre detyrimeve konstruktive pasqyron mundësinë që disa punonjës mund të largohen pa marrë pagesa për ndarjen e fitimit. Paragrafi 22 jep kushte të mëtejshme që duhet të plotësohen përpara se një njësi të mund të njohë koston e pritshme të pagesave të lidhura me performancën, pagesave të bonusit, dhe pagesave të ndarjes së fitimit.

21. Një njësi mund të mos ketë detyrim ligjor për të paguar një bonus. Megjithatë, në disa raste, një njësi ka një praktikë të pagesës së bonuseve. Në raste të tilla, njësi ka një detyrim konstruktiv sepse njësi nuk ka alternativë reale përveçse të paguajë bonusin. Matja e detyrimit konstruktiv pasqyron mundësinë që disa punonjës të largohen pa marrë bonus.
22. Një njësi mund të bëjë një vlerësim të besueshëm të detyrimit të saj ligjor ose konstruktiv sipas një skeme pagese të lidhur me performancën, skemën e bonusit, ose skemën e ndarjes së fitimit kur, dhe vetëm kur:
  - (a) Kushtet formale të skemës përmbajnë një formulë për përcaktimin e shumës së përfitimit;
  - (b) Njësi përcakton shumat që duhen paguar përpara se pasqyrat financiare të autorizohen për publikim; ose
  - (c) Praktika e kaluar jep evidencë të qartë të shumës së detyrimit konstruktiv të njësisë.
23. Një detyrim sipas skemave të ndarjes së fitimit dhe skemave të bonusit rezulton nga shërbimi i punonjësve dhe jo nga një transaksion me pronarët e njësisë. Prandaj, një njësi njeh koston e skemave të ndarjes së fitimit dhe bonusit jo si një shpërndarje fitimi, por si një shpenzim.
24. Nëse pagesat e ndarjes së fitimit dhe bonusit nuk pritet të shlyhen plotësisht përpara dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës së raportimit në të cilën punonjësit kryejnë shërbimin përkatës, këto pagesa janë përfitime të tjera afatgjata të punonjësve (shih paragrafët 155-161).

### **Dhënia e Informacioneve Shpjeguese**

25. Megjithëse ky Standard nuk kërkon paraqitje informacionesh specifike për përfitimet afatshkurtra të punonjësve, Standarde të tjerë mund të kërkojnë paraqitje informacionesh. Për shembull, SNKSP 20 kërkon dhënien e informacioneve për shpërblimin e përgjithshëm të personelit drejtues kryesor dhe SNKSP 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* kërkon dhënien e informacioneve për shpenzimet e përfitimeve të punonjësve.

## **Përfitimet Pas Punësimit—Dallimi ndërmjet Skemave me Kontribute të Përcaktuara dhe Skemave me Përfitime të Përcaktuara**

26. Përfitimet pas punësimit përfshijnë zëra të tillë si:
- (a) Përfitimet e pensionit (p.sh., pensionet dhe pagesat e menjëhershme në momentin e daljes në pension); dhe
  - (b) Përfitime të tjerë pas punësimit, si sigurimi i jetës pas punësimit, dhe kujdesi mjekësor pas punësimit.
- Marrëveshjet sipas të cilave një njësi jep përfitime pas punësimit janë skema të përfitimeve pas punësimit. Një njësi zbaton këtë Standard për të gjitha marrëveshjet e tilla, pavarësisht nëse ato përfshijnë ose jo krijimin e një njësie të veçantë, të tillë si një skema pensionesh, skema mbi pensionin, ose skema të përfitimeve të pensionit, për të grumbulluar kontribute dhe për të paguar përfitime.
27. Skemat e përfitimeve pas punësimit klasifikohen si skema me kontribute të përcaktuara ose skema me përfitime të përcaktuara, në varësi të thelbit ekonomik të skemës, që burojnë nga termat dhe kushtet e tyre kryesore.
28. Sipas skemave me kontribut të përcaktuar, detyrimi ligjor ose konstruktiv i njësisë është i kufizuar deri në shumën që njësia pranon të kontribuojë në atë skemë. Kështu, shumta e përfitimeve pas punësimit që përfiton punonjësi përcaktohet nga shumta e kontributeve të paguara nga njësia (ndoshta edhe nga punonjësi) në një fond përfitimesh të pas-punësimit ose në një kompani sigurimesh, së bashku me fitimet e investimeve që krijohen nga kontributet e paguara ndër vite. Si pasojë, rreziku aktuarial (që përfitimet mund të jenë më të vogla se sa pritej) dhe rreziku i investimit (që aktivet e investuara do të jenë të pamjaftueshme për të përmbushur përfitimet e pritshme) në thelb, janë mbi punonjësin.
29. Shembuj të rasteve kur detyrimi i një njësie nuk kufizohet vetëm në shumën që ajo pranon të kontribuojë në fond janë kur njësia ka një detyrim ligjor ose konstruktiv shtesë nëpërmjet:
- (a) Një formulë të përfitimeve të skemës që nuk lidhet vetëm me shumën e kontributeve por kërkon që njësia të japë kontribute të mëtejshme nëse aktivet janë të pamjaftueshme për të përmbushur përfitimet në formulën e përfitimeve të skemës;
  - (b) Një garancie, në mënyrë indirekte nëpërmjet një skeme ose drejtpërdrejt, të një fitimi të specifikuar nga kontributet; ose
  - (c) Njëpërmjet atyre praktikave informale që krijojnë një detyrim konstruktiv. Për shembull, një detyrim konstruktiv mund të krijohet

kur një njësi ka një histori të rritjes së përfitimeve për ish-punonjësit për të mbajtur ritmin me inflacionin, edhe kur nuk ka asnjë detyrim ligjor për ta bërë këtë.

30. Sipas skemave me përfitimeve të përcaktuara:
- (a) Detyrimi i njësisë është të sigurojë përfitimet e dakordësuara për punonjësit aktualë dhe të mëparshëm; dhe
  - (b) Rreziku aktuarial (që përfitimet do të kushtojnë më shumë se sa pritej) dhe rreziku i investimit në thelb, bien mbi njësinë. Nëse ecuria aktuariale ose ecuria e investimit është më keq se sa pritej, detyrimi i njësisë mund të rritet.
31. Paragrafët 32–51 shpjegojnë dallimin ndërmjet skemave me kontribute të përcaktuara dhe skemave me përfitime të përcaktuara në kontekstin e skemave me shumë punëdhënës, skemave me përfitime të përcaktuara që ndajnë rreziqet ndërmjet njësive nën kontrollin e përbashkët, skemave shtetërore dhe përfitimeve të siguruara.

#### **Skemat me Shumë Punëdhënës**

32. **Një njësi duhet të klasifikojë një skemë me shumë punëdhënës si një skemë me kontribute të përcaktuara ose një skemë me përfitime të përcaktuara sipas kushteve të skemës (duke përfshirë çdo detyrim konstruktiv që shkon përtej kushteve formale).**
33. **Nëse një njësi merr pjesë në një skemë me përfitime të përcaktuara me shumë punëdhënës, përveç rasteve kur zbatohet paragrafi 34, ajo do të:**
- (a) **Njohë pjesën e saj proporcionale të detyrimit për përfitimet e përcaktuara, aktivet e skemës dhe koston e shoqëruar me skemën në të njëjtën mënyrë si për çdo skemë tjetër me përfitime të përcaktuara; dhe**
  - (b) **Paraqesë informacionin e kërkuar nga paragrafët 137–150 (duke përfshirë paragrafin 150(d)).**
34. **Kur informacioni i mjaftueshëm nuk disponohet për të përdorur kontabilizimin e përfitimeve të përcaktuara për një skemë me përfitime të përcaktuara me shumë punëdhënës, një njësi do të:**
- (a) **Njohë skemën në përputhje me paragrafët 53 dhe 54 sikur të ishte një skemë me kontribute të përcaktuara; dhe**
  - (b) **Paraqesë informacionin e kërkuar nga paragrafi 150.**
35. Një shembull i një skeme me përfitime të përcaktuara me shumë punëdhënës është ai ku:

- (a) Skema financohet mbi bazën e pagesës sipas progresit: kontributet vendosen në një nivel që pritet të jetë i mjaftueshëm për të paguar përfitimet që duhet të paguhen në të njëjtën periudhë; dhe përfitimet e ardhshme të fituara gjatë periudhës aktuale do të paguhen nga kontributet e ardhshme; dhe
- (b) Përfitimet e punonjësve përcaktohen nga kohëzgjatja e shërbimit të tyre dhe njësitë pjesëmarrëse nuk kanë mjete reale për t'u tërhequr nga skema pa paguar një kontribut për përfitimet e fituara nga punonjësit deri në datën e tërheqjes. Një skemë e tillë krijon rrezik aktuarial për njësinë: nëse kostoja përfundimtare e përfitimeve të fituara më parë në fund të periudhës së raportimit është më shumë se sa pritej, njësia do të duhet ose të rrisë kontributet e saj ose të bindë punonjësit të pranojnë një reduktim të përfitimeve. Prandaj, një skemë e tillë është një skemë përfitimesh të përcaktuara.

36. Kur ka informacion të mjaftueshëm për një skemë me përfitime të përcaktuara me shumë punëdhënës, një njësi kontabilizon pjesën e saj proporcionale të detyrimit të përfitimeve të përcaktuara, aktiveve të skemës, dhe koston së përfitimit të pas-punësisimit të shoqëruar me skemën në të njëjtën mënyrë si për çdo skemë tjetër me përfitime të përcaktuara. Megjithatë, një njësi mund të mos jetë në gjendje të identifikojë pjesën e vet në pozicionin financiar dhe performancën e skemës me besueshmëri të mjaftueshme për qëllime të kontabilitetit. Kjo mund të ndodhë nëse:

- (a) Skema i ekspozon njësitë pjesëmarrëse ndaj rreziqeve aktuariale që shoqërohen me punonjësit aktualë dhe të mëparshëm të njësive të tjera, me rezultatin që nuk ka bazë të qëndrueshme dhe të besueshme për alokimin e detyrimit, të aktiveve të skemës dhe koston për njësitë individuale që marrin pjesë në skemë; ose
- (b) Njësia nuk ka qasje për informacion të mjaftueshëm rreth skemës që plotëson kërkesat e këtij Standardi.

Në ato raste, një njësi kontabilizon skemën sikur të ishte një skemë me kontribute të përcaktuara, dhe jep informacion shtesë të kërkuar nga paragrafi 150.

37. Mund të ketë një marrëveshje kontraktuale midis skemës me disa punëdhënës dhe pjesëmarrësve të saj, e cila përcakton se si defiçiti në skemë do t'u shpërndahet pjesëmarrësve (ose si defiçiti do të financohet). Një pjesëmarrës në një skemë me shumë punëdhënës me një marrëveshje të tillë që kontabilizon skemën si një skemë me kontribute të përcaktuara në përputhje me paragrafin 34 do të njohë aktivin ose detyrimin që lind nga marrëveshja kontraktuale dhe të ardhurat ose shpenzimet që rezultojnë në defiçit ose defiçit.

38. Skemat me shumë punëdhënës janë të dallueshëm nga skemat e administrimit në grup. Skema e administrimit në grup është thjesht një grupim i skemave të një punëdhënësi të vetëm të kombinuar për të lejuar punëdhënësit pjesëmarrës të bashkojnë aktivet e tyre për qëllime investimi dhe të reduktojnë menaxhimin e investimeve dhe kostot e administrimit, por pretendimet e punëdhënësve të ndryshëm ndahen për përfitimin e vetëm të punonjësve të tyre. Skemat e administrimit në grup nuk paraqesin probleme të veçanta kontabël sepse informacioni është lehtësisht i disponueshëm për t'i trajtuar ata në të njëjtën mënyrë si çdo skemë tjetër i një punëdhënësi të vetëm dhe sepse skema të tillë nuk i ekspozojnë njësitë pjesëmarrëse ndaj rreziqeve aktuariale që shoqërohen me punonjësit aktualë dhe të mëparshëm të njësive të tjera. Përkufizimet në këtë Standard kërkojnë që një njësi të klasifikojë një skemë administrimi në grup si një skemë me kontribute të përcaktuara ose një skemë me përfitime të përcaktuara në përputhje me kushtet e skemës (duke përfshirë çdo detyrim konstruktiv që shkon përtej kushteve formale).
39. **Në përcaktimin se kur duhet njohur, dhe si duhet matur, një detyrim në lidhje me mbylljen e një skeme me përfitime të përcaktuara me shumë punëdhënës, ose tërheqjen e njësisë nga një skemë me përfitime të përcaktuara me shumë punëdhënës, një njësi do të zbatojë SNKSP 19, *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara.***

Skemat e Përfitimeve të Përcaktuara që Ndajnë Rreziqet ndërmjet Njësive nën Kontroll të Përbashkët

40. Skemat me përfitime të përcaktuara që ndajnë rreziqet ndërmjet njësive të ndryshme nën kontroll të përbashkët, për shembull, njësitë kontrolluese dhe të kontrolluara, nuk janë skema me shumë punëdhënës.
41. Një njësi që merr pjesë në një skemë të tillë merr informacion për skemën në tërësi, të matur në përputhje me këtë Standard, mbi bazën e supozimeve që zbatohen për skemën në tërësi. Nëse ka një marrëveshje kontraktuale, marrëveshje detyruese, ose politike të deklaruar për ngarkimin e kostos neto të përfitimit të përcaktuar për skemën në tërësi, e matur në përputhje me këtë Standard për njësitë individuale brenda njësisë ekonomike, njësia, në pasqyrat e saj financiare të veçanta ose individuale, do të njohë koston neto të përfitimit të përcaktuar të shkaktuar në këtë mënyrë. Nëse nuk ka një marrëveshje, një rregullim, ose një politikë të tillë, kostoja neto e përfitimit të përcaktuar do të njihet në pasqyrat financiare të veçanta ose individuale të njësisë që është ligjërisht punëdhënësi sponsorizues për skemën. Njësitë e tjera, në pasqyrat e tyre financiare të veçanta ose individuale, do të njohin një

kosto të barabartë me kontributin e tyre të pagueshëm për periudhën.

42. Ka raste në sektorin publik ku një njësi kontrolluese dhe një ose më shumë njësi të kontrolluara marrin pjesë në një skemë përfitimesh të përcaktuara. Përveç rasteve kur ka një marrëveshje kontraktuale, marrëveshje detyruese, ose politikë të deklaruar, siç specifikohet në paragrafin 41, njësia e kontrolluar kontabilizon në bazë të kontributeve të përcaktuara dhe njësia kontrolluese kontabilizon sipas bazës me përfitime të përcaktuara në pasqyrat e saj financiare të konsoliduara. Njësia e kontrolluar gjithashtu jep informacion shpjegues se ajo kontabilizon në bazë të kontributit të përcaktuar në pasqyrat e saj financiare të veçanta. Një njësi e kontrolluar që kontabilizon sipas kontributit të përcaktuar jep gjithashtu detaje të njësisë kontrolluese dhe deklaron se, në pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë kontrolluese, kontabiliteti bëhet sipas bazës me përfitime të përcaktuara. Njësia e kontrolluar jep gjithashtu informacionet e kërkuara në paragrafin 151.
43. **Pjesëmarrja në një skemë të tillë është një transaksion i palës së ndërlidhur për çdo njësi individuale. Prandaj, një njësi ekonomike, në pasqyrat e saj financiare të veçanta ose individuale, duhet të japë informacion e kërkuar nga paragrafi 151.**

#### Skemat Shtetërore

44. **Një njësi do të kontabilizojë një skemë shtetërore në të njëjtën mënyrë si për një skemë me shumë punëdhënës (shih paragrafët 32 dhe 39).**
45. Skemat shtetërore përcaktohen me legjislacion për të mbuluar të gjitha njësitë (ose të gjitha njësitë në një kategori të caktuar, për shembull, një industri specifike) dhe operohen nga qeveria kombëtare, shtetërore, ose lokale ose nga një organ tjetër (për shembull, një agjenci e krijuar posaçërisht për këtë qëllim). Ky Standard trajton vetëm përfitimet e punonjësve të njësisë dhe nuk adreson kontabilitetin për ndonjë detyrim sipas skemave shtetërore që lidhen me punonjësit dhe punonjësit e kaluar të njësisve që nuk kontrollohen nga njësia raportuese. Ndërkohë që qeveritë mund të krijojnë skema shtetërore dhe të japin përfitime për punonjësit e njësisve të sektorit privat dhe/ose individët e vetëpunësuar, detyrimet që lindin në lidhje me skema të tilla nuk adresohen në këtë Standard. Disa skema të krijuar nga një njësi japin përfitime të detyrueshme, si zëvendësim për përfitimet që përndryshe do të mbuloheshin nga një skemë shtetërore, ashtu edhe përfitime vullnetare shtesë. Skema të tillë nuk janë skema shtetërore.
46. Shumë skema shtetërore financohen në bazë të pagesës sipas progresit: kontributet vendosen në një nivel që pritet të jetë i

mjaftueshëm për të paguar përfitimet e kërkuara që duhet të paguhen në të njëjtën periudhë; përfitimet e ardhshme të fituara gjatë periudhës aktuale do të paguhen nga kontributet e ardhshme. Njësitë e mbuluara nga skemat shtetërore i kontabilizojnë ato skema ose si skema kontributesh të përcaktuara ose si skema përfitimesh të përcaktuara. Trajtimi kontabël varet nëse njësia ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar përfitimet e ardhshme. Nëse detyrimi i vetëm i një njësie është të paguajë kontributet në kohën e duhur, dhe njësia nuk ka ndonjë detyrim për të paguar përfitimet e ardhshme, ajo e kontabilizon atë skemë shtetërore si një skemë me kontribute të përcaktuara.

47. Një skemë shtetërore mund të klasifikohet si një skemë kontributesh të përcaktuar nga një njësi e kontrolluar. Megjithatë, është një supozim i kundërshtueshëm që skema shtetërore do të karakterizohet si një skemë përfitimesh të përcaktuara nga njësia kontrolluese. Kur ky supozim kundërshtohet, skema shtetërore kontabilizohet si një skemë kontributesh të përcaktuar.

#### **Përfitimet e Siguruara**

48. **Një njësi mund të paguajë primet e sigurimit për të financuar një skemë përfitimesh të pas-punësimit. Njësia do ta trajtojë një skemë të tillë si një skemë me kontribute të përcaktuara, përveç rastit kur njësia do të ketë (drejtpërdrejt ose indirekt nëpërmjet skemës) një detyrim ligjor ose konstruktiv ose:**

- (a) **Të paguajë drejtpërdrejt përfitimet e punonjësve kur atyre u vjen afati; ose**
- (b) **Të paguajë shuma të mëtejshme nëse siguruesi nuk paguan të gjitha përfitimet e ardhshme të punonjësve në lidhje me shërbimin e punonjësve në periudhat aktuale dhe ato të mëparshme.**

**Nëse njësia pranon një detyrim të tillë ligjor ose konstruktiv, njësia do ta trajtojë skemën si një skemë me përfitime të përcaktuara.**

49. Përfitimet e siguruara nga një policë siguracioni nuk duhet të kenë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë ose automatike me detyrimin e njësisë për përfitimet e punonjësve. Skemat e përfitimeve pas-punësimit që kanë të bëjnë me skema sigurimi i nënshtrohen të njëjtit dallim ndërmjet kontabilitetit dhe financimit si skemat e tjerë të financuar.
50. Kur një njësi financon një detyrim të përfitimit pas-punësimit duke kontribuar në një skemë sigurimi sipas të cilit njësia (ose drejtpërdrejt, indirekt nëpërmjet skemës, nëpërmjet mekanizmit për caktimin e primeve të ardhshëm, ose nëpërmjet një marrëdhënieje të palës me siguruesin) ruan një detyrim ligjor ose konstruktiv, pagesa e primeve nuk përbën një



marrëveshje kontributi të përcaktuar. Nga kjo rezulton se njësia:

- (a) Kontabilizon një policë siguracioni të kualifikuar si një aktiv të skemës (shih paragrafin 8); dhe
- (b) Njeh policat e tjera të siguracionit si të drejta rimbursimi (nëse policat plotësojnë kriteret në paragrafin 118).

51. Kur një policë sigurimi është në emër të një pjesëmarrësi të caktuar të skemës ose një grupi pjesëmarrësish në skemë, dhe njësia nuk ka ndonjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të mbuluar ndonjë humbje për policën e sigurimit, njësia nuk ka ndonjë detyrim për të paguar përfitime për punonjësit, dhe siguruksi ka përgjegjësinë e vetme për pagesën e përfitimeve. Pagesa e primeve fikse sipas kontratave të tilla në thelb, është shlyerja e detyrimit të përfitimit të punonjësve, dhe jo një investim për të përmbushur detyrimin. Si konsekuencë, njësia nuk ka më një aktiv ose një detyrim. Prandaj, një njësi i trajton këto pagesa si kontribute në një skemë me kontribute të përcaktuara.

### **Përfitimet Pas Punësimit—Skemat me Kontribute të Përcaktuara**

52. Kontabilizimi për skemat e kontributeve të përcaktuara është i thjeshtë sepse detyrimi i njësisë raportuese për çdo periudhë përcaktohet nga shumat që do të kontribuohen për atë periudhë. Si konsekuencë, nuk kërkohen supozime aktuariale për të matur detyrimin ose shpenzimin, dhe nuk ka asnjë mundësi për ndonjë fitim ose humbje aktuariale. Për më tepër, detyrimet maten mbi një bazë të paskontuar, përveç rasteve kur ata nuk priten të shlyhen plotësisht përpara dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës raportuese në të cilën punonjësit kryejnë shërbimin përkatës.

### **Njohja dhe Matja**

53. Kur një punonjës ka kryer shërbim për një njësi gjatë një periudhe, njësia do të njohë kontributin e pagueshëm në një skemë kontributesh të përcaktuara në këmbim të atij shërbimi:
- (a) Si një detyrim (shpenzim i llogaritur i akumuluar), pas zbritjes së çdo kontributi të paguar më parë. Nëse kontributi i paguar më parë tejkalon kontributin për tu paguar për shërbimin përpara fundit të periudhës së raportimit, një njësi do ta njohë atë tepëri si një aktiv (shpenzim i parapaguar) në masën që parapagimi do të çojë, për shembull, në një reduktim të pagesave të ardhshme ose një rimbursim monetar; dhe
  - (b) Si një shpenzim, përveç rastit kur një Standard tjetër kërkon ose lejon përfshirjen e kontributit në koston e një aktivi (shih,

**për shembull, SNKSP 12 dhe SNKSP 17).**

54. **Kur kontributet në një skemë kontributesh të përcaktuara nuk pritet të shlyhen plotësisht përpara dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës raportuese në të cilën punonjësit kryejnë shërbimin përkatës, ata do të zbriten duke përdorur normën e zbritjes të specifikuar në paragrafin 85.**

Dhënia e Informacioneve Shpjeguese

55. **Një njësi do të paraqesë informacion për shumën e njohur si shpenzim për skemat me kontribute të përcaktuara.**
56. Aty ku kërkohet nga SNKSP 20, një njësi do japë informacion për kontributet në skemat me kontribute të përcaktuara për personelin drejtues kryesor.

### **Përfitimet Pas Punësimit—Skemat me Përfitime të Përcaktuara**

57. Kontabiliteti për skemat me përfitime të përcaktuara është kompleks, sepse kërkohen supozime aktuariale për të matur detyrimin dhe shpenzimin, dhe ekziston mundësia e fitimeve dhe humbjeve aktuariale. Për më tepër, detyrimet maten mbi një bazë të skontuar, sepse ata mund të shlyhen shumë vite pasi punonjësit të kryejnë shërbimin përkatës.

### **Njohja dhe Matja**

58. Skemat me përfitime të përcaktuara mund të jenë të pafinancuara, ose ato mund të financohen tërësisht ose pjesërisht nga kontributet e një njësie, dhe nganjëherë punonjësit e saj, drejt një njësie ose fondi, që është ligjërisht e ndarë nga njësia raportuese dhe nga i cili paguhen përfitimet e punonjësve. Paguesa e përfitimeve të financuara kur ajo duhet të paguhet varet jo vetëm nga pozicioni financiar dhe performanca e investimit të fondit, por edhe nga aftësia dhe vullneti i një njësie për të korigjuar çdo mungesë në aktivet e fondit. Prandaj, njësia është, në thelb, duke marrë përsipër rreziqet aktuariale dhe të investimit që lidhen me skemën. Rrjedhimisht, shpenzimi i njohur për një skemë me përfitime të përcaktuara nuk është domosdoshmërisht shuma e kontributit që duhet paguar për periudhën.
59. Pasqyrimi në kontabilitet që u bën një njësi ekonomike skemave me përfitime të përcaktuara ndjek këto hapa:
- (a) Përcaktimin e defiçitit ose sufiçitit. Ky përfshin:
    - (i) Përdorimin e një teknike aktuariale, metodën e kreditimit të njësisë matëse të projektuar, për të bërë një vlerësim të besueshëm të kostos përfundimtare për njësinë ekonomike të përfitimt që punonjësit kanë fituar në këmbim të shërbimit

- të tyre në periudhat aktuale dhe ato të mëparshme (shih paragrafët 69–71). Kjo kërkon që një njësi ekonomike të përcaktojë se sa përfitime i atribuohen periudhave aktuale dhe atyre të mëparshme (shih paragrafët 72-76) dhe të bëjë vlerësime (supozime aktuariale) rreth kushteve demografikë (të tillë si qarkullimi, largimi dhe zëvendësimi i punonjësve dhe vdekshmëria) dhe kushteve financiare (si p.sh. rritjet e ardhshme të pagave dhe kostove mjekësore) që do të ndikojnë në koston e përfitimit (shih paragrafët 77–100);
- (ii) Skontimin e atij përfitimi për të përcaktuar vlerën aktuale të detyrimit të përfitimit të përcaktuar dhe koston aktuale të shërbimit (shih paragrafët 69–71 dhe 85–88);
  - (iii) Zbritjen e vlerës së drejtë të çdo aktivi të skemës (shih paragrafët 115–117) nga vlera aktuale e detyrimit për përfitimet e përcaktuara;
- (b) Përcaktimin e shumës së detyrimit (aktivit) neto të përfitimeve të përcaktuara si shumë e defiçitit ose sufiçitit të përcaktuar në pikën (a), rregulluar për çdo efekt të limitimit të një aktivi neto të përfitimeve të përcaktuara në kufirin e sipërm të aktivit (shih paragrafin 66).
- (c) Përcaktimin e shumave që do të njihen në sufiçit ose defiçit:
- (i) Koston aktuale të shërbimit (shih paragrafët 72–76 dhe paragrafin 124A).
  - (ii) Çdo kosto të shërbimit të kaluar dhe fitim ose humbje nga shlyerja (shih paragrafët 101–114).
  - (iii) Interesi neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara (shih paragrafët 125–128).
- (d) Përcaktimin e rimatjeve të detyrimit (aktivit) neto të përfitimeve të përcaktuara, që duhet të njihet në aktivet/kapitalin neto, duke përfshirë:
- (i) Fitimet dhe humbjet aktuariale (shih paragrafët 130 dhe 131);
  - (ii) Fitimet nga aktivet e skemës, duke përfshirë shumën e përfshira në interesin neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara (shih paragrafin 132); dhe
  - (iii) Çdo ndryshim në efektin e kufirit të sipërm të aktivit (shih paragrafin 66), duke përfshirë shumën e përfshira në interesin neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara.

Kur një njësi ka më shumë se një skemë përfitimesh të përcaktuara,

njësia i zbaton këto procedura për secilën skemë me peshë të rëndësishme veçmas.

60. **Një njësi do të përcaktojë detyrimin (aktivin) neto të përfitimit të përcaktuar me rregullsi të mjaftueshme që shumat e njohura në pasqyrat financiare të mos ndryshojnë materialisht nga shumat që do të përcaktoheshin në fund të periudhës së raportimit.**
61. Ky Standard inkurajon, por nuk kërkon, që një njësi të përfshijë një aktuar të kualifikuar në matjen e të gjitha detyrimeve materiale të përfitimeve pas punësimit. Për arsye praktike, një njësi mund të kërkojë nga një aktuar i kualifikuar të kryejë një vlerësim të detajuar të detyrimit përpara fundit të periudhës së raportimit. Megjithatë, rezultatet e këtij vlerësimi përditësohen për çdo transaksion material dhe ndryshime të tjera materiale në rrethanat (duke përfshirë ndryshimet në çmimet e tregut dhe normat e interesit) deri në fund të periudhës së raportimit.
62. Në disa raste, vlerësimet, mesataret, dhe rrugët e shkurtra llogaritëse mund të ofrojnë një përafrim të besueshëm të llogaritjeve të detajuara të ilustruara në këtë Standard.

#### *Kontabilitetit për Detyrimin Konstruktiv*

63. **Një njësi do të kontabilizojë jo vetëm detyrimin e saj ligjor sipas kushteve formale të një skeme me përfitime të përcaktuara, por edhe për çdo detyrim konstruktiv që lind nga praktikat joformale të njësisë. Praktikant joformale krijojnë një detyrim konstruktiv ku njësisia nuk ka alternativë reale përveç pagesës së përfitimeve të punonjësve. Një shembull i një detyrimi konstruktiv është kur një ndryshim në praktikat informale të njësisë do të shkaktonte dëme të papranueshme në marrëdhënien e saj me punonjësit.**
64. Kushtet formale të një skeme përfitimesh të përcaktuara mund të lejojnë një njësi të përfundojë detyrimin e saj sipas skemës. Megjithatë, zakonisht është e vështirë për një njësi të përfundojë detyrimin e saj sipas një skeme (pa pagesë) nëse punonjësit do të mbahen. Prandaj, në mungesë të evidencës për të kundërtën, kontabilizimi i përfitimeve pas punësimit supozon se një njësi që aktualisht po premtim përfitime të tilla do të vazhdojë ta bëjë këtë gjatë jetës së mbetur të punës së punonjësve.

#### *Pasqyra e Pozicionit Financiar*

65. **Një njësi do të njohë detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara në pasqyrën e pozicionit financiar..**
66. **Kur një njësi ka një suficit në një skemë përfitimesh të përcaktuara, ajo do të masë aktivin neto të përfitimeve të përcaktuara me më të**

**voglën prej:**

- (a) **Suficitit në skemën e përfitimeve të përcaktuara; dhe**
- (b) **Kufirit të sipërm të aktivit, të përcaktuar duke përdorur normën e zbritjes së specifikuar në paragrafin 85.**

67. Një aktiv neto i përfitimeve të përcaktuara mund të krijohet kur një skemë përfitimesh të përcaktuara është mbifinancuar ose kur janë krijuar fitime aktuariale. Një njësi njuh një aktiv neto të përfitimeve të përcaktuara në raste të tilla sepse:

- (a) Njësia kontrollon një burim, i cili është aftësia për të përdorur suficitin për të gjeneruar përfitime të ardhshme;
- (b) Ky kontroll është rezultat i ngjarjeve të kaluara (kontributet e paguara nga njësia dhe shërbimi i kryer nga punonjësi); dhe
- (c) Përfitimet e ardhshme ekonomike janë të disponueshëm për njësinë në formën e një reduktimi në kontributet e ardhshme ose një rimbursimi monetar, qoftë drejtpërdrejt për njësinë ose në mënyrë indirekte për një skemë tjetër me defçit. Kufiri i sipërm i aktivit është vlera aktuale e atyre përfitimeve të ardhshme.

**Njohja dhe Matja—Vlera Aktuale e Detyrimeve për Përfitime të Përcaktuara dhe Kostoja Aktuale e Shërbimit**

68. Kostoja përfundimtare e një skeme përfitimesh të përcaktuara mund të ndikohet nga shumë variabla, të tilla si pagat përfundimtare, qarkullimi dhe vdekshmëria e punonjësve, kontributet e punonjësve dhe tendencat e kostos mjekësore. Kostoja përfundimtare e skemës është e pasigurt dhe kjo pasiguri ka gjasa të vazhdojë për një periudhë të gjatë kohore. Për të matur vlerën aktuale të detyrimeve për përfitime të pas-punësimit dhe koston e shërbimit aktual përkatës, është e nevojshme:

- (a) Të aplikohet një metodë vlerësimi aktuarial (shih paragrafët 69–71);
- (b) T'u atribuohen përfitimet periudhave të shërbimit (shih paragrafët 72–76); dhe
- (c) Të bëhen supozime aktuariale (shih paragrafët 77–100).

*Metoda e Vlerësimit Aktuarial*

69. **Një njësi ekonomike përdor metodën e kreditimit për njësi të projektuar për të përcaktuar vlerën aktuale të detyrimeve të veta për përfitimet e përcaktuara dhe koston përkatëse të shërbimit aktual**

**dhe, nëse ka, koston e shërbimit të shkuar.**

70. Metoda e kreditit për njësi të projektuar (ndonjëherë e njohur si metoda e përfitimit të akumuluar të alokuar sipas shërbimit ose si metoda e përfitimit/viteve të shërbimit) e sheh çdo periudhë shërbimi si të tillë që krijon një njësi (matëse) shtesë të së drejtës së përfitimit (shih paragrafët 72-76) dhe mat çdo njësi veç për të ndërtuar detyrimin përfundimtar (shih paragrafët 77–100).
71. Një njësi zbrit të gjithë detyrimin e përfitimit pas punësimit, edhe nëse një pjesë e detyrimit pritet të shlyhet përpara dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit.

*Lidhja e Përfitimit me Periudhat e Shërbimit*

72. **Në përcaktimin e vlerës aktuale të detyrimeve të saj të përfitimeve të përcaktuara dhe koston së shërbimit aktual përkatës dhe, kur është e zbatueshme, koston së shërbimit të kaluar, një njësi do t'i atribuojë përfitimet periudhave të shërbimit sipas formulës së përfitimit të skemës. Megjithatë, nëse shërbimi i një punonjësi në vitet e mëvonshme do të çojë në një nivel materialisht më të lartë përfitimi se në vitet e mëparshme, një njësi duhet t'i atribuojë përfitimet në bazë lineare nga:**
- (a) **Data kur shërbimi nga punonjësi për herë të parë çon në përfitime sipas skemës (nëse përfitimet janë të kushtëzuara nga shërbimi i mëtejshëm) deri në**
  - (b) **Datën kur shërbimi i mëtejshëm nga punonjësi nuk do të çojë në ndonjë shumë materiale përfitimesh të mëtejshme sipas skemës, të ndryshme nga rritjet të mëtejshme të pagave.**
73. Metoda e kreditit të projektuar për njësi kërkon që një njësi (ekonomike) t'i atribuojë përfitimet periudhës aktuale (për të përcaktuar koston aktuale të shërbimit) dhe periudhat aktuale dhe ato të mëparshme (në mënyrë që të përcaktojë vlerën aktuale të detyrimeve të përfitimeve të përcaktuara). Një njësi (ekonomike) ia atribuon përfitimet periudhave në të cilat lind detyrimi për të dhënë përfitime pas punësimit. Ky detyrim lind kur punonjësit kryejnë shërbime në këmbim të përfitimeve pas punësimit që një njësi pret të paguajë në periudhat e ardhshme të raportimit. Teknikat aktuariale lejojnë një njësi të masë atë detyrim me besueshmëri të mjaftueshme për të justifikuar njohjen e një detyrimi.
74. Shërbimi i punonjësit krijon një detyrim sipas një skeme përfitimesh të përcaktuara edhe nëse përfitimet kushtëzohen nga punësimi i ardhshëm (me fjalë të tjera ato nuk janë të garantuara). Shërbimi i punonjësit përpara datës kur ato bëhen të garantuara krijon një detyrim konstruktiv sepse, në fund të çdo periudhe raportimi të njëpasnjëshme, shumat e

shërbimit të ardhshëm që një punonjës do të duhet të kryejë përpara se të ketë të drejtën e përfitimit zvogëlohet. Në matjen e detyrimit të saj të përfitimeve të përcaktuara, një njësi merr në konsideratë probabilitetin që disa punonjës mund të mos plotësojnë ndonjë kërkesë garancie (të bërjes së përfitimeve të garantuara). Në mënyrë të ngjashme, megjithëse disa përfitime pas punësimit, për shembull, përfitimet mjekësore pas punësimit, bëhen të pagueshme vetëm nëse ndodh një ngjarje e caktuar kur një punonjës nuk është më i punësuar, një detyrim krijohet kur punonjësi kryen shërbimin që do të japë të drejtën për përfitim nëse ndodh ngjarja e specifikuar. Probabiliteti që ngjarja e specifikuar do të ndodhë ndikon në matjen e detyrimit, por nuk përcakton nëse detyrimi ekziston.

75. Detyrimi rritet deri në datën kur shërbimi i mëtejshëm nga punonjësi nuk do të çojë në ndonjë shumë materiale përfitimesh të mëtejshme. Prandaj, të gjitha përfitimet i atribuohen periudhave që përfundojnë në ose përpara asaj date. Përfitimi i atribuohet periudhave kontabël individuale sipas formulës së përfitimit të skemës. Megjithatë, nëse shërbimi i një punonjësi në vitet e mëvonshme do të çojë në një nivel materialisht më të lartë përfitimi se në vitet e mëparshme, një njësi i atribuon përfitimet në bazë lineare deri në datën kur shërbimi i mëtejshëm nga punonjësi nuk do të çojë në një shumë materiale përfitimesh të mëtejshme. Kjo për shkak se shërbimi i punonjësit gjatë gjithë periudhës përfundimisht do të çojë në përfitime në atë nivel më të lartë.
76. Kur shuma e një përfitimi është një pjesë konstante e pagës përfundimtare për çdo vit shërbimi, rritjet e ardhshme të pagave do të ndikojnë në shumën e kërkuar për të shlyer detyrimin që ekziston për shërbimin përpara përfundimit të periudhës së raportimit, por nuk krijojnë një detyrim shtesë. Prandaj:
- (a) Për qëllim të paragrafit 72(b), rritja e pagave nuk çon në përfitime të mëtejshme, edhe pse shuma e përfitimeve varet nga paga përfundimtare; dhe
  - (b) Shuma e përfitimit që i atribuohet çdo periudhe është një pjesë konstante e pagës me të cilën lidhet përfitimi.

### *Supozimet Aktuariale*

77. Supozimet aktuariale duhet të jenë të paanshme dhe të pajtueshme reciprokisht.
78. Supozimet aktuariale janë vlerësimet më të mira të një njësie për variablat që do të përcaktojnë koston përfundimtare të dhënies së përfitimeve pas punësimit. Supozimet aktuariale përfshijnë:

- (a) Supozime demografike për karakteristikat e ardhshme të punonjësve aktualë dhe atyre të mëparshëm (dhe atyre në varësi/ngarkim të tyre) të cilët kanë të drejtë për përfitime. Supozimet demografike merren me çështje të tilla si:
- (i) Vdekshmëria (shih paragrafët 83 dhe 84);
  - (ii) Treguesit e qarkullimit të punonjësve, e aftësisë së kufizuar, dhe daljes në pension të parakohshëm;
  - (iii) Pjesa e anëtarëve të skemës me persona në ngarkim që do të permbushin kriteret për përfitime;
  - (iv) Pjesa e anëtarëve të skemës që do të zgjedhin çdo opsion të formës së pagesës të disponueshëm sipas kushteve të skemës; dhe
  - (v) Ritmet e kërkesave për pagesë sipas skemave mjekësore.
- (b) Supozimet financiare, që kanë të bëjnë me elemente të tillë si:
- (i) Normën e skontimit (shih paragrafët 85–88);
  - (ii) Nivelet e përfitimeve, duke përfshirë çdo kosto të përfitimeve që duhet të plotësohen nga punonjësit, dhe pagën e ardhshme (shih paragrafët 89–97);
  - (iii) Në rastin e përfitimeve mjekësore, kostot e ardhshme mjekësore, duke përfshirë kostot e administrimit të kërkesave për pagesë (d.m.th., kostot që do të shkaktohen në përpunimin dhe zgjidhjen e kërkesave për pagesë, duke përfshirë tarifatat ligjore dhe të personave që përpunojnë ankesat) (shih paragrafët 98–100); dhe
  - (iv) Taksat e pagueshme nga skema për kontributet që lidhen me shërbimin përpara fundit të periudhës së raportimit ose mbi përfitimet që rezultojnë nga ai shërbim.

79. Supozimet aktuariale janë të paanshme nëse nuk janë as të pakujdesshme dhe as tepër konservatore.

80. Supozimet aktuariale janë reciprokisht të pajtueshme nëse pasqyrojnë marrëdhëniet ekonomike midis faktorëve të tillë si inflacioni, normat e rritjes së pagave dhe normat e skontimit. Për shembull, të gjitha supozimet që varen nga një nivel i caktuar inflacioni (siç janë supozimet për normat e interesit dhe rritjet e pagave dhe përfitimeve) në çdo periudhë të caktuar të ardhshme supozojnë të njëjtin nivel inflacioni në atë periudhë.

81. Një njësi përcakton normën e zbritjes dhe supozimet e tjera financiare në terma nominalë (të deklaruar), përveç rasteve kur vlerësimet në terma realë (të rregulluar për inflacionin) janë më të besueshëm, për shembull,



në një ekonomi hiperinflacioniste (shih SNKSP 10, *Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacioniste*), ose kur përfitimi është i lidhur me indeksin, dhe ka një treg të thellë të obligacioneve të lidhura me indeksin të së njëjtës monedhë dhe kusht/kohëzgjatje.

82. **Supozimet financiare do të bazohen në pritshmëritë e tregut, në fund të periudhës së raportimit, për periudhën gjatë së cilës do të shlyhen detyrimet.**

*Supozimet Aktuariale: Vdekshmëria*

83. **Një njësi do të përcaktojë supozimet e saj të vdekshmërisë duke iu referuar vlerësimit më të mirë të vdekshmërisë së anëtarëve të skemës, si gjatë ashtu edhe pas punësimit.**
84. Për të vlerësuar koston përfundimtare të përfitimit, një njësi merr në konsideratë ndryshimet e pritshme të vdekshmërisë, për shembull duke modifikuar tabelat standarde të vdekshmërisë me vlerësime të përmirësimeve të vdekshmërisë.

*Supozimet Aktuariale – Norma e Skontimit*

85. **Norma e përdorur për të skontuar detyrimet e përfitimeve pas punësimit (të financuara dhe të pafinancuara) do të pasqyrojë vlerën në kohë të parasë. Monedha dhe koha e instrumentit financiar të zgjedhur për të pasqyruar vlerën në kohë të parasë do të jenë në përputhje me monedhën dhe afatin e vlerësuar të detyrimeve të përfitimeve pas punësimit.**
86. Një supozim aktuarial që ka një efekt material është norma e skontimit. Norma e skontimit pasqyron vlerën monetare në kohë, por jo rrezikun aktuarial ose investues. Për më tepër, norma e skontimit nuk pasqyron rrezikun e kreditit specifik për njësinë të mbartur nga kreditorët e njësisë, dhe as nuk pasqyron rrezikun që eksperiencia e ardhshme mund të ndryshojë nga supozimet aktuariale.
87. Norma e skontimit pasqyron vlerësimin kohor të pagesave të përfitimeve. Në praktikë, një njësi shpesh e arrin këtë duke aplikuar një normë mesatare të ponderuar të vetme të skontimit që pasqyron kohën dhe shumën e vlerësuar të pagesave të përfitimeve, si dhe monedhën në të cilën do të paguhet përfitimet.
88. Një njësi (ekonomike) bën një gjykim nëse norma e skontimit që pasqyron vlerën monetare në kohë që përafrohet më së miri duke iu referuar normave të tregut në fund të periudhës së raportimit për obligacionet e qeverisë, obligacionet e korporatave me cilësi të lartë ose nga një instrument tjetër financiar. Në disa juridiksione, ajo çka ofron tregu në fund të periudhës së raportimit për obligacionet qeveritare do të

japë përafrimin më të mirë të vlerës në kohë të parasë. Megjithatë, mund të ketë juridiksione në të cilat ky nuk është rasti, për shembull, juridiksione ku nuk ka treg të thellë në obligacionet qeveritare, ose në të cilat normat e interesit në fund të periudhës së raportimit për obligacionet qeveritare nuk pasqyrojnë vlerën kohore të parasë. Në raste të tilla, njësi raportuese përcakton normën me një metodë tjetër, si p.sh. duke iu referuar asaj çka ofron tregu për obligacionet e korporatave me cilësi të lartë. Mund të ketë gjithashtu rrethana kur nuk ka treg të thellë në obligacionet e qeverisë ose obligacionet e korporatave me cilësi të lartë me një maturim mjaftueshëm të gjatë që të përputhet me maturimin e vlerësuar të të gjitha pagesave të përfitimeve. Në rrethana të tilla, një njësi përdor normat aktuale të tregut me kohëzgjatje të përshtatshme për të skontuar pagesat më afatshkurtëra, dhe vlerëson normën e skontimit për maturime më të gjata duke ekstrapoluar normat aktuale të tregut përgjatë kurbës së rendimentit të të ardhurave. Vlera totale aktuale e një detyrimi të përfitimeve të përcaktuara nuk ka gjasa të jetë veçanërisht sensitiv ndaj normës së skontimit të aplikuar për pjesën e përfitimeve që është e pagueshme përtej maturimit përfundimtar të instrumentit financiar të disponueshëm, si obligacionet qeveritare ose obligacionet e korporatave.

*Supozimet Aktuariale—Pagat, Përfitimet dhe Kostot Mjekësore*

89. **Një njësi do të masë detyrimet e saj të përfitimeve të përcaktuara sipas një baze që pasqyron:**
- (a) **Përfitimet e përcaktuara në kushtet e skemës (ose që rezultojnë nga ndonjë detyrim konstruktiv që shkon përtej atyre kushteve) në fund të periudhës së raportimit;**
  - (b) **Çdo rritje të parashikuar të ardhshme të pagave që ndikon në përfitimet e pagueshme;**
  - (c) **Efektin e çdo kufizimi në pjesën e punëdhënësit në koston e përfitimeve të ardhshme;**
  - (d) **Kontributet nga punonjësit ose palët e treta që ulin koston përfundimtare për njësinë (ekonomike) të atyre përfitimeve; dhe**
  - (e) **Ndryshimet e parashikuara të ardhshme në nivelin e çdo përfitimi shtetëror që ndikon në përfitimet e pagueshme sipas një skeme përfitimesh të përcaktuara, nëse, dhe vetëm nëse:**
    - (i) **Ato ndryshime ishin miratuar para fundit të periudhës së raportimit; ose**
    - (ii) **Të dhënat historike, ose evidencë tjetër e besueshme, tregojnë se këto përfitime shtetërore do të ndryshojnë**

**në një mënyrë të parashikueshme, për shembull, në përputhje me ndryshimet e ardhshme në nivelet e përgjithshme të çmimeve ose nivelet e përgjithshme të pagave.**

90. Supozimet aktuariale pasqyrojnë ndryshimet e përfitimeve të ardhshme që përcaktohen në kushtet formale të një skeme (ose një detyrim konstruktiv që shkon përtej këtyre kushteve) në fund të periudhës së raportimit. Ky është rasti nëse, për shembull:
- (a) Njësia ka një histori përfitimesh në rritje, për shembull, për të zbutur efektet e inflacionit dhe nuk ka asnjë tregues se kjo praktikë do të ndryshojë në të ardhmen;
  - (b) Njësia është e detyruar, ose nga kushtet formale të një skeme (ose një detyrim konstruktiv që shkon përtej këtyre kushteve) ose legjislacioni, të përdorë çdo sufiçit në skemë për përfitimin e pjesëmarrësve të skemës (shih paragrafin 110(c)); ose
  - (c) Përfitimet ndryshojnë në përgjigje të objektivit të performancës ose kriterëve të tjera. Për shembull, kushtet e skemës mund të thonë se ai do të paguajë përfitime të reduktuara ose do të kërkojë kontribute shtesë nga punonjësit nëse aktivet e skemës janë të pamjaftueshëm. Matja e detyrimit pasqyron vlerësimin më të mirë të efektit të objektivit të performancës ose kriterëve të tjera.
91. Supozimet aktuariale nuk pasqyrojnë ndryshimet e përfitimeve të ardhshme që nuk janë përcaktuar në kushtet formale të skemës (ose një detyrim konstruktiv) në fund të periudhës së raportimit. Ndryshime të tilla do të rezultojnë në:
- (a) Kosto të kaluar të shërbimit, në masën që ata ndryshojnë përfitimet për shërbimin përpara ndryshimit; dhe
  - (b) Kosto aktuale të shërbimit për periudhat pas ndryshimit, në masën që ata ndryshojnë përfitimet për shërbimin pas ndryshimit.
92. Vlerësimet e rritjes së ardhshme të pagave marrin parasysh inflacionin, vjetërsinë, promovimin dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm, si oferta dhe kërkesa në tregun e punës.
93. Disa skema përfitimesh të përcaktuara kufizojnë kontributet që kërkohet të paguajë një njësi. Kostoja përfundimtare e përfitimeve merr parasysh efektin e një kufiri mbi kontributet. Efekti i një kufiri në kontribute përcaktohet në periudhën më të shkurtër prej:
- (a) Jetëgjatësisë së vlerësuar të njësisë; dhe
  - (b) Jetëgjatësisë së parashikuar të skemës.
94. Disa skema përfitimesh të përcaktuara kërkojnë që punonjësit ose palët e treta të kontribuojnë në koston e skemës. Kontributet e punonjësve ulin

koston e përfitimeve për njësinë. Një njësi merr parasysh nëse kontributet e palëve të treta ulin koston e përfitimeve për njësinë, ose janë një e drejtë rimbursimi siç përshkruhet në paragrafin 118. Kontributet nga punonjësit ose palët e treta janë përcaktuar ose në kushtet formale të skemës (ose vijnë nga një detyrim konstruktiv që shkon përtej këtyre kushteve), ose janë lënë të papërcaktuara. Kontributet e papërcaktuara nga punonjësit ose palët e treta ulin koston e shërbimit me pagesën e këtyre kontributeve në skemë.

95. Kontributet nga punonjësit ose palët e treta të përcaktuara në kushtet formale të skemës ose ulin koston e shërbimit (nëse janë të lidhura me shërbimin), ose ndikojnë në rimatjet e detyrimit (aktivitet) neto të përfitimeve të përcaktuara (nëse nuk janë të lidhura me shërbimin). Një shembull i kontributeve që nuk janë të lidhura me shërbimin është kur kontributet kërkohen për të reduktuar një defiçit që vjen nga humbjet në aktivitet e skemës ose nga humbjet aktuariale. Nëse kontributet nga punonjësit ose palët e treta janë të lidhura me shërbimin, ata kontribute ulin koston e shërbimit si më poshtë:

- (a) Nëse shuma e kontributeve varet nga numri i viteve të shërbimit, një njësi do t'i atribuojë kontributet periudhave të shërbimit duke përdorur të njëjtën metodë atribrimi të kërkuar nga paragrafi 72 për përfitimin bruto (d.m.th. ose duke përdorur formulën e kontributit të skemës ose në një bazë lineare); ose
- (b) Nëse shuma e kontributeve është e pavarur nga numri i viteve të shërbimit, njësi lejohet të njohë këta kontribute si një ulje të koston së shërbimit në periudhën në të cilën është kryer shërbimi përkatës. Shembuj të kontributeve që janë të pavarur nga numri i viteve të shërbimit përfshijnë ata që janë një përqindje fikse e pagës së punonjësit, një shumë fikse gjatë gjithë periudhës së shërbimit ose në varësi të moshës së punonjësit.

Paragrafi AG13 ofron udhëzimet përkatëse të aplikimit.

96. Për kontributet nga punonjësit ose palët e treta që i atribuohen periudhave të shërbimit në përputhje me paragrafin 95(a), ndryshimet në kontribute rezultojnë në:

- (a) Koston aktuale dhe të kaluar e shërbimit (nëse këta ndryshime nuk janë përcaktuar në kushtet formale të një skeme dhe nuk krijohen nga një detyrim konstruktiv); ose
- (b) Fitimet dhe humbjet aktuariale (nëse këta ndryshime përcaktohen në kushtet formale të një skeme, ose krijohen nga një detyrim konstruktiv).

97. Disa përfitime pas punësimit janë të lidhur me variabla të tillë si niveli i

përfitimeve nga pensionet e sigurimeve shoqërore ose kujdesi mjekësor shtetëror. Matja e përfitimeve të tillë pasqyron vlerësimin më të mirë të këtyre variablave, bazuar në të dhëna historike dhe evidencë tjetër të besueshme.

98. **Supozimet për kostot mjekësore do të marrin parasysh ndryshimet e vlerësuar të ardhshme në koston e shërbimeve mjekësore, që rezultojnë si nga inflacioni ashtu edhe nga ndryshimet specifike në kostot mjekësore.**
99. Matja e përfitimeve mjekësore pas punësimit kërkon supozime për nivelin dhe shpeshësinë e pretendimeve të ardhshme dhe koston e përmbushjes së këtyre pretendimeve. Një njësi vlerëson kostot e ardhshme mjekësore mbi bazën e të dhënave historike për eksperiencën e vetë njësisë, të plotësuar aty ku është e nevojshme nga të dhënat historike nga njësi të tjera, kompani sigurimesh, ofrues mjekësorë, ose burime të tjerë. Vlerësimet e kostove të ardhshme mjekësore marrin në konsideratë efektin e përparimeve teknologjike, ndryshimet në modelet e përdorimit ose të ofrimit të kujdesit shëndetësor, dhe ndryshimet në gjendjen shëndetësore të pjesëmarrësve në skemë.
100. Niveli dhe shpeshësia e pretendimeve janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj moshës, gjendjes shëndetësore, dhe gjinisë së punonjësve (dhe personave në ngarkim të tyre) dhe mund të jenë sensitive ndaj faktorëve të tjerë si vendndodhja gjeografike. Prandaj, të dhënat historike rregullohen në masën që përzierja demografike e popullsisë ndryshon nga ajo e popullsisë së përdorur si bazë për të dhënat. Ato gjithashtu rregullohen aty ku ka evidencë të besueshme se tendencat historike nuk do të vazhdojnë.

### **Kostoja e Shërbimit të Kaluar dhe Fitimet e Humbjet në Shlyerje**

101. **Kur përcakton koston e shërbimit të kaluar, ose një fitim apo humbje nga shlyerja, një njësi do të rimatë detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara duke përdorur vlerën e drejtë aktuale të aktiveve të skemës dhe supozimet aktuale aktuariale (duke përfshirë normat aktuale të interesit të tregut dhe çmimet e tjera aktuale të tregut), duke pasqyruar:**
- (a) **Përfitimet e ofruara sipas skemës dhe aktivet e skemës përpara ndryshimit, reduktimit, ose shlyerjes së skemës; dhe**
  - (b) **Përfitimet e ofruara sipas skemës dhe aktivet e skemës pas ndryshimit, reduktimit ose shlyerjes së skemës.**
102. Një njësi nuk ka nevojë të bëjë dallimin midis koston së shërbimit të kaluar që rezulton nga një ndryshim i skemës, koston së shërbimit të kaluar që rezulton nga një reduktim dhe një fitimi ose humbjeje nga

shlyerja nëse këta transaksione ndodhin së bashku. Në disa raste, një ndryshim i skemës ndodh përpara një shlyerjeje, si për shembull kur një njësi ndryshon përfitimet sipas skemës dhe shlyen përfitimet e ndryshuara më vonë. Në ata raste, një njësi njih koston e shërbimit të kaluar përpara çdo fitimi ose humbjeje nga shlyerja.

103. Një shlyerje ndodh së bashku me një ndryshim dhe reduktim të skemës nëse një skemë përfundon me rezultatin që detyrimi shlyhet dhe skema ndalon së ekzistuari. Megjithatë, përfundimi i një skeme nuk është një shlyerje nëse skema zëvendësohet nga një skemë e re që ofron përfitime që janë, në thelb, të njëjta.

103A.

Kur ndodh një ndryshim, refuktim ose shlyerje skeme, një njësi do të njohë dhe të masë çdo kosto shërbimi të kaluar, ose një fitim ose humbje nga shlyerja, në përputhje me paragrafët 101-103 dhe paragrafët 104-114. Duke vepruar kështu, një njësi nuk do të marrë parasysh efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit. Një njësi do të përcaktojë më pas efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit pas ndryshimit, reduktimit ose shlyerjes së skemës dhe do të njohë çdo ndryshim në këtë efekt në përputhje me paragrafin 59(d).

#### *Kostoja e Shërbimit të Kaluar*

104. Kostoja e shërbimit të kaluar është ndryshimi në vlerën aktuale të detyrimit të përfitimeve të përcaktuara që rezultojnë nga një ndryshim ose reduktim i skemës.
105. **Një njësi do të njohë koston e shërbimit të kaluar si shpenzim në datat më të hershmen nga sa vijon:**
- (a) **Kur ndodh ndryshimi ose reduktimi i skemës; dhe**
  - (b) **Kur njësi njih koston përkatëse të ristrukturimit (shih SNKSP 19) ose përfitimet nga përfundimi (shih paragrafin 168).**
106. Një ndryshim i skemës ndodh kur një njësi prezanton, ose tërheq, një skemë përfitimesh të përcaktuara ose ndryshon përfitimet e pagueshme sipas një skeme ekzistuese të përfitimeve të përcaktuara.
107. Një reduktim ndodh kur një njësi redukton ndjeshëm numrin e punonjësve të mbuluar nga një skemë. Një reduktim mund të krijohet nga një ngjarje e izoluar, si mbyllja e një fabrike, ndërprerja e një operacioni ose përfundimi apo pezullimi i një skeme.
108. Kostoja e shërbimit të kaluar mund të jetë ose pozitive (kur përfitimet fillojnë ose ndryshohen në mënyrë që vlera aktuale e detyrimit të përfitimeve të përcaktuara të rritet) ose negative (kur përfitimet reduktohen ose ndryshohen në mënyrë që vlera aktuale e detyrimit të përfitimeve të përcaktuara të ulet).
109. Kur një njësi redukton përfitimet e pagueshme sipas një skeme

ekzistuese përfitimesh të përcaktuara dhe, në të njëjtën kohë, rrit përfitimet e tjera të pagueshme sipas skemës për të njëjtët punonjës, njësia ekonomike e trajton ndryshimin si një ndryshim të vetëm neto.

110. Kostoja e shërbimit të kaluar përjashton:
- (a) Efektin e diferencave ndërmjet rritjes së pagës aktuale dhe asaj të supozuar më parë në detyrimin për të paguar përfitime për shërbimin në vitet e mëparshme (nuk ka kosto shërbimi të kaluar sepse supozimet aktuariale lejojnë pagat e parashikuara);
  - (b) Nënvlërësime dhe mbivlerësime të rritjeve të pensione ve të papërcaktuara kur një njësi ka një detyrim konstruktiv për të dhënë rritje të tilla (nuk ka kosto të shërbimit të kaluar sepse supozimet aktuariale lejojnë rritje të tilla);
  - (c) Vlerësimet e përmirësimeve të përfitimeve që rezultojnë nga fitimet aktuariale ose nga fitimi i aktiveve të skemës që janë njohur në pasqyrat financiare nëse njësia është e detyruar, ose nga kushtet formale të një skeme (ose një detyrim konstruktiv që shkon përtej këtyre kushteve) ose legjislacioni, për të përdorur çdo suficit në skemë për përfitimet e pjesëmarrësve të skemës, edhe nëse rritja e përfitimit nuk është dhënë ende zyrtarisht (nuk ka kosto shërbimi të kaluar sepse rritja që rezulton në detyrim është një humbje aktuariale, shih paragrafin 90) ; dhe
  - (d) Rritja e përfitimeve të garantuara (d.m.th., përfitimet që nuk janë të kushtëzuara nga punësimi i ardhshëm, shih paragrafin 74) kur, në mungesë të përfitimeve të reja ose të përmirësuar, punonjësit plotësojnë kërkesat e garantimit (nuk ka kosto shërbimi të kaluar sepse njësia njohu koston e vlerësuar të përfitimeve si koston aktuale të shërbimit gjatë kryerjes së shërbimit).

*Fitimet dhe Humbjet në një Shlyerje (pagesë)*

111. Fitimi ose humbja nga një shlyerje është diferenca midis:
- (a) Vlerës aktuale të detyrimit të përfitimeve të përcaktuara që po shlyhet, siç përcaktohet në datën e shlyerjes; dhe
  - (b) Çmimi i shlyerjes, duke përfshirë çdo aktiv të skemës të transferuar dhe çdo pagesë të bërë drejtpërdrejt nga njësia në lidhje me shlyerjen.
112. **Një njësi do të njohë një fitim ose humbje nga shlyerja e një skeme përfitimesh të përcaktuara kur të ndodhë shlyerja.**
113. Një shlyerje ndodh kur një njësi hyn në një transaksion që eliminon të gjithë detyrimin e mëtejshëm ligjor ose konstruktiv për një pjesë ose të gjitha përfitimet e dhëna sipas një skeme përfitimesh të përcaktuara (e

ndryshme nga një pagesë e përfitimeve për, ose në emër të, punonjësve në përputhje me kushtet e skemës dhe e përfshirë në supozimet aktuariale). Për shembull, një transferim i njëhershëm i detyrimeve të rëndësishme të punëdhënësit sipas skemës tek një kompani sigurimesh përmes blerjes së një police sigurimi është një shlyerje; Një pagesë monetare e vetme, sipas kushteve të skemës, për pjesëmarrësit e skemës në këmbim të të drejtave të tyre për të marrë përfitime të specifikuar pas punësimit nuk është (shlyerje).

114. Në disa raste, një njësi blen një policë sigurimi për të financuar disa ose të gjitha përfitimet e punonjësve në lidhje me shërbimin e punonjësve në periudhat aktuale dhe ato të mëparshme. Blerja e një police të tillë nuk është një shlyerje nëse njësia ruan një detyrim ligjor ose konstruktiv (shih paragrafin 48) për të paguar shumën të mëtejshme nëse siguruari nuk paguan përfitimet e punonjësve të specifikuar në policën e sigurimit. Paragrafët 118–121 kanë të bëjnë me njohjen dhe matjen e të drejtave të rimbursimit sipas policës së sigurimit që nuk janë aktive të skemës.

### **Njohja dhe Matja — Aktivet e Skemës**

#### *Vlera e Drejtë e Aktiveve të Skemës*

115. Vlera e drejtë e çdo aktivi të skemës zbritet nga vlera aktuale e detyrimit për përfitime të përcaktuara në përcaktimin e defiçitit ose sufiçitit.
116. Aktivet e skemës përjashtojnë kontributet e papaguara që i detyrohen fondit nga njësia raportuese, si dhe çdo instrument financiar të patransferueshëm i emtuar nga njësia dhe i mbajtur nga fondi. Aktivet e skemës reduktohen nga çdo detyrim i fondit që nuk lidhet me përfitimet e punonjësve, për shembull, të pagueshmet tregtare dhe të tjera e detyrimet që rezultojnë nga instrumentet financiarë derivativë.
117. Kur aktivet e skemës përfshijnë policën e sigurimit kualifikuese që përputhen saktësisht me shumën dhe kohën e disa ose të gjitha përfitimeve të pagueshme sipas skemës, vlera e drejtë e këtyre policave të sigurimit konsiderohet të jetë vlera aktuale e detyrimeve të lidhura me të (subjekt i çdo reduktimi të kërkuar nëse shumën e arkëtueshme sipas policave të sigurimit nuk janë të rikuperueshme plotësisht).

#### *Rimbursimet*

118. **Kur, dhe vetëm kur, është praktikisht e sigurt se një palë tjetër do të rimbursojë disa ose të gjitha shpenzimet e kërkuara për të shlyer një detyrim për përfitime të përcaktuara, një njësi do të:**
- (a) **Njohë të drejtën e saj për rimbursim si një aktiv të veçantë. Njësia do të masë aktivin me vlerën e drejtë.**
  - (b) **Veçojë dhe njohë ndryshimet në vlerën e drejtë të së drejtës**



**së saj për rimbursim në të njëjtën mënyrë si për ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve të skemës (shih paragrafët 126 dhe 128). Komponentët e kostos së përfitimeve të përcaktuara të njohura në përputhje me paragrafin 122 mund të njihen neto nga shumat që lidhen me ndryshimet në vlerën e mbartur të së drejtës për rimbursim.**

119. Ndonjëherë, një njësi është në gjendje t'i drejtohet një pale tjetër, si p.sh. një siguruesi, për të paguar një pjesë ose të gjithë shpenzimet e kërkuara për të shlyer një detyrim të përfitimeve të përcaktuara. Policat kualifikuese të sigurimit, siç përcaktohen në paragrafin 8, janë aktive të skemës. Një njësi kontabilizon policat e sigurimit të kualifikuar në të njëjtën mënyrë si për të gjithë aktivet e tjerë të skemës dhe paragrafi 118 nuk është relevant (shih paragrafët 48–51 dhe 117).
120. Kur një policë sigurimi e mbajtur nga një njësi nuk është një policë sigurimi kualifikuese, ajo policë sigurimi nuk është një aktiv i skemës. Paragrafi 118 është relevant për raste të tilla: njësia njih të drejtën e saj për rimbursim sipas policës së sigurimit si një aktiv më vete, dhe jo si një zbritje në përcaktimin e defiçitit ose sufiçitit të përfitimeve të përcaktuara. Paragrafi 142(b) kërkon që njësia të japë një përshkrim të shkurtër të lidhjes ndërmjet të drejtës së rimbursimit dhe detyrimit përkatës.
121. Nëse e drejta për rimbursim lind nga një policë sigurimi ose një marrëveshje ligjërishit detyruese që përputhet saktësisht me shumën dhe kohën e disa ose të gjitha përfitimeve të pagueshme sipas një skeme përfitimesh të përcaktuara, vlera e drejtë e të drejtës së rimbursimit konsiderohet të jetë vlera aktuale e detyrimit përkatës (subjekt i çdo reduktimi të kërkuar nëse rimbursimi nuk është i rikuperueshëm plotësisht).

### **Përbërësit e Kostos së Përfitimeve të Përcaktuara**

122. **Një njësi do të njohë përbërësit e kostos së përfitimit të përcaktuar, me përjashtim të masës që një SNKSP tjetër kërkon ose lejon përfshirjen e tyre në koston e një aktivi, si më poshtë:**
- (a) **Koston e shërbimit (shih paragrafët 68–114 dhe paragrafin 124A) në sufiçit ose defiçit;**
  - (b) **Interesin neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara (shih paragrafët 125–128) në sufiçit ose defiçit; dhe**
  - (c) **Rimatjet e detyrimit (aktivit) neto të përfitimeve të përcaktuara (shih paragrafët 129–132) në aktivet/kapitalin neto.**
123. SNKSP-të e tjera kërkojnë përfshirjen e disa kostove të përfitimeve të punonjësve brenda kostos së aktiveve, të tilla si inventarët dhe

ndërtesave, makinerive, dhe pajisjeve (shih SNKSP 12 dhe SNKSP 17). Çdo kosto e përfitimit pas punësimit e përfshirë në koston e aktiveve të tilla përfshin proporcionin e duhur të përbërësve të renditur në paragrafin 122.

124. **Rimatjet e detyrimit (aktivit) neto të përfitimeve të përcaktuara të njohura në aktivet/kapitalin neto nuk do të riklasifikohen në sufiçit ose defiçit në një periudhë të mëpasshme. Megjithatë, njësia mund t'i transferojë ato shuma të njohura në aktivet/kapitalin neto brenda aktiveve/kapitalit neto.**

*Kosto e Shërbimit Aktual*

- 124A. **Një njësi do të përcaktojë koston e shërbimit aktual duke përdorur supozimet aktuariale të përcaktuara në fillim të periudhës së raportimit vjetor. Megjithatë, nëse një njësi rimat detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara në përputhje me paragrafin 101, ajo do të përcaktojë koston e shërbimit aktual për pjesën e mbetur të periudhës vjetore të raportimit pas ndryshimit, reduktimit ose shlyerjes së skemës duke përdorur supozimet aktuariale të përdorura për të rimatur detyrimin (aktivin) neto për përfitime të përcaktuara në përputhje me paragrafin 101(b).**

*Interesi Neto mbi Detyrimin (Aktivin) Neto të Përfitimit të Përcaktuar*

125. **Një njësi do të përcaktojë interesin neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara duke shumëzuar detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara me normën e skontimit të specifikuar në paragrafin 85.**
- 125A. **Për të përcaktuar interesin neto në përputhje me paragrafin 125, një njësi do të përdorë detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara dhe normën e skontimit të përcaktuar në fillim të periudhës vjetore të raportimit. Megjithatë, nëse një njësi rimat detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara në përputhje me paragrafin 101, njësia do të përcaktojë interesin neto për pjesën e mbetur të periudhës vjetore të raportimit pas ndryshimit, reduktimit ose shlyerjes së skemës duke përdorur:**
- (a) **Detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara përcaktuar në përputhje me paragrafin 101(b); dhe**
  - (b) **Normën e skontimit të përdorur për të rimatur detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara në përputhje me paragrafin 101(b).**

**Në zbatimin e paragrafit 125A, njësia do të marrë gjithashtu parasysh çdo ndryshim në detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara gjatë periudhës që rezulton nga kontributet ose**

**pagesat e përfitimeve.**

126. Interesi neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara mund të shihet si i përbërë nga të ardhurat nga interesi për aktivet e skemës, kostoja e interesit për detyrimin e përfitimit të përcaktuar dhe interesi mbi efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit të përmendur në paragrafin 66.
127. Të ardhurat nga interesi për aktivet e skemës janë një komponent i fitimit nga aktivet e skemës dhe përcaktohen duke shumëzuar vlerën e drejtë të aktiveve të skemës me normën e skontimit të specifikuar në paragrafin 125A. Një njësi do të përcaktojë vlerën e drejtë të aktiveve të skemës në fillim të periudhës së raportimit. Megjithatë, nëse një njësi rimat detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara në përputhje me paragrafin 101, njësia do të përcaktojë të ardhurat nga interesi për pjesën e mbetur të periudhës vjetore të raportimit pas ndryshimit, reduktimit ose shlyerjes së skemës duke përdorur aktivet e skemës të përdorura për të rimatur detyrimin (aktiv) neto të përfitimeve të përcaktuara në përputhje me paragrafin 101(b). Në zbatimin e paragrafit 127, njësia do të marrë gjithashtu parasysh çdo ndryshim në aktivet e skemës të mbajtura gjatë periudhës që rezulton nga pagesat e kontributeve ose përfitimeve. Diferenca midis të ardhurave nga interesi për aktivet e skemës dhe fitimit nga aktivet e skemës përfshihet në rimatjen e detyrimit (aktivitet) neto të përfitimeve të përcaktuara.
128. Interesi mbi efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit është pjesë e ndryshimit total në efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit dhe përcaktohet duke shumëzuar efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit me normën e skontimit të specifikuar në paragrafin 125A. Një njësi duhet të përcaktojë efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit në fillim të periudhës së raportimit vjetor. Megjithatë, nëse një njësi rimat detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara në përputhje me paragrafin 101, njësia do të përcaktojë interesin mbi efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit për pjesën e mbetur të periudhës vjetore të raportimit pas ndryshimit, reduktimit ose shlyerjes së skemës duke marrë parasysh çdo ndryshim në efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit të përcaktuar në përputhje me paragrafin 103A. Diferenca midis interesit mbi efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit dhe ndryshimit total në efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit përfshihet në rimatjen e detyrimit (aktivitet) neto të përfitimeve të përcaktuara.

*Rimatjet e Detyrimit (Aktivitet) Neto të Përfitimeve të Përcaktuara*

129. Rimatjet e detyrimit (aktivitet) neto të përfitimeve të përcaktuara përfshijnë
- (a) Fitimet dhe humbjet aktuariale (shih paragrafët 130 dhe 131);
  - (b) Fitimin nga aktivet e skemës (shih paragrafin 132), duke përjashtuar shumat e përfshira në interesin neto mbi detyrimin

(aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara (shih paragrafin 127); dhe

- (c) Çdo ndryshim në efektin e kufirit të sipërm të aktivit, duke përjashtuar shumat e përfshira në interesin neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara (shih paragrafin 128).

130. Fitimet dhe humbjet aktuariale rezultojnë nga rritja ose zvogëlimi i vlerës aktuale të detyrimit të përfitimeve të përcaktuara për shkak të ndryshimeve në supozimet aktuariale dhe rregullimet nga eksperiencia. Shkaqet e fitimeve dhe humbjeve aktuariale përfshijnë, për shembull:

- (a) Treguesit e papritur të lartë ose të ulët të qarkullimit të punonjësve, pensionit të parakohshëm ose vdekshmërisë ose rritjes së pagave, përfitimeve (nëse kushtet formale ose konstruktive të një skeme parashikojnë/lejojnë rritje të përfitimeve inflacionare) ose kostove mjekësore;
- (b) Efekti i ndryshimeve në supozimet në lidhje me opsionet e pagesës së përfitimeve;
- (c) Efekti i ndryshimeve në vlerësimet e qarkullimit të ardhshëm të punonjësve, pensionit të parakohshëm ose vdekshmërisë ose rritjes së pagave, përfitimeve (nëse kushtet formale ose konstruktive të një skeme parashikojnë/lejojnë rritje të përfitimeve inflacionare) ose kostove mjekësore; dhe
- (d) Efekti i ndryshimeve në normën e skontimit.

131. Fitimet dhe humbjet aktuariale nuk përfshijnë ndryshime në vlerën aktuale të detyrimit të përfitimeve të përcaktuara për shkak të prezantimit, ndryshimit, reduktimit ose shlyerjes së skemës të përfitimeve të përcaktuara, ose ndryshimeve në përfitimet e pagueshme sipas skemës të përfitimeve të përcaktuara. Ndryshime të tilla rezultojnë në kosto të shërbimit të kaluar ose fitime ose humbje nga shlyerja.

132. Në përcaktimin e fitimit nga aktivet e skemës, një njësi zbrit kostot e menaxhimit të aktiveve të skemës dhe çdo taksë të pagueshme nga vetë skema, të ndryshme nga tatimi i përfshirë në supozimet aktuariale të përdorura për të matur detyrimin e përfitimt të përcaktuar (paragrafi 78). Kostot e tjera të menaxhimit nuk zbriten nga fitimi i aktiveve të skemës.

## Paraqitja

*Kompensimi i të drejtave dhe detyrimeve*

133. **Një njësi do të kompensojë një aktiv në lidhje me një skemë kundrejt një detyrimi që lidhet me një skemë tjetër kur, dhe vetëm kur, njësia:**

- (a) **Ka të drejtë të imponueshme ligjërisht për të përdorur një**

**sufiçit në një skemë për të shlyer detyrimet sipas skemës tjetër; dhe**

- (b) **Synon ose të shlyejë detyrimet në bazë neto, ose të realizojë sufiçit në një skemë dhe të shlyejë njëkohësisht detyrimin e saj sipas skemës tjetër.**

134. Kriteret e kompensimit janë të ngjashme me ato të përcaktuara për instrumentet financiare në SNKSP 28, *Instrumentet Financiare: Paraqitja*.

#### *Dallimi Afatshkurtër / Afatgjatë*

135. Disa njësi dallojnë aktivet dhe detyrimet afatshkurtër nga aktivet dhe detyrimet afatgjatë. Ky Standard nuk specifikon nëse një njësi duhet të dallojë pjesët afatshkurtër dhe afatgjatë të aktiveve dhe detyrimeve që vijnë nga përfitimet pas punësimit.

#### *Komponentët e Kostos për Përfitimet e Përcaktuara*

136. Paragrafi 122 kërkon që një njësi të njohë koston e shërbimit dhe interesin neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara në sufiçit ose defiçit. Ky Standard nuk specifikon se si një njësi duhet të prezantojë koston e shërbimit dhe interesin neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara. Një njësi i prezanton këta komponentë në përputhje me SNKSP 1.

#### **Dhënia e Informacioneve Shpjeguese**

137. **Një njësi do të paraqesë informacion i cili:**

- (a) **Shpjegon karakteristikat e skemave të saj të përfitime të përcaktuara dhe rreziqet që shoqërohen me ta (shih paragrafin 141);**
- (b) **Identifikon dhe shpjegon shumat në pasqyrat e saj financiare që vijnë nga skemat e saj të përfitimeve të përcaktuara (shih paragrafët 142–146); dhe**
- (c) **Përshkruan se si skemat e saj të përfitimeve të përcaktuara mund të ndikojnë në shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve monetare të ardhshëm të njësisë (shih paragrafët 147–149).**

138. Për të përmbushur objektivat në paragrafin 137, një njësi do të marrë parasysh të gjitha që vijnë:

- (a) Nivelin e detajeve të nevojshme për të përmbushur kërkesat e paraqitjes së informacioneve;
- (b) Sa theks duhet vënë në secilën prej kërkesave të ndryshme;

- (c) Në çfarë mase është bërë grupimi apo ndarja; dhe
  - (d) Nëse përdoruesit e pasqyrave financiare kanë nevojë për informacion shtesë për të vlerësuar informacionin sasior të paraqitur.
139. Nëse informacionet shpjegues të dhënë në përputhje me kërkesat e këtij Standardi dhe SNKSP-ve të tjera janë të pamjaftueshëm për të përmbushur objektivat në paragrafin 137, një njësi do të japë informacione shtesë të nevojshme për të përmbushur këta objektiva. Për shembull, një njësi mund të prezantojë një analizë të vlerës aktuale të detyrimit të përfitimit të përcaktuar që dallon natyrën, karakteristikat dhe rreziqet e detyrimit. Një paraqitje e tillë e informacionit mund të dallojë:
- (a) Midis shumave që i detyrohen anëtarëve aktivë, anëtarëve që marrin përfitime por nuk bëjnë më kontribute, dhe pensionistëve.
  - (b) Midis përfitimeve të garantuara dhe përfitimeve të akumuluar, por jo të garantuara.
  - (c) Midis përfitimeve të kushtëzuara, shumave që i atribuohen rritjeve të ardhshme të pagave dhe përfitimeve të tjera.
140. Një njësi do të vlerësojë nëse të gjithë ose disa informacione shpjegues duhet të ndahen për të dalluar skemat ose grupet e skemave me rreziqe materialisht të ndryshëm. Për shembull, një njësi mund të ndajë informacionet shpjegues rreth skemave që tregojnë një ose më shumë nga karakteristikat e mëposhtme:
- (a) Vendndodhjet e ndryshme gjeografike.
  - (b) Karakteristika të ndryshme si skema pensioni me pagë të sheshtë, skema pensioni të pagës përfundimtare ose skema mjekësore pas punësimit.
  - (c) Mjediset e ndryshme rregullatore.
  - (d) Segmente të ndryshëm të raportimit.
  - (e) Marrëveshje të ndryshme financimi (p.sh., tërësisht të pafinancuara, tërësisht ose pjesërisht të financuara).

*Karakteristikat e Skemave me Përfitime të Përcaktuara dhe Rreziqet që Shoqërohen me to*

141. Një njësi do të paraqesë:
- (a) Informacion rreth karakteristikave të skemave të saj me përfitime të përcaktuara, duke përfshirë:
    - (i) Natyrën e përfitimeve të dhëna nga skema (p.sh., skema me përfitime të përcaktuara të pagës përfundimtare ose skema e bazuar në kontribute me garantor).

- (ii) Një përshkrim të kuadrit rregulator në të cilin operon skema, për shembull niveli i çdo kërkesë minimale të financimit dhe çdo efekt i kuadrit rregulator në skemë , siç është kufiri i sipërm i aktivitetit (shih paragrafin 66).
  - (iii) Një përshkrim të përgjegjësive të çdo njësie tjetër për administrimin e skemës, për shembull, përgjegjësitë e administratorëve të besuar ose të menaxhimit të skemës.
- (b) Një përshkrim të rreziqeve ndaj të cilëve skema e ekspozon njësinë, i fokusuar në çdo rrezik të pazakontë, specifik të njësisë ose të skemës, dhe të çdo përqendrim të konsiderueshëm rreziku. Për shembull, nëse aktivitetet e skemës investohen kryesisht në një klasë investimesh, p.sh., prona, skema mund ta ekspozojë njësinë ndaj një përqendrimi të rrezikut të tregut të pronave.
  - (c) Një përshkrim i çdo ndryshimi, reduktimi dhe shlyerjeje të skemës.
  - (d) Bazën mbi të cilën është përcaktuar norma e skontimit.

*Shpjegimi i Shifrave në Pasqyrat Financiare*

142. Një njësi do të japë një rakordim duke filluar nga teprica fillestare në atë përfundimtare për secilën nga sa vijon, nëse është e aplikueshme:
- (a) Detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara, që tregon rakordime të veçanta për:
    - (i) Aktivitetet e skemës.
    - (ii) Vlerën aktuale të detyrimit të përfitimeve të përcaktuara.
    - (iii) Efektin e kufirit të sipërm të aktivitetit.
  - (b) Çdo të drejtë rimbursimi. Një njësi do të përshkruajë gjithashtu marrëdhënien ndërmjet çdo të drejte rimbursimi dhe detyrimit përkatës.
143. Çdo rakordim i renditur në paragrafin 142 do të tregojë secilën nga sa vijon, nëse është e aplikueshme:
- (a) Koston aktuale të shërbimit.
  - (b) Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit.
  - (c) Rimatjet e detyrimit (aktivitetit) neto të përfitimeve të përcaktuara, duke treguar veç:
    - (i) Fitimin nga aktivitetet e skemës, duke përjashtuar shumatat e përfshira në interes në (b).
    - (ii) Fitimet dhe humbjet aktuariale që vijnë nga ndryshimet në supozimet demografike (shih paragrafin 78(a)).

- (iii) Fitimet dhe humbjet aktuariale që vijnë nga ndryshimet në supozimet financiare (shih paragrafin 78(b)).
  - (iv) Ndryshimet në efektin e kufizimit të një aktivi neto të përfitimeve të përcaktuara në kufirin e sipërm të aktivitetit, duke përfshirë shumën e përfshira në interes në (b). Një njësi do të japë gjithashtu informacione shpjeguese se si e përcaktoi përfitimin maksimal ekonomik të disponueshëm, d.m.th. nëse këta përfitime do të ishin në formën e rimbursimeve, reduktimeve në kontributet e ardhshëm ose një kombinim i të dyjave.
- (d) Koston e shërbimit të kaluar dhe fitimet e humbjet që vijnë nga shlyerjet. Siç lejohet nga paragrafi 102, kostoja e shërbimit të kaluar dhe fitimet dhe humbjet që vijnë nga shlyerjet nuk duhet të dallohen nëse ata ndodhin së bashku.
  - (e) Efektin e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor.
  - (f) Kontributet në skemë, duke treguar veç ata nga punëdhënësi dhe nga pjesëmarrësit e skemës.
  - (g) Pagesat nga skema, duke treguar veç shumën e paguar në lidhje me çdo shlyerje.
  - (h) Efektet e kombinimeve dhe shitjeve të sektorit publik.
144. Një njësi do të ndajë vlerën e drejtë të aktiveve të skemës në klasa që dallojnë natyrën dhe rreziqet e këtyre aktiveve, duke e nën-ndarë çdo klasë të aktiveve të skemës në ato që kanë një çmim tregu të kuotuar në një treg aktiv dhe në ato që nuk e kanë. Për shembull, dhe duke marrë parasysh nivelin e paraqitjes së informacioneve të diskutuar në paragrafin 138, një njësi mund të dallojë midis:
- (a) Mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare;
  - (b) Instrumenteve të kapitalit (të ndarë sipas llojit të industrisë, madhësisë së kompanisë, gjeografisë etj.);
  - (c) Instrumenteve të borxhit (të ndarë sipas llojit të emetuesit, cilësisë së kreditit, gjeografisë etj.);
  - (d) Pasurive të paluajtshme (të ndara sipas gjeografisë etj.);
  - (e) Derivatëve (të ndarë sipas llojit të rrezikut bazë në kontratë, për shembull, kontratat e normës së interesit, kontratat e këmbimit valutor, kontratat e kapitalit, kontratat e kreditit, këmbimet e jetëgjatësisë etj.);
  - (f) Fondeve të investimeve (të ndarë sipas llojit të fondit);



- (g) Letrave me vlerë të mbështetura nga aktivet; dhe
  - (h) Borxhit të strukturuar.
145. Një njësi do të paraqesë informacion për vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të transferueshëm të vetë njësisë (ekonomike) të mbajtura si aktive të skemës, dhe vlerën e drejtë të aktiveve të skemës që janë pronë e okupuar nga, ose aktive të tjerë të përdorur nga, njësia.
146. Një njësi do të japë informacion për supozimet e rëndësishme aktuariale të përdorura për të përcaktuar vlerën aktuale të detyrimit të përfitimit të përcaktuar (shih paragrafin 78). Një informacion i tillë do të jetë në terma absolutë (p.sh., si përqindje absolute, dhe jo vetëm si një ndryshim ndërmjet përqindjeve të ndryshme dhe variabla të tjerë). Kur një njësi jep informacione në total për një grupim të skemave, ajo do të japë informacione të tilla në formën e mesatare të ponderuara ose intervaleve relativisht të ngushta.

*Shuma, Koha dhe Pasiguria e Flukseve Monetare të Ardhshëm*

147. Një njësi do të paraqesë:
- (a) Një analizë të ndjeshmërisë për çdo supozim aktuarial të rëndësishëm (siç është paraqitur në paragrafin 146) në fund të periudhës së raportimit, duke treguar se si do të ishte ndikuar detyrimi i përfitimeve të përcaktuara nga ndryshimet në supozimin aktuarial përkatës që ishin të mundshëm në mënyrë të arsyeshme në atë datë.
  - (b) Metodën dhe supozimet e përdorura në përgatitjen e analizave të kërkuara të ndjeshmërisë nga (a) dhe kufizimet e këtyre metodave.
  - (c) Ndryshimet nga periudha e mëparshme në metodat dhe supozimet e përdorura në përgatitjen e analizave të ndjeshmërisë, dhe arsyet e ndryshimeve të tilla.
148. Një njësi do të paraqesë një përshkrim të çdo strategjie të përputhjes aktiv-pasiv të përdorur nga skema ose njësia, duke përfshirë përdorimin e anuiteteve dhe teknikave të tjera, të tilla si këmbimet e jetëgjatësisë, për të menaxhuar rrezikun.
149. Për të dhënë një tregues të efektit të skemës të përfitimeve të përcaktuara në flukset monetare të ardhshëm të njësisë, një njësi do të paraqesë:
- (a) Një përshkrim të çdo marrëveshjeje financimi dhe politike financimi që ndikon në kontributet e ardhshme.
  - (b) Kontributet e pritshme në skemë për periudhën e ardhshme të raportimit.

- (c) Informacionin për profilin e maturimit të detyrimit për përfitime të përcaktuara. Kjo do të përfshijë kohëzgjatjen mesatare të ponderuar të detyrimit të përfitimeve të përcaktuara dhe mund të përfshijë informacione të tjerë për shpërndarjen në kohë të pagesave të përfitimeve, të tilla si një analizë maturimi të pagesave të përfitimeve.

*Skemat me Shumë Punëdhënës*

150. Nëse një njësi merr pjesë në një skemë përfitimesh të përcaktuara me shumë punëdhënës, ajo do të paraqesë:
- (a) Një përshkrim të marrëveshjeve të financimit, duke përfshirë metodën e përdorur për të përcaktuar normën e kontributeve të njësisë dhe çdo kërkesë minimale për financim.
  - (b) Një përshkrim të masës në të cilën njësia mund të jetë përgjegjëse ndaj skemës për detyrimet e njësisë të tjera sipas termave dhe kushteve të skemës me shumë punëdhënës.
  - (c) Një përshkrim të çdo alokimi të rënë dakord të një defiçiti ose sufiçiti në:
    - (i) Përfundimin e skemës; ose
    - (ii) Tërheqjen e njësisë nga skema.
  - (d) Nëse njësia e kontabilizon atë skemë sikur të ishte një skemë kontributesh të përcaktuara në përputhje me paragrafin 34, ajo do të paraqesë informacionin në vijim, krahas informacionit të kërkuar nga (a)-(c) dhe në vend të informacionit të kërkuar nga paragrafët 141 –149:
    - (i) Faktin që skema është një skemë përfitimesh të përcaktuara.
    - (ii) Arsyen pse informacioni i mjaftueshëm nuk disponohet për t'i mundësuar njësisë të kontabilizojë skemën si një skemë përfitimesh të përcaktuara.
    - (iii) Kontributet e pritshme në skemë për periudhën e ardhshme të raportimit.
    - (iv) Informacionin për çdo defiçit ose sufiçit në skemë që mund të ndikojë në shumën e kontributeve të ardhshme, duke përfshirë bazën e përdorur për të përcaktuar atë defiçit ose sufiçit dhe implikimet, nëse ka, për njësinë (ekonomike).
    - (v) Një tregues të nivelit të pjesëmarrjes së njësisë në skemë krahasuar me njësitë e tjera pjesëmarrëse. Shembuj masash që mund të ofrojnë një tregues të tillë përfshijnë

pjesën përkatëse të kontributeve totale në skemë ose pjesën përkatëse të numrit total të anëtarëve aktivë, anëtarëve në pension, dhe ish-anëtarëve që kanë të drejtë për përfitime, nëse ky informacion është i disponueshëm.

*Skemat e Përfitimeve të Përcaktuara që Ndajnë Rreziqet ndërmjet Njësive nën Kontrollin e Përbashkët*

151. Nëse një njësi merr pjesë në një skemë me përfitime të përcaktuara që ndan rreziqet ndërmjet njësive nën kontroll të përbashkët, ajo do të paraqesë:
- (a) Marrëveshjen kontraktuale ose politikën e deklaruar për tarifimin e kostos neto të përfitimit të përcaktuar ose faktin se nuk ekziston një politikë e tillë.
  - (b) Politikën për përcaktimin e kontributit që duhet të paguhet nga njësia.
  - (c) Nëse njësia kontabilizon një alokim të kostos neto të përfitimit të përcaktuar siç vihet në dukje në paragrafin 41, i gjithë informacioni rreth skemës në tërësi kërkohet nga paragrafët 137-149.
  - (d) Nëse njësia kontabilizon kontributin e pagueshëm për periudhën siç përshkruhet në paragrafin 41, informacioni për skemën në tërësi kërkohet nga paragrafët 137–139, 141, 144–146 dhe 149(a) dhe (b).
152. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 151(c) dhe (d) mund të jepet duke i kryqëzuar informacionet shpjeguese në pasqyrat financiare të një njësie tjetër të grupit nëse:
- (a) Pasqyrat financiare të këtij grupi identifikojnë dhe paraqesin veç informacionin e kërkuar për skemën; dhe
  - (b) Pasqyrat financiare të njësisë së këtij grupi janë të disponueshme për përdoruesit e pasqyrave financiare në të njëjtat kushte si pasqyrat financiare të njësisë dhe në të njëjtën kohë, ose më herët se, pasqyrat financiare të njësisë.

*Kërkesat për Dhënie Informacione Shpjeguese në SNKSP-të e Tjera*

153. Aty ku kërkohet nga SNKSP 20, një njësi jep informacione për:
- (a) Transaksionet e palëve të lidhura me skemat e përfitimeve pas punësimit; dhe
  - (b) Përfitimet pas punësimit për personelin drejtues kryesor.

154. Aty ku kërkohet nga SNKSP 19, një njësi jep informacione për detyrimet e kushtëzuara që vijnë nga detyrimet e përfitimeve pas punësimit.

### **Përfitime të Tjera Afatgjata të Punonjësve**

155. Përfitimet e tjera afatgjata të punonjësve përfshijnë artikuj të tillë si në vijim, nëse nuk pritet të shlyhen tërësisht përpara dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës së raportimit në të cilën punonjësit kryejnë shërbimin përkatës:
- (a) Pagesat për mungesat afatgjatë në punë si p.sh. shërbimi i gjatë ose fundjavë e gjatë;
  - (b) Përvjetore të rëndësishëm ose përfitime të tjera të shërbime afatgjatë;
  - (c) Përfitime afatgjata që lidhen me aftësinë e kufizuar;
  - (d) Ndarja e fitimit dhe bonuset;
  - (e) Shpërblimi i shtyrë; dhe
  - (f) Kompensimi i pagueshëm nga njësia derisa një individ të hyjë në një punë të re.
156. Matja e përfitimeve të tjera afatgjata të punonjësve zakonisht nuk i nënshtrohet të njëjtës shkallë pasigurie si matja e përfitimeve pas punësimit. Për këtë arsye, ky Standard kërkon një metodë të thjeshtuar të kontabilitetit për përfitimet e tjera afatgjata të punonjësve. Ndryshe nga kontabiliteti i kërkuar për përfitimet pas punësimit, kjo metodë nuk njuh rimatjet në aktivet/kapitalin neto.
157. Ky Standard përfshin një supozim të kundërshtueshëm se pagesat afatgjata të aftësisë së kufizuar zakonisht nuk i nënshtrohen të njëjtës shkallë pasigurie si matja e përfitimeve pas punësimit. Kur ky supozim nuk është i vërtetë, njësia konsideron nëse disa ose të gjitha pagesat afatgjata të aftësisë së kufizuar duhet të kontabilizohen në përputhje me paragrafët 57–154.

### **Njohja dhe Matja**

158. **Në njohjen dhe matjen e sufiçitit ose defiçitit në një skemë tjetër përfitimi afatgjatë të punonjësve, një njësi do të zbatojë paragrafët 58–100 dhe 115–117. Një njësi do të zbatojë paragrafët 118–121 në njohjen dhe matjen e çdo të drejte rimbursimi.**
159. **Për përfitime të tjera afatgjata të punonjësve, një njësi do të njohë totalin neto të shumave të mëposhtme në sufiçit ose defiçit, me përjashtim të masës që një SNKSP tjetër kërkon ose lejon përfshirjen e tyre në koston e një aktivi:**

- (a) **Koston e shërbimit (shih paragrafët 68–114 dhe paragrafin 124A);**
  - (b) **Interesi neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara (shih paragrafët 125-128); dhe**
  - (c) **Rimatjet e detyrimit (aktivit) neto të përfitimeve të përcaktuara (shih paragrafët 129–132).**
160. Një formë e përfitimit tjetër afatgjatë të punonjësve është përfitimi afatgjatë i aftësisë së kufizuar. Nëse niveli i përfitimit varet nga kohëzgjatja e shërbimit, një detyrim lind kur shërbimi kryhet. Matja e këtij detyrimi pasqyron probabilitetin që do të kërkohet pagesa, dhe kohëzgjatjen për të cilën pritet të bëhet pagesa. Nëse niveli i përfitimit është i njëjtë për çdo punonjës me aftësi të kufizuar, pavarësisht viteve të shërbimit, kostoja e prishme e këtyre përfitimeve njihet kur ndodh një ngjarje që shkakton një aftësi të kufizuar afatgjatë.

### **Dhënia e Informacioneve Shpjeguese**

161. Megjithëse ky Standard nuk kërkon paraqitje informacionesh shpjegues specifike për përfitime të tjera afatgjata të punonjësve, SNKSP-të e tjera mund të kërkojnë paraqitje informacionesh shpjegues. Për shembull, SNKSP 20 kërkon paraqitje informacionesh për përfitimet e punonjësve për personelin drejtues kryesor. SNKSP 1 kërkon paraqitjen e informacioneve për shpenzimet e përfitimeve të punonjësve.

### **Përfitimet e Përfundimit të Punësimit**

162. Ky Standard trajton përfitimet e përfundimit të punësimit veç nga përfitimet e tjerë të punonjësve, sepse ngjarja që krijojnë një detyrim është përfundimi i punësimit dhe jo shërbimi i punonjësit. Përfitimet e përfundimit të punësimit rezultojnë ose nga vendimi i një njësie për të ndërprerë punësimin ose nga vendimi i një punonjësi për të pranuar ofertën e përfitimeve të një njësie në këmbim të përfundimit të punësimit.
163. Përfitimet nga përfundimi i punësimit nuk përfshijnë përfitimet e punonjësve që rezultojnë nga përfundimi i punësimit me kërkesë të punonjësit pa ofertën e një njësie, ose si rezultat i kërkesave të detyrueshme të daljes në pension, sepse këta përfitime janë përfitime pas punësimit. Disa njësi japin një nivel më të ulët përfitimi për përfundimin e punësimit me kërkesë të punonjësit (në thelb, një përfitim pas punësimit) sesa për përfundimin e punësimit me kërkesë të njësisë. Diferenca midis përfitimit të dhënë për ndërprerjen e punësimit me kërkesë të punonjësit dhe një përfitimi më të lartë të dhënë me kërkesë të njësisë është një përfitim nga përfundimi i punësimit.
164. Forma e përfitimit të punonjësit nuk përcakton nëse ai jepet në këmbim

të shërbimit apo në këmbim të përfundimit të punësimit të punonjësit. Përfitimet e përfundimit të punësimit janë zakonisht pagesa në një shumë të vetme, por ndonjëherë përfshijnë gjithashtu:

- (a) Përmirësimin e përfitimeve pas punësimit, qoftë në mënyrë indirekte nëpërmjet një skeme përfitimesh të punonjësve ose drejtpërdrejt.
- (b) Paga deri në fund të një periudhe të caktuar njoftimi nëse punonjësi nuk kryen ndonjë shërbim të mëtejshëm që ofron përfitime ekonomike për njësinë.

165. Treguesit që një përfitim punonjësi jepet në këmbim të shërbimeve përfshijnë të mëposhtmet:

- (a) Përfitimi kushtëzohet nga dhënia e shërbimit të ardhshëm (përfshirë përfitimet që rriten nëse jepet shërbim i mëtejshëm).
- (b) Përfitimi jepet në përputhje me kushtet e një skeme përfitimi të punonjësve.

166. Disa përfitime nga përfundimi i punësimit jepen në përputhje me kushtet e një skeme ekzistuese të përfitimeve të punonjësve. Për shembull, ata mund të specifikohen me statut, kontratë pune ose marrëveshje sindikale, ose mund të nënkuptohen si rezultat i praktikës së mëparshme të punëdhënësit për të dhënë përfitime të ngjashme. Si një shembull tjetër, nëse një njësi vë në dispozicion një ofertë përfitimesh për më shumë se një periudhë të shkurtër, ose ka më shumë se një periudhë e shkurtër ndërmjet ofertës dhe datës së pritshme të përfundimit aktual të punësimit, njësia merr parasysh nëse ka krijuar një skemë të re përfitimesh të punonjësit dhe si rrjedhim nëse përfitimet e ofruara sipas asaj skeme janë përfitime të përfundimit të punësimit apo përfitime pas punësimit. Përfitimet e punonjësve të dhëna në përputhje me kushtet e një skeme përfitimesh të punonjësve janë përfitime të përfundimit të punësimit nëse të dyja rezultojnë nga vendimi i një njësie për të përfunduar punësimin e një punonjësi dhe nuk kushtëzohen nga dhënia e shërbimit në të ardhmen.

167. Disa përfitime të punonjësve jepen pavarësisht nga arsyeja e largimit të punonjësit. Pagesa e përfitimeve të tilla është e sigurt (në varësi të çdo kushti që e garanton ose kërkesave minimale të shërbimit), por koha e pagesës së tyre është e pasigurt. Megjithatë përfitime të tilla përshkruhen në disa juridiksione si dëmshpërblime për përfundimin e punësimit ose shpërblime për përfundimin e punës, ata janë përfitime pas punësimit dhe jo përfitime nga përfundimi i punës, dhe një njësi i kontabilizon ata si përfitime pas punësimit.

**Njohja**

168. **Një njësi do të njohë një detyrim dhe shpenzim për përfitimet e përfundimit të punësimit në datën më të hershme nga këto në vijim:**
- (a) Kur njësia nuk mund të tërheqë më ofertën e këtyre përfitimeve; dhe
  - (b) Kur njësia njuh kostot për një ristrukturim që është brenda fushëveprimit të SNKSP 19 dhe përfshin pagesën e përfitimeve nga përfundimi i punësimit.
169. Për përfitimet e përfundimit të punësimit të pagueshme si rezultat i vendimit të një punonjësi për të pranuar një ofertë përfitimesh në këmbim të përfundimit të punësimit, koha kur një njësi nuk mund të tërheqë më ofertën e përfitimeve të përfundimit të punësimit është më e hershme:
- (a) Kur punonjësi pranon ofertën; dhe
  - (b) Kur një kufizim (p.sh., një kërkesë ligjore, rregullatore ose kontraktuale ose kufizim tjetër) në aftësinë e njësisë për të tërhequr ofertën hyn në fuqi. Kjo do të ishte kur oferta bëhet, nëse kufizimi ekzistonte në kohën e ofertës.
170. Për përfitimet e përfundimit të punësimit të pagueshme si rezultat i vendimit të një njësie për të përfunduar punësimin e një punonjësi, njësia nuk mund ta tërheqë më ofertën kur njësia u ka komunikuar punonjësve të prekur një skemë përfundimi të punësimit që plotëson të gjitha kriteret e mëposhtme:
- (a) Veprimet e nevojshme/e kërkuara për të përfunduar skemën tregojnë se nuk ka gjasa që të bëhen ndryshime të konsiderueshme në skemë.
  - (b) Skema identifikon numrin e punonjësve, punësimi i të cilëve do të ndërpritet, klasifikimet ose funksionet e tyre të punës dhe vendndodhjet e tyre (por skema nuk ka nevojë të identifikojë çdo punonjës individual) dhe datën e pritshme të përfundimit të punësimit.
  - (c) Skema përcakton përfitimet e përfundimit të punësimit që punonjësit do të marrin në detaje të mjaftueshme që punonjësit të mund të përcaktojnë llojin dhe shumën e përfitimeve që do të marrin kur të ndërpritet punësimi.
171. Kur një njësi njuh përfitime nga përfundimi i punësimit, njësisë mund t'i duhet gjithashtu të kontabilizojë një ndryshim të skemës ose një reduktim të përfitimeve të tjera të punonjësve (shih paragrafin 105).

**Matja**

172. **Një njësi do të matë përfitimet e përfundimit të punësimit në njohjen**

fillestare, dhe do të matë dhe njohë ndryshimet e mëvonshme, në përputhje me natyrën e përfitimit të punonjësve, me kusht që nëse përfitimet nga përfundimi i punësimit janë një përmirësim për përfitimet pas punësimit, njësia do të zbatojë kërkesat për përfitimet pas punësimit. Përndryshe:

- (a) Nëse përfitimet e përfundimit të punësimit priten të shlyhen plotësisht përpara dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës së raportimit në të cilën njihet përfitimi nga përfundimi i punësimit, njësia do të zbatojë kërkesat për përfitimet afatshkurtra të punonjësve.
- (b) Nëse përfitimet e përfundimit të punësimit nuk priten të shlyhen plotësisht përpara dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës së raportimit, njësia do të zbatojë kërkesat për përfitime të tjera afatgjata të punonjësve.

173. Për shkak se përfitimet e përfundimit të punësimit nuk jepen në këmbim të shërbimit, paragrafët 72-76 në lidhje me atribuimin e përfitimit ndaj periudhave të shërbimit nuk janë relevantë.

#### **Dhënia e Informacioneve Shpjeguese**

174. Megjithëse ky Standard nuk kërkon dhënie informacionesh shpjeguese specifike për përfitimet e përfundimit të punësimit, SNKSP-të e tjera mund të kërkojnë të jepen informacione shpjegues. Për shembull, SNKSP 20 kërkon të jepen informacione shpjegues për përfitimet e punonjësve për personelin drejtues kryesor. SNKSP 1 kërkon të jepen informacione shpjegues për shpenzimet e përfitimeve të punonjësve.

#### **Dispozita Kalimtare**

175. Një njësi do të zbatojë këtë Standard në mënyrë retrospektive, në përputhje me SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, përveç se:

- (a) Një njësi nuk ka nevojë të rregullojë vlerën e mbartur të aktiveve jashtë fushëveprimit të këtij Standardi për ndryshimet në kostot e përfitimeve të punonjësve që janë përfshirë në vlerën e mbartur përpara datës së aplikimit fillestar. Data e aplikimit fillestar është fillimi i periudhës më të hershme të mëparshme të prezantuar në pasqyrat e para financiare në të cilat njësia adopton këtë Standard.
- (b) Në pasqyrat financiare për periudhat që fillojnë përpara datës 1 janar, 2018, nuk është e nevojshme që një njësi të prezantojë informacion krahasues për informacionet e kërkuara nga paragrafi 147 për ndjeshmërinë/sensitivitetin e detyrimit të përfitimeve të përcaktuara.



## Data Efektive

176. Një njësi do të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2018. Adoptimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.

176A.

Paragrafët 59, 101, 122, 125, 127, 128 dhe 159 u ndryshuan, dhe paragrafët 103A, 124A dhe 125A u shtuan nga *Përmirësime të SNKSP-ve, 2018*, botuar në tetor 2018. Një njësi do të zbatojë këta ndryshime të amendamenteve, reduktimeve ose shlyerjeve të skemës që ndodhin në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në ose pas datës 1 janar, 2019. Aplikimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi i zbaton këta ndryshime më herët, ajo do të paraqesë informacion për këtë fakt.

177. Kur një njësi adopton SNKSP-të e kontabilitetit sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, siç përkufizohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive*, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të SNKSP-ve.

## Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 25 (2008)

178. Ky Standard zëvendëson SNKSP 25, *Përfitimet e Punonjësve (2008)*. SNKSP 25 mbetet i zbatueshëm derisa SNKSP 39 të zbatohet ose të hyjë në fuqi, cilado të jetë më herët.

## **SNKSP 40—KOMBINIMET E SEKTORIT PUBLIK**

### **Shënime të Mirënjohjes**

Kërkesat për kontabilitetin e blerjeve të këtij Standardi Ndërkombëtar të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) bazohen në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 3, *Kombinimet e Biznesit*, publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ekstraktet nga SNRF 3 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Customer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: [publications@ifrs.org](mailto:publications@ifrs.org)

Internet: [www.ifrs.org](http://www.ifrs.org)

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

## SNKSP 40—KOMBINIMET E SEKTORIT PUBLIK

### Historia e SNKSP

*Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e publikuara deri më 31 janar, 2019.*

SNKSP 40, Kombinimet e Sektorit Publik u publikua në janar 2017.

Që atëherë, SNKSP 40 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

☐ *Përmirësime të SNKSP-ve 2018* (botuar në tetor 2018)

SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* (botuar në gusht 2018)

Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 40

| Paragrafi i Ndikuar | Si u Ndikua | Ndikuar Nga                        |
|---------------------|-------------|------------------------------------|
| 25                  | U Ndryshua  | SNKSP 41 Gusht 2018                |
| 45                  | U Ndryshua  | SNKSP 41 Gusht 2018                |
| 70                  | U Ndryshua  | SNKSP 41 Gusht 2018                |
| 100A                | I Ri        | Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018 |
| 111                 | U Ndryshua  | SNKSP 41 Gusht 2018                |
| 115                 | U Ndryshua  | SNKSP 41 Gusht 2018                |
| 117                 | U Ndryshua  | SNKSP 41 Gusht 2018                |
| 126A                | I Ri        | SNKSP 41 Gusht 2018                |
| 126B                | I Ri        | Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018 |
| AG88                | U Ndryshua  | SNKSP 41 Gusht 2018                |

## SNKSP 40—KOMBINIMET E SEKTORIT PUBLIK

## PËRMBAJTJA

|                                                                                                                                                | Paragrafi |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Objektivi.....                                                                                                                                 | 1         |
| Objekti .....                                                                                                                                  | 2–4       |
| Përkufizime.....                                                                                                                               | 5         |
| Identifikimi i një Kombinimi të Sektorit Publik.....                                                                                           | 6         |
| Klasifikimi i Kombinimeve të Sektorit Publik .....                                                                                             | 7–14      |
| Treguesit që Mund të Japin Evidencë se Kombinimi është një<br>Bashkim.....                                                                     | 12–14     |
| Kontabiliteti për Bashkimet .....                                                                                                              | 15        |
| Metoda e Grupimit të Modifikuar të Interesave Në Kontabilitet .....                                                                            | 16–57     |
| Identifikimi i Njesisë Rezultuese .....                                                                                                        | 17–18     |
| Përcaktimi i Datës së Bashkimit .....                                                                                                          | 19–20     |
| Njohja dhe Matja e Aktiveve të Identifikueshëm, Detyrimeve të Ndërmarrë<br>dhe çdo Interesi Jokontrollues në Operacionet e Kombinimit<br>..... | 21–35     |
| Njohja dhe Matja e Elementeve të Aktiveve/Kapitalit Neto që Krijohen<br>si Rezultat i një Bashkimi .....                                       | 36–39     |
| Periudha e Matjes.....                                                                                                                         | 40–44     |
| Kostot e Lidhura me Bashkimin 45                                                                                                               |           |
| Matja e Mëpasshme dhe Kontabiliteti.....                                                                                                       | 46–49     |
| Paraqitja e Pasqyrave Financiare.....                                                                                                          | 50–52     |
| Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.....                                                                                                        | 53–57     |
| Kontabiliteti për Blerjet .....                                                                                                                | 58        |
| Metoda e Blerjes .....                                                                                                                         | 59–125    |
| Identifikimi i Blerësit .....                                                                                                                  | 60–61     |
| Përcaktimi i Datës së Blerjes.....                                                                                                             | 62–63     |

|                                                                                                                                                                                                        |         |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|
| Njohja dhe Matja e Aktiveve të Identifikueshëm të Blerë, Detyrimeve të Ndërrmarra dhe çdo Interesi Jokontrollues në Operacionin e Blerë .....                                                          | 64–84   |
| Njohja dhe Matja e Emrit të Mirë ose një Fitimi nga një Blerje me Zbritje .....                                                                                                                        | 85–98   |
| Një Blerje e Realizuar në Faza .....                                                                                                                                                                   | 99–100  |
| Udhëzime Shtesë për Aplikimin e Metodës së Blerjes Ku një Blerje Arrihet Nëpërmjet Ndryshimeve në të Drejtat e Votimit vetëm me Kontratë, dhe Rrethana të Ngjashme në të Cilat Pagesa nuk Transferohet | 101–102 |
| Periudha e Matjes .....                                                                                                                                                                                | 103–108 |
| Përcaktimi i Asaj që është Pjesë e Transaksionit të Blerjes .....                                                                                                                                      | 109–111 |
| Matja e Mëpasshme dhe Kontabiliteti.....                                                                                                                                                               | 112–118 |
| Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.....                                                                                                                                                                | 119–125 |
| Data Efektive dhe Periudha kalimtare.....                                                                                                                                                              | 126–134 |
| Data Efektive .....                                                                                                                                                                                    | 126     |
| Periudha Kalimtare .....                                                                                                                                                                               | 127–134 |

---

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, janë të përcaktuara në paragrafët 1–134. Të gjitha paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 40 duhet të lexohet në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit në mungesë të udhëzimeve të qarta.

## Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të përmirësojë përshtatshmërinë, përfaqësimin besnik dhe krahasueshmërinë e informacionit që një njësi (ekonomike) raportimi jep në pasqyrat e saj financiare për një kombinim të sektorit publik dhe efektet e tij. Për ta arritur këtë, ky Standard vendos parimet dhe kërkesat se si:
  - (a) Një njësi raportuese klasifikon një kombinim të sektorit publik si një bashkim ose një blerje;
  - (b) Një njësi rezultuese njeh dhe mat në pasqyrat e saj financiare aktivet e identifikueshëm të marrë, detyrimet e ndërmarrë dhe çdo interes jokontrollues në një bashkim;
  - (c) Një njësi rezultuese njeh dhe mat përbërësit e aktiveve/kapitalit neto dhe rregullime të tjerë të njohur në një bashkim;
  - (d) Një blerës njeh dhe mat në pasqyrat e tij financiare aktivet e identifikueshëm të blerë, detyrimet e ndërmarra dhe çdo interes jokontrollues në operacionin e blerë;
  - (e) Një blerës njeh dhe mat emrin e mirë të marrë, ose fitimin apo humbjen që vjen nga, një blerje; dhe
  - (f) Një njësi raportuese përcakton se çfarë informacioni duhet të paraqesë për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë natyrën dhe efektet financiare të një kombinimi të sektorit publik.

## Objekti

2. Një njësi që përgatit dhe paraqet pasqyrat financiare sipas kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara do të zbatojë këtë Standard në kontabilitetin për kombinimet e sektorit publik.
3. Ky Standard zbatohet për një transaksion ose ngjarje tjetër që plotëson përkufizimin e një kombinimi të sektorit publik. Ky standard nuk zbatohet për:
  - (a) Kontabilizimin për formimin e një marrëveshjeje të përbashkët në pasqyrat financiare të vetë marrëveshjes ë përbashkët.
  - (b) Blerjen ose marrjen e një aktivi ose një grupi aktivesh (dhe çdo detyrimi të lidhur me ta) që nuk përbën një operacion. Në raste të tilla, një njësi do të identifikojë dhe njohë aktivet individualë të identifikueshëm të blerë ose të marrë (duke përfshirë ato aktive që plotësojnë përkufizimin dhe kriteret e

njohjes së aktiveve jomaterialë në SNKSP 31, *Aktivët Afatgjatë Jomateriale*) dhe detyrimet e lindura. Një transaksion ose ngjarje e tillë nuk krijon emër të mirë.

- (c) Supozimin e një detyrimi ose i një grupi detyrimesh që nuk përbën një operacion. Në raste të tilla, një njësi do të identifikojë dhe njohë detyrimet individuale të ndërmarra.
4. Kërkesat e këtij Standardi nuk zbatohen për blerjen nga një njësi investuese, siç përcaktohet në SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara*, të një investimi në një njësi të kontrolluar që kërkohet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit.

#### Përkufizime

5. Termat e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuar:

Një **kombinim i sektorit publik** është bashkimi i operacioneve të veçanta në një njësi të sektorit publik.

Përkufizime të Përgjithshme që Lidhen me të Gjithë Kombinimet e Sektorit Publik

Për qëllimet e këtij Standardi, **interesat e kapitalit** përdoren gjerësisht për të nënkuptuar interesat e pronësisë së njësive në pronësi të investuesve dhe interesat e pronarëve, anëtarëve ose pjesëmarrësve të njësive të përbashkëta.

Një aktiv është **i identifikueshëm** nëse:

- (a) Është i ndashëm, d.m.th mund të veçohet ose ndahet nga njësia dhe të shitet, transferohet, liçencohet, jepet me qira, ose shkëmbehet, individualisht ose së bashku me një marrëveshje detyruese të lidhur me të, aktiv ose detyrim të identifikueshëm, pavarësisht nëse njësia synon të bëjë këtë; ose
- (b) Krijohet nga marrëveshjet detyruese (përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore), pavarësisht nëse këto të drejta janë të transferueshme ose të ndashme nga njësia ose nga të drejta dhe detyrime të tjera.

Një **njësi e përbashkët** është një njësi, e ndryshme nga një njësi në pronësi të investuesit, që jep dividendë, kosto më të ulëta ose përfitime të tjera ekonomike drejtpërdrejt për pronarët, anëtarët ose pjesëmarrësit e saj. Për shembull, një kompani sigurimi e



përbashkët, një bashkim krediti dhe një njësi ko-operative janë të gjitha njësi të përbashkëta.

Një **operacion** është një grup i integruar aktivitetesth dhe aktivesh dhe/ose detyrimesh të lidhura që mund të kryhen dhe menaxhohen me qëllim të arritjes së objektivave të një njësie, duke ofruar mallra dhe/ose shërbime.

Për qëllime të këtij standardi, **pronarët** përdoret gjërësisht për të përfshirë çdo palë me interesa pronësie të matshëm në një operacion. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në, mbajtësit e interesave të kapitalit të njëjësive në pronësi të investuesve dhe pronarëve ose anëtarëve të, ose pjesëmarrësve në, njësi të përbashkëta.

Një **kombinim i sektorit publik nën kontroll të përbashkët** është një kombinim i sektorit publik, në të cilin të gjitha njësitë ose operacionet e përfshira kontrollohen përfundimisht nga e njëjta njësi, si para ashtu edhe pas kombinimit të sektorit publik.

Përkufizime që Lidhen me Bashkimet

Një **bashkim** krijon një njësi të re dhe është ose:

- (a) Një kombinim i sektorit publik në të cilin asnjë palë në kombinim nuk fiton kontrollin e një ose më shumë operacioneve; ose
- (b) Një kombinim i sektorit publik në të cilin njëra palë në kombinim fiton kontrollin e një ose më shumë operacioneve, dhe në të cilën ka evidencë se kombinimi ka thelbin ekonomik të një bashkimi.

(Paragrafi AG1 jep udhëzime shtesë.)

**Data e bashkimit** është data në të cilën njësia rezultuese merr kontrollin e operacioneve të kombinuara.

Një **operacion i kombinuar** është një operacion që kombinohet me një ose më shumë operacione të tjerë për të formuar njësinë e re në një bashkim.

Një **njësi rezultuese (e re)** është njësia që është rezultat i dy ose më shumë operacioneve të kombinuara në një bashkim (paragrafi AG1 jep udhëzime shtesë).

Përkufizime që Lidhen me Blerjet

Një **operacion i blerë** është operacion mbi të cilin blerësi fiton kontrollin në një blerje.

Një **blerës** është njësia që fiton kontrollin e një ose më shumë operacioneve në një blerje.

Një **blerje** është një kombinim i sektorit publik në të cilin njëra palë në kombinim fiton kontrollin e një ose më shumë operacioneve, dhe ka evidencë se kombinimi nuk është një bashkim.

**Data e blerjes** është data në të cilën blerësi fiton kontrollin e operacionit të blerë.

**Shuma e kushtëzuar** është zakonisht një detyrim i blerësit për të transferuar aktive shtesë ose interesa të kapitalit tek ish-pronarët e një operacioni të blerë si pjesë e këmbimit për kontrollin e operacionit të blerë nëse ndodhin ngjarje të caktuara të ardhshme ose plotësohen kushtet. Megjithatë, shuma e kushtëzuar gjithashtu mund t'i japë blerësit të drejtën për kthimin e shumës së transferuar më parë nëse plotësohen kushtet e specifikuar.

**Emri i mirë** është një aktiv që përfaqëson përfitimet e ardhshme ekonomike që vijnë nga aktive të tjerë të marrë në një blerje që nuk janë identifikuar dhe njohur veç.

Termet e përkufizuar në SNKSP-të e tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ato Standarde dhe riprodhohen në *Fjalorin e Termave të Përkufizuar* publikuar veçmas.

## Identifikimi i një Kombinimi të Sektorit Publik

6. Një njësi do të përcaktojë nëse një transaksion ose një ngjarje tjetër është një kombinim i sektorit publik duke zbatuar përkufizimet në këtë Standard, i cili kërkon që aktivet dhe detyrimet të përbëjnë një operacion. Nëse aktivet dhe detyrimet nuk përbëjnë një operacion, njësia do të kontabilizojë transaksionin ose ngjarjen tjetër në përputhje me SNKSP-të e tjera. Paragrafët AG2-AG9 japin udhëzime për identifikimin e një kombinimi të sektorit publik.

## Klasifikimi i Kombinimeve të Sektorit Publik

7. Nëse asnjë palë në një kombinim të sektorit publik nuk fiton kontrollin e një ose më shumë operacioneve si rezultat i kombinimit, kombinimi do të klasifikohet si një bashkim. Paragrafët AG10–AG18 japin udhëzime për përcaktimin nëse njëra palë në një kombinim të sektorit publik fiton kontrollin e një ose më shumë operacioneve si rezultat i atij kombinimi.
8. Nëse njëra palë në një kombinim të sektorit publik fiton kontrollin e një ose më shumë operacioneve si rezultat i kombinimit, një njësi do të marrë në konsideratë substancën ekonomike të kombinimit në klasifikimin e kombinimit ose si një bashkim ose si një blerje. Një kombinim në të cilin njëra palë fiton kontrollin e një ose më shumë operacioneve do të klasifikohet si një blerje, përveç nëse ka thelbin

ekonomik të një bashkimi.

9. Në përcaktimin e klasifikimit të kombinimit të sektorit publik, një njësi merr parasysh nëse trajtimi kontabël i kombinimit që rezulton ofron informacion që plotëson objektivat e raportimit financiar dhe që plotëson Karakteristikat Cilësore (KC). Për të vlerësuar thelbin ekonomik të kombinimit, një njësi merr parasysh treguesit që lidhen me shumën/pagesën dhe procesin e vendimmarrjes në paragrafët 12–13. Këta tregues, individualisht ose të kombinuar, zakonisht do të japin evidencë se substanca ekonomike e kombinimit është ajo e një bashkimi. Nuk është e nevojshme që një kombinim të plotësojë të dy këta tregues për t'u klasifikuar si një bashkim. Paragrafët AG19–AG39 ofrojnë udhëzime shtesë.
10. Një analizë e treguesve në lidhje me shumën dhe procesin e vendimmarrjes në paragrafët 12-13 zakonisht do të prodhojë një rezultat përfundimtar dhe do të japë evidencë të mjaftueshme për substancën ekonomike të kombinimit të sektorit publik për të përcaktuar nëse kombinimi është një bashkim. Në rrethana të tilla, klasifikimi që rezulton dhe trajtimi kontabël shoqërues do të sigurojë që përdoruesit të kenë të drejtë në informacionin që plotëson objektivat e raportimit financiar dhe që plotëson KC-në.
11. Në rrethana të jashtëzakonshme, pas aplikimit të treguesve në paragrafët 12-13, rezultatet mund të mos jenë përfundimtarë ose mund të mos japin evidencë të mjaftueshme për substancën ekonomike të kombinimit të sektorit publik. Në rrethana të tilla, një njësi konsideron gjithashtu se cili klasifikim do të jepte informacionin që përmbush më mirë objektivat e raportimit financiar dhe që plotëson më mirë KC-të, duke pasur parasysh paragrafin 14. Paragrafët AG40–AG41 ofrojnë udhëzime shtesë.

### **Treguesit që Mund të Japin Evidencë se Kombinimi është një Bashkim**

#### *Treguesit e Lidhur me Shumën*

12. Treguesit e mëposhtëm mund të japin evidencë se kombinimi është një bashkim:
  - (a) Shuma paguhet për arsye të ndryshme nga kompensimi i atyre që kanë të drejtën mbi aktivet neto të një operacioni të transferuar për heqjen dorë nga ajo e drejtë (paragrafët AG27–AG28 ofrojnë udhëzime shtesë);
  - (b) Shuma nuk u paguhet atyre që kanë të drejtën mbi aktivet neto të një operacioni të transferuar (paragrafët AG29–AG30 ofrojnë udhëzime shtesë); ose
  - (c) Shuma nuk paguhet sepse nuk ka asnjë të identifikuar (qoftë një

individ apo një njësi) me të drejtën mbi aktivet neto të një njësie (ekonomike) të transferuar (paragrafi AG31 ofron udhëzime shtesë).

*Treguesit e Lidhur me Procesin e Vendimmarrjes*

13. Treguesit e mëposhtëm mund të japin evidencë se kombinimi është një bashkim:
- (a) Një kombinim i sektorit publik imponohet nga një palë e tretë pa përfshirë asnjë palë në kombinim në procesin e vendimmarrjes (paragrafët AG32–AG35 ofrojnë udhëzime shtesë);
  - (b) Një kombinim i sektorit publik i nënshtrohet aprovimit nga qytetarët e secilës palë nëpërmjet referendumeve (paragrafi AG36 ofron udhëzime shtesë); ose
  - (c) Ndodh një kombinim i sektorit publik nën kontroll të përbashkët (paragrafët AG37–AG39 ofrojnë udhëzime shtesë).

*Çështje shtesë që duhet të merren parasysh kur treguesit e lidhur me shumën dhe procesin e vendimmarrjes nuk japin evidencë të mjaftueshme për të përcaktuar nëse kombinimi është një bashkim.*

14. Analiza e treguesve në lidhje me shumën dhe procesin e vendimmarrjes, në rrethana të jashtëzakonshme, mund të prodhojë rezultate jopërfundimtare ose të mos japë evidencë të mjaftueshme për të përcaktuar nëse kombinimi është një bashkim, bazuar në thelbin ekonomik të kombinimit të sektorit publik dhe treguesve në paragrafët 12-13. Në rrethana të tilla, një njësi merr parasysh se cili klasifikim dhe trajtim kontabël që rezultojnë do të jepte informacionin që plotëson më mirë objektivat e raportimit financiar. Paragrafët AG42–AG46 ofrojnë udhëzime shtesë. Një njësi konsideron gjithashtu se cili klasifikim dhe trajtim kontabël rezultues do të jepte informacionin që plotëson më mirë KC-të relevante, përfaqësimin besnik, kuptueshmërinë, korrektësinë kohore, krahasueshmërinë dhe verifikueshmërinë. Paragrafët AG47–AG50 ofrojnë udhëzime shtesë.

## **Kontabiliteti për Bashkimet**

15. **Një njësi e re e dalë nga bashkimi do të kontabilizojë çdo bashkim duke zbatuar metodën e kontabilitetit të grupimit të modifikuar të interesave.**

### **Metoda e Grupimit të Modifikuar të Interesave në Kontabilitet**

16. Zbatimi i metodës së grupimit të modifikuar të interesave të kontabilitetit

kërkon:

- (a) Identifikimin e njësisë rezultuese (të re);
- (b) Përcaktimin e datës së bashkimit;
- (c) Njohjen dhe matjen e aktiveve të identifikueshëm të marrë, detyrimeve të ndërmarrë dhe çdo interesi jokontrollues në operacionet e kombinuara, në përputhje me kërkesat në SNKSP-të; dhe
- (d) Njohjen dhe matjen e përbërësve të aktiveve/kapitalit neto dhe rregullime të tjera nga një bashkim.

### **Identifikimi i Njësisë Rezultuese (Njësia e Re)**

- 17. **Për çdo bashkim, duhet të identifikohet një njësi e re.**
- 18. Paragrafi 5 i këtij Standardi përcakton një njësi rezultuese si "njësia ekonomike që është rezultat i dy ose më shumë operacioneve të kombinuara në një bashkim". Njësia rezultuese do të identifikohet më pas si njësi që merr kontrollin e operacioneve të kombinuara si rezultat i bashkimit.

### **Përcaktimi i Datës së Bashkimit**

- 19. **Njësia rezultuese do të identifikojë datën e bashkimit, e cila është data në të cilën ajo merr kontrollin e operacioneve të kombinuara.**
- 20. Data në të cilën njësi rezultuese merr kontrollin e operacioneve të kombinuara mund të jetë data në të cilën njësi rezultuese merr aktivet dhe merr përsipër detyrimet e operacioneve të kombinuara. Është e mundur që njësi rezultuese të mos marrë titullin ligjor të aktiveve ose të marrë përgjegjësi ligjore për detyrimet e operacioneve të kombinuara. Në këto rrethana, njësi rezultuese do të marrë shpesh kontrollin e aktiveve dhe detyrimeve të operacioneve të kombinuara në datën në të cilën përgjegjësia për aktivet dhe detyrimet i delegohet zyrtarisht njësisë rezultuese. Megjithatë, njësi rezultuese mund të marrë kontrollin në një datë tjetër. Për shembull, legjislacioni ose një marrëveshje me shkrim mund të parashikojë që njësi rezultuese të marrë kontrollin e aktiveve dhe detyrimeve të operacioneve të kombinuara në një datë të caktuar. Një njësi rezultuese do të marrë parasysht të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse në identifikimin e datës së bashkimit.

### **Njohja dhe Matja e Aktiveve të Identifikueshëm, Detyrimeve të Ndërmarra dhe çdo Interesi Jokontrollues në Operacionet e Kombinuara**

*Parimi i Njohjes*

- 21. **Që nga data e bashkimit, njësi rezultuese do të njohë aktivet e identifikueshëm, detyrimet dhe çdo interes jokontrollues që njihet**

**në pasqyrat financiare të operacioneve të kombinuara në datën e bashkimit. Njohja e aktiveve dhe detyrimeve të identifikueshëm të marra i nënshtrohet kushteve të specifikuara në paragrafët 22-23.**

Kushtet e Njohjes

22. **Efektet e të gjithë transaksioneve ndërmjet operacioneve të kombinuara eliminohen në përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë rezultuese (paragrafët AG51–AG52 ofrojnë udhëzime përkatëse për aplikim).**
23. Për t'u kualifikuar për njohje si pjesë e aplikimit të metodës së grupimit të modifikuar të interesave, aktivet dhe detyrimet e identifikueshëm duhet të plotësojnë përkufizimet e aktiveve dhe detyrimeve në *Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik* në datën e bashkimit. Për shembull, kostot që njësi rezultuese pret, por nuk është e detyruar, të shkaktojë në të ardhmen për të realizuar planin e saj për të dalë nga një aktivitet i një operacioni të kombinuar ose për të përfunduar punësimin ose për të zhvendosur punonjësit e një operacioni të kombinuar, nuk janë detyrime në datën e bashkimit. Prandaj, njësi rezultuese nuk i njej ato kosto si pjesë e aplikimit të metodës së grupimit të modifikuar të interesave. Në vend të kësaj, njësi rezultuese njej këto kosto në pasqyrat e saj financiare të pas-kombinimit në përputhje me SNKSP-të e tjera.

Klasifikimi ose Përcaktimi i Aktiveve dhe Detyrimeve në një Bashkim

24. **Në datën e bashkimit, njësi rezultuese do të klasifikojë ose përcaktojë aktivet dhe detyrimet e marra në një bashkim duke përdorur klasifikimet ose përcaktimet e aplikuara më parë nga operacionet e kombinuara. Një njësi rezultuese nuk do të adoptojë klasifikime ose emërtime të ndryshme në njohjen fillestare, edhe nëse kjo lejohet nga SNKSP-të e tjera.**
25. Në disa situata, SNKSP-të parashikojnë kontabilitet të ndryshëm në varësi të mënyrës se si një njësi klasifikon ose përcakton një aktiv ose detyrim të caktuar. Shembuj të klasifikimeve ose emërtimeve që njësi rezultuese do të bëjë në bazë të klasifikimeve ose emërtimeve të aplikuara më parë nga operacionet e kombinuara përfshijnë, por nuk kufizohen në:
- (a) Klasifikimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare të veçanta të matura me vlerën e drejtë ose me koston e amortizuar, në përputhje me SNKSP 41, *Instrumentet Financiare*;
  - (b) Përcaktimin e një instrumenti derivativ si një instrument mbrojtës në përputhje me SNKSP 41; dhe

- (c) Vlerësimi nëse një derivativ i përfshirë duhet të ndahet nga një kontratë bazë në përputhje me SNKSP 41 (i cili është një çështje 'klasifikimi' në mënyrën si ky Standard përdor atë term).

*Parimi i Matjes*

26. **Njësia rezultuese do të masë aktivet dhe detyrimet e identifikueshëm të operacioneve të kombinuara me vlerat e mbartura të tyre në pasqyrat financiare të operacioneve të kombinuara në datën e bashkimit, duke iu nënshtruar kërkesave të paragrafit 27 (paragrafët AG53-AG54 ofrojnë udhëzime përkatëse për aplikim).**
27. **Që nga data e bashkimit, njësia ekonomike rezultuese do të rregullojë vlerat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve të identifikueshëm të operacioneve të kombinuara, kur kërkohet që të jenë në përputhje me politikat kontabël të njësisë rezultuese.**
28. Metoda e grupimit të modifikuar të interesave rezulton në një njësi të re të vetme të kombinuar. Një grup i vetëm uniform politikash kontabël, në përputhje me kërkesat e SNKSP-ve, adoptohet nga ajo njësi, dhe vlerat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve të identifikueshëm të operacioneve të kombinuara rregullohen, aty ku kërkohet, për t'u përshtatur me këto politika kontabël.
29. Njësia rezultuese do të masë çdo interes jokontrollues në një operacion të kombinuar me vlerat e tyre të mbartura në pasqyrat financiare të atij operacioni të kombinuar në datën e bashkimit, të rregulluar për pjesën proporcionale të interesave jokontrolluese të rregullimeve të bëra në përputhje me paragrafin 27.
30. Paragrafët 33–35 përcaktojnë llojet e aktiveve dhe detyrimeve të identifikueshëm që përfshijnë artikujt për të cilët ky Standard ofron përjashtime të kufizuara nga parimi i matjes.

*Përjashtime nga Parimet e Njohjes dhe Matjes*

31. Ky Standard ofron përjashtime të kufizuara nga parimet e tij të njohjes dhe matjes. Paragrafët 32–35 specifikojnë si zërat e veçantë për të cilët jepen përjashtime, ashtu edhe natyrën e këtyre përjashtimeve. Njësia rezultuese do të kontabilizojë ata zëra duke zbatuar kërkesat në paragrafët 32-35, të cilat do të rezultojnë në disa zëra që janë:
- (a) Njohur ose duke zbatuar kushtet e njohjes krahas atyre në paragrafët 22-23 ose duke zbatuar kërkesat e SNKSP-ve të tjera, me rezultate që ndryshojnë nga zbatimi i parimit dhe kushteve të njohjes.

- (b) Matur me një shumë të ndryshme nga vlerat e mbartura të tyre në datën e bashkimit.

Përrjashtim nga Parimi i Njohjes

Liçencat dhe të drejtat e ngjashme të dhëna më parë nga një operacion i kombinuar në një operacion tjetër të kombinuar

32. Një licencë ose e drejtë e ngjashme, e dhënë më parë nga një operacion i kombinuar në një tjetër operacion të kombinuar dhe e njohur si një aktiv afatgjatë jomaterial nga operacioni i kombinuar marrës, do të njihet nga njësia rezultuese si një aktiv afatgjatë jomaterial. Licenca ose e drejta e ngjashme nuk do të eliminohet në përputhje me paragrafin 22 (paragrafët AG55–AG56 ofrojnë udhëzime përkatëse të aplikimit).

Përrjashtime për të dy Parimet e Njohjes dhe të Matjes

Tatimet mbi të Ardhurat (Kur Janë të Përrshira në Kushtet e Bashkimit)

33. Bashkimet që përrshijnë njësi të sektorit publik mund të rezultojnë në faljen nga një autoritet tatimor të shumave të detyrimeve tatimore si pjesë e kushteve të bashkimit. Njësia rezultuese nuk do të njohë ndonjë artikull tatimor që falet si rezultat i kushteve të bashkimit (paragrafët AG57–AG58 ofrojnë udhëzime përkatëse të aplikimit).
34. Njësia rezultuese do të njohë dhe masë çdo zë tatimor të mbetur të përrshirë ose që krijohet nga një bashkim në përputhje me standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton tatimet mbi të ardhurat. Njësia rezultuese do të njohë dhe masë çdo të ardhur të mbetur nga tatimi i përrshirë ose që vjen nga një bashkim në përputhje me SNKSP 23, *Të Ardhurat nga Transaksionet pa Këmbim (Taksat dhe Transfertat)*.

Përrfitimet e Punonjësve

35. Njësia rezultuese do të njohë dhe masë një detyrim (ose aktiv, nëse ka) që lidhet me marrëveshjet e përrfitimeve të punonjësve të operacionit të kombinuar në përputhje me SNKSP 39, *Përrfitimet e Punonjësve*.

**Njohja dhe Matja e Elementeve të Aktiveve/Kapitalit Neto që Krijohen si Rezultat i një Bashkimi**

36. **Një bashkim nuk krijon emrin e mirë (paragrafët AG59–AG60 ofrojnë udhëzime përkatëse të aplikimit).**
37. **Njësia rezultuese do të njohë brenda aktiveve/kapitalit neto shuma të barabarta dhe të kundërta me zërat e mëposhtëm:**
- (a) **Vlerat e mbartura të aktiveve të operacioneve të kombinuara;;**



- (b) **Vlerat e mbartura të detyrimeve të operacioneve të kombinuara; dhe**
  - (c) **Vlerat e mbartura të interesave jokontrolluese të operacioneve të kombinuara.**
38. **Njësia rezultuese do të njohë brenda aktiveve/kapitalit neto rregullimet përkatëse në lidhje me:**
- (a) **Elimininimin e transaksioneve ndërmjet operacioneve të kombinuara në përputhje me paragrafin 22;**
  - (b) **Rregullimet e bëra në vlerat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve të identifikueshëm të operacioneve të kombinuara kur kërkohet për të qenë konform politikave kontabël të njësisë rezultuese, në përputhje me paragrafin 27; dhe**
  - (c) **Rregullimet e bëra në lidhje me përjashtimet nga parimet e njohjes dhe/ose matjes, në përputhje me paragrafët 32-35.**
39. **Njësia rezultuese e re mund të paraqesë shumat e njohura brenda aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafët 37 dhe 38 si:**
- (a) **Një balancë fillestare e vetme; ose**
  - (b) **Si komponentë të veçantë të aktiveve/kapitalit neto.**

Periudha e Matjes

40. **Nëse kontabiliteti fillestar për një bashkim është i paplotë deri në fund të periudhës së raportimit në të cilën ndodh bashkimi, njësia rezultuese do të raportojë në pasqyrat e saj financiare shumat e përkohshme për zërat për të cilët kontabiliteti është i paplotë. Gjatë periudhës së matjes, njësia rezultuese do të rregullojë në mënyrë retrospektive shumat e përkohshme të njohura në datën e bashkimit për të pasqyruar informacionin e ri të marrë rreth fakteve dhe rrethanave që ekzistonin në datën e bashkimit dhe, nëse dihet, do të kishin ndikuar në matjen e shumave të njohura deri në atë datë. Gjatë periudhës së matjes, njësia rezultuese do të njohë gjithashtu aktive ose detyrime shtesë nëse merret informacion i ri për fakte dhe rrethana që ekzistonin në datën e bashkimit dhe, nëse dihet, do të kishin rezultuar në njohjen e atyre aktiveve dhe detyrimeve në atë datë. Periudha e matjes përfundon sapo njësia rezultuese merr informacionin që kërkonte për faktet dhe rrethanat që ekzistonin në datën e bashkimit ose mëson se më shumë informacion nuk mund të merret. Megjithatë, periudha e matjes nuk duhet të tejkalojë një vit nga data e bashkimit.**
41. **Periudha e matjes është periudha pas datës së bashkimit gjatë së cilës njësia rezultuese mund të rregullojë shumat e përkohshme të njohura**

për një bashkim. Periudha e matjes i jep njësisë rezultuese një kohë të arsyeshme për të marrë informacionin e nevojshëm për të identifikuar dhe matur aktivet, detyrimet dhe çdo interes jokontrollues në operacionet e kombinuara në datën e bashkimit në përputhje me kërkesat e këtij Standardi. Informacioni i nevojshëm për të identifikuar dhe matur aktivet, detyrimet dhe çdo interes jokontrollues në operacionet e kombinuara do të jetë përgjithësisht i disponueshëm në datën e bashkimit. Megjithatë, ky mund të mos jetë rasti kur operacionet e kombinuara kanë përgatitur më parë pasqyrat e tyre financiare duke përdorur politika të ndryshme të kontabilitetit.

42. Njësia rezultuese nje një rritje (ulje) në shumën e përkohshme të njohur për një aktiv (detyrim) të identifikueshëm duke rregulluar komponentët e aktiveve/kapitalit neto të njohur në përputhje me paragrafët 37–38. Megjithatë, informacioni i ri i marrë gjatë periudhës së matjes ndonjëherë mund të rezultojë në një rregullim të shumës së përkohshme të më shumë se një aktivi ose detyrimi. Për shembull, njësia rezultuese mund të ketë marrë përsipër një detyrim për të paguar dëmet në lidhje me një aksident në një nga objektet e operacionit të kombinuar, një pjesë ose të gjitha të cilat mbulohen nga polica e sigurimit të përgjegjësive së operacionit të kombinuar. Nëse njësia rezultuese merr informacion të ri gjatë periudhës së matjes për vlerën e mbartur të atij detyrimi, rregullimi i fitimit ose humbjes që rezulton nga një ndryshim në shumën e përkohshme të njohur për detyrimin do të kompensohej (tërësisht ose pjesërisht) nga një rregullimin përkatës i fitimit ose humbjes që rezulton nga një ndryshim në shumën e përkohshme të njohur për dëmin e arkëtueshëm nga siguresi.
43. Gjatë periudhës së matjes, njësia rezultuese do të njohë rregullimet në shumën e përkohshme sikur kontabilizimi për bashkimin të kishte përfunduar në datën e bashkimit. Kështu, njësia rezultuese do të rishikojë informacionin krahasues për periudhat e mëparshme të prezantuara në pasqyrat financiare sipas nevojës, duke përfshirë bërjen e çdo ndryshimi në zhvlerësimin ose amortizimin e njohur në plotësimin e kontabilitetit fillestar.
44. Pas përfundimit të periudhës së matjes, njësia rezultuese do të rishikojë kontabilitetin për një bashkim vetëm për të korrigjuar një gabim në përputhje me SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*.

### **Kostot e Lidhura me Bashkimin**

45. Kostot e lidhura me bashkimin janë kosto që njësia rezultuese ose operacionet e kombinuara shkaktojnë për të realizuar një bashkim. Këto

kosto përfshijnë tarifa këshilluese, ligjore, kontabiliteti, vlerësimi dhe tarifa të tjera profesionale ose këshilluese; kostot e përgjithshme administrative; dhe çdo kosto të regjistrimit dhe emetimit të letrave me vlerë të borxhit dhe kapitalit. Njësia rezultuese dhe operacionet e kombinuara do të kontabilizojnë kostot e lidhura me bashkimin si shpenzime në periudhat në të cilat janë shkaktuar kostot dhe janë marrë shërbimet, me një përjashtim. Kostot për emetimin e letrave me vlerë të borxhit ose të kapitalit do të njihen në përputhje me SNKSP 28, *Instrumentet Financiare: Paraqitja*, dhe SNKSP 41 *Instrumentet Financiare*.

### **Matja e Mëpasshme dhe Kontabiliteti**

46. Në përgjithësi, një njësi rezultuese do të matë dhe do të kontabilizojë më pas aktivitetet dhe detyrimet e marra dhe instrumentet e kapitalit të emetuara në një bashkim në përputhje me SNKSP-të e tjera të zbatueshme për këta artikuj, në varësi të natyrës së tyre. Megjithatë, ky Standard ofron udhëzime për matjen emëvonshme dhe kontabilitetin për aktivitetet e marrë dhe detyrimet e mëposhtëm të ndërmarrë ose të krijuar në një bashkim:
- (a) Liçenca dhe të drejta të ngjashme të dhëna më parë nga një operacion i kombinuar në një operacion tjetër të kombinuar;
  - (b) Transfertat, kreditë konçesionare dhe përfitime të ngjashme të marra nga një operacion i kombinuar mbi bazën e kritereve që ndryshojnë si rezultat i një bashkimi; dhe
  - (c) Tatimet mbi të ardhurat (kur nuk përfshihen në kushtet e bashkimit).

### *Licencat Dhe të Drejtat e Ngjashme të Dhëna më Parë nga një Operacion i Kombinuar për një Operacion Tjetër të Kombinuar*

47. Një liçencë ose e drejtë e ngjashme, e dhënë më parë nga një operacion i kombinuar tek një operacion tjetër i kombinuar dhe e njohur si një aktiv afatgjatë jomaterial, do të amortizohet gjatë periudhës së mbetur të marrëveshjes detyruese në të cilën është dhënë e drejta, ku e drejta është dhënë për një periudhë të kufizuar. Kur e drejta është dhënë për një periudhë të pacaktuar, njësia rezultuese do të testojë të drejtën për zhvlerësim të paktën çdo vit, dhe sa herë që ka një tregues se e drejta mund të zhvlerësohet. Një njësi rezultuese që më pas ia shet këtë liçencë ose të drejtë të ngjashme një pale të tretë, do të përfshijë vlerën e mbartur të aktivitetit afatgjatë jomaterial në përcaktimin e fitimit ose humbjes nga shitja.

### *Transferta, Kredi Konçesionare dhe Përfitime të Ngjashme të Marra nga një*

*Operacion i Kombinuar mbi Bazën e Krieteve që Mund të Ndryshojnë si Rezultat i një Bashkimi*

48. Një transferim, kredi koncesionare ose përfitim i ngjashëm, i marrë më parë nga një operacion i kombinuar mbi bazën e krieteve që ndryshojnë si rezultat i një bashkimi, do të rivlerësohet prospektivisht në përputhje me SNKSP-të e tjera (paragrafët AG61–AG63 ofrojnë udhëzimet përkatëse të aplikimit).

*Tatimet mbi të Ardhurat (Kur nuk janë të Përfshira në Kushtet e Bashkimit)*

49. Bashkimet që përfshijnë njësitë e sektorit publik mund të rezultojnë në faljen nga një autoritet tatimor të shumave të taksave pas bashkimit. Njësia rezultuese do të kontabilizojë tatimin e falur në mënyrë prospektive në përputhje me standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit trajton tatimet mbi të ardhurat.

### **Paraqitja e Pasqyrave Financiare**

50. **Me përjashtim të rasteve kur një njësi rezultuese nuk është një njësi e re pas një kombinimi të sektorit publik, grupi i parë i pasqyrave financiare të njësisë rezultuese pas bashkimit do të përmbajë:**
- (a) **Një pasqyrë fillestare të pozicionit financiar në datën e bashkimit;**
  - (b) **Një pasqyrë të pozicionit financiar në datën e raportimit;**
  - (c) **Një pasqyrë të performancës financiare për periudhën nga data e bashkimit deri në datën e raportimit;**
  - (d) **Një pasqyrë e ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto për periudhën nga data e bashkimit deri në datën e raportimit;**
  - (e) **Një pasqyrë të flukseve monetare për periudhën nga data e bashkimit deri në datën e raportimit;**
  - (f) **Nëse njësia vë në dispozicion të publikut buxhetin e saj të aprovuar, një krahasim shumave të buxhetit dhe shumave aktuale për periudhën nga data e bashkimit deri në datën e raportimit, qoftë si një pasqyrë financiare shtesë e veçantë ose si një kolonë buxheti në pasqyrat financiare; dhe**
  - (g) **Shënime, që përmbajnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjegues.**
51. **Kur një njësi rezultuese nuk është një njësi e re pas një kombinimi të sektorit publik, njësia rezultuese do të paraqesë:**
- (a) **Shumat e njohura të çdo klase kryesore të aktiveve dhe**

**detyrimeve, dhe komponentët përbërës të aktiveve/kapitalit neto nga operacionet e kombinuara të përfshira në njësinë rezultuese;**

- (b) **Çdo rregullim të bërë në komponentët e aktiveve/kapitalit neto kur kërkohet për të qenë në përputhje me politikt kontabël të operacioneve të kombinuara me ato të njësisë rezultuese; dhe**
- (c) **Çdo rregullim të bërë për të eliminuar transaksionet ndërmjet operacioneve të kombinuara.**

52. Në varësi të kërkesave në paragrafët 54 dhe 56, njësia rezultuese lejohet, por nuk i kërkohet të paraqesë pasqyrat financiare për periudhat para datës së bashkimit (paragrafët AG64–AG65 ofrojnë udhëzime përkatëse të aplikimit). Kur një njësi rezultuese zgjedh të prezantojë pasqyrat financiare për periudha para datës së bashkimit, ajo do të paraqesë informacionin e kërkuar nga paragrafi 54(g).

#### **Dhënia e Informacioneve Shpjeguese**

53. **Njësia rezultuese do të paraqesë informacion që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë natyrën dhe efektin financiar të një bashkimi.**

54. Për të përmbushur objektivin në paragrafin 53, njësia rezultuese do të paraqesë informacionin e mëposhtëm për çdo bashkim që ndodh gjatë periudhës së raportimit:

- (a) Emrin dhe një përshkrim të secilit operacion të kombinuar.
- (b) Datën e bashkimit.
- (c) Arsyet kryesore për bashkimin duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, bazën ligjore për bashkimin.
- (d) Shumat e njohura në datën e bashkimit për secilën klasë kryesore të aktiveve dhe detyrimeve të transferuara.
- (e) Rregullimet e bëra në vlerat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve të regjistruara nga secili operacion i kombinuar në datën e bashkimit:
  - (i) Për të eliminuar efektin e transaksioneve ndërmjet operacioneve të kombinuara në përputhje me paragrafin 22; dhe
  - (ii) Për të qenë në përputhje me politikat kontabël të njësisë ekonomike rezultuese në përputhje me paragrafin 27.
- (f) Një analizë të aktiveve/kapitalit neto, duke përfshirë çdo komponent që paraqitet veç, dhe çdo rregullim të konsiderueshëm

si suficitet ose deficitet e rivlerësimit, të njohura në përputhje me paragrafët 37–38.

- (g) Nëse një njësi rezultuese zgjedh të paraqesë pasqyrat financiare për periudhat para datës së bashkimit në përputhje me paragrafin 52, njësia rezultuese do të paraqesë informacionin e mëposhtëm për çdo operacion të kombinuar:
- (i) Një pasqyrë të pozicionit financiar në fund të periudhës(ave);
  - (ii) Një pasqyrë të performancës financiare për periudhën(at) e mëparshme;
  - (iii) Një pasqyrë të ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto për periudhën(at) e mëparshme;
  - (iv) Një pasqyrë të flukseve monetare për periudhën(at) e mëparshme; dhe
  - (v) Shënime, që përmbajnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjerë shpjegues.

Njësia rezultuese nuk do ta rideklarojë këtë informacion, por do ta paraqesë informacionin në të njëjtën bazë siç përdoret në pasqyrat financiare të operacioneve të kombinuara. Njësia rezultuese do të paraqesë informacion për metodën në të cilën prezantohet ky informacion.

- (h) Nëse, në kohën kur pasqyrat financiare të njësisë rezultuese autorizohen për publikim, data e fundit e raportimit të ndonjë prej operacioneve të kombinuara nuk i paraprin menjëherë datës së bashkimit, njësia rezultuese do të paraqesë informacionin e mëposhtëm:
- (i) Shumat e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe suficioni ose deficioni i secilit operacion të kombinuar nga data e fundit e raportimit të operacioneve të kombinuara deri në datën e bashkimit. Shumat e të ardhurave do të analizohen në një mënyrë të përshtatshme për operacionet e njësisë, në përputhje me paragrafin 108 të SNKSP 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*. Shumat e shpenzimeve do të analizohen duke përdorur një klasifikim të bazuar ose në natyrën e shpenzimeve ose në funksionin e tyre brenda njësisë, cilado që jep informacion që është besnikërisht përfaqësues dhe më relevant, në përputhje me paragrafin 109 të SNKSP 1.
  - (ii) Shumat e raportuara nga secili operacion i kombinuar

menjëherë përpara datës së bashkimit për secilën klasë kryesore të aktiveve dhe detyrimeve.

- (iii) Shumat e raportuara nga secili operacion i kombinuar menjëherë përpara datës së bashkimit në aktivet/kapitalin neto.

Njësia rezultuese nuk është e detyruar të paraqesë informacion kur ajo ka zgjedhur të prezantojë pasqyrat financiare për periudhat para datës së bashkimit, siç specifikohet në nënparagrafin (g) më sipër.

- 55. **Njësia rezultuese do të paraqesë informacion që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë efektet financiare të rregullimeve të njohura në periudhën aktuale të raportimit që lidhen me bashkimet që kanë ndodhur në periudhën ose periudhat e mëparshme të raportimit.**
- 56. Për të përmbushur objektivin në paragrafin 55, njësia rezultuese do të paraqesë informacionin e mëposhtëm:
  - (a) Nëse kontabiliteti fillestar për një bashkim është i paplotë (shih paragrafin 40) për aktive ose detyrime të veçanta, dhe shumat e njohura në pasqyrat financiare për bashkimin janë përcaktuar kështu vetëm përkohësisht:
    - (i) Arsyet pse kontabiliteti fillestar për bashkimin është i paplotë;
    - (ii) Aktivet ose detyrimet për të cilat kontabiliteti fillestar është i paplotë; dhe
    - (iii) Natyrën dhe shumën e çdo rregullimi të periudhës së matjes të njohur gjatë periudhës së raportimit në përputhje me paragrafin 43.
  - (b) Nëse shumat e detyrimeve tatimore falen si rezultat i kushteve të bashkimit (shih paragrafët 33–34):
    - (i) Shumën e detyrimit tatimor që është falur; dhe
    - (ii) Kur njësia rezultuese është autoriteti tatimor, detajet e rregullimit të bërë për të arkëtueshmet tatimore.
- 57. Nëse informacionet shpjegues specifike të kërkuar nga ky SNKSP dhe SNKSP-të e tjera nuk përmbushin objektivat e përcaktuara në paragrafët 53 dhe 55, njësia rezultuese do të paraqesë çfarëdolloj informacioni shtesë të nevojshëm për të përmbushur këta objektiva.

## **Kontabiliteti për Blerjet**

58. **Një blerës do të kontabilizojë çdo blerje duke zbatuar metodën e kontabilitetit të blerjes.**

### **Metoda e Blerjes në Kontabilitet**

59. Zbatimi i metodës së blerjes në kontabilitet kërkon:
- (a) Identifikimin e blerësit;
  - (b) Përcaktimin e datës së blerjes;
  - (c) Njohjen dhe matjen e aktiveve të identifikueshëm të blerë, detyrimeve të ndërmarra dhe çdo interesi jokontrollues në operacionin e blerë; dhe
  - (d) Njohjen dhe matjen e emrit të mirë, një fitimi ose një humbjeje nga një blerje.

### **Identifikimi i Blerësit**

60. **Për çdo blerje, pala në kombinim që fiton kontrollin e një ose më shumë operacioneve do të identifikohet si blerësi.**
61. Pala në kombinim që fiton kontrollin e një ose më shumë operacioneve identifikohet kur përcaktohet klasifikimi i kombinimit të sektorit publik në përputhje me paragrafët 7, 8 dhe AG10–AG18.

### **Përcaktimi i Datës së Blerjes**

62. **Blerësi do të identifikojë datën e blerjes, e cila është data në të cilën ai merr kontrollin e operacionit të blerë.**
63. Data në të cilën blerësi merr kontrollin e operacionit të blerë është përgjithësisht data në të cilën blerësi transferon ligjërisht shumën dhe/ose blen aktivet dhe merr përsipër detyrimet e operacionit të blerë - data e mbylljes. Megjithatë, blerësi mund të marrë kontrollin në një datë që është ose më herët ose më vonë se data e mbylljes. Për shembull, data e blerjes i paraprin datës së mbylljes nëse një marrëveshje me shkrim parashikon që blerësi të marrë kontrollin e operacionit të blerë në një datë përpara datës së mbylljes. Një blerës do të marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse në identifikimin e datës së blerjes.

### **Njohja dhe Matja e Aktiveve të Identifikueshëm të Blera, Detyrimeve të Ndërmarra dhe çdo Interesi Jokontrollues në Operacionin e Blerë**

#### *Parimi i Njohjes*

64. **Në datën e blerjes, blerësi do të njohë, veç nga çdo emër i mirë i njohur, aktivet e identifikueshëm të blerë, detyrimet e ndërmarra**



**dhe çdo interes jokontrullues në operacionin e blerë. Njohja e aktiveve të identifikueshëm të blera dhe e detyrimeve të ndërmarra i nënshtrohet kushteve të specifikuar në paragrafët 65 dhe 66.**

Kushtet e Njohjes

65. Për t'u kualifikuar për njohje si pjesë e aplikimit të metodës së blerjes, aktivet e identifikueshëm të blerë dhe detyrimet e ndërmarra duhet të plotësojnë përkufizimin e aktiveve dhe detyrimeve në *Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik* në datën e blerjes, dhe të jetë e mundur të maten në një mënyrë që arrin karakteristikat cilësore dhe merr parasysh kufizimet në informacion në raportimin financiar me qëllim të përgjithshëm. Për shembull, kostot që blerësi pret, por nuk është i detyruar të shkaktojë në të ardhmen për të realizuar planin e tij për të dalë nga një aktivitet i një operacioni të blerë ose për të përfunduar punësimin ose për të zhvendosur punonjësit e një operacioni të blerë, nuk janë detyrime në datën e blerjes. Prandaj, blerësi nuk i njuh këto kosto si pjesë e aplikimit të metodës së blerjes. Në vend të kësaj, blerësi njuh ato kosto në pasqyrat e tij financiare të pas-kombinimit në përputhje me SNKSP-të e tjera.
66. Krahas kësaj, për t'u kualifikuar për njohje si pjesë e aplikimit të metodës së blerjes, aktivet e identifikueshëm të blerë dhe detyrimet e ndërmarra duhet të jenë pjesë e asaj që blerësi dhe operacioni i blerë (ose ish-pronarët e tij) shkëmbyen në transaksionin e blerjes dhe jo rezultat i një transaksioni të veçantë. Blerësi do të zbatojë udhëzimet në paragrafët 109-111 për të përcaktuar se cilët aktive të blerë ose detyrime të ndërmarra janë pjesë e këmbimit për operacionin e blerë dhe cilat, nëse ka, janë rezultat i transaksioneve të veçanta që do të kontabilizohen në përputhje me natyrën e tyre dhe SNKSP-të e aplikueshme.
67. Zbatimi i parimit dhe kushteve të njohjes nga blerësi mund të rezultojë në njohjen e disa aktiveve dhe detyrimeve që operacioni i blerë nuk i kishte njohur më parë si aktive dhe detyrime në pasqyrat e tij financiare. Për shembull, blerësi njuh aktivet jomateriale të identifikueshëm të blera/marra, të tilla si një patentë ose një marrëdhënie me klientin, që operacioni i blerë nuk i njihnte si aktive në pasqyrat e tij financiare, sepse ai i zhvilloi ata së brendshmi dhe i ngarkoi/regjistroi kostot përkatëse në shpenzim.
68. Paragrafët AG72–AG84 ofrojnë udhëzime për njohjen e qirave operative dhe aktiveve jomateriale. Paragrafët 76–82 përcaktojnë llojet e aktiveve dhe detyrimeve të identifikueshëm që përfshijnë artikuj për të cilët ky Standard ofron përjashtime të kufizuara nga parimi dhe kushtet e njohjes.

Klasifikimi ose Përcaktimi i Aktiveve të Identifikueshëm të Blerë dhe Detyrimeve të Ndërmarrë në një Blerje

69. **Në datën e blerjes, blerësi do të klasifikojë ose përcaktojë aktivet e identifikueshëm të blerë dhe detyrimet e ndërmarrë si të nevojshme për të zbatuar më pas SNKSP-të e tjera. Blerësi do t'i bëjë këta klasifikime ose përcaktime në bazë të kushteve të marrëveshjes detyruese (përfshirë kushtet kontraktuale), kushteve ekonomike, politikave të tij të funksionimit/operimit ose të kontabilitetit dhe kushteve të tjera përkatëse siç ekzistojnë në datën e blerjes.**
70. Në disa situata, SNKSP-të parashikojnë kontabilitet të ndryshëm në varësi të mënyrës se si një njësi klasifikon ose përcakton një aktiv ose detyrim të caktuar. Shembuj të klasifikimeve ose përcaktimeve që blerësi do të bëjë në bazë të kushteve përkatëse/të përshtatshme siç ekzistojnë në datën e blerjes përfshijnë, por nuk kufizohen në:
- (a) Klasifikimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare të veçanta si të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit ose me kosto të amortizuar, ose si një aktiv financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me SNKSP 41;
  - (b) Përcaktimin e një instrumenti derivativ si një instrument mbrojtës në përputhje me SNKSP 41; dhe
  - (c) Vlerësimi nëse një derivativ i përfshirë duhet të ndahet nga një kontratë bazë në përputhje me SNKSP 41 (i cili është një çështje 'klasifikimi' në mënyrën si ky Standard përdor atë term).
71. Ky Standard ofron dy përjashtime nga parimi në paragrafin 69:
- (a) Klasifikimi i një marrëveshjeje qiraje si një qira operuese ose një qira financiare në përputhje me SNKSP 13, *Kontratat e Qirave*; dhe
  - (b) Klasifikimi i një kontrate si kontratë sigurimi në përputhje me standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton kontratat e sigurimit.
- Blerësi do t'i klasifikojë ato marrëveshje detyruese në bazë të kushteve dhe faktorëve të tjerë në fillimin e marrëveshjes detyruese (ose, nëse kushtet e marrëveshjes detyruese janë modifikuar në një mënyrë që do të ndryshonte klasifikimin e saj, në datën e atij modifikimi, që mund të jetë data e blerjes).

#### *Parimi i Matjes*

72. **Blerësi do të masë aktivet e identifikueshëm të blerë dhe detyrimet e ndërmarrë me vlerat e tyre të drejta në datën e blerjes.**

73. Për çdo blerje, blerësi do të masë në datën e blerjes komponentët e interesave jokontrolluese në operacionin e blerë që janë interesa pronësie aktualë dhe u japin të drejtë zotëruesve të tyre për një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë në rast likuidimi me ose:
- (a) Vlerën e drejtë; ose
  - (b) Pjesën proporcionale të instrumenteve aktualë të pronësisë në shumat e njohura të aktiveve neto të identifikueshëm të operacionit të blerë.
- Të gjithë komponentët e tjerë të interesave jokontrolluese do të maten me vlerën e drejtë të tyre në datën e blerjes, përveç rasteve kur kërkohet një bazë tjetër matjeje nga SNKSP-të.
74. Paragrafët 78–84 specifikojnë llojet e aktiveve dhe detyrimeve të identifikueshëm që përfshijnë artikujt për të cilët ky Standard lejon përjashtime të kufizuara nga parimi i matjes.

*Përjashtime nga Parimet e Njohjes dhe Matjes*

75. Ky Standard ofron përjashtime të kufizuara nga parimet e tij të njohjes dhe matjes. Paragrafët 76–84 specifikojnë si artikujt e veçantë për të cilët lejohen përjashtime, ashtu edhe natyrën e atyre përjashtimeve. Blerësi do të kontabilizojë ata artikuj duke zbatuar kërkesat në paragrafët 76-84, të cilat do të rezultojnë që disa zëra të jenë:
- (a) Njohur ose duke zbatuar kushtet e njohjes krahas atyre në paragrafët 65-66, ose duke zbatuar kërkesat e SNKSP-ve të tjera, me rezultate që ndryshojnë nga zbatimi i parimit dhe kushteve të njohjes.
  - (b) Matur me një shumë të ndryshme nga vlera e tyre e drejtë në datën e blerjes.

*Përjashtim nga Parimi i Njohjes*

*Detyrimet e Kushtëzuara*

76. SNKSP 19, *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivitetet e Kushtëzuara*, përcakton një detyrim të kushtëzuar si:
- (a) Një detyrim i mundshëm që krijohet nga ngjarje të kaluara, dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nga ndodhja ose jo e një ose më shumë ngjarjeve të pasigurta të ardhshme që nuk janë tërësisht nën kontrollin e njësisë; ose
  - (b) Një detyrim aktual që krijohet nga ngjarje të kaluara, por nuk njihet sepse:

- (i) Nuk ka probabilitet që një fluks dalës burimesh që personifikojnë përfitime ose potencial shërbimi do të kërkohet për të shlyer detyrimin; ose
- (ii) Shuma e detyrimit nuk mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme.

77. Kërkesat në SNKSP 19 nuk zbatohen në përcaktimin se cilat detyrime të kushtëzuara të njihen në datën e blerjes. Në vend të kësaj, blerësi do të njohë në datën e blerjes një detyrim të kushtëzuar të ndërmarrë në një blerje ku shuma transferohet nëse është një detyrim aktual që lind nga ngjarje të kaluara dhe vlera e tij e drejtë mund të matet me besueshmëri<sup>1</sup>. Prandaj, në kundërshtim me SNKSP 19, blerësi njih një detyrim të kushtëzuar të marrë përsipër në një blerje ku shuma transferohet në datën e blerjes edhe nëse nuk është e mundur që një fluks dalës burimesh që personifikon përfitime ekonomike ose potencial shërbimi do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Paragrafi 115 jep udhëzime për kontabilizimin e mëpasshëm për detyrimet e kushtëzuara.

Përjashtimet nga të Dyja Parimet e Njohjes dhe Matjes

Tatimet mbi të Ardhurat (Kur Janë të Përfshira në Kushtet e Blerjes)

78. Blerjet nga një njësi e sektorit publik mund të rezultojnë në faljen e nga një autoritet tatimor të shumave të detyrimeve tatimore si pjesë e kushteve të blerjes. Blerësi nuk do të njohë ndonjë artikull tatimor që falet si rezultat i kushteve të blerjes (paragrafët AG85–AG87 ofrojnë udhëzime përkatëse të aplikimit).

79. Blerësi do të njohë dhe masë çdo artikull/zë tatimor të mbetur të përfshirë në ose që krijohet nga një blerje në përputhje me standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton tatimet mbi të ardhurat. Njësia blerëse do të njohë dhe masë çdo të ardhur të mbetur nga tatimi i përfshirë në ose që krijohet nga një blerje në përputhje me SNKSP 23.

Përfitimet e Punonjësve

80. Blerësi do të njohë dhe masë një detyrim (ose aktiv, nëse ka) në lidhje me marrëveshjet e përfitimeve të punonjësve të operacionit të blerë në përputhje me SNKSP 39.

Aktivitet e Dëmshpërblimit

81. Shitësi në një blerje mund të dëmshpërblejë kontraktualisht blerësin për rezultatin e një ngjarje ose rrethanë të mundshme ose pasigurie që lidhet me të gjithë ose një pjesë të një aktivi ose detyrimi specifik. Për shembull, shitësi mund të dëmshpërblejë blerësin për humbjet mbi një shumë të caktuar për një detyrim që vjen nga një ngjarje ose rrethanë e

mundshme e caktuar; me fjalë të tjera, shitësi do të garantojë që detyrimi i blerësit nuk do të kalojë një shumë të caktuar. Si rezultat, blerësi merr një aktiv dëmshpërblimi. Blerësi do të njohë një aktiv dëmshpërblimi në të njëjtën kohë që njezh zërin e dëmshpërblyer të matur në të njëjtën bazë si zëri i dëmshpërblyer, në varësi të nevojës për një shumë të lejuar vlerësimi për shumat e pambledhshme. Prandaj, nëse dëmshpërblimi lidhet me një aktiv ose një detyrim që njihet në datën e blerjes dhe matet me vlerën e drejtë të tij në datën e blerjes, blerësi do të njohë aktivin e dëmshpërblimit në datën e blerjes të matur me vlerën e drejtë të tij në datën e blerjes. Për një aktiv dëmshpërblimi të matur me vlerën e drejtë, efektet e pasigurisë në lidhje me flukset e ardhshme monetare për shkak të të mbledhshmërisë përfshihen në masën e vlerës së drejtë dhe nuk është e nevojshme një shumë e lejuar vlerësimi e veçantë (paragrafi AG88 ofron udhëzimet përkatëse të aplikimit).

82. Në disa rrethana, dëmshpërblimi mund të lidhet me një aktiv ose një detyrim që është një përjashtim nga parimet e njohjes ose të matjes. Për shembull, një dëmshpërblim mund të lidhet me një detyrim të kushtëzuar që nuk njihet në datën e blerjes sepse vlera e tij e drejtë nuk është e matshme në mënyrë të besueshme në atë datë. Në mënyrë alternative, një dëmshpërblim mund të lidhet me një aktiv ose një detyrim, për shembull, ai që rezulton nga një përfitim punonjësi, i cili matet mbi një bazë të ndryshme nga vlera e drejtë në datën e blerjes. Në këto rrethana, aktivi i dëmshpërblimit do të njihet dhe matet duke përdorur supozime në përputhje me ato të përdorura për të matur elementin/artikullin e dëmshpërblyer, duke iu nënshtruar vlerësimit të menaxhimit për arkëtueshmërinë e aktivitetit të dëmshpërblimit dhe çdo kufizim kontraktual mbi shumën e dëmshpërblyer. Paragrafi 116 jep udhëzime për kontabilizimin e mëposhëm për një aktiv dëmshpërblimi.

### Përjashtime nga Parimi i Matjes

#### Të Drejta të Rifituara

83. Blerësi do të masë vlerën e një të drejte të rifituar të njohur si një aktiv jomaterial në bazë të kohëzgjatjes së mbetur të marrëveshjes detyruese përkatëse, pavarësisht nëse pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh rinovimet potenciale të marrëveshjeve detyruese kur matnin vlerën e drejtë të saj. Paragrafët AG79–AG80 ofrojnë udhëzime përkatëse të aplikimit.

### Transaksionet e Pagesave të Bazuara në Aksione

84. Blerësi do të masë një detyrim ose një instrument kapitali që lidhet me transaksionet e pagesave të bazuara në aksione të operacionit të blerë ose zëvendësimin e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione të një operacioni të blerë me transaksionet e pagesave të bazuara në

aksione të blerësit në përputhje me standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton pagesat e bazuara në aksione.

**Njohja dhe Matja e Emrit të Mirë ose Fitimi nga një Blerje me Zbritje**

85. **Blerësi do të njohë emrin e mirë në datën e blerjes të matur si tejkalim i (a) mbi (b) më poshtë, në varësi të kërkesave të paragrafit 86:**

- (a) **Totali i;**
  - (i) **Shumës së transferuar matet në përputhje me këtë Standard, i cili në përgjithësi kërkon vlerën e drejtë në datën e blerjes (shih paragrafin 95);**
  - (ii) **Shumës së çdo interesi jokontrollues në operacionin e blerë të matur në përputhje me këtë Standard; dhe**
  - (iii) **Në një blerje të arritur në faza (shih paragrafët 99-100), vlera e drejtë në datën e blerjes e interesit të kapitalit të zotëruar më parë nga blerësi në veprimtarinë e blerë.**
- (b) **Shuma neto në datën e blerjes të aktiveve të identifikueshëm të blera dhe detyrimeve të ndërmarrë të matur në përputhje me këtë Standard.**

86. **Blerësi do të njohë emrin e mirë vetëm në masën që blerja do të rezultojë në:**

- (a) **Krijim të flukseve monetar hyrës (si p.sh. blerja e një operacioni gjenerues të mjeteve monetare); dhe/ose**
- (b) **Një reduktim në flukset dalës monetare neto të blerësit.**

**Një blerës do të njohë çdo tepricë të mëtejshme të (a) mbi (b) në paragrafin 85 më sipër si një humbje në sufiçit ose defiçit. Paragrafi AG93 ofron udhëzime përkatëse të aplikimit.**

87. Në një blerje në të cilën blerësi dhe operacioni i blerë (ose ish-pronarët e tij) shkëmbejnë vetëm interesa të kapitalit, vlera e drejtë në datën e blerjes së interesave të kapitalit të operacionit të blerë mund të jetë më besueshmërisht e matshme sesa vlera e drejtë në datën e blerjes të interesave të kapitalit të blerësit. Nëse është kështu, blerësi do të përcaktojë shumën e emrit të mirë duke përdorur vlerën e drejtë në datën e blerjes të interesave të kapitalit të operacionit të blerë në vend të vlerës së drejtë në datën e blerjes të interesave të kapitalit të transferuar. Për të përcaktuar shumën e emrit të mirë në një blerje në të cilën nuk transferohet ndonjë shumë, blerësi do të përdorë vlerën e drejtë në datën e blerjes të interesit të blerësit në operacionin e blerë në vend të vlerës së drejtë në datën e blerjes të shumës së transferuar (paragrafi 85

(a) (i)). Paragrafi AG94 ofron udhëzime përkatëse të aplikimit.

*Blerje me Zbritje*

88. Ka raste kur në një kombinim të sektorit publik të klasifikuar si blerje, një blerës do të bëjë një blerje me zbritje, e cila është një blerje në të cilën shumën në paragrafin 85(b) tejkalon totalin e shumave të specifikuar në paragrafin 85(a). Nëse ky tejkalim qëndron pas zbatimit të kërkesave në paragrafin 90, blerësi do të njohë fitimin që rezulton në sufiçit ose defiçit në datën e blerjes. Fitimi do t'i atribuohet blerësit.
89. Një blerje me zbritje mund të ndodhë, për shembull, në një blerje që është një shitje e detyruar në të cilën shitësi po vepron nën detyrimin/shtysën ekonomik(e). Megjithatë, përjashtimet e njohjes ose të matjes për zëra të veçantë të diskutuar në paragrafët 76-84 mund të rezultojnë gjithashtu në njohjen e një fitimi (ose ndryshimin e shumës së një fitimi të njohur) në një blerje me zbritje.
90. Përpara se të njohë një fitim nga një blerje me zbritje, blerësi duhet të rivlerësojë nëse i ka identifikuar saktë të gjithë aktivet e blera dhe të gjitha detyrimet e ndërmarra dhe do të njohë çdo aktiv ose detyrim shtesë që identifikohet në atë rishikim. Blerësi do të rishikojë më pas procedurat e përdorura për të matur shumën që ky Standard kërkon që të njihen në datën e blerjes për të gjitha nga sa vijon:
- (a) Aktivet e identifikueshëm të blerës dhe detyrimet e ndërmarra;
  - (b) Interesi jokontrullues në operacionin e blerës, nëse ka;
  - (c) Për një blerje të arritur në fazë, interesin e kapitalit të zotëruar më parë të blerësit në operacionin e blerës; dhe
  - (d) Shumën e transferuar.
- Objektivi i rishikimit është të sigurojë që matjet pasqyrojnë në mënyrë të përshtatshme marrjen në konsideratë të të gjithë informacionit të disponueshëm në datën e blerjes.
91. Në sektorin publik, një njësi ndonjëherë merr kontrollin e një operacioni në një transaksion pa këmbim, në të cilin ajo transferon një shumë që nuk është afërsisht e barabartë me vlerën e drejtë të operacionit të blerës. Rrethana të tilla përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:
- (a) Konfiskimet e kompensuar të operacioneve ose njësisve; dhe
  - (b) Transferimin e një operacioni të blerësit nga një donator për shumën nominale.
92. Kur përmbajtja ekonomike e kombinimit të sektorit publik është ajo e një blerjeje, blerje të tilla pa këmbim trajtohen si blerje me zbritje dhe kontabilizohen në përputhje me paragrafët 88-90.

*Një Blerje pa Këmbim dhe pa Transferimin e Shumës*

93. Në sektorin publik, një njësi ndonjëherë merr kontrollin e një operacioni në një transaksion pa këmbim në të cilin nuk transferon ndonjë shumë apo pagesë. Rrethana të tilla përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:
- (a) Konfiskimet e pakompensuara të operacioneve ose njësive (të njohura edhe si shtetëzime të detyruara).
  - (b) Transferimi i një operacioni te njësia nga një donator pa asnjë pagesë. Transferime të tilla mund të marrin formën e një trashëgimie.
- Dhe
- (c) Transferimi i një operacioni te njësia ku operacioni ka detyrime neto. Njësia mund të pranojë transferimin e detyrimeve neto për të parandaluar ndërprerjen e operacionit. Transaksione të tilla ndonjëherë njihen si "shpëtime nga kolapsi financiar".
94. Kur përmbajtja ekonomike e kombinimit të sektorit publik është ajo e një blerjeje, blerësi që merr kontrollin e një operacioni të blerë në një transaksion pa këmbim, në të cilin nuk transferon asnjë vlerë, nuk njihet emrin e mirë. Blerësi njihet një fitim ose një humbje në sufiçit ose defiçit në përputhje me paragrafin 86.

*Shuma e Transferuar*

95. Shuma e transferuar në një blerje do të matet me vlerën e drejtë, e cila do të llogaritet si shuma e vlerave të drejta në datën e blerjes të aktiveve të transferuara nga blerësi, detyrimeve të shkaktuara nga blerësi ndaj ish-pronarëve të operacionit të blerë dhe interesat e kapitalit të emtuar nga blerësi. (Megjithatë, çdo pjesë e çmimeve të pagesave të bazuara në aksione të blerësit e shkëmbyer për çmimet e mbajtura nga punonjësit e operacionit të blerë që përfshihet në shumën e transferuar në blerje do të matet në përputhje me paragrafin 84 dhe jo me vlerën e drejtë.) Shembuj të formave të mundshme të shumave përfshijnë mjete monetare, aktive të tjera, një operacion ose një njësi e kontrolluar e blerësit, shuma të kushtëzuara, instrumente të zakonshme ose të preferuara të kapitalit, opsionet, garancitë dhe interesat e anëtarëve të njësive të përbashkëta.
96. Shuma e transferuar mund të përfshijë aktive ose detyrime të blerësit që kanë vlera të mbartura që ndryshojnë nga vlerat e tyre të drejta në datën e blerjes (për shembull, aktive jomonetare ose një operacion i blerësit). Nëse po, blerësi do të rimasë aktivet ose detyrimet e transferuara në vlerat e tyre të drejta në datën e blerjes dhe do të njohë fitimet ose humbjet që rezultojnë, nëse ka, në sufiçit ose defiçit. Megjithatë, ndonjëherë aktivet ose detyrimet e transferuara mbeten brenda njësisë



së kombinuar pas blerjes (për shembull, sepse aktivet ose detyrimet u transferuan te operacioni i blerë dhe jo te ish-pronarët e tij), dhe për këtë arsye blerësi ruan kontrollin mbi to. Në këtë situatë, blerësi do t'i masë ato aktive dhe detyrime me vlerën e tyre të mbartur menjëherë përpara datës së blerjes dhe nuk do të njohë një fitim ose humbje në sufiçit ose defiçit për aktivet ose detyrimet që ai kontrollon si para dhe pas blerjes.

### Pagesa e Kushtëzuar

97. Shuma që blerësi transferon në këmbim të operacionit të blerë përfshin çdo aktiv ose detyrim që rezulton nga një marrëveshje e shumës së kushtëzuar (shih paragrafin 95). Blerësi do të njohë vlerën e drejtë në datën e blerjes të shumës së kushtëzuar si pjesë e pagesës së transferuar në këmbim të operacionit të blerë.
98. Blerësi do të klasifikojë një detyrim për të paguar shumën e kushtëzuar që plotëson përkufizimin e një instrumenti financiar si një detyrim financiar ose si një element i aktiveve/kapitalit neto në bazë të përkufizimeve të një instrumenti të kapitalit dhe një detyrimi financiar në paragrafin 9 të SNKSP 28. Blerësi do të klasifikojë si aktiv një të drejtë për kthimin e shumës së transferuar më parë nëse plotësohen kushtet e specifikuar. Paragrafi 117 jep udhëzime për kontabilitetin pasues për shumat/pagesat e kushtëzuara.

### Një Blerje e Realizuar në Faza

99. Një blerës ndonjëherë merr kontrollin e një operacioni të blerë në të cilin ai mbante një interes kapitali menjëherë përpara datës së blerjes. Në atë datë, njësia A blen një interes shtesë prej 40 për qind në njësinë B, i cili i jep kontrollin e njësisë B. Ky Standard i referohet një transaksioni të tillë si një blerje e arritur në faza, ndonjëherë referuar edhe si një blerje me hapa.
100. Në një blerje të arritur në faza, blerësi do të rimasë interesin e tij të kapitalit të mbajtur më parë në operacionin e blerë me vlerën e drejtë të tij në datën e blerjes dhe do të njohë fitimin ose humbjen që rezulton, nëse ka, në sufiçit ose defiçit ose në aktivet/kapitalin neto, si është e përshtatshme. Në periudhat e mëparshme të raportimit, blerësi mund të ketë njohur ndryshime në vlerën e interesit të kapitalit të tij në operacionin e blerë në aktivet/kapitalin neto. Nëse është kështu, shuma që është njohur në aktivet/kapitalin neto do të njihet në të njëjtën bazë siç do të kërkohej nëse blerësi do të kishte hequr dorë nga shitur drejtpërdrejt interesin e kapitalit të mbajtur më parë.
- 100A. Kur një palë në një marrëveshje të përbashkët (siç përcaktohet në SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta*) merr kontrollin e një operacioni që është një operacion i përbashkët (siç përkufizohet në SNKSP 37), dhe kishte të drejta për aktivet dhe detyrimet për detyrimet/pasivet që

lidhen me atë operacion të përbashkët menjëherë përpara datës së blerjes, transaksioni është një blerje e arritur në faza. Prandaj, blerësi do të zbatojë kërkesat për një blerje të arritur në faza, duke përfshirë rimatjen e interesit të tij të mbajtur më parë në operacionin e përbashkët në mënyrën e përshkruar në paragrafin 100. Duke vepruar kështu, blerësi do të rimasë të gjithë interesin e tij të mbajtur më parë në operacionin e përbashkët.

**Udhëzime Shtesë për Zbatimin e Metodës së Blerjes ku një Blerje Arrihet nëpërmjet Ndryshimeve në të Drejtat e Vetimit, Vetëm me Kontratë, dhe Rrethana të Ngjashme në të Cilat Shuma nuk Transferohet**

*Një Blerje e Arritur përmes Ndryshimeve në të Drejtat e Vetimit, Vetëm përmes Kontratës, dhe Rrethana të Ngjashme që nuk Përfshijnë Transferimin e Shumës*

101. Një blerës ndonjëherë merr kontrollin e një operacioni të blerë pa transferuar ndonjë pagesë. Metoda e blerjes e kontabilitetit për një blerje zbatohet për ato kombinime të sektorit publik. Rrethana të tilla përfshijnë:
- (a) Operacioni i blerë riblen një numër të mjaftueshëm të aksioneve të tij që një investues ekzistues (blerësi) të marrë kontrollin.
  - (b) E drejta e vetos së pakicës skadon që më parë e pengonte blerësin të kontrollonte një operacion të blerë në të cilin blerësi kishte të drejtat e votës të shumicës.
  - (c) Blerësi dhe operacioni i blerë bien dakord të kombinojnë operacionet e tyre vetëm me kontratë. Blerësi nuk transferon asnjë vlerë në këmbim të kontrollit të një operacioni të blerë dhe nuk mban asnjë interes të matshëm të pronësisë në operacionin e blerë, qoftë në datën e blerjes apo më parë.
102. Në një blerje të arritur vetëm me kontratë, blerësi do t'u atribuojë pronarëve të operacionit të blerë shumën e aktiveve neto të operacionit të blerë të njohur në përputhje me këtë Standard. Me fjalë të tjera, interesat e matshëm të pronësisë në operacionin e blerë që mbahen nga palë të ndryshme nga blerësi janë një interes jokontrollues në pasqyrat financiare të pas-kombinimit të blerësit edhe nëse rezultati është se të gjitha interesat e matshëm të pronësisë në operacionin e blerë i janë atribuar interesit jokontrollues.

**Periudha e Matjes**

103. Nëse kontabiliteti fillestar për një blerje është i paplotë deri në fund të periudhës së raportimit në të cilën ndodh blerja, blerësi duhet të raportojë në pasqyrat e tij financiare shumat e përkohshme për zërat/artikujt për të cilët kontabiliteti është i paplotë. Gjatë

periudhës së matjes, blerësi do të rregullojë në mënyrë retrospektive shumat e përkohshme të njohura në datën e blerjes për të pasqyruar informacionin e ri të marrë rreth fakteve dhe rrethanave që ekzistonin në datën e blerjes dhe, nëse dihen, do të kishin ndikuar në matjen e shumave të njohura në datën e blerjes. Gjatë periudhës së matjes, blerësi do të njohë gjithashtu aktive ose detyrime shtesë nëse merret informacion i ri për faktet dhe rrethanat që ekzistonin në datën e blerjes dhe, nëse dihet, do të kishte rezultuar në njohjen e atyre aktiveve dhe detyrimeve në atë datë. Periudha e matjes përfundon sapo blerësi merr informacionin që kërkonte për faktet dhe rrethanat që ekzistonin në datën e blerjes ose mëson se më shumë informacion nuk mund të merret. Megjithatë, periudha e matjes nuk duhet të kalojë një vit nga data e blerjes.

104. Periudha e matjes është periudha pas datës së blerjes gjatë së cilës blerësi mund të rregullojë shumat e përkohshme të njohura për një blerje. Periudha e matjes i jep blerësit një kohë të arsyeshme për të marrë informacionin e nevojshëm për të identifikuar dhe matur sa vijon që nga data e blerjes në përputhje me kërkesat e këtij Standardi:
- (a) Aktivitetet e identifikueshëm të blerë, detyrimet e ndërmarra dhe çdo interes jokontrrollues në operacionin e blerë;
  - (b) Shuma e transferuar për operacionin e blerë (ose shuma tjetër e përdorur në matjen e emrit të mirë);
  - (c) Në një blerje të arritur në faza, interesi i kapitalit në operacionin e blerë të mbajtur më parë nga blerësi; dhe
  - (d) Emri i mirë, humbja ose fitimi që rezulton nga një blerje me zbritje.
105. Blerësi do të marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës në përcaktimin nëse informacioni i marrë pas datës së blerjes duhet të rezultojë në një rregullim të shumave të përkohshme të njohura ose nëse ai informacion rezulton nga ngjarje që kanë ndodhur pas datës së blerjes. Faktorët përkatës përfshijnë datën kur merret informacion shtesë dhe nëse blerësi mund të identifikojë një arsye për një ndryshim në shumat e përkohshme. Informacioni që merret menjëherë pas datës së blerjes ka më shumë gjasa të pasqyrojë rrethanat që ekzistonin në datën e blerjes sesa informacioni i marrë disa muaj më vonë. Për shembull, nëse nuk mund të identifikohet një ngjarje ndërhyrëse që ka ndryshuar vlerën e tij të drejtë, shitja e një aktivi tek një palë e tretë menjëherë pas datës së blerjes për një shumë që ndryshon ndjeshëm nga vlera e drejtë e tij e përkohshme e matur në atë datë ka gjasa të tregojë një gabim në shumën e përkohshme.
106. Blerësi njuh një rritje(ulje) në shumën e përkohshme të njohur për një

aktiv (detyrim) të identifikueshëm me anë të një ulje (rritje) të emrit të mirë. Megjithatë, informacioni i ri i marrë gjatë periudhës së matjes ndonjëherë mund të rezultojë në një rregullim të shumës së përkohshme të më shumë se një aktivi ose detyrimi. Për shembull, blerësi mund të ketë ndërmarrë një detyrim për të paguar dëmet në lidhje me një aksident në një nga objektet e operacionit të blerë, një pjesë ose të gjitha të cilave mbulohen nga polica e sigurimit të përgjegjësishë së operacionit të blerë. Nëse blerësi merr informacion të ri gjatë periudhës së matjes në lidhje me vlerën e drejtë në datën e blerjes të atij detyrimi, rregullimi i emrit të mirë që rezulton nga një ndryshim në shumën e përkohshme të njohur për detyrimin do të kompensohej (tërësisht ose pjesërisht) nga një vlerë korresponduese rregullimi e emrit të mirë që rezulton nga një ndryshim në shumën e përkohshme të njohur për dëmin e arkëtueshëm nga siguroesi.

107. Gjatë periudhës së matjes, blerësi do të njohë rregullimet në shumat e përkohshme sikur kontabilizimi për blerjen të kishte përfunduar në datën e blerjes. Kështu, blerësi do të rishikojë informacionin krahasues për periudhat e mëparshme të prezantuara në pasqyrat financiare sipas nevojës, duke përfshirë bërjen e çdo ndryshimi në zhvlerësimin, amortizimin ose efekte të tjera të të ardhurave të njohura në plotësimin e kontabilitetit fillestar.
108. Pas përfundimit të periudhës së matjes, blerësi do të rishikojë kontabilitetin për një blerje vetëm për të korrigjuar një gabim në përputhje me SNKSP 3.

### **Përcaktimi i asaj që është Pjesë e Transaksionit të Blerjes**

109. **Blerësi dhe operacioni i blerë mund të kenë një marrëdhënie paraprake ose marrëveshje tjetër përpara se të fillonin negociatat për blerjen, ose mund të hyjnë në një marrëveshje gjatë negociatave që është e ndarë nga blerja. Në secilën situatë, blerësi do të identifikojë çdo shumë që nuk është pjesë e asaj që blerësi dhe operacioni i blerë (ose ish-pronarët e tij) shkëmbyen në blerje, d.m.th., shuma që nuk janë pjesë e këmbimit për operacionin e blerë. Blerësi do të njohë si pjesë të aplikimit të metodës së blerjes vetëm shumën e transferuar për operacionin e blerë dhe aktivet e blera dhe detyrimet e marra në këmbim për operacionin e blerë. Transaksionet e veçanta do të kontabilizohen në përputhje me SNKSP-të përkatëse.**
110. Një transaksion i kryer nga ose në emër të blerësit ose kryesisht për përfitimin e blerësit ose të njësisë ekonomike të kombinuar, në vend të kryesisht për përfitimin e operacionit të blerë (ose ish-pronarëve të tij) përpara blerjes, ka gjasa të jetë një transaksion i veçantë. Më poshtë janë shembuj të transaksioneve të veçantë që nuk duhet të përfshihen

në aplikimin e metodës së blerjes:

- (a) Një transaksion që në fakt rregullon marrëdhëniet para-ekzistuese midis blerësit dhe operacionit të blerë;
- (b) Një transaksion që shpërblen punonjësit ose ish-pronarët e operacionit të blerë për shërbimet e ardhshme; dhe
- (c) Një transaksion që shpërblen punonjësit ose ish-pronarët e operacionit të blerë për shërbimet e ardhshme; dhe

Paragrafët AG99–AG106 ofrojnë udhëzime përkatëse të aplikimit.

#### *Kostot e Lidhura me Blerjen*

111. Kostot e lidhura me blerjen janë kosto që blerësi kryen për të realizuar një blerje. Këto kosto përfshijnë tarifën e gjetësit; tarifa këshillimore, ligjore, kontabiliteti, vlerësimi dhe kosto të tjera profesionale ose këshilluese; kostot e përgjithshme administrative, duke përfshirë kostot e mbajtjes së një departamenti të brendshëm të blerjeve; dhe kostot e regjistrimit dhe emetimit të letrave me vlerë të borxhit dhe kapitalit. Blerësi do të llogarisë kostot e lidhura me blerjen si shpenzime në periudhat në të cilat janë kryer kostot dhe janë marrë shërbimet, me një përjashtim. Kostot për emetimin e letrave me vlerë të borxhit ose kapitalit do të njihen në përputhje me SNKSP 28 dhe SNKSP 41.

#### **Matja e Mëpasshme dhe Kontabiliteti**

112. **Në përgjithësi, një blerës më pas do të matë dhe do të kontabilizojë aktivet e blera, detyrimet e ndërmarra ose të shkaktuara dhe instrumentet e kapitalit të emetuara në një blerje në përputhje me SNKSP-të e tjera të zbatueshme për këta zëra, në varësi të natyrës së tyre. Megjithatë, ky Standard ofron udhëzime për matjen dhe kontabilizimin e mëvonshëm për aktivet e blerë në vijim, detyrimet e ndërmarra ose të shkaktuara dhe instrumentet e kapitalit të emetuar në një blerje:**
- (a) **Të drejtat e rifituara;**
  - (b) **Detyrimet e kushtëzuara të njohura në datën e blerjes;**
  - (c) **Aktivitet e dëmshpërblimit;**
  - (d) **Pagesa e kushtëzuar; dhe**
  - (e) **Tatimet mbi të ardhurat (ku nuk përfshihen në kushtet e blerjes).**

**Paragrafët AG107–AG108 ofrojnë udhëzime përkatëse të aplikimit.**

#### *Të Drejta të Rifituara*

113. Një e drejtë e rifituar e njohur si një aktiv jomaterial do të amortizohet

gjatë periudhës së mbetur të marrëveshjes detyruese në të cilën është dhënë e drejta, kur e drejta është dhënë për një periudhë të kufizuar. Kur e drejta është dhënë për një periudhë të pacaktuar, njësia rezultuese do të testojë të drejtën për zhvlerësim të paktën çdo vit, dhe sa herë që ka një tregues se e drejta mund të zhvlerësohet. Një blerës që më pas shet një të drejtë të rimarrë/rifituar tek një palë e tretë, do të përfshijë vlerën e mbartur të aktivitetit jomaterial në përcaktimin e fitimit ose humbjes nga shitja.

*Transferta, Kredi Koncesionare dhe Përfitime të Ngjashme të Marra nga një Blerës ose Operacioni i Fituar mbi Bazën e Kriteve që Mund të Ndryshojnë si Rezultat i një Blerje*

114. Një transferim, kredi koncesionare ose përfitime të ngjashme, të marra më parë nga një blerës ose një operacion i blerë në bazë të kriteve që ndryshojnë si rezultat i një blerjeje, do të rivlerësohen në mënyrë prospektive në përputhje me SNKSP-të e tjera (paragrafët AG109-AG111 ofrojnë udhëzime përkatëse për aplikimin).

*Detyrimet e Kushtëzuara*

115. Pas njohjes fillestare dhe derisa detyrimi të shlyhet, anulohet ose skadon, blerësi do të masë një detyrim të kushtëzuar të njohur në një blerje në vlerën më të lartë të:
- (a) Shumës që do të njihej në përputhje me SNKSP 19; dhe
  - (b) Shumës së njohur fillimisht minus, nëse është e përshtatshme, amortizimin i akumuluar të njohur në përputhje me SNKSP 9, *Të Ardhurat nga Transaksionet e Këmbimit*.

Kjo kërkesë nuk zbatohet për kontratat e kontabilizuara në përputhje me SNKSP 41, *Instrumentet Financiare*.

*Aktivitetet e Dëmshpërblimit*

116. Në fund të çdo periudhe raportimi pasues, blerësi do të masë një aktivitet dëmshpërblimi që është njohur në datën e blerjes në të njëjtën bazë si pasivi ose aktivi i kompensuar, subjekt i çdo kufizimi kontraktual në shumën e tij dhe, për një aktivitet dëmshpërblimi që nuk matet më pas me vlerën e drejtë të tij, vlerësimi i drejtuesve për arkëtueshmërinë e aktivitetit të dëmshpërblimit. Blerësi do të çregjistrojë aktivitetin e dëmshpërblimit vetëm kur ai mbledh aktivitetin, e shet atë ose humbet të drejtën për të.

*Pagesa e Kushtëzuar*

117. Disa ndryshime në vlerën e drejtë të shumës së kushtëzuar që blerësi njihet pas datës së blerjes mund të jenë rezultat i informacionit shtesë që blerësi mori pas kësaj date në lidhje me faktet dhe rrethanat që

ekzistonin në datën e blerjes. Ndryshime të tilla janë rregullime të periudhës së matjes në përputhje me paragrafët 103-107. Megjithatë, ndryshimet që rezultojnë nga ngjarjet pas datës së blerjes, të tilla si përmbushja e një objekti fitimi, arritja e një çmimi të caktuar aksioni ose arritja e një momenti kyç në një projekt kërkimi dhe zhvillimi, nuk janë rregullime të periudhës së matjes. Blerësi do të kontabilizojë ndryshimet në vlerën e drejtë të shumës së kushtëzuar që nuk janë rregullime të periudhës së matjes si më poshtë:

- (a) Shuma e kushtëzuar e klasifikuar si një komponent i aktiveve/kapitalit neto nuk do të rimatet dhe shlyerja e tij e mëvonshme do të kontabilizohet brenda aktiveve/kapitalit neto.
- (b) Shuma tjetër e kushtëzuar që:
  - (i) Është brenda fushëveprimit të SNKSP 41 do të matet me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi dhe ndryshimet në vlerën e drejtë do të njihen në sufiçit ose defiçit në përputhje me SNKSP 41.
  - (ii) Nuk është brenda fushëveprimit të SNKSP 41 do të matet me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi dhe ndryshimet në vlerën e drejtë do të njihen në sufiçit ose defiçit.

### *Tatimet mbi të Ardhurat (Ku nuk Përfshihen në Kushtet e Blerjes)*

118. Blerjet që përfshijnë njësi të sektorit publik mund të rezultojnë në faljen nga një autoritet tatimor të shumave tatimore pas blerjes. Blerësi do të kontabilizojë tatimin e falur në mënyrë prospektive në përputhje me standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton tatimet mbi të ardhurat.

### **Dhënia e Informacioneve Shpjeguese**

119. **Blerësi do të japë informacion që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të tij financiare të vlerësojnë natyrën dhe efektin financiar të një blerjeje që ndodh ose:**
- (a) **Gjatë periudhës aktuale të raportimit; ose**
  - (b) **Pas përfundimit të periudhës së raportimit, por përpara se pasqyrat financiare të autorizohen për publikim.**
120. Për të përmbushur objektivin në paragrafin 119, blerësi do të paraqesë informacionin e mëposhtëm për çdo blerje që ndodh gjatë periudhës së raportimit:
- (a) Emrin dhe një përshkrim të operacionit të fituar.
  - (b) Datën e blerjes.

- (c) Përqindja e interesave të kapitalit votues ose ekuivalentit të fituar.
- (d) Arsyet kryesore për blerjen dhe një përshkrim se si blerësi mori kontrollin e operacionit të blerë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, bazën ligjore për blerjen.
- (e) Një përshkrim cilësor të faktorëve që përbëjnë emrin e mirë të njohur, të tilla si sinergjitë e pritshme nga kombinimi i operacioneve të operacionit të blerë dhe blerësit, aktivet afatgjatë jomateriale që nuk kualifikohen për njohje të veçantë ose faktorë të tjerë.
- (f) Vlerën e drejtë në datën e blerjes e shumës totale të transferuar dhe vlerën e drejtë në datën e blerjes të çdo klase të madhe të shumës, si p.sh.:
  - (i) Mjetet monetare;
  - (ii) Aktive të tjera materiale ose jomateriale, duke përfshirë një operacion ose njësi ekonomike të kontrolluar të blerësit;
  - (iii) Detyrimet e shkaktuara, për shembull, një detyrim për shumën e kushtëzuar; dhe
  - (iv) Interesat e kapitalit të blerësit, duke përfshirë numrin e instrumenteve të emetuara ose të emetueshme dhe metodën e matjes së vlerës së drejtë të këtyre instrumenteve ose interesave.
- (g) Për marrëveshjet e shumës së kushtëzuar dhe aktiveve të dëmshpërblimit:
  - (i) Shumën e njohur në datën e blerjes;
  - (ii) Një përshkrim të marrëveshjes dhe bazës për përcaktimin e shumës së pagesës; dhe
  - (iii) Një vlerësim të intervalit të rezultateve (të pazbritura) ose, nëse një interval nuk mund të vlerësohet, ai fakt dhe arsyet pse një interval nuk mund të vlerësohet. Nëse shuma maksimale e pagesës është e pakufizuar, blerësi do ta paraqesë këtë fakt.
- (h) Për llogaritë e arkëtueshme të blera:
  - (i) Vlerën e drejtë të tyre;
  - (ii) Shumat bruto të tyre në përputhje me një marrëveshje detyruese; dhe
  - (iii) Vlerësimin më të mirë në datën e blerjes të flukseve monetare në përputhje me një marrëveshje detyruese që nuk pritet të mblihdet.



Informacionet do të jepen sipas klasave kryesore të llogarive të arkëtueshme, të tilla si kreditë, qiratë financiare direkte dhe çdo klasë tjetër të llogarive të arkëtueshme.

- (i) Shumat e njohura në datën e blerjes për çdo klasë kryesore të aktiveve të blera dhe detyrimeve të ndërmarra.
- (j) Për çdo detyrim të kushtëzuar të njohur në përputhje me paragrafin 77, informacioni i kërkuar në paragrafin 98 të SNKSP 19. Nëse një detyrim i kushtëzuar nuk njihet për shkak se vlera e tij e drejtë nuk mund të matet me besueshmëri, blerësi do të paraqesë:
  - (i) Informacioni i kërkuar nga paragrafi 100 i SNKSP 19; dhe
  - (ii) Arsyet pse detyrimi nuk mund të matet me besueshmëri.
- (k) Shuma totale e emrit të mirë që pritet të jetë e zbritshme për qëllime tatimore.
- (l) Për transaksionet që njihen veç nga blerja e aktiveve dhe marrja e detyrimeve gjatë blerjes në përputhje me paragrafin 109:
  - (i) Një përshkrim të çdo transaksioni;
  - (ii) Si e ka kontabilizuar blerësi për çdo transaksion;
  - (iii) Shumat e njohura për çdo transaksion dhe zërin përkatës në pasqyrat financiare në të cilin njihet secila shumë; dhe
  - (iv) Nëse transaksioni është shlyerja efektive e një marrëdhënieje para-ekzistuese, metoda e përdorur për të përcaktuar shumën e shlyerjes.
- (m) Paraqitja e informacioneve të transaksioneve të njohura veç të kërkuara nga (l) do të përfshijnë shumën e kostove të lidhura me blerjen dhe, veç, shumën e këtyre kostove të njohura si shpenzim dhe zërin përkatës në pasqyrën e performancës financiare në të cilët janë njohur këto shpenzime. Shuma e çdo kosto emetimi që nuk njihet si shpenzim dhe mënyra se si ato janë njohur gjithashtu duhet të paraqitet.
- (n) Në një blerje në të cilën një humbje njihet në sufiçit ose defiçit (shih paragrafin 86):
  - (i) Shumën e humbjes së njohur në përputhje me paragrafin 86 dhe zërin përkatës në pasqyrën e performancës financiare në të cilën njihet humbja; dhe
  - (ii) Një përshkrim të arsyeve pse transaksioni rezultoi në humbje.
- (o) Në një blerje me zbritje (shih paragrafët 88–90):

- (i) Shuma e çdo fitimi të njohur në përputhje me paragrafin 88 dhe zërin përkatës në pasqyrën e performancës financiare në të cilin njihet fitimi; dhe
  - (ii) Një përshkrim të arsyeve pse transaksioni rezultoi në një fitim.
- (p) Për çdo blerje në të cilën blerësi zotëron më pak se 100 për qind të interesave të pronësisë të matshme ose ekuivalente në operacionin e blerë në datën e blerjes:
- (i) Shuma e interesit jokontrollues në operacionin e blerë të njohur në datën e blerjes dhe bazën e matjes për atë shumë; dhe
  - (ii) Për çdo interes jokontrollues në një operacion të blerë të matur me vlerën e drejtë, teknikat e vlerësimit dhe inputet e rëndësishme të përdorura për të matur atë vlerë.
- (q) Në një blerje të arritur në faza;
- (i) Vlera e drejtë në datën e blerjes të interesit të kapitalit në operacionin e blerë të mbajtur nga blerësi menjëherë përpara datës së blerjes; dhe
  - (ii) Shuma e çdo fitimi ose humbjeje të njohur si rezultat i rimatjes së vlerës së drejtë të interesit të kapitalit në operacionin e blerë të mbajtur nga blerësi përpara blerjes (shih paragrafin 100) dhe zërin përkatës në pasqyrën e performancës financiare në të cilin njihet ky fitim ose humbje.
- (r) Informacionin e mëposhtëm:
- (i) Shumat e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe sufiçitin ose defiçitin e operacionit të blerë që nga data e blerjes, të përfshira në pasqyrën e konsoliduar të performancës financiare për periudhën e raportimit; dhe
  - (ii) Të ardhurat dhe shpenzimet, dhe sufiçiti ose defiçiti i njësisë së kombinuar për periudhën aktuale të raportimit sikur data e blerjes për të gjitha blerjet që ndodhën gjatë vitit të kishte qenë në fillim të periudhës së raportimit vjetor.

Nëse paraqitja e ndonjë prej informacioneve të kërkuar nga ky nënparagraf është e pazbatueshme, blerësi do ta paraqesë atë fakt dhe të shpjegojë pse paraqitja e informacionit është e pamundur. Ky Standard përdor termin "i papraktikueshëm" me të njëjtin kuptim si në SNKSP 3.

---

121. Për blerjet individualisht jomateriale që ndodhin gjatë periudhës së

raportimit dhe që janë materiale kolektivisht, blerësi duhet të japë informacionin e përgjithshëm të kërkuar nga paragrafi 120(e)–(r).

122. Nëse data e blerjes së një transaksioni blerjeje është pas përfundimit të periudhës së raportimit, por përpara se pasqyrat financiare të autorizohen për publikim, blerësi do të japë informacionin e kërkuar nga paragrafi 120, përveç rasteve kur kontabiliteti fillestar për blerjen është i paplotë në kohën kur pasqyrat financiare janë të autorizuar për publikim. Në këtë situatë, blerësi do të përshkruajë se cilat informacione shpjegues nuk mund të jepen dhe arsyet pse ata nuk mund të jepen.
123. **Blerësi do të japë informacion që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të tij financiare të vlerësojnë efektet financiare të rregullimeve të njohura në periudhën aktuale të raportimit që lidhen me blerjet që kanë ndodhur në periudhën ose periudhat e mëparshme të raportimit.**
124. Për të përmbushur objektivin në paragrafin 123, blerësi do të paraqesë informacionin e mëposhtëm për çdo blerje materiale ose në total për blerjet individualisht jomateriale që janë materiale kolektivisht:
- (a) Nëse kontabiliteti fillestar për një blerje është i paplotë (shih paragrafin 103) për aktive, pasive, interesa jokontrolluese ose zëra të pagesave dhe shumat e njohura në pasqyrat financiare për blerjen janë përcaktuar kështu vetëm provizorisht:
- (i) Arsyet pse kontabiliteti fillestar për blerjen është i paplotë;
  - (ii) Aktivitet, detyrimet, interesat e pronësisë të matshme (ose ekuivalentët) ose zërat e pagesës për të cilët kontabiliteti fillestar është i paplotë; dhe
  - (iii) Natyrën dhe shumën e çdo rregullimi të periudhës së matjes të njohur gjatë periudhës së raportimit në përputhje me paragrafin 107.
- (b) Për çdo periudhë raportimi pas datës së blerjes derisa njësia të mbledhë, shesë ose të humbasë ndryshe të drejtën për një aktiv të pagesave të kushtëzuara, ose derisa njësia të shlyejë një detyrim të shumave të kushtëzuara ose pasi detyrimi anulohet ose skadon:
- (i) Çdo ndryshim në shumat e njohura, duke përfshirë çdo diferencë që lind pas shlyerjes;
  - (ii) Çdo ndryshim në gamën/intervalin e rezultateve (të pazbritura) dhe arsyet për ata ndryshime; dhe
  - (iii) Teknikat e vlerësimit dhe të dhënat kryesore të modelit të përdorura për të matur shumën e kushtëzuar.
- (c) Për detyrimet e kushtëzuara të njohura në një blerje, blerësi duhet

të japë informacionin e kërkuar nga paragrafët 97 dhe 98 të SNKSP 19 për çdo klasë provizioni.

- (d) Një rakordim të vlerës së mbartur të emrit të mirë në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit duke treguar veç:
- (i) Shumën bruto dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi në fillim të periudhës së raportimit.
  - (ii) Emrin e mirë shtesë të njohur gjatë periudhës së raportimit.
  - (iii) Rregullimet që rezultojnë nga njohja e mëpasshme e shumave gjatë periudhës së raportimit në përputhje me standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton tatimet mbi të ardhurat.
  - (iv) Emrin e mirë të çregjistruar gjatë periudhës së raportimit.
  - (v) Humbjet nga zhvlerësimi të njohura gjatë periudhës së raportimit në përputhje me SNKSP 26, *Zhvlerësimi i Aktiveve që Gjenerojnë Mjete Monetare*. (SNKSP 26 kërkon paraqitjen e informacioneve për shumën e rikuperueshme dhe zhvlerësimin e emrit të mirë, krahas kësaj kërkese.)
  - (vi) Diferencat neto të kursit të këmbimit që krijohen gjatë periudhës së raportimit në përputhje me SNKSP 4, *Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit të Monedhave të Huaja*.
  - (vii) Çdo ndryshim tjetër në vlerën e mbartur gjatë periudhës së raportimit.
  - (viii) Shuma bruto dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi në fund të periudhës së raportimit.
- (e) Shumën dhe shpjegimin e çdo fitimi ose humbjeje të njohur në periudhën aktuale të raportimit që edhe:
- (i) Lidhet me aktivet e identifikueshëm të blerë ose detyrimet e ndërmarra në një blerje që është realizuar në periudhën aktuale ose të mëparshme të raportimit; edhe
  - (ii) Ka një madhësi, natyrë ose shpeshhtësi të tillë që paraqitja e informacioneve është me rëndësi për të kuptuar pasqyrat financiare të njësisë së kombinuar.
- Dhe
- (f) Nëse shumat e detyrimeve tatimore falen si rezultat i kushteve të blerjes (shih paragrafët 78–79):
- (i) Shumën e detyrimit tatimor që është falur; dhe

- (ii) Aty ku blerësi është autoriteti tatimor, detajet e rregullimit të bërë për tatimet e arkëtueshme.

125. Nëse informacionet specifike të kërkuara nga ky SNKSP dhe SNKSP-të e tjera nuk përmbushin objektivat e përcaktuara në paragrafët 119 dhe 123, blerësi do të paraqesë çdo informacion shtesë të nevojshëm për të përmbushur këta objektiva.

## Data Efektive dhe Periudha Kalimtare

### Data Efektive

126. Ky Standard do të zbatohet prospektivisht për kombinimet e sektorit publik për të cilat data e bashkimit ose e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në ose pas 1 janarit, 2019. Aplikimi mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton këtë Standard përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të japë informacion për këtë fakt.
- 126A. Paragrafët 25, 45, 70, 111, 115, 117 dhe AG88 u ndryshuan nga SNKSP 41, i publikuar në gusht 2018. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2022. Aplikimi mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të japë informacion për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 41 në të njëjtën kohë.
- 126B. Paragrafi 100A u shtua nga *Përmirësime të SNKSP-ve, 2018*, publikuar në tetor 2018. Një njësi do ta zbatojë këtë ndryshim për kombinimet e sektorit publik për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të pasqyrave të para vjetore financiare që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2019. Aplikimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi e zbaton këtë ndryshim për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të japë informacion për këtë fakt.

### Periudha Kalimtare

127. Aktivet dhe detyrimet që lindin nga kombinimet e sektorit publik, datat e blerjes ose të bashkimit të të cilave i paraprijnë zbatimit të këtij Standardi nuk do të rregullohen me zbatimin e këtij Standardi.
128. Balancat e shumave të kushtëzuara që krijohen nga blerjet, datat e blerjes të së cilave i paraprijnë datës kur një njësi e ka zbatuar për herë të parë këtë Standard, nuk do të rregullohen me zbatimin e parë të këtij Standardi. Paragrafët 129-132 do të zbatohen në kontabilitetin vijues për këto balanca. Paragrafët 129-132 nuk do të zbatohen për kontabilitetin për balancat e shumave të kushtëzuara që lindin nga blerjet me datat e

blerjes në ose pas datës kur njësia zbatoi për herë të parë këtë Standard. Në paragrafët 129–132 blerjet i referohen ekskluzivisht blerjeve, data e blerjes së të cilave i parapriu zbatimit të këtij Standardi.

129. Nëse një marrëveshje blerjeje parashikon një rregullim të kostos së blerjes në varësi të ngjarjeve të ardhshme, blerësi do të përfshijë shumën e atij rregullimi në koston e blerjes në datën e blerjes nëse rregullimi është i mundshëm dhe mund të matet me besueshmëri.
130. Një marrëveshje blerjeje mund të lejojë rregullime të kostos së blerjes që janë të kushtëzuara nga një ose më shumë ngjarje të ardhshme. Për shembull, rregullimi mund të jetë i kushtëzuar nga një nivel i caktuar fitimi që mbahet ose arrihet në periudhat e ardhshme, ose nga mbajtja e çmimit të tregut të instrumenteve të emtuar. Zakonisht është e mundur të vlerësohet shuma e çdo rregullimi të tillë në kohën e kontabilizimit fillestar për blerjen pa dëmtuar besueshmërinë e informacionit, edhe pse ekziston njëfarë pasigurie. Nëse ngjarjet e ardhshme nuk ndodhin ose vlerësimi duhet të rishikohet, kostoja e blerjes do të rregullohet në përputhje me rrethanat.
131. Megjithatë, kur një marrëveshje blerjeje parashikon/lejon një rregullim të tillë, ky rregullim nuk përfshihet në koston e blerjes në kohën e kontabilizimit fillimisht të blerjes nëse ai ose nuk është i mundshëm ose nuk mund të matet me besueshmëri. Nëse ky rregullim më pas bëhet i mundshëm dhe mund të matet me besueshmëri, shuma shtesë do të trajtohet si një rregullim i kostos së blerjes.
132. Në disa rrethana, blerësit mund t'i kërkohe t'i bëjë një pagesë të mëvonshme shitësit si kompensim për një reduktim në vlerën e aktiveve të dhëna, instrumenteve të kapitalit të emtuara ose detyrimeve të ndërmarra ose të ndërmarra nga blerësi në këmbim të kontrollit të operacionit të blerë. Ky është rasti, për shembull, kur blerësi garanton çmimin e tregut të kapitalit ose instrumenteve të borxhit të emtuar si pjesë e kostos së blerjes dhe kërkohet të emetojë kapital shtesë ose instrumente borxhi për të rikthyer koston e përcaktuar fillimisht. Në raste të tilla, nuk njihet rritje në koston e blerjes. Në rastin e instrumenteve të kapitalit, vlera e drejtë e pagesës shtesë kompensohet nga një reduktim i barabartë në vlerën që i atribuohet instrumenteve të emtuara fillimisht. Në rastin e instrumenteve të borxhit, pagesa shtesë konsiderohet si ulje e primit ose rritje e zbritjes në emetimin fillestar.
133. Një njësi, si një njësi e përbashkët, që nuk e ka zbatuar ende këtë Standard dhe ka një ose më shumë kombinime të sektorit publik që janë kontabilizuar duke përdorur metodën e blerjes (që përfshin amortizimin e emrit të mirë) do të zbatojë dispozitat e tranzicionit në paragrafët AG114–AG115.

*Tatimi mbi Të Ardhurat*

134. Për kombinimet e sektorit publik në të cilat data e blerjes ose e bashkimit ka qenë përpara zbatimit të këtij Standardi, blerësi ose njësia rezultuese do të zbatohë kërkesat e standardit përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton tatimet mbi të ardhurat në mënyrë prospektive. Nga data kur zbatohet ky Standard, blerësi ose njësia rezultuese do të njohë çdo ndryshim të kërkuar nga standardi përkatës ndërkombëtar ose kombëtar i kontabilitetit që ka të bëjë me tatimet mbi të ardhurat si një rregullim ndaj sufiçitit ose defiçitit (ose, nëse kërkohet nga standardi i kontabilitetit përkatës ndërkombëtar ose kombëtar që trajton tatimet mbi të ardhurat, sufiçitin ose defiçitin e jashtëm).

## SNKSP 41—INSTRUMENTET FINANCIARE

### Shënime të Mirënjohjes

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) është hartuar kryesisht nga Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (SNRF) 9, *Instrumentet Financiare*, IKINRF 16, *Mbrojtjet e një Investimi Neto në një Operacion të Huaj*, dhe IKINRF 19, *Eliminimi i Detyrimeve Financiare me Instrumente të Kapitalit* publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ekstrakte nga SNRF 9, KINRF 16 dhe KINRF 19 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit Ndërkombëtar të Standardeve të Raportimit Financiar.

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Customer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: [publications@ifrs.org](mailto:publications@ifrs.org)

Internet: [www.ifrs.org](http://www.ifrs.org)

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.



## SNKSP 41—INSTRUMENTET FINANCIARE

### Historia e SNKSP

*Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e botuara deri në janar 31, 2019.*

SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* u publikua në gusht 2018.

Që atëherë, SNKSP 36 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

*Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41)*

### Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 41

| Paragrafi i Ndikuar         | Si u Ndikua | Ndikuar Nga                                                                                                                                                                            |
|-----------------------------|-------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 156A                        | I Ri        | Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019 |
| Titulli para paragrafit 184 | I Ri        | Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019 |
| 184                         | I Ri        | Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019 |
| 185                         | I Ri        | Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ                                     |

**INSTRUMENTET FINANCIARE**

| <b>Paragrafi i Ndikuar</b> | <b>Si u Ndikua</b> | <b>Ndikuar Nga</b>                                                                                                                                                                     |
|----------------------------|--------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                            |                    | (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019                                                                                                                                                    |
| 186                        | I Ri               | Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019 |
| 187                        | I Ri               | Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019 |
| 188                        | I Ri               | Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019 |
| 189                        | I Ri               | Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019 |
| AG73                       | U Ndryshua         | Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019 |
| AG74                       | U Ndryshua         | Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019 |

INSTRUMENTET FINANCIARE

| <b>Paragrafi i Ndikuar</b> | <b>Si u Ndikua</b> | <b>Ndikuar Nga</b>                                                                                                                                                                     |
|----------------------------|--------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| AG74A                      | I Ri               | Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019 |

**SNKSP 41—INSTRUMENTET FINANCIARE**

**PËRMBAJTJA**

|                                                           | Paragrafi |
|-----------------------------------------------------------|-----------|
| Objektivi.....                                            | 1         |
| Objekti .....                                             | 2–8       |
| Përkufizime.....                                          | 9         |
| Njohja dhe çregjistrimi .....                             | 10–38     |
| Njohja fillestare .....                                   | 10–11     |
| Çregjistrimi i aktiveve financiare .....                  | 12–34     |
| Çregjistrimi i detyrimeve financiare.....                 | 35–38     |
| Klasifikimi .....                                         | 39–56     |
| Klasifikimi i aktiveve financiare .....                   | 39–44     |
| Klasifikimi i detyrimeve financiare.....                  | 45–46     |
| Derivatvët e përfshirë .....                              | 47–53     |
| Riklasifikimi .....                                       | 54–56     |
| Matja.....                                                | 57–112    |
| Matja fillestare.....                                     | 57–60     |
| Matja e mëpasshme e aktiveve financiare .....             | 61–63     |
| Matja e mëpasshme e detyrimeve financiare .....           | 64–65     |
| Shumat e matjes së vlerës së drejtë .....                 | 66–68     |
| Matja e kostos së amortizuar.....                         | 69–72     |
| Zhvlerësimi .....                                         | 73–93     |
| Riklasifikimi i aktiveve financiare .....                 | 94–100    |
| Fitimet dhe humbjet .....                                 | 101–112   |
| Kontabiliteti mbrojtës.....                               | 113–155   |
| Objektivi dhe fushëveprimi i kontabilitetit mbrojtës..... | 113–115   |
| Instrumentet mbrojtës.....                                | 116–121   |
| Elementet e mbrojtur .....                                | 122–128   |
| Kriteret e kualifikimit për kontabilitetin mbrojtës ..... | 129       |

## INSTRUMENTET FINANCIARE

---

|                                                                                                                    |         |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|
| Kontabiliteti për marrëdhëniet mbrojtëse kualifikuese .....                                                        | 130–145 |
| Mbrojtjet e një grupi elementesh .....                                                                             | 146–151 |
| Opsioni për të përcaktuar një ekspozim krediti si të matur me vlerën e drejtë përmes sufiçitit ose deficitit ..... | 152–155 |
| Data efektive dhe periudha kalimtare .....                                                                         | 156–184 |
| Data efektive .....                                                                                                | 156–157 |
| Periudha kalimtare .....                                                                                           | 158–184 |

---

## Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të vendosë parime për raportimin financiar të aktiveve dhe detyrimeve financiare që do të prezantojnë informacion të përshtatshëm dhe të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare për vlerësimin e tyre të shumave, kohës dhe pasigurisë së flukseve monetare të ardhshme të një njësie.

## Objekti

2. **Ky Standard do të zbatohet nga të gjithë njësitë ekonomike për të gjitha llojet e instrumenteve financiare, përveç:**
  - (a) **Atyre interesave në njësitë e kontrolluara, pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta që kontabilizohen në përputhje me SNKSP 34, Pasqyrat Financiare të Veçanta, SNKSP 35, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, ose SNKSP 36, Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta.** Megjithatë, në disa raste, SNKSP 34, SNKSP 35 ose SNKSP 36 kërkojnë ose lejojnë një njësi të kontabilizojë një interes në një njësi të kontrolluar, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët në përputhje me disa ose të gjitha kërkesat e këtij Standardi. Njësitë do të zbatojnë gjithashtu këtë Standard për derivativët e një interesi në një njësi të kontrolluar, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, përveç rastit kur derivativi plotëson përkufizimin e një instrumenti të kapitalit të njësisë (ekonomike) në SNKSP 28, *Instrumentet Financiare: Paraqitja*.
  - (b) **Të drejtave dhe detyrimeve sipas qirave për të cilat zbatohet SNKSP 13, Kontratat e Qirave.** Megjithatë:
    - (i) **Llogaritë e arkëtueshme të qirave financiare (d.m.th., investimet neto në qiratë financiare) dhe të qirave operative të njohura nga një qiradhënës i nënshtrohen kërkesave për çregjistrim dhe zhvlerësim të këtij Standardi;**
    - (ii) **Detyrimet e qirave të njohura nga një qiramarrës i nënshtrohen kërkesave të çregjistrimit në paragrafin 35 të këtij Standardi; dhe**
    - (iii) **Derivativët që janë të përfshirë në qira i nënshtrohen kërkesave të këtij Standardi për derivativët e përfshirë.**
  - (c) **Të drejtave dhe detyrimeve të punëdhënësve sipas planeve të përfitimeve të punonjësve, për të cilat zbatohet SNKSP 39, Përfitimet e Punonjësve.**
  - (d) **Instrumenteve financiare të emetuar nga njësia që plotësojnë**

përkufizimin e një instrumenti të kapitalit në SNKSP 28 (përfshirë opionet dhe garancitë) ose që kërkohet të klasifikohen si instrument kapitali në përputhje me paragrafët 15 dhe 16 ose paragrafët 17 dhe 18 të SNKSP 28. Megjithatë, mbajtësi i instrumenteve të tillë të kapitalit do të zbatojë këtë Standard për ata instrumente, përveç rastit kur ata plotësojnë përjashtimin në (a).

- (e) Të drejtave dhe detyrimeve që lindin sipas:
- (i) Një kontrate sigurimi, të ndryshme nga të drejtat dhe detyrimet e një emetuesi që lindin nga një kontratë sigurimi që plotëson përkufizimin e një kontrate garancie financiare në paragrafin 9; ose
  - (ii) Një kontrate që është brenda fushëveprimit të standardit përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton kontratat e sigurimit, sepse përmban një karakteristikë të pjesëmarrjes me dëshirë.

Ky Standard zbatohet për një derivativ që është i përfshirë në një kontratë nëse derivativi nuk është në vetvete një kontratë sigurimi (shih paragrafët 47-53 dhe shtojcën A paragrafët AG99-AG110 të këtij Standardi). Një njësi e zbaton këtë Standard për kontratat e garancisë financiare, por do të zbatojë standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që ka të bëjë me kontratat e sigurimit nëse emetuesi zgjedh të zbatojë atë standard në njohjen dhe matjen e tyre. Pavarësisht (i) më sipër, një njësi mund të zbatojë këtë Standard për kontrata të tjera sigurimi që përfshijnë transferimin e rrezikut financiar.

- (f) Ndonjë kontrate të ardhshme ndërmjet një blerësi dhe një aksioneri shitës për të blerë ose shitur një operacion të blerë që do të rezultojë në një kombinim të sektorit publik për të cilin SNKSP 40 zbatohet në një datë blerjeje të ardhshme. Kohëzgjatja e kontratës së ardhshme nuk duhet të kalojë një periudhë të arsyeshme normalisht të nevojshme për të marrë ndonjë aprovim të kërkuar dhe për të përfunduar transaksionin.
- (g) Angazhimeve të kredive të ndryshme nga ato angazhime të kredive të përshkruara në paragrafin 4. Megjithatë, një emetues i angazhimeve të kredive do të zbatojë kërkesat për zhvlerësim të këtij Standardi për angazhimet e kredisë që nuk janë ndryshe brenda fushëveprimit të këtij Standardi. Gjithashtu, të gjitha angazhimet e kredisë i nënshtrohen kërkesave të këtij Standardi për çregjistrim.

- (h) Instrumenteve financiare, kontratave dhe detyrimeve sipas transaksioneve të pagesave të bazuara në aksion, për të cilat zbatohet standardi përkatës ndërkombëtar ose kombëtar i kontabilitetit që trajton pagesën e bazuar në aksione, me përjashtim të kontratave brenda fushëveprimit të paragrafëve 5-8 të këtij Standardi për të cilat zbatohet ky Standard.
- (i) Të drejtave për pagesat për rimbursimin të njësisë për shpenzimet që i kërkohet të bëjë për të shlyer një detyrim që e njih si provizion në përputhje me SNKSP 19 *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivitetet e Kushtëzuara*, ose për të cilat, në një periudhë më të hershme, ajo njohu një dispozitë në përputhje me SNKSP 19.
- (j) Njohjes fillestare dhe matjes fillestare të të drejtave dhe detyrimeve që vijnë nga transaksionet e të ardhurave pa këmbim, për të cilat zbatohet SNKSP 23, *Të Ardhurat nga Transaksionet pa Këmbim (Taksat dhe Transfertat)*; përveç siç përshkruhet në paragrafin AG6.
- (k) Të drejtave dhe detyrimeve në bazë të marrëveshjeve të shërbimeve koncesionare për të cilat zbatohet SNKSP 32, *Marrëveshjet e Shërbimeve Koncesionare: Grantdhënësi Megjithatë*, detyrimet financiare të njohur nga një grantdhënës sipas modelit të detyrimit financiar u nënshtrohen dispozitave të çregjistrimit të këtij Standardi (shih paragrafët 35-38 dhe shtojcën A, paragrafët AG39-AG47).
3. Kërkesat për zhvlerësim të këtij Standardi do të zbatohen për ato të drejta që vijnë nga SNKSP 9, *Të Ardhurat nga Transaksionet e Këmbimit* dhe transaksioneve të SNKSP 23 të cilat krijojnë instrumente financiare për qëllime të njohjes së fitimeve ose humbjeve nga zhvlerësimi.
4. Angazhimet e mëposhtme të kredisë janë brenda fushëveprimit të këtij Standardi:
- (a) Angazhimet e kredisë që njësia i përcakton si detyrime financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit (shih paragrafin 46). Një njësi që ka një praktikë të mëparshme të shitjes së aktiveve që rezultojnë nga angazhimet e saj të kredisë, menjëherë pas fillimit, do të zbatojë këtë Standard për të gjitha angazhimet e saj të kredisë në të njëjtën klasë.
- (b) Angazhimet për kredi që mund të shlyhen neto me mjete monetare ose duke dhënë ose emetuar një instrument tjetër financiar. Këta angazhime të kredisë janë derivative. Një angazhim kredie nuk konsiderohet si i shlyer neto vetëm



sepse kredia paguhet me këste (për shembull, një kredi ndërtimi hipotekore që paguhet me këste në përputhje me ecurinë e ndërtimit).

- (c) Angazhimet për të dhënë një kredi me një normë interesi nën nivelin e tregut (shih paragrafin 45(d)).
5. Ky Standard do të zbatohet për ato kontrata për të blerë ose shitur një elementë jofinanciar që mund të shlyhet neto në mjete monetare ose një instrument tjetër financiar, ose duke shkëmbyer instrumente financiare, sikur kontratat të ishin instrumente financiare, me përjashtim të kontratave në të cilat ishte hyrë dhe vazhdojnë të mbahen për qëllimin e marrjes ose dhënies së një elementi jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësisë për blerje, shitje ose përdorim. Megjithatë, ky Standard do të zbatohet për ato kontrata që një njësi përcakton si të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me paragrafin 6.
6. Një kontratë për të blerë ose shitur një element jofinanciar që mund të shlyhet neto me mjete monetare ose një instrument tjetër financiar, ose duke shkëmbyer instrumente financiare, sikur kontrata të ishte një instrument financiar, mund të përcaktohet në mënyrë të pakthyeshme si e matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçit edhe nëse ajo është krijuar për qëllimin e marrjes ose dhënies së një artikulli jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të blerjes, shitjes ose përdorimit të njësisë. Ky përcaktim është i disponueshëm vetëm në fillimin e kontratës dhe vetëm nëse eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje njohjeje (ndonjëherë të referuar si 'mospërputhje kontabël') që përndryshe do të lindte nga mosnjohja e asaj kontrate sepse ajo është e përjashtuar nga fushëveprimi i këtij Standardi (shih paragrafin 5).
7. Ka mënyra të ndryshme në të cilat një kontratë për blerjen ose shitjen e një artikulli jofinanciar mund të shlyhet neto me mjete monetare ose në një instrument tjetër financiar ose duke këmbyer instrumente financiare. Këto përfshijnë:
- (a) Kur kushtet e kontratës lejojnë secilën palë ta shlyejë atë neto në mjete monetare ose në një instrument tjetër financiar ose duke shkëmbyer instrumente financiare;
- (b) Kur aftësia për të shlyer neto në mjete monetare ose në një instrument tjetër financiar, ose duke këmbyer instrumente financiare, nuk është e shprehur qartë në kushtet e kontratës, por njësisia ka një praktikë të shlyerjes së kontratave të ngjashme neto në mjete monetare ose në një instrument tjetër financiar ose duke

këmbyer instrumente (qoftë me palën tjetër, duke hyrë në kontrata kompensuese ose duke e shitur kontratën përpara ushtrimit ose skadimit të saj);

- (c) Kur, për kontrata të ngjashme, njësia ka një praktikë të marrjes së artikullit bazë dhe shitjes së tij brenda një periudhe të shkurtër pas dorëzimit me qëllim të gjenerimit të një fitimi nga luhatjet afatshkurtra në çmim ose marzhin e tregtarit; dhe
- (d) Kur elementi jofinanciar që i nënshtrohet kontratës është lehtësisht i konvertueshëm në mjete monetare.

Një kontratë për të cilën zbatohet (b) ose (c) nuk është lidhur për qëllimin e marrjes ose dhënies së elementit jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësisë për blerje, shitje ose përdorim dhe, në përputhje me rrethanat, është brenda fushëveprimit të këtij Standardi. Kontratat e tjera për të cilat zbatohet paragrafi 5 vlerësohen për të përcaktuar nëse në to është hyrë dhe vazhdojnë të mbahen për qëllimin e marrjes ose dhënies së elementit jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të blerjes, shitjes ose përdorimit të njësisë dhe, në përputhje me rrethanat, nëse ato janë brenda fushëveprimit të këtij Standardi.

- 8. Një opSION i shkruar për të blerë ose shitur një artikull jofinanciar që mund të shlyhet neto me mjete monetare ose një instrument tjetër financiar, ose duke këmbyer instrumente financiare, në përputhje me paragrafin 7(a) ose 7(d) është brenda fushëveprimit të këtij Standardi. Në një kontratë të tillë nuk mund të hyet për qëllimin e marrjes ose dhënies së elementit/artikullit jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të blerjes, shitjes ose përdorimit të njësisë.

## Përkufizime

- 9. **Termet e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuar:**

**Humbjet 12-mujore të pritshme të kreditit** janë pjesa e humbjeve të pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës që përfaqësojnë humbjet e pritshme të kreditit që rezultojnë nga ngjarjet e mospagimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

**Kostoja e amortizuar e një aktivi financiar ose detyrimi financiar** është shuma me të cilën matet aktivi ose detyrimi financiar në njohjen fillestare minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference midis asaj shume fillestare dhe shumës së maturuar dhe, për aktivet financiare, e rregulluar për çdo provizion për humbje (shume të lejuar për akomodimin e humbjeve).

Një **aktiv financiar me kredit të zhvlerësuar** është një aktiv financiar

që zhvlerësohet kur kanë ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset monetare të ardhshëm të vlerësuar të atij aktivi financiar. Evidenca se një aktiv financiar është me kredit të zhvlerësuar përfshin të dhëna të prekshme për ngjarjet e mëposhtme:

- (a) Vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose huamarrësit;
- (b) Një shkelje të kontratës, të tilla si një mospagim ose një ngjarje pagese e vonuar;
- (c) Huadhënësi(t) e huamarrësit, për arsye ekonomike ose kontraktuale që lidhen me vështirësitë financiare të huamarrësit, i kanë dhënë huamarrësit një lejim preferencial ose normë(a) që huadhënësi(t) nuk do ta konsideronin ndryshe;
- (d) Po bëhet e mundur që huamarrësi të hyjë në falimentim ose në një riorganizim tjetër financiar;
- (e) Zhdukja e një tregu aktiv për atë aktiv financiar për shkak të vështirësive financiare; ose
- (f) Blerja ose krijimi i një aktivi financiar me një zbritje të thellë që pasqyron humbjet e shkaktuara të kreditit.

Mund të mos jetë e mundur të identifikohet një ngjarje e vetme diskrete, përkundrazi, efekti i kombinuar i disa ngjarjeve mund të ketë bërë që aktivet financiare të kalojnë me kredit të zhvlerësuar.

**Humbja e kreditit** është diferenca midis të gjitha flukseve monetare kontraktuale që i detyrohen një njësie në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukseve monetare që njësia pret të marrë (d.m.th., të gjitha mungesat e mjeteve monetare), të zbritura me normën fillestare të interesit efektiv (ose norma e interesit efektiv me kredit të rregulluar për aktivet financiare të blerë ose të krijuara me me kredit të zhvlerësuar). Një njësi duhet të vlerësojë flukset monetare duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (për shembull, parapagimin, zgjatjen, opsionet e blerjes dhe të ngjashme) gjatë jetës së pritshme të atij instrumenti financiar. Flukset monetare që merren parasysh do të përfshijnë flukse monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose përmirësime të tjera të kreditit që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale. Ekziston një supozim se jeta e pritshme e një instrumenti financiar mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Megjithatë, në ato raste të rralla kur nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri jetëgjatësia e pritshme e një instrumenti financiar, njësia do të përdorë afatin e mbetur kontraktual të instrumentit

financiar.

**Norma efektive e interesit me kredit të rregulluar** është norma që zbrit saktësisht pagesat ose arkëtimet e ardhshme të vlerësuara në mjete monetare gjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar në koston e amortizuar të një aktiviteti financiar që është një aktiv financiar i blerë ose që ishte fillimisht me kredit të zhvlerësuar. Kur llogaritet norma efektive e interesit me kredit të rregulluar, një njësi duhet të vlerësojë flukset e pritshme të mjeteve monetare duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar (për shembull, parapagimin, zgjatjen, opsionet e blerjes dhe të ngjashme) dhe humbjet e pritshme të kreditit. Llogaritja përfshin të gjitha tarifatat dhe pikët e paguara ose të marra ndërmjet palëve në kontratë që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit (shih paragrafët AG156-AG158), kostot e transaksionit dhe të gjitha primet ose zbritjet e tjera. Ekziston një supozim se flukset monetare dhe jeta e pritshme e një grupi instrumentesh të ngjashëm financiare mund të vlerësohen me besueshmëri. Megjithatë, në ato raste të rralla kur nuk është e mundur të vlerësohen me besueshmëri flukset monetare ose jetëgjatësia e mbetur e një instrumenti financiar (ose grupi instrumentesh financiare), njësi do të përdorë flukset monetare kontraktuale gjatë gjithë kohëzgjatjes kontraktuale të instrumentit financiar (ose grupit të instrumenteve financiare).

**Cregjistrimi** është heqja e një aktiviteti financiar ose detyrimi financiar të njohur më parë nga pasqyra e pozicionit financiar të një njësie.

Një **derivativ** është një instrument financiar ose kontratë tjetër brenda fushëveprimit të këtij Standardi me të tre karakteristikat e mëposhtme.

- (a) Vlera e tij ndryshon në përgjigje ndaj ndryshimit të një norme interesi të specifikuar, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të lëndës së parë apo produkteve bujqësore, kursit të këmbimit valutor, indeksit të çmimeve ose normave, vlerësimit të kreditit ose indeksit të kreditit, ose variablave të tjerë, të dhënë në rastin e një variabli jofinanciar që variabli nuk është specifik për një palë në kontratë (ndonjëherë i quajtur 'themelor').
- (b) Ai nuk kërkon investim neto fillestar ose një investim neto fillestar që është më i vogël se sa do të kërkohej për llojet e tjera të kontratave që pritet të kenë një përgjigje të ngjashme ndaj ndryshimeve në faktorët e tregut.
- (c) Ai zgjidhet në një datë të ardhshme.

**Dividendët apo shpërndarjet e ngjashme** janë pagesa të shpërndara

për mbajtësit e instrumenteve të kapitalit në raport/proporcion me zotërimet e tyre të një klase të caktuar kapitali.

**Metoda e interesit efektiv** është metoda që përdoret në llogaritjen e kostos së amortizuar të një aktivi financiar ose një detyrimi financiar dhe në alokimin dhe njohjen e të ardhurave të interesit ose shpenzimet e interesit në sufitit ose deficit gjatë periudhës përkatëse.

**Norma efektive e interesit** është norma që zbret saktësisht pagesat ose arkëtimet e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare gjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar ose detyrimit financiar me vlerën e mbartur bruto të një aktivi financiar ose me koston e amortizuar të një detyrimi financiar. Kur llogaritet norma efektive e interesit, një njësi duhet të vlerësojë flukset e pritshme të mjeteve monetare duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (për shembull, parapagimin, zgjatjen, blerjen dhe opsionet e ngjashme), por nuk do të marrë parasysh humbjet e pritshme të kreditit. Llogaritja përfshin të gjitha tarifatat dhe pikët e paguara ose të marra ndërmjet palëve në kontratë që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit (shih paragrafët AG156–AG158), kostot e transaksionit dhe të gjitha primet ose zbritjet e tjera. Ekziston një supozim se flukset monetare dhe jeta e pritshme e një grupi instrumentesh të ngjashëm financiare mund të vlerësohen me besueshmëri. Megjithatë, në ato raste të rralla kur nuk është e mundur të vlerësohen me besueshmëri flukset monetare ose jetëgjatësia e pritshme e një instrumenti financiar (ose grupi instrumentesh financiare), njësi do të përdorë flukset monetare kontraktuale gjatë gjithë kohëzgjatjes kontraktuale të instrumentit financiar (ose grupit të instrumenteve financiare).

Një **humbje e pritshme e kreditit** është mesatarja e ponderuar e humbjeve të kreditit me rreziqet përkatëse të mospagimit që ndodhin si pesha.

Një **kontratë garancie financiare** është një kontratë që kërkon që emetuesi të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin e një humbjeje që pëson për shkak se një debitor i specifikuar nuk arrin të bëjë pagesën në kohën e duhur, në përputhje me kushtet origjinale ose të modifikuara të një instrumenti borxhi.

Një **detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit** është një detyrim financiar që plotëson një nga kushtet e mëposhtëm:

- (a) Ai plotëson përkufizimin e “i mbajtur për tregtim”.
- (b) Pas njohjes fillestare, ai përcaktohet nga njësi ekonomike si

me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me paragrafin 46 ose 51.

- (c) Ai përcaktohet ose në njohjen fillestare ose më pas si me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me paragrafin 152.

Një angazhim i vendosur është një marrëveshje detyruese për këmbimin e një sasive të specifikuar burimesh me një çmim të specifikuar në një datë ose data të specifikuar të ardhshme.

Një transaksion i parashikuar është një transaksion për të cilin nuk jeni angazhuar, por i parashikuar në të ardhmen.

Vlera e mbartur bruto e një aktivi financiar është kostoja e amortizuar e një aktivi financiar, përpara se të rregullohet për çdo shumë të lejuar ndihmëse për humbje.

Raporti mbrojtës është marrëdhënia midis sasisë së instrumentit mbrojtës dhe sasisë së elementit të mbrojtur sipas peshës të tyre relative.

Një instrument financiar i mbajtur për tregtim është një aktiv ose detyrim financiar që:

- (a) Është blerë ose krijuar kryesisht për qëllimin e shitjes ose riblerjes së tij në një afat të afërt;
- (b) Në njohjen fillestare është pjesë e një portofoli instrumentesh financiare të identifikuar që menaxhohen së bashku dhe për të cilat ka evidencë të një modeli aktual të tanishëm të marrjes së fitimit afatshkurtër; ose
- (c) Është një derivativ (me përjashtim të një derivativi që është një kontratë garancie financiare ose një instrument mbrojtës i përcaktuar dhe efektiv).

Një fitim ose humbje nga zhvlerësimi njihet në sufiçit ose defiçit në përputhje me paragrafin 80 dhe lind nga zbatimi i kërkesave për zhvlerësim në paragrafët 73-93.

Humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës janë humbjet e pritshme të kreditit që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospagimit gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar.

Një provizion humblesh është shuma e lejuar për humbjet e pritshme të kreditit nga aktivet financiare të matur në përputhje me paragrafin 40, të arkëtueshmet nga qiratë, shuma e akumuluar e zhvlerësimit për aktivet financiare e matur në përputhje me paragrafin 41 dhe provizioni për humbjet e pritshme të kreditit për

angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare.

Një fitim ose humbie nga modifikimi është shuma që vjen nga rregullimi i vlerës së mbartur bruto të një aktivi financiar për të pasqyruar flukset monetare kontraktuale të rinegociuara ose të modifikuara. Njësia rillogarit vlerën e mbartur bruto të një aktivi financiar si vlerën aktuale të pagesave ose arkëtimeve të ardhshme monetare gjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar të rinegociuar ose të modifikuar që janë zbritur me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar (ose normën origjinale të interesit efektiv me kredit të rregulluar për aktivet financiare të blera ose që filluan si me kredit të zhvlerësuar) ose, kur është e zbatueshme, norma e interesit efektive të rishikuar e llogaritur në përputhje me paragrafin 139. Kur vlerëson flukset e pritura monetare të një aktivi financiar, një njësi duhet të marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar (për shembull, parapagimin, opsionet e blerjes dhe të ngjashme), por nuk do të konsiderojë humbjet e pritshme fillestare të kreditit, përveç rastit kur aktivi financiar është një aktiv financiar i blerë ose i origjinuar si me kredit të zhvlerësuar, rast në të cilin një njësi do të marrë në konsideratë edhe humbjet fillestare të pritura të kreditit që u konsideruan gjatë llogaritjes së normës efektive fillestare të rregulluar të interesit.

Një aktiv financiar është i vonuar në pagesa kur një palë nuk ka arritur të bëjë një pagesë kur ajo pagesë duhej të paguhej sipas kontratës.

Një aktiv financiar i blerë ose krijuar me kredit të zhvlerësuar është me kredit të zhvlerësuar në njohjen fillestare.

Data e riklasifikimit është dita e parë e periudhës së parë të raportimit pas ndryshimit në modelin e menaxhimit që rezulton në një njësi që riklasifikon aktivet financiare.

Një blerje ose shitje në mënyrë të rregullt është një blerje ose shitje e një aktivi financiar sipas një kontrate, kushtet e së cilës kërkojnë dorëzimin e aktivitetit brenda afateve kohore të përcaktuar përgjithësisht me rregullore ose konvencione në tregun në fjalë.

Kostot e transaksionit janë kosto rritëse shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, emetimit ose shitjes së një aktivi financiar ose detyrimi financiar (shih paragrafin AG163). Një kosto shtesë është ajo që nuk do të kishte ndodhur nëse njësia nuk do të kishte blerë, emetuar ose shitur instrumentin financiar.

Termet e përcaktuar në SNKSP-të e tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ato Standarde, dhe riprodhohen në *Fjalorin e Termave të Përkufizuar* të botuar veçmas. Termat e

mëposhtëm përcaktohen në SNKSP 28 ose në SNKSP 30, *Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese*: rreziku i kreditit, rreziku i monedhës, rreziku i likuiditetit, rreziku i tregut, instrumenti i kapitalit, aktivi financiar, instrumenti financiar, detyrimi financiar dhe instrumenti i kthyesëm.

## Njohja dhe Çregjistrimi

### Njohja Fillestare

10. Një njësi do të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar në pasqyrën e saj të pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, njësia bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit (shih paragrafët AG15 dhe AG16). Kur një njësi njuh fillimisht një aktiv financiar, ajo do ta klasifikojë atë në përputhje me paragrafët 39-44 dhe do ta matë atë në përputhje me paragrafët 57 dhe 59. Kur një njësi njuh fillimisht një detyrim financiar, ajo do ta klasifikojë atë në përputhje me paragrafët 45 dhe 46 dhe do ta masë atë në përputhje me paragrafin 57.

### *Blerje ose Shitje të Rregullta të Aktiveve Financiare*

11. Një blerje ose shitje e rregullt e aktiveve financiare do të njihet dhe çregjistrohet, sipas rastit, duke përdorur kontabilitetin në datën e tregtimit ose kontabilitetin e datës së shlyerjes (shih paragrafët AG17–AG20).

### Çregjistrimi i Aktiveve Financiare

12. Në pasqyrat financiare të konsoliduara, paragrafët 13-20, AG15, AG16 dhe AG21-AG38 zbatohen në një nivel të konsoliduar. Prandaj, një njësi fillimisht konsolidon të gjitha njësitë e kontrolluara në përputhje me SNKSP 35 dhe më pas i zbaton ata paragrafë për njësinë ekonomike që rezultojnë.
13. Përpara se të vlerësojë nëse, dhe në çfarë mase, çregjistrimi është i përshtatshëm sipas paragrafëve 14-20, një njësi përcakton nëse këta paragrafë duhet të zbatohen për një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjesë të një grupi aktivesh financiare të ngjashme) ose një aktivi financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashëm) në tërësinë e tij, si më poshtë.
  - (a) Paragrafët 14–20 zbatohen për një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjesë të një grupi aktivesh financiare të ngjashëm) nëse dhe vetëm nëse, pjesa që konsiderohet për çregjistrim plotëson një nga tre kushtet e mëposhtëm.
    - (i) Pjesa përfshin vetëm flukse monetare të identifikuar në



mënyrë specifike nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashëm). Për shembull, kur një njësi ekonomike hyn në një vazhdë normash interesi ku pala tjetër fiton të drejtën për flukset monetare të interesit, por jo flukset monetare kryesore të principalit nga një instrument borxhi, paragrafët 14-20 zbatohen për flukset monetare të interesit.

- (ii) Pjesa përfshin vetëm një pjesë plotësisht proporcionale (pro rata) të flukseve monetare nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashëm). Për shembull, kur një njësi hyn në një marrëveshje ku kundërpala fiton të drejtat për një pjesë prej 90 për qind të të gjithë flukseve monetare të një instrumenti borxhi, paragrafët 14-20 zbatohen për 90 për qind të atyre flukseve monetare. Nëse ka më shumë se një kundërpalë, secilës kundërpalë nuk i kërkohet të ketë një pjesë proporcionale të flukseve monetare me kusht që njësia transferuese të ketë një pjesë plotësisht proporcionale.
  - (iii) Pjesa përfshin vetëm një pjesë plotësisht proporcionale (pro rata) të flukseve monetare të identifikuar në mënyrë specifike nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashëm). Për shembull, kur një njësi hyn në një marrëveshje ku kundërpala fiton të drejtat për një pjesë 90 për qind të flukseve monetare të interesit nga një aktiv financiar, paragrafët 14–20 zbatohen për 90 për qind të këtyre flukseve monetare të interesit. Nëse ka më shumë se një kundërpalë, secilës kundërpalë nuk i kërkohet të ketë një pjesë proporcionale të flukseve monetare të identifikuar në mënyrë specifike me kusht që njësia transferuese të ketë një pjesë plotësisht proporcionale.
- (b) Në të gjitha rastet e tjera, paragrafët 14–20 zbatohen për aktivin financiar në tërësinë e tij (ose për grupin e aktiveve financiare të ngjashme në tërësinë e tyre). Për shembull, kur një njësi transferon (i) të drejtat për 90 përqindëshin e parë ose të fundit të arkëttimeve të mjeteve monetare nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare), ose (ii) të drejtat për 90 përqind të flukseve monetare nga një grup llogarish të arkëtueshme, por ofron një garanci për të kompensuar blerësin për çdo humbje krediti deri në 8 përqind të shumës së principalit të të arkëtueshmeve, paragrafët 14-20 zbatohen për aktivin financiar (ose një grup aktivesh financiare të

ngjashme) në tërësinë e tij.

Në paragrafët 14–23, termi 'aktiv financiar' i referohet ose një pjese të një aktivi financiar (ose një pjese të një grupi aktivesh financiare të ngjashëm) siç identifikohet në (a) më sipër ose, përndryshe, një aktivi financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashëm) në tërësinë e tij.

14. Një njësi duhet të çregjistrojë një aktiv financiar kur dhe vetëm kur:
- (a) Të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar skadojnë ose eliminohen, ose
  - (b) Ai transferon aktivin financiar siç përcaktohet në paragrafët 15 dhe 16 dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim në përputhje me paragrafin 17.

(Shih paragrafin 11 për shitjet e rregullta të aktiveve financiare.)

15. Një njësi transferon një aktiv financiar nëse dhe vetëm nëse, ai ose:
- (a) Transferon të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të aktivit financiar, ose
  - (b) Ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të aktivit financiar, por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'i paguar flukset monetare një ose më shumë marrësve në një marrëveshje që plotëson kushtet në paragrafin 16.

16. Kur një njësi ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të një aktivi financiar ("aktivi origjinal"), por merr një detyrim kontraktual për t'i paguar ata flukse monetare për një ose më shumë njësi ("përfituesit e mundshëm të ardhshëm"), njësia trajton transaksionin si transferim të një aktivi financiar nëse dhe vetëm nëse plotësohen të tre kushtet e mëposhtëm.

- (a) Njësia nuk ka asnjë detyrim t'u paguajë shuma marrësve eventualë, përveç rastit kur mbledh shuma ekuivalente nga aktivi origjinal. Paradhëniet afatshkurtra nga njësia me të drejtën e rikuperimit të plotë të shumës së dhënë hua plus interesin e grumbulluar me normat e tregut nuk e çënojnë këtë kusht.
- (b) Njësia është e ndaluar nga kushtet e kontratës së transferimit të shesë ose të premtojë aktivin origjinal, ndryshe nga si garanci për marrësit eventualë për detyrimin për t'u paguar atyre flukse monetare.
- (c) Njësia ka detyrimin të paguajë çdo fluks monetar që mbledh në emër të marrësve eventualë pa vonesa materiale. Krahas

kësaj, njësia ekonomike nuk ka të drejtë të riinvestojë flukse monetare të tillë, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalente të mjeteve monetare (siç përkufizohet në SNKSP 2, *Pasqyrat e Fluxeve Monetare*) gjatë periudhës së shkurtër të shlyerjes nga data e mbledhjes deri në datën e dërgesës së kërkuar tek përfituesit eventualë, dhe interesi i fituar nga këta investime u kalon përfituesve eventualë.

17. Kur një njësi transferon një aktiv financiar (shih paragrafin 15), ajo duhet të vlerësojë shkallën në të cilën ajo ruan rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Në këtë rast:
- (a) Nëse njësia transferon përgjithësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, njësia do të çregjistrojë aktivin financiar dhe do të njohë veç si aktive ose detyrime çdo të drejtë dhe detyrim të krijuar ose mbajtur në transferim.
  - (b) Nëse njësia ruan përgjithësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, njësia do të vazhdojë të njohë aktivin financiar.
  - (c) Nëse njësia as nuk transferon dhe as nuk ruan përgjithësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, njësia do të përcaktojë nëse ajo ka mbajtur kontrollin e aktivit financiar. Në këtë rast:
    - (i) Nëse njësia nuk ka mbajtur kontrollin, ajo do të çregjistrojë aktivin financiar dhe do të njohë veç si aktive ose detyrime çdo të drejtë dhe detyrim të krijuar ose mbajtur në transferim.
    - (ii) Nëse njësia ka mbajtur kontrollin, ajo do të vazhdojë të njohë aktivin financiar në masën e përfshirjes së vazhdueshme të saj në aktivin financiar (shih paragrafin 27).
18. Transferimi i rreziqeve dhe përfitimeve (shih paragrafin 17) vlerësohet duke krahasuar ekspozimin e njësisë, para dhe pas transfertës, me ndryshueshmërinë në shumat dhe kohën e flukseve monetare neto të aktivit të transferuar. Një njësi ka mbajtur në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivit financiar nëse ekspozimi i saj ndaj ndryshueshmërisë në vlerën aktuale të flukseve monetare neto të ardhshme nga aktiviteti financiar nuk ndryshon ndjeshëm si rezultat i transferimit (p.sh., sepse njësia ka shitur një aktiv financiar që i nënshtrohet një marrëveshjeje për ta blerë atë mbrapsht me një çmim fiks ose çmimin e shitjes plus një fitim të huadhënësit). Një njësi ka


transferuar në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivi financiar nëse ekspozimi i saj ndaj një ndryshueshmërie të tillë nuk është më i konsiderueshëm në lidhje me ndryshueshmërinë totale në vlerën aktuale të flukseve monetare neto të ardhshme të shoqëruara me aktivin financiar (p.sh. sepse njësia ka shitur një aktiv financiar që i nënshtrohet vetëm një opsioni për ta rikthyer atë *me vlerën e drejtë* në kohën e riblerjes ose ka transferuar një pjesë proporcionale të flukseve monetare nga një aktiv financiar më i madh në një marrëveshje, siç është një nën-pjesëmarrje kredie, që plotëson kushtet në paragrafin 16).

19. Shpesh do të jetë e qartë nëse njësia ka transferuar ose mbajtur në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk do të ketë nevojë për të kryer ndonjë llogaritje. Në raste të tjera, do të jetë e nevojshme të llogaritet dhe të krahasohet ekspozimi i njësisë ndaj ndryshueshmërisë në vlerën aktuale të flukseve neto të ardhshme të mjeteve monetare para dhe pas transferimit. Llogaritja dhe krahasimi bëhen duke përdorur si normë zbritjeje një normë të përshtatshme interesi aktual të tregut. E gjithë ndryshueshmëria arsyeshëm e mundshme në flukset monetare neto merret parasysh, duke u dhënë peshë më të madhe atyre rezultateve që kanë më shumë gjasa të ndodhin.
20. Nëse njësia ka mbajtur kontrollin (shih paragrafin 17(c)) të aktivitetit të transferuar varet nga aftësia e marrësit për të shitur aktivin. Nëse marrësi ka aftësinë praktike për t'ia shitur aktivin në tërësi një pale të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë këtë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për transferimin, njësia nuk e ka mbajtur kontrollin. Në të gjitha rastet e tjera, njësia ka ruajtur kontrollin.

*Transfertat që Kualifikohen për Çregjistrim*

21. **Nëse një njësi transferon një aktiv financiar në një transfertë që kualifikohet për çregjistrim në tërësinë e tij dhe ruan të drejtën për t'i shërbyer aktivitetit financiar kundrejt një tarife, ajo do të njohë ose një aktiv shërbimi ose një detyrim shërbimi për atë kontratë shërbimi. Nëse tarifa që do të merret nuk pritet të kompensojë njësinë në mënyrë adekuate për kryerjen e shërbimit, një detyrim shërbimi për detyrimin e shërbimit do të njihet me vlerën e tij të drejtë. Nëse tarifa që do të merret pritet të jetë më shumë se kompensimi adekuat për shërbimin, një aktiv shërbimi do të njihet për të drejtën e shërbimit në një shumë të përcaktuar në bazë të një alokimi të vlerës së mbartur të aktivitetit më të madh financiar në përputhje me paragrafin 24.**

## INSTRUMENTET FINANCIARE



22. Nëse, si rezultat i një transferimi, një aktiv financiar çregjistrohet në tërësi, por transferimi rezulton që njësia të marrë një aktiv të ri financiar ose të ndërmarrë një detyrim të ri financiar ose një detyrim shërbimi, njësia do të njohë aktivin e ri financiar, detyrimin financiar ose detyrimin e shërbimit me vlerën e drejtë.
23. Në çregjistrimin e një aktivi financiar në tërësinë e tij, diferenca midis:
- (a) Vlerës së mbartur (e matur në datën e çregjistrimit); dhe
  - (b) Shumës së përfituar (duke përfshirë çdo aktiv të ri të marrë minus çdo detyrim të ri të ndërmarrë)
- do të njihet në sufiçit ose defiçit.
24. Nëse aktivi i transferuar është pjesë e një aktivi financiar më të madh (p.sh., kur një njësi transferon flukse monetare të interesit që janë pjesë e një instrumenti borxhi, shih paragrafin 13(a)) dhe pjesa e transferuar kualifikohet për çregjistrim në tërësi, shuma e mbartur e mëparshme e aktivit financiar më të madh do të shpërndahet ndërmjet pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që çregjistrohet, në bazë të vlerave të drejta relative të atyre pjesëve në datën e transferimit. Për këtë qëllim, një aktiv i ruajtur i shërbimit do të trajtohet si një pjesë që vazhdon të njihet. Diferenca midis:
- (a) Vlerës së mbartur (e matur në datën e çregjistrimit) e alokuar për pjesën e çregjistruar; dhe
  - (b) Shumës së marrë për pjesën e çregjistruar (duke përfshirë çdo aktiv të ri të marrë minus çdo detyrim të ri të ndërmarrë)
- do të njihet në sufiçit ose defiçit.
25. Kur një njësi alokon vlerën e mbartur të mëparshme të një aktivi financiar më të madh midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që çregjistrohet, vlera e drejtë e pjesës që vazhdon të njihet duhet të matet. Kur njësia ka një histori shitjeje të pjesëve të ngjashme me pjesën që vazhdon të njihet ose ekzistojnë transaksione të tjerë tregu për pjesë të tilla, çmimet e fundit të transaksioneve aktuale ofrojnë vlerësimin më të mirë të vlerës së drejtë të tij. Kur nuk ka kuota çmimesh ose transaksione të fundit të tregut për të mbështetur vlerën e drejtë të pjesës që vazhdon të njihet, vlerësimi më i mirë i vlerës së drejtë është diferenca midis vlerës së drejtë të aktivit financiar më të madh në tërësi dhe shumës së marrë nga marrësi për pjesën që çregjistrohet.

*Transfertat që nuk Kualifikohen për Çregjistrim*

26. Nëse një transferim nuk rezulton në mosnjohje/çregjistrim sepse njësia ka mbajtur në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit të transferuar, njësia do të vazhdojë ta njohë

aktivin e transferuar në tërësinë e tij dhe do të njohë një detyrim financiar për shumën e marrë. Në periudhat pasardhëse, njësia do të njohë çdo të ardhur nga aktivi i transferuar dhe çdo shpenzim të shkaktuar për detyrimin financiar.

*Përfshirja e Vazhdueshme në Aktivet e Transferuara*

27. Nëse një njësi as nuk transferon dhe as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivi të transferuar, dhe ruan kontrollin e aktivitetit të transferuar, njësia vazhdon ta njohë aktivin e transferuar në masën e përfshirjes së saj të vazhdueshme. Shtrirja e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë në aktivin e transferuar është shkalla në të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar. Për shembull:
- (a) Kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë merr formën e garantimit të aktivitetit të transferuar, shtrirja e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë është më e ulët se (i) shumën e aktivitetit dhe (ii) shumën maksimale të pagesës së marrë që mund t'i kërkohej njësisë për të ripaguar ('shumën e garancisë').
  - (b) Kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (ose të dyja) mbi aktivin e transferuar, shtrirja e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë është shumën e aktivitetit të transferuar që njësia mund të riblejë. Megjithatë, në rastin e një opsioni shitjeje me shkrim për një aktiv që matet me vlerën e drejtë, shtrirja e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë është e kufizuar në më të voglën e vlerës së drejtë të aktivitetit të transferuar dhe çmimit të ushtrimit të opsionit (shih paragrafin AG34).
  - (c) Kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë merr formën e një opsioni të shlyer me mjete monetare ose një provizionin të ngjashëm për aktivin e transferuar, shtrirja e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë matet në të njëjtën mënyrë si ajo që rezulton nga opsionet e shlyera pa mjete monetare, siç përcaktohet në (b) më sipër.
28. Kur një njësi vazhdon të njohë një aktiv në masën e përfshirjes së tij të vazhdueshme, njësia njih gjithashtu një detyrim shoqëruar. Pavarësisht nga kërkesat e tjera të matjes në këtë Standard, aktivi i transferuar dhe detyrimi shoqëruar maten mbi një bazë që pasqyron të drejtat dhe detyrimet që njësia ka ruajtur. Detyrimi shoqëruar matet në atë mënyrë që vlera e mbartur neto e aktivitetit të transferuar dhe detyrimit shoqëruar është:
- (a) Kostoja e amortizuar e të drejtave dhe detyrimeve të mbajtura nga njësia, nëse aktivi i transferuar matet me koston e

amortizuar; ose

- (b) E barabartë me vlerën e drejtë të të drejtave dhe detyrimeve të mbajtura nga njësia kur maten në bazë të pavarur/të veçantë, nëse aktivi i transferuar matet me vlerën e drejtë.
29. Njësia do të vazhdojë të njohë çdo të ardhur që lind nga aktivi i transferuar në masën e përfshirjes së vazhdueshme të saj dhe do të njohë çdo shpenzim të shkaktuar për detyrimin shoqërues.
30. Për qëllime të matjes së mëvonshme, ndryshimet e njohura në vlerën e drejtë të aktivitetit të transferuar dhe detyrimit shoqërues kontabilizohen në mënyrë të qëndrueshme me njëri-tjetrin në përputhje me paragrafin 101 dhe nuk do të kompensohen.
31. Nëse përfshirja e vazhdueshme e një njësie është vetëm në një pjesë të një aktivi financiar (p.sh., kur një njësi ruan një opion për të riblerë një pjesë të një aktivi të transferuar, ose ruan një interes të mbetur që nuk rezulton në mbajtjen e të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë dhe njësia ruan kontrollin), njësia shpërndan vlerën e mbartur të mëparshme të aktivitetit financiar midis pjesës që vazhdon të njohë nën përfshirjen e vazhdueshme, dhe pjesës që nuk njeh më në bazë të vlerave të drejta relative të atyre pjesëve në datën e transferimit. Për këtë qëllim, zbatohen kërkesat e paragrafit 25. Diferenca midis:
- (a) Vlerës së mbartur (e matur në datën e çregjistrimit) e alokuar për pjesën që nuk njihet më; dhe
- (b) Shumës së përfituar për pjesën që nuk njihet më
- do të njihet në sufiçit ose defiçit.**
32. Nëse aktivi i transferuar matet me koston e amortizuar, opsioni në këtë Standard për të përcaktuar një detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit nuk është i zbatueshëm për detyrimin shoqërues.

*Të Gjitha Transfertat*

33. Nëse një aktiv i transferuar vazhdon të njihet, aktivi dhe detyrimi shoqërues nuk do të kompensohen. Në mënyrë të ngjashme, njësia nuk do të kompensojë ndonjë të ardhur që vjen nga aktivi i transferuar me ndonjë shpenzim të shkaktuar për detyrimin shoqërues (shih paragrafin 47 të SNKSP 28).
34. Nëse një transferues i jep kolateral jomonetar (siç janë instrumentet e borxhit ose kapitalit) marrësit, kontabiliteti i kolateralit nga transferuesi dhe marrësi varet nga fakti nëse marrësi ka të drejtë të shesë ose të ripremtojë kolateralin dhe nëse transferuesi nuk ka



**paguar në kohë. Transferuesi dhe marrësi do të kontabilizojnë kolateralin si më poshtë:**

- (a) Nëse marrësi ka të drejtën me kontratë ose zakon të shesë ose të ripremtojë kolateralin, atëherë transferuesi do ta riklasifikojë atë aktiv në pasqyrën e tij të pozicionit financiar (p.sh., si një aktiv i huazuar, instrumente të kapitalit të premtuara si garanci ose të arkëtueshmet e riblerjes) veç nga aktivet e tjera.
- (b) Nëse marrësi shet kolateralin e premtuar si garanci, ai do të njohë të ardhurat nga shitja dhe një detyrim të matur me vlerën e drejtë për detyrimin e tij për të kthyer kolateralin.
- (c) Nëse transferuesi nuk paguan në kohë sipas kushteve të kontratës dhe nuk ka më të drejtë të shpengojë/shlyejë kolateralin, ai do të çregjistrojë kolateralin, dhe marrësi do të njohë kolateralin si aktivin e tij të matur fillimisht me vlerën e drejtë ose, nëse ai e ka shitur tashmë kolateralin, do të çregjistrojë detyrimin e tij për kthimin e kolateralit.
- (d) Me përjashtim të rasteve të parashikuara në (c), transferuesi do të vazhdojë të mbajë kolateralin si aktiv të tij dhe marrësi nuk do ta njohë kolateralin si aktiv.

#### **Çregjistrimi i Detyrimeve Financiare**

- 35. **Një njësi do të heqë një detyrim financiar (ose një pjesë të një detyrimi financiar) nga pasqyra e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur ai është eliminuar—d.m.th., kur detyrimi i specifikuar në kontratë është shlyer, eliminuar, anuluar ose ka skaduar.**
- 36. **Një këmbim midis një huamarrësi ekzistues dhe huadhënësit të instrumenteve të borxhit me kushte thelbësisht të ndryshme do të kontabilizohet si një eliminim i detyrimit financiar fillestar dhe si njohje e një detyrimi të ri financiar. Në mënyrë të ngjashme, një modifikim thelbësor i kushteve të një detyrimi financiar ekzistues ose një pjese të tij (nëse i atribuohet apo jo vështirësisë financiare të debitorit) do të kontabilizohet si një eliminim i detyrimit financiar fillestar dhe njohje/regjistrim i një detyrimi të ri financiar.**
- 37. **Diferenca midis vlerës së mbartur të një detyrimi financiar (ose një pjese të një detyrimi financiar) të eliminuar ose transferuar te një palë tjetër dhe shumës së paguar, duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar ose detyrim të ndërmarrë, do të njihet në sufiçit ose defiçit. Kur një detyrim eliminohet nga huadhënësi ose merret përsipër nga një palë e tretë si pjesë e një transaksioni pa këmbim, një njësi zbaton SNKSP 23.**

38. Nëse një njësi riblen një pjesë të një detyrimi financiar, njësia do të alokojë vlerën e mbartur të mëparshme të detyrimit financiar midis pjesës që vazhdon të njihet/regjistrohet dhe pjesës që çregjistrohet bazuar në vlerat e drejta relative të atyre pjesëve në datën e riblerjes. Diferenca ndërmjet (a) vlerës së mbartur të alokuar për pjesën e çregjistruar dhe (b) shumës së paguar, duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar ose detyrimet e ndërmarra, për pjesën e çregjistruar do të njihen në sufiçit ose defiçit.

## Klasifikimi

### Klasifikimi i Aktiveve Financiare

39. Nëse nuk zbatohet paragrafi 44, një njësi do të klasifikojë aktivet financiare si të matura më pas me koston e amortizuar, me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto ose vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në bazë të të dyjave:

- (a) Modelit të menaxhimit të njësisë për aktivet financiare; dhe
- (b) Karakteristikave kontraktuale të fluksit monetar të aktivit financiar.

40. Një aktiv financiar do të matet me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtëm:

- (a) Aktivi financiar mbahet brenda një modeli menaxhimi, objektivi i të cilit është të mbajë aktive financiare për të mbledhur flukset monetare kontraktuale dhe
- (b) Kushtet kontraktuale të aktivit financiar krijojnë në data të specifikuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar.

Paragrafët AG48–AG88 japin udhëzime se si të zbatohen këta kushte.

41. Një aktiv financiar do të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtëm:

- (a) Aktivi financiar mbahet brenda një modeli menaxhimi, objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale ashtu edhe nga shitja e aktiveve financiare; dhe
- (b) Kushtet kontraktuale të aktivit financiar krijojnë në data të specifikuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar.

Paragrafët AG48–AG88 japin udhëzime se si të zbatohen këta

**kushte.**

42. **Për qëllimin e zbatimit të paragrafëve 40(b) dhe 41(b):**
- (a) **Principali është vlera e drejtë e aktivit financiar në njohjen fillestare. Paragrafi AG64 jep udhëzime shtesë mbi kuptimin e principalit.**
  - (b) **Interesi konsiston në pagesën për vlerën në kohë të parasë, për rrezikun e kreditit të shoqëruar me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të huadhënies, si dhe një marzh fitimi. Paragrafët AG63 dhe AG67–AG71 ofrojnë udhëzime shtesë mbi kuptimin e interesit, duke përfshirë kuptimin e vlerës në kohë të parasë.**
43. **Një aktiv financiar do të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit, përveçse kur matet me koston e amortizuar në përputhje me paragrafin 40 ose me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41. Megjithatë një njësi mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme në njohjen fillestare për investime të veçanta në instrumente të kapitalit që përndryshe do të mateshin me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit për të prezantuar ndryshime të mëvonshme në vlerën e drejtë në aktivet/kapitalin neto (shih paragrafët 106–107).**

*Opsioni për të Përcaktuar një Aktiv Financiar me Vlerën e Drejtë nëpërmjet Sufiçitit ose Defiçitit*

44. **Pavarësisht paragrafëve 39–43, një njësi mund, në njohjen fillestare, të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit, nëse duke vepruar kështu eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje njohjeje (ndonjëherë referuar si një "mospërputhje kontabël" ) që përndryshe do të lindte nga matja e aktiveve ose detyrimeve ose njohja e fitimeve dhe humbjeve të tyre në baza të ndryshme (shih paragrafët AG91–AG94).**

#### **Klasifikimi i Detyrimeve Financiare**

45. **Një njësi do të klasifikojë të gjitha detyrimet financiare si të matur më pas me koston e amortizuar, me përjashtim të:**
- (a) **Detyrimeve financiare me vlerën e drejtë përmes sufiçitit ose defiçitit. Këta detyrime, duke përfshirë derivativët që janë detyrime, do të maten më pas me vlerën e drejtë.**
  - (b) **Detyrimet financiare që lindin kur një transferim i një aktivi financiar nuk kualifikohet për çregjistrim ose kur zbatohet**

qasja e përfshirjes së vazhdueshme. Paragrafët 26 dhe 28 zbatohen për matjen e këtyre detyrimeve financiare.

- (c) Kontratat e garancisë financiare. Pas njohjes fillestare, një emetues i një kontrate të tillë (përveç rastit kur zbatohet paragrafi 45(a) ose (b)) më pas do ta masë atë në vlerën më të lartë të:
- (i) Shumës së lejuar për kompensimin e humbjes e përcaktuar në përputhje me paragrafët 73–93; dhe
  - (ii) Shumës së njohur fillimisht (shih paragrafin 57) minus, kur është e përshtatshme, shumën kumulative të amortizimit të njohur në përputhje me parimet e SNKSP 9.
- (d) Angazhimet për të dhënë një kredi me një normë interesi nën nivelin e tregut. Një emetues i një angazhimi të tillë (përveç nëse zbatohet paragrafi 45(a)) më pas do ta masë atë në vlerën më të lartë të:
- (i) Shumës së lejuar për kompensimin e humbjes e përcaktuar në përputhje me paragrafët 73–93; dhe
  - (ii) Shumës së njohur fillimisht (shih paragrafin 57) minus, kur është e përshtatshme, shumën e amortizimit të akumuluar të njohur në përputhje me parimet e SNKSP 9.
- (e) Vlera e kushtëzuar e njohur nga një blerës në një kombinim të sektorit publik për të cilin zbatohet SNKSP 40. Një shumë e tillë e kushtëzuar do të matet më pas me vlerën e drejtë me ndryshimet e njohura në sufiçit ose deficiit.

*Opsioni për të Përcaktuar një Detyrim Financiar me Vlerë të Drejtë nëpërmjet Sufiçitit ose Deficitit*

46. Një njësi në njohjen fillestare, mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një detyrim financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose deficiitit kur lejohet nga paragrafi 51, ose kur një gjë e tillë rezulton në informacion më të rëndësishëm, sepse ose:
- (a) Ai eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje matjeje ose njohjeje (ndonjëherë referuar si 'një mospërputhje kontabël') që përndryshe do të lindte nga matja e aktiveve ose detyrimeve ose nga njohja e fitimeve dhe humbjeve të tyre në baza të ndryshme (shih paragrafët AG91–AG94); ose
  - (b) Një grup detyrimesh financiare ose aktivesh financiare dhe detyrimesh financiare menaxhohet dhe performanca e tij

vlërësohet mbi bazën e vlerës së drejtë, në përputhje me një strategji të dokumentuar të menaxhimit të rrezikut ose investimit, dhe informacioni për grupin jepet brenda në këtë bazë personelit drejtues kryesor të njësisë (siç përcaktohet në **SNKSP 20, Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Palët e Lidhura**), për shembull, organi drejtues i njësisë dhe shefi ekzekutiv (shih paragrafët AG95–AG98).

### Derivativët e Përfshirë

47. Një derivativ i përfshirë është një komponent i një kontrate hibride që përfshin gjithashtu një bartës joderivativ - me efektin që disa nga flukset monetare të instrumentit të kombinuar variojnë në një mënyrë të ngjashme me një derivativ të pavarur. Një derivativ i përfshirë bën që disa ose të gjitha flukset monetare që përndryshe do të kërkoheshin nga kontrata të modifikohen sipas një norme interesi të caktuar, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të komoditeteve (lëndë të para, ose produkte bujqësore), kursit të këmbimit valutor, indeksit të çmimeve ose normave, vlerësimit të kreditit ose indeksit të kreditit, ose variabli tjetër, me kusht që në rastin e një variabli jofinanciar, variabli të mos jetë specifik për një palë në kontratë. Një derivativ që është i bashkangjitur me një *instrument financiar*, por është i transferueshëm kontraktualisht, në mënyrë të pavarur nga ai instrument, ose ka një kundërpalë tjetër, nuk është një derivativ i përfshirë, por një instrument financiar i veçantë.

#### *Kontratat Hibride me Bartës të Aktiveve Financiare*

48. Nëse një kontratë hibride përmban një bartës që është një aktiv brenda fushëveprimit të këtij Standardi, një njësi do të zbatojë kërkesat në paragrafët 39–44 për të gjithë kontratën hibride.

#### *Kontratat e Tjera Hibride*

49. Nëse një kontratë hibride përmban një bartës që nuk është një aktiv brenda fushëveprimit të këtij Standardi, një derivativ i përfshirë do të ndahet nga bartësi dhe do të kontabilizohet si një derivativ sipas këtij Standardi nëse, dhe vetëm nëse:
- (a) Karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e derivativit të përfshirë nuk janë të lidhura ngushtë me karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e bartësit (shih paragrafët AG103 dhe AG106);
  - (b) Një instrument i veçantë me të njëjtat terma si derivativi i përfshirë do të plotësonte përkufizimin e një derivati; dhe
  - (c) Kontrata hibride nuk matet me vlerën e drejtë me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në sufiçit ose defiçit (d.m.th., një

derivativ që është i përfshirë në një detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit nuk është i ndarë).

50. Nëse një derivativ i përfshirë është i ndarë, kontrata bartëse do të kontabilizohet në përputhje me Standardet përkatëse. Ky Standard nuk adreson nëse një derivativ i përfshirë do të prezantohet veç në pasqyrën e pozicionit financiar.
51. Pavarësisht nga paragrafët 49 dhe 50, nëse një kontratë përmban një ose më shumë derivativë të përfshirë dhe bartësi nuk është një aktiv brenda fushëveprimit të këtij Standardi, një njësi mund të përcaktojë të gjithë kontratën hibride si me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit, përveç rasteve kur:
- (a) Derivatvët e përfshirë nuk modifikojnë ndjeshëm flukset monetare që përndryshe do të kërkoheshin nga kontrata; ose
  - (b) Është e qartë me pak ose aspak analizë, kur një instrument i ngjashëm hibrid konsiderohet për herë të parë se ndarja e derivativeve të përfshirë është e ndaluar, siç është një opsion parapagimi i përfshirë në një kredi që i lejon mbajtësit të parapagujë kredinë për përfaqësimin e saj të amortizuar.
52. Nëse një njësi i kërkohet nga ky Standard që të ndajë një derivativ të përfshirë nga bartësi i tij, por nuk është në gjendje të matë derivativin e përfshirë veç qoftë në blerje ose në fund të një periudhe raportimi financiar të mëpasshëm, ajo do të përcaktojë të gjithë kontratën hibride si me vlerën e drejtë përmes suficitit ose deficitit.
53. Nëse një njësi nuk është në gjendje të matë me besueshmëri vlerën e drejtë të një derivativi të përfshirë në bazë të termave dhe kushteve të tij, vlera e drejtë e derivativit të përfshirë është diferenca midis vlerës së drejtë të kontratës hibride dhe vlerës së drejtë të bartëses. Nëse njësi nuk është në gjendje të masë vlerën e drejtë të derivativit të përfshirë duke përdorur këtë metodë, paragrafi 52 zbatohet dhe kontrata hibride përcaktohet si me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit.

### Riklasifikimi

54. Kur dhe vetëm kur, një njësi ndryshon modelin e saj të menaxhimit për aktivet financiare, ajo do të riklasifikojë të gjithë aktivet financiare të ndikuar në përputhje me paragrafët 39–43. Shih paragrafët 94–100, AG111–AG113 dhe AG220–AG221 për udhëzime shtesë mbi riklasifikimin e aktiveve financiare.
55. Një njësi nuk do të riklasifikojë asnjë detyrim financiar.

56. Ndryshimet e mëposhtëm në rrethana nuk janë riklasifikime për qëllimet e paragrafëve 54–55:
- (a) Një artikull që ishte më parë një instrument mbrojtës i përcaktuar dhe efektiv në një mbrojtje të fluksit monetar ose mbrojtje të investimit neto, nuk kualifikohet më si i tillë;
  - (b) Një artikull bëhet një instrument mbrojtës i përcaktuar dhe efektiv në një mbrojtje të fluksit monetar ose një mbrojtje të investimit neto; dhe
  - (c) Ndryshimet në matje në përputhje me paragrafët 152–155.

## **Matja**

### **Matja Fillestare**

57. **Me përjashtim të llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme afatshkurtra brenda fushëveprimit të paragrafit 60, në njohjen fillestare, një njësi do të masë një aktiv financiar ose detyrim financiar me vlerën e tij të drejtë plus ose minus, në rastin e një aktivi financiar ose detyrimi financiar jo me vlerën drejtë nëpërmjet suficitit ose defiçitit, kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të aktivit financiar ose detyrimit financiar.**
58. **Megjithatë, nëse vlera e drejtë e aktivit financiar ose detyrimit financiar në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, një njësi do të zbatojë paragrafin AG117.**
59. Kur një njësi përdor kontabilizimin e datës së shlyerjes për një aktiv që matet më pas me koston e amortizuar, aktivi njihet fillimisht me vlerën e tij të drejtë në datën e tregtimit (shih paragrafët AG17–AG20).
60. Pavarësisht kërkesës në paragrafin 57, në njohjen fillestare, një njësi mund të masë të arkëtueshmet dhe të pagueshmet afatshkurtra me shumën fillestare të faturës nëse efekti i zbritjes është jomaterial.

### **Matja e Mëpasshme e Aktiveve Financiare**

61. **Pas njohjes fillestare, një njësi do të masë një aktiv financiar në përputhje me paragrafët 39–44 me:**
- (a) **Koston e amortizuar;**
  - (b) **Vlerën e drejtë përmes aktiveve/kapitalit neto; ose**
  - (c) **Vlerën e drejtë përmes suficitit ose defiçitit.**
62. **Një njësi do të zbatojë kërkesat e zhvlerësimit në paragrafët 73-93 për aktivet financiare që maten me koston e amortizuar në**

përputhje me paragrafin 40 dhe për aktivet financiare që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41.

63. Një njësi do të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në paragrafët 137-143 (dhe, nëse është e aplikueshme, paragrafët 99-105 të SNKSP 29, *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*) për kontabilitetin mbrojtës me vlerën e drejtë për një mbrojtje të portofolit të rrezikut të normës së interesit) një aktiv financiar që është përcaktuar si një element i mbrojtur.

#### **Matja e Mëpasshme e Detyrimeve Financiare**

64. Pas njohjes fillestare, një njësi do të masë një detyrim financiar në përputhje me paragrafët 45–46.
65. Një njësi do të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në paragrafët 137-143 (dhe, nëse është e zbatueshme, paragrafët 99-105 të SNKSP 29 për mbrojtjen e vlerës së drejtë të kontabilitetit për një mbrojtje portofoli të rrezikut të normës së interesit) për një detyrim financiar që është përcaktuar si artikull i mbrojtur.

#### **Konsideratat për Matjen me Vlerën e Drejtë**

66. Në përcaktimin e vlerës së drejtë të një aktivi financiar ose një pasivi financiar për qëllimin e zbatimit të këtij Standardi, SNKSP 28 ose SNKSP 30, një njësi do të zbatojë paragrafët AG144–AG155 të Shtojcës A.
67. Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë janë çmimet e kuotuar në një treg aktiv. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, një njësi vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Objektivi i përdorimit të një teknike vlerësimi është të përcaktojë se cili do të kishte qenë çmimi i transaksionit në datën e matjes në një këmbim të pa ndikuar të motivuar nga konsideratat normale të funksionimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve të pa ndikuara të fundit të tregut midis palëve të mirëinformuara, të gatshme, nëse ka, referenca të vlerës së drejtë aktuale të një instrumenti tjetër që është në thelb i njëjtë, analiza të flukseve monetare të skontuar dhe modele të çmimit opsional. Nëse ekziston një teknikë vlerësimi që përdoret zakonisht nga pjesëmarrësit e tregut për të përcaktuar çmimin e instrumentit dhe kjo teknikë është demonstruar se jep vlerësime të besueshme të çmimeve të marra në transaksionet aktualë të tregut, njësia e përdor atë teknikë. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përdor maksimalisht të dhënat e tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në të dhënat hyrëse specifike të njësisë. Ajo përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në përcaktimin e një çmimi dhe është në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për përcaktimin e çmimit të instrumenteve financiare. Periodikisht, një njësi përmirëson



teknikën e vlerësimit dhe e teston atë për vlefshmërinë duke përdorur çmimet nga çdo transaksion aktual i observueshëm i tregut në të njëjtin instrument (d.m.th., pa modifikim ose ripaketim) ose bazuar në çdo të dhënë të disponueshme të observueshme të tregut.

68. Vlera e drejtë e një detyrimi financiar me një karakteristikë kërkesë (p.sh., një depozitë pa afat) nuk është më e vogël se shumta e pagueshme sipas kërkesës, e zbritur nga data e parë që mund të kërkohej të paguhet shumta.

### **Matja me Koston e Amortizuar**

#### *Aktivitet Financiare*

#### Metoda e Interesit Efektiv

69. **Të ardhurat nga interesi do të llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv (shih paragrafët 9 dhe AG156–AG162). Kjo do të llogaritet duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën e mbartur bruto të një aktivi financiar me përjashtim të:**
- (a) **Aktiveve financiare të blerë ose të origjinuara me kredit të zhvlerësuar. Për ato aktive financiare, njësia do të aplikojë normën efektive të interesit me kredit të rregulluar për koston e amortizuar të aktivitetit financiar që nga njohja fillestare.**
  - (b) **Aktiveve financiare që nuk janë aktive financiare të blerë ose të origjinuar me kredit të zhvlerësuar, por më pas janë shndërruar në aktive financiare me kredit të zhvlerësuar. Për këto aktive financiare, njësia do të zbatojë normën efektive të interesit për koston e amortizuar të aktivitetit financiar në periudhat pasardhëse të raportimit.**
70. Një njësi që, në një periudhë raportimi, llogarit të ardhurat nga interesi duke aplikuar metodën e interesit efektiv për koston e amortizuar të një aktivi financiar në përputhje me paragrafin 69(b), në periudhat pasuese të raportimit, do të llogarisë të ardhurat nga interesi duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën e mbartur bruto nëse rreziku i kreditit për instrumentin financiar përmirësohet në mënyrë që aktivi financiar të mos jetë më me kredit të zhvlerësuar dhe përmirësimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi janë zbatuar kërkesat në paragrafin 69(b) (të tilla si një përmirësim në vlerësimin e kreditit të huamarrësit).

#### Modifikimi i Flukseve Monetare Kontraktuale

71. Kur flukset monetare kontraktuale të një aktivi financiar rinegocohen ose modifikohen ndryshe dhe rinegocimi ose modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e atij aktivi financiar në përputhje me këtë Standard, një

njësi do të rillogarisë vlerën e mbartur bruto të aktivitetit financiar dhe do të njohë një modifikim të fitimit ose humbjes në sufitin ose defitit. Vlera e mbartur bruto e aktivitetit financiar do të rillogaritet si vlera aktuale e flukseve monetare kontraktuale të rinegociuar ose të modifikuar që janë zbritur me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar (ose normën efektive të interesit me kredit të rregulluar për aktivitetin financiar të blerë ose të origjinar me kredit të zhvlerësuar) ose, kur është e zbatueshme, norma efektive e interesit e rishikuar e llogaritur në përputhje me paragrafin 139. Çdo kosto ose tarifë e shkaktuar rregullon vlerën e mbartur të aktivitetit financiar të modifikuar dhe amortizohet gjatë kohëzgjatjes së mbetur të aktivitetit financiar të modifikuar.

#### Pakësimi i vlerës

72. Një njësi do të reduktojë drejtpërdrejt vlerën e mbartur bruto të një aktivi financiar kur njësia nuk ka pritshmëri të arsyeshme për të rikuperuar një aktiv financiar në tërësinë e tij ose një pjesë të tij. Pakësimi i vlerës përbën një ngjarje çregjistrimi (shih paragrafin AG37(r)).

#### Zhvlerësimi

##### *Njohja e Humbjeve të Pritshme të Kreditit*

##### Qasja e Përgjithshme

73. **Një njësi do të njohë një provizion humbjesh për *humbjet e pritshme të kreditit* për një aktiv financiar që matet në përputhje me paragrafët 40 ose 41, një qira të arkëtueshme, ose një angazhim kredie dhe një kontratë garancie financiare për të cilën zbatohen kërkesat e zhvlerësimit në përputhje me paragrafin 2. (g), 45 (c) ose 45 (d).**
74. Një njësi do të zbatojë kërkesat e zhvlerësimit për njohjen dhe matjen e një provizionit humbjesh për aktivitetin financiar që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41. Megjithatë, provizioni për humbjen do të njihet në aktivet/kapitalin neto dhe nuk do të reduktojë vlerën e mbartur të aktivitetit financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.
75. **Në varësi të paragrafëve 85–88, në çdo datë raportimi, një njësi do të masë provizionin e humbjes për një instrument financiar me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës, nëse rreziku i kreditit për atë instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.**
76. Objektivi i kërkesave të zhvlerësimit është njohja e humbjeve të pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës për të gjitha instrumentet financiare për të cilat ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut të kreditit që nga njohja

fillestare - qoftë e vlerësuar në baza individuale apo kolektive - duke marrë parasysh të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetshëm, duke përfshirë atë që është largpamës.

77. **Në varësi të paragrafëve 85–88, nëse në datën e raportimit, rreziku i kreditit për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, një njësi do të masë provizionin e humbjes për atë instrument financiar me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme 12-mujore të kreditit.**
78. Për angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare, data që njësia bëhet palë e angazhimit të parëvokueshëm do të konsiderohet si data e njohjes fillestare për qëllime të zbatimit të kërkesave të zhvlerësimit.
79. Nëse një njësi ka matur provizionin e humbjes për një instrument financiar me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetës në periudhën e mëparshme të raportimit, por përcakton në datën aktuale të raportimit se paragrafi 75 nuk përmbushet më, njësia do të masë provizionin e humbjes në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit 12-mujore në datën aktuale të raportimit.
80. Një njësi duhet të njohë në sufiçit ose defiçit, si një fitim ose humbje zhvlerësimi, shumën e humbjeve të pritshme të kreditit (ose rikthimin) që kërkohet për të rregulluar provizionin e humbjes në datën e raportimit në shumën që kërkohet të njihet në përputhje me këtë Standard.

#### Përcaktimi i Rritjeve të Konsiderueshme të Rrezikut të Kreditit

81. Në çdo datë raportimi, një njësi do të vlerësojë nëse rreziku i kredisë për një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Kur bën vlerësimin, një njësi do të përdorë ndryshimin në rrezikun e mospagimit që ndodh gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar në vend të ndryshimit në shumën e humbjeve të pritshme të kreditit. Për të bërë këtë vlerësim, një njësi ekonomike duhet të krahasojë rrezikun që të ndodhë mospagimi i instrumentit financiar në datën e raportimit me rrezikun që të ndodhë mospagimi i instrumentit financiar sipas datës kur është bërë njohja fillestare dhe të marrë në konsideratë informacionin mbështetës dhe të arsyeshëm, që është i disponueshëm pa ndonjë përpjekje apo kosto të panevojshme, që tregon se rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm që nga koha e njohjes fillestare.
82. Një njësi mund të supozojë se rreziku i kreditit për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, nëse instrumenti financiar përcaktohet se ka rrezik të ulët krediti në datën e raportimit (shih paragrafët AG186-AG188).
83. Nëse informacioni i arsyeshëm dhe i mbështetur mbi të ardhmen është i

disponueshëm pa kosto të panevojshme, një njësi nuk mund të mbështetet vetëm në informacionin e të shkuarës kur përcakton nëse rreziku i kreditit është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Megjithatë, kur informacioni i të ardhmes që shtrihet përtej datës së ripagimit (mbi baza individuale ose kolektive) nuk mund të sigurohet pa ndonjë kosto apo përpjekje të papërshtatshme, një njësi ekonomike mund të përdorë informacionin pas datës së ripagimit për të përcaktuar nëse ka pasur rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë që nga njohja e tij fillestare. Pavarësisht sesi një njësi ekonomike vlerëson rritjen e ndjeshme të rrezikut të kredisë, ka një hipotezë të kundërshtueshme që rreziku i kredisë të një aktivi financiar rritet në mënyrë të ndjeshme që nga momenti i njohjes fillestare në rast se pagesat kontraktuale janë vonuar me më shumë se 30 ditë. Një njësi ekonomike mund ta kundërshtojë këtë hipotezë nëse njësia ekonomike ka informacion të arsyeshëm dhe të mbështetur i cili mund të jetë i disponueshëm pa ndonjë kosto të papërshtatshme, i cili demonstroi që rreziku i kredisë nuk është rritur në mënyrë të ndjeshme që nga momenti i njohjes fillestare edhe pse pagesat kontraktuale janë vonuar me më shumë se 30 ditë. Kur një njësi përcakton se ka pasur rritje të konsiderueshme në rrezikun e kreditit përpara se pagesat kontraktuale të jenë vonuar për më shumë se 30 ditë, supozimi i kundërshtueshëm nuk zbatohet.

#### Aktivet Financiare të Modifikuar

84. Nëse flukset monetare kontraktuale të një aktivi financiar janë rinegociuar ose modifikuar dhe aktivi financiar nuk është çregjistruar, një njësi do të vlerësojë nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kreditit të instrumentit financiar në përputhje me paragrafin 75, duke krahasuar:
- (a) Rrezikun e mospagesës në kohë që ndodh në datën e raportimit (bazuar në kushtet e modifikuar kontraktuale); dhe
  - (b) Rrezikun e një mospagese në kohë që ndodh në njohjen fillestare (bazuar në kushtet origjinale, të pandryshuara kontraktuale).

#### Aktive Financiare të Blerë ose të Origjinuar me Kredit të Zhvlerësuar

85. **Pavarësisht nga paragrafët 75 dhe 77, në datën e raportimit, një njësi do të njohë vetëm ndryshimet kumulative në humbjet e pritshme të kreditit gjatë jetës që nga njohja fillestare si një provizion për humbje për aktivet financiare të blerë ose të origjinuar me kredit të zhvlerësuar.**
86. Në çdo datë raportimi, një njësi do të njohë në sufiçit ose defiçit shumën e ndryshimit në humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës si një fitim ose humbje nga zhvlerësimi. Një njësi do të njohë ndryshimet e

favorshme në humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës si një fitim nga zhvlerësimi, edhe nëse humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës janë më të vogla se shumica e humbjeve të pritshme të kreditit që janë përfshirë në flukset monetare të vlerësuara në njohjen fillestare.

*Qasja e Thjeshtuar për Llogaritë e Arkëtueshme*

87. **Pavarësisht nga paragrafët 75 dhe 77, një njësi do të matë gjithmonë provizionin e humbjes me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës për:**
- (a) **Llogaritë e arkëtueshme që rezultojnë nga transaksionet e këmbimit që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 9 dhe transaksionet pa këmbim brenda fushëveprimit të SNKSP 23.**
  - (b) **Llogaritë e arkëtueshme e qirave që rezultojnë nga transaksionet që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 13, nëse njësi zgjedh si politikën e saj kontabël të masë provizionin e humbjes me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetës. Kjo politikë e kontabilitetit do të zbatohet për të gjitha të arkëtueshmet e qirave, por mund të zbatohet veç për të arkëtueshmet e qirave financiare dhe të zakonshme.**
88. Një njësi mund të zgjedhë politikën e saj të kontabilitetit për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të arkëtueshmet e qirave, pavarësisht nga njëra-tjetra.
89. Kërkesat për aktivet financiare të blerë ose të origjinuara me kredit të zhvlerësuar (shih paragrafët 9 dhe 85 deri në 86) nuk zbatohen për të arkëtueshmet afatshkurtra.

*Matja e Humbjeve të Pritshme të Kreditit*

90. **Një njësi do të masë humbjet e pritshme të kreditit të një instrumenti financiar në një mënyrë që pasqyron:**
- (a) **Një shumë e paanshme dhe e ponderuar sipas probabilitetit që përcaktohet duke vlerësuar një interval rezultatesh të mundshme;**
  - (b) **Vlerën në kohë të parasë; dhe**
  - (c) **Informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është i disponueshëm pa kosto të panevojshme në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.**
91. Kur maten humbjet e pritshme të kreditit, një njësi nuk duhet domosdoshmërisht të identifikojë çdo skenar të mundshëm. Megjithatë,

ajo duhet të marrë në konsideratë rrezikun ose probabilitetin që të ndodhë një humbje krediti duke reflektuar mundësinë që të ndodhë një humbje krediti dhe mundësinë që të mos ndodhë ndonjë humbje krediti, edhe nëse mundësia për të ndodhur një humbje krediti është shumë e ulët.

92. Periudha maksimale që duhet marrë parasysh kur maten humbjet e pritshme të kreditit është periudha maksimale kontraktuale (duke përfshirë opsionet e zgjatjes) gjatë së cilës njësia është e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit dhe jo një periudhë më e gjatë, edhe nëse kjo periudhë më e gjatë është në përputhje me praktikën e biznesit.
93. Megjithatë, disa instrumente financiare përfshijnë si një kredi ashtu edhe një komponent angazhimi të patërhequr dhe aftësia kontraktuale e njësisë për të kërkuar shlyerjen dhe anulimin e angazhimit të patërhequr nuk e kufizon ekspozimin e njësisë ndaj humbjeve të kredisë në periudhën e njoftimit kontraktual. Për instrumente të tillë financiare, dhe vetëm ato instrumente financiare, njësia do të masë humbjet e pritshme të kreditit gjatë periudhës që njësia është e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit dhe humbjet e pritshme të kreditit nuk do të zbuten nga veprimet e menaxhimit të rrezikut të kreditit, edhe nëse kjo periudhë zgjat përtej periudhës maksimale kontraktuale.

#### **Riklasifikimi i Aktiveve Financiare**

94. **Nëse një njësi riklasifikon aktivet financiare në përputhje me paragrafin 54, ajo do të zbatojë riklasifikimin në mënyrë prospektive nga data e riklasifikimit. Njësia nuk do të rideklarojë ndonjë fitim të njohur më parë, humbje (përfshirë fitimet ose humbjet e zhvlerësimit) ose interes. Paragrafët 95–100 përcaktojnë kërkesat për riklasifikimet.**
95. **Nëse një njësi riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes së kostos së amortizuar, në kategorinë e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit, vlera e drejtë e tij matet në datën e riklasifikimit. Çdo fitim ose humbje që vjen nga një diferencë ndërmjet kostos së mëparshme të amortizuar të aktivit financiar dhe vlerës së drejtë njihet në sufiçit ose defiçit.**
96. **Nëse një njësi riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet së sufiçitit ose defiçitit, në kategorinë e matjes së kostos së amortizuar, vlera e drejtë e tij në datën e riklasifikimit bëhet vlera e re e mbartur bruto. (Shih paragrafin AG221 për udhëzim mbi përcaktimin e një norme interesi efektive dhe një provizion për humbje në datën e riklasifikimit.)**
97. **Nëse një njësi riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes së kostos së amortizuar, në kategorinë e matjes me vlerën e drejtë**

nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto, vlera e drejtë e tij matet në datën e riklasifikimit. Çdo fitim ose humbje që vjen nga një diferencë midis kostos së mëparshme të amortizuar të aktivitetit financiar dhe vlerës së drejtë njihet në aktivet/kapitalin neto. Norma efektive e interesit dhe matja e humbjeve të pritshme të kreditit nuk rregullohen si rezultat i riklasifikimit. (Shih paragrafin AG220.)

98. Nëse një njësi riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes me vlerën e drejtë përmes aktiveve/kapitalit neto, në kategorinë e matjes me koston e amortizuar, aktivi financiar riklasifikohet me vlerën e drejtë në datën e riklasifikimit. Megjithatë, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në aktivet/kapitalin neto hiqet nga aktivet/kapitali neto dhe rregullohet kundrejt vlerës së drejtë të aktivitetit financiar në datën e riklasifikimit. Si rezultat, aktivi financiar matet në datën e riklasifikimit sikur të ishte matur gjithmonë me koston e amortizuar. Ky rregullim ndikon në aktivet/kapitalin neto, por nuk ndikon në sufiçitin ose deficitin dhe për këtë arsye nuk është një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*). Norma efektive e interesit dhe matja e humbjeve të pritshme të kreditit nuk rregullohen si rezultat i riklasifikimit. (Shih paragrafin AG220.)
99. Nëse një njësi riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes me vlerën e drejtë përmes të sufiçitit ose deficitit, në kategorinë e matjes me vlerën e drejtë përmes aktiveve/kapitalit neto, aktivi financiar vazhdon të matet me vlerën e drejtë. (Shih paragrafin AG221 për udhëzim mbi përcaktimin e një norme interesi efektive dhe një provizion për humbje në datën e riklasifikimit.)
100. Nëse një njësi riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes me vlerën e drejtë përmes aktiveve/kapitalit neto, në kategorinë e matjes me vlerën e drejtë përmes sufiçitit ose deficitit, aktivi financiar vazhdon të matet me vlerën e drejtë. Fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në aktivet/kapitalin neto riklasifikohet nga aktivet/kapitali neto në sufiçit ose deficit si një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1) në datën e riklasifikimit.

#### **Fitimet dhe Humbjet**

101. Një fitim ose humbje nga një aktiv ose detyrim financiar që matet me vlerën e drejtë do të njihet në sufiçit ose deficit, përveç rasteve kur:
- (a) Është pjesë e një marrëdhënieje mbrojtëse (shih paragrafët 137-143 dhe, nëse zbatohet, paragrafët 99-105 të SNKSP 29 për kontabilizimin e mbrojtjes me vlerën e drejtë për një mbrojtje të portofolit të rrezikut të normës së interesit);

- (b) Është një investim në një instrument kapitali dhe njësia ka zgjedhur të prezantojë fitime dhe humbje nga ai investim në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 106;
- (c) Është një detyrim financiar i përcaktuar si me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit dhe njësisë i kërkohet të prezantojë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kreditit të detyrimit në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 108; ose
- (d) Është një aktiv financiar i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41 dhe njësisë i kërkohet të njohë disa ndryshime në vlerën e drejtë në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 111.
102. Dividentët ose shpërndarjet e ngjashme njihen në sufiçit ose defiçit vetëm kur:
- (a) Është vendosur e drejta e njësisë për të marrë pagesën e dividendit;
- (b) Ka probabilitet që përfitimet ekonomike të shoqëruara me dividendin të kalojnë tek njësia ekonomike; dhe
- (c) Shuma e dividendit mund të matet me besueshmëri.
103. **Një fitim ose humbje nga një aktiv financiar që matet me koston e amortizuar dhe nuk është pjesë e një marrëdhënieje mbrojtëse (shih paragrafët 137-143 dhe, nëse është e zbatueshme, paragrafët 99-105 të SNKSP 29 për kontabilitetin mbrojtës të vlerës së drejtë për një mbrojtje portofoli të rrezikut të normës së interesit) do të njihet në sufiçit ose defiçit kur aktivi financiar çregjistrohet, riklasifikohet në përputhje me paragrafin 95, nëpërmjet procesit të amortizimit ose për të njohur fitimet ose humbjet nga zhvlerësimi. Një njësi do të zbatojë paragrafët 95 dhe 97 nëse riklasifikon aktivet financiare jashtë nga kategoria e matjes me koston e amortizuar. Një fitim ose humbje nga një detyrim financiar që matet me koston e amortizuar dhe nuk është pjesë e një marrëdhënieje mbrojtëse (shih paragrafët 137-143 dhe, nëse është e zbatueshme, paragrafët 99-105 të SNKSP 29 për kontabilitetin mbrojtës të vlerës së drejtë për një mbrojtje portofoli të rrezikut të normës së interesit) do të njihet në sufiçit ose defiçit kur detyrimi financiar çregjistrohet dhe nëpërmjet procesit të amortizimit. (Shih paragrafin AG224 për udhëzim mbi fitimet ose humbjet nga këmbimi i monedhave të huaja.)**
104. **Një fitim ose humbje nga aktivet financiare ose detyrimet financiare që janë artikuj të mbrojtur në një marrëdhënie mbrojtëse do të njihen në përputhje me paragrafët 137-143 dhe, nëse është e zbatueshme, paragrafët 99-105 të SNKSP 29 për kontabilitetin**



mbrojtës me vlerën e drejtë për një mbrojtje portofoli të rrezikut të normës së interesit.

105. Nëse një njësi njuh aktive financiare duke përdorur kontabilitetin në datën e shlyerjes (shih paragrafët 11, AG17 dhe AG20), çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitetit që do të merret gjatë periudhës ndërmjet datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes nuk njihet për aktivitetet e matur me kosto të amortizuara. Megjithatë, për aktivitetet e matur me vlerën e drejtë, ndryshimi në vlerën e drejtë do të njihet në sufiçit ose defiçit ose në aktivitet/kapitalin neto, sipas rastit në përputhje me paragrafin 101. Data e tregtimit do të konsiderohet data e njohjes fillestare për qëllimet e zbatimit të kërkesave të zhvlerësimit.

*Investimet në Instrumentet e Kapitalit*

106. Në njohjen fillestare, një njësi mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të prezantuar në aktivitet/kapitalin neto ndryshime të mëvonshme në vlerën e drejtë të një investimi në një instrument kapitali brenda fushëveprimit të këtij Standardi që as nuk mbahet për tregtim dhe as për shumën e kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim të sektorit publik. (Shih paragrafin AG226 për udhëzime mbi fitimet ose humbjet nga këmbimi i huaj.)
107. Nëse një njësi bën zgjedhjen në paragrafin 106, ajo do të njohë si sufiçit ose defiçit dividendë ose shpërndarje të ngjashme nga ai investim në përputhje me paragrafin 102.

*Detyrimet e Përcaktuar si me Vlerë të Drejtë përmes Sufiçitit ose Defiçitit*

108. Një njësi do të prezantojë një fitim ose humbje nga një detyrim financiar që përcaktohet si me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me paragrafin 46 ose paragrafin 51 si më poshtë:
- (a) Shuma e ndryshimit në vlerën e drejtë të detyrimit financiar që i atribuohet ndryshimeve në rrezikun e kredisë të atij detyrimi do të prezantohet në aktivitet/kapitalin neto (shih paragrafët AG236–AG243), dhe
  - (b) Shuma e mbetur e ndryshimit në vlerën e drejtë të detyrimit do të prezantohet në sufiçit ose defiçit, përveç rastit kur trajtimi i efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kreditit të detyrimit të përshkruar në (a) do të krijonte ose zgjeronte një mospërputhje kontabël në sufiçit ose defiçit (rast në të cilin zbatohet paragrafi 109). Paragrafët AG228–AG230 dhe AG233–AG235 japin udhëzime për përcaktimin nëse një mospërputhje kontabël do të krijohej apo do të zgjerohej.

109. Nëse kërkesat në paragrafin 108 do të krijonin ose zgjeronin një mospërputhje kontabël në sufiçit ose defiçit, një njësi do të prezantojë të gjitha fitimet ose humbjet për atë detyrim (duke përfshirë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kreditit të atij detyrimi) në sufiçit ose defiçit.
110. Pavarësisht nga kërkesat në paragrafët 108 dhe 109, një njësi do të prezantojë në sufiçit ose defiçit të gjitha fitimet dhe humbjet nga angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare që përcaktohen si me vlerën e sufiçit nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit.

*Aktivet e Matura me Vlerën e Drejtë përmes Aktiveve/Kapitalit Neto*

111. Një fitim ose humbje nga një aktiv financiar i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41 do të njihet në aktivet/kapitalin neto, me përjashtim të fitimeve ose humbjeve nga zhvlerësimi (shih paragrafët 73-93) dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimi i huaj (shih paragrafët AG224–AG225), derisa aktivi financiar të çregjistrohet ose riklasifikohet. Kur aktivi financiar çregjistrohet, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në aktivet/kapitalin neto riklasifikohet nga aktivet/kapitali neto në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi (shih paragrafët 125A–125C të SNKSP 1). Nëse aktivi financiar riklasifikohet nga kategorisë së matjes me vlerën e drejtë përmes së aktiveve/kapitalit neto, njësia do të kontabilizojë fitimin ose humbjen kumulative që ishte njohur më parë në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafët 98 dhe 100. Interesi i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv njihet në sufiçit ose defiçit.
112. Siç përshkruhet në paragrafin 111, nëse një aktiv financiar matet me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41, shumat që njihen në sufiçit ose defiçit janë të njëjta me shumat që do të ishin njohur në sufiçit ose defiçit nëse aktivi financiar do të ishte matur me koston e amortizuar.

## Kontabiliteti Mbrojtës

### Objektivi dhe Fushëveprimi i Kontabilitetit Mbrojtës

113. Objektivi i kontabilitetit mbrojtës është të përfaqësojë, në pasqyrat financiare, efektin e aktiviteteve të menaxhimit të rrezikut të një njësie që përdorin instrumente financiare për të menaxhuar ekspozimet që vijnë nga rreziqe të veçanta që mund të ndikojnë tek dufiçiti ose defiçiti (ose aktivet/kapitali neto, në rastin e investimeve në instrumentet e kapitalit për të cilat një njësi ka zgjedhur të prezantojë ndryshime në vlerën e drejtë në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 106). Kjo qasje synon të përcjellë kontekstin e instrumenteve mbrojtës për të cilët

zbatohet kontabiliteti mbrojtës në mënyrë që të lehtësojë një kuptueshmëri intuitive të qëllimit dhe efektit të tyre.

114. Një njësi mund të zgjedhë të përcaktojë një marrëdhënie mbrojtëse midis një instrumenti mbrojtës dhe një elementi të mbrojtur në përputhje me paragrafët 116-128 dhe AG244-AG274. Për marrëdhëniet mbrojtëse që plotësojnë kriteret kualifikuese, një njësi duhet të kontabilizojë fitimin ose humbjen nga instrumenti mbrojtës dhe elementi i mbrojtur në përputhje me paragrafët 130-143 dhe AG294-AG321. Kur elementi i mbrojtur është një grup zërash, një njësi do të përmbushë kërkesat shtesë në paragrafët 146–151 dhe AG333–AG348.
115. Për një mbrojtje me vlerën e drejtë të ekspozimit të normës së interesit të një portofoli aktivesh ose detyrimesh financiare (dhe vetëm për një mbrojtje të tillë), një njësi mund të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në SNKSP 29 në vend të atyre në këtë Standard. Në atë rast, njësia duhet të zbatojë gjithashtu kërkesat specifike për kontabilizimin mbrojtës me vlerën e drejtë për një mbrojtje portofoli të rrezikut të normës së interesit dhe të përcaktojë si element të mbrojtur një pjesë që është një shumë valutore (shih paragrafët 91, 100 dhe AG157-AG175 të SNKSP 29).

### **Instrumentet Mbrojtëse**

#### *Instrumentet Kualifikuese*

116. **Një derivativ i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës, me përjashtim të disa opsioneve të shkruar (shih paragrafin AG247).**
117. **Një aktiv financiar joderivativ ose një detyrim financiar joderivativ i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës, përveç rastit kur është një detyrim financiar i përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit për të cilin shuma e ndryshimit të tij në vlerën e drejtë që i atribuohet ndryshimeve në rrezikun e kreditit të atij detyrimi prezantohet në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 108. Për një mbrojtje të rrezikut të monedhës së huaj, komponenti i rrezikut të monedhës së huaj i një aktivi financiar joderivativ ose një detyrim financiar joderivativ mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës me kusht që ai të mos jetë një investim në një instrument kapitali për të cilin një njësi ka zgjedhur të prezantojë ndryshime në vlerën e drejtë në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 106.**
118. **Për qëllime të kontabilitetit mbrojtës, vetëm kontratat me një palë të jashtme të njësisë raportuese (d.m.th., të jashtme të njësisë ekonomike ose njësisë individuale për të cilën raportohet) mund të**

**përcaktohen si instrumente mbrojtës.**

*Përcaktimi i Instrumenteve Mbrojtëse*

119. Një instrument kualifikues duhet të përcaktohet në tërësi si një instrument mbrojtës. Përfshihen e vetme të lejuara janë:
- (a) Ndarja e vlerës së brendshme dhe vlerës kohore të një kontrate opsioni dhe përcaktimi/klasifikimi si instrument mbrojtës vetëm ndryshimin në vlerën e brendshme të një opsioni dhe jo ndryshimin në vlerën e tij në kohë/kohore (shih paragrafët 144 dhe AG322–AG326);
  - (b) Ndarja e elementit të ardhshëm dhe elementit të momentit (spot) të një kontrate të ardhshme dhe përcaktimi si instrument mbrojtës vetëm i ndryshimit në vlerën e elementit spot të një kontrate të ardhshme dhe jo të elementit të ardhshëm; në mënyrë të ngjashme, shpërndarja e bazës së monedhës së huaj mund të ndahet dhe të përfshihet nga përcaktimi i një instrumenti financiar si instrument mbrojtës (shih paragrafët 145 dhe AG327–AG332); dhe
  - (c) Një pjesë e të gjithë instrumentit mbrojtës, si 50 për qind e shumës nominale, mund të përcaktohet si instrument mbrojtës në një marrëdhënie mbrojtëse. Megjithatë, një instrument mbrojtës nuk mund të përcaktohet për një pjesë të ndryshimit të tij në vlerën e drejtë që rezulton vetëm nga një pjesë e periudhës kohore gjatë së cilës instrumenti mbrojtës mbetet i papaguar.
120. Një njësi mund të shikojë në kombinim dhe të përcaktojë së bashku si instrument mbrojtës, çdo kombinim të këtyre që vijojnë (duke përfshirë ato rrethana në të cilat rreziku ose rreziqet që vijnë nga disa instrumente mbrojtës kompensojnë ato që vijnë nga të tjerët):
- (a) Derivativët ose një pjesë e tyre; dhe
  - (b) Joderivativët ose një pjesë e tyre.
121. Megjithatë, një instrument derivativ që kombinon një opSION të shkruar dhe një opSION të blerë (për shembull, një hapsirë e normës së interesit) nuk kualifikohet si një instrument mbrojtës nëse është, në fakt, një opSION i shkruar neto në datën e përcaktimit (përveç nëse kualifikohet në përputhje me paragrafin AG247). Në mënyrë të ngjashme, dy ose më shumë instrumente (ose proporcione të tyre) mund të caktohen së bashku si instrument mbrojtës vetëm nëse, në kombinim, ato nuk janë, në fakt, një opSION i shkruar neto në datën e përcaktimit (përveç rastit kur ai kualifikohet në përputhje me paragrafin AG247).

**Elementet e Mbrojtur**

*Elementet Kualifikuese*

122. Një element i mbrojtur mund të jetë një aktiv ose detyrim i njohur, një angazhim i panjohur i palëkundur, një transaksion i parashikuar ose një investim neto në një operacion të huaj. Elementi i mbrojtur mund të jetë:

- (a) Një element i veçantë; ose
- (b) Një grup elementesh (subjekt i paragrafëve 146–151 dhe AG333–AG348).

Një element i mbrojtur mund të jetë gjithashtu një komponent i një elementi ose grupi të tillë elementesh (shih paragrafët 128 dhe AG256–AG274).

123. Elementi i mbrojtur duhet të jetë i matshëm në mënyrë të besueshme.

124. Nëse një element i mbrojtur është një transaksion i parashikuar (ose një komponent i tij), ai transaksion duhet të ketë shumë probabilitet të ndodhë.

125. Një ekspozim total që është një kombinim i një ekspozimi që mund të kualifikohet si një element i mbrojtur në përputhje me paragrafin 122 dhe një derivativ mund të përcaktohet si një element i mbrojtur (shih paragrafët AG252–AG253). Kjo përfshin një transaksion të parashikuar të një ekspozimi total (dmth. transaksionet e ardhshme të paangazhuara por të parashikuara që do të shkaktonin një ekspozim dhe një derivativi) nëse ai ekspozim total ka shumë probabilitet të ndodhë dhe, pasi të ketë ndodhur dhe për rrjedhojë nuk parashikohet më, përbush kriteret për të qënë një element i mbrojtur.

126. Për qëllime të kontabilitetit mbrojtës, vetëm aktivet, detyrimet, angazhimet e palëkundura ose transaksionet e parashikuara me shumë probabilitet me një palë të jashtme të njësisë raportuese mund të përcaktohen si artikuj të mbrojtur. Kontabiliteti mbrojtës mund të zbatohet për transaksionet ndërmjet njësive në të njëjtën njësi ekonomike vetëm në pasqyrat financiare individuale ose të veçanta të atyre njësive dhe jo në pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive ekonomike, me përjashtim të:

- (a) Pasqyrave financiare të konsoliduara të një njësie investuese, siç përcaktohet në SNKSP 35, ku transaksionet ndërmjet një njësie investuese dhe njësive të saj të kontrolluara të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit nuk do të

**eliminohen në pasqyrat financiare të konsoliduara; ose**

- (b) **Pasqyrave financiare të konsoliduara të një njësie kontrolluese të një njësie investimi, siç përkufizohet në SNKSP 35, e cila nuk është në vetvete një njësi investuese, ku transaksionet ndërmjet një njësie investuese të kontrolluar dhe investimet e një njësie investuese të kontrolluar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose defiçitit nuk do të eliminohen në pasqyrat financiare të konsoliduara.**

127. Megjithatë, si përjashtim nga paragrafi 126, rreziku i monedhës së huaj i një elementi monetar brenda një njësie ekonomike (për shembull, një i pagueshëm/i arkëtueshëm ndërmjet dy njësive të kontrolluara) mund të kualifikohet si një element i mbrojtur në pasqyrat financiare të konsoliduara nëse rezulton në një ekspozim ndaj fitimeve ose humbjeve nga kursi i këmbimit që nuk eliminohen plotësisht në konsolidim në përputhje me SNKSP 4, *Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit në Monedhë të Huaj*. Në përputhje me SNKSP 4, fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit të elementëve monetare brenda një njësie ekonomike nuk eliminohen plotësisht në konsolidim kur elementi monetar transaktohet ndërmjet dy njësive brenda njësisë ekonomike që kanë monedha të ndryshme funksionale. Krahas kësaj, rreziku i monedhës së huaj i një transaksioni të parashikuar me shumë probabilitet për të ndodhur brenda njësisë ekonomike mund të kualifikohet si një element i mbrojtur në pasqyrat financiare të konsoliduara me kusht që transaksioni të jetë i shprehur në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë që hyn në atë transaksion dhe rreziku i monedhës së huaj do të ndikojë në suficitin ose defiçitin e konsoliduar.

*Përcaktimi i Elementeve të Mbrojtur*

128. Një njësi mund të përcaktojë një zë në tërësinë e tij ose një komponent të një elementi si element të mbrojtur në një marrëdhënie mbrojtëse. Një element i tërë përfshin të gjithë ndryshimet në flukset monetare ose vlerën e drejtë të një elementi. Një komponent përfshin më pak se i gjithë ndryshimi i vlerës së drejtë ose ndryshueshmëria e fluksit monetar të një elementi. Në atë rast, një njësi mund të përcaktojë vetëm llojet e mëposhtme të komponentëve (përfshirë kombinimet) si artikuj të mbrojtur:
- (a) Vetëm ndryshimet në flukset monetare ose vlerën e drejtë të një elementi që i atribuohet një rreziku ose rreziqeve specifike (komponenti i rrezikut), me kusht që, bazuar në një vlerësim brenda kontekstit të strukturës së veçantë të tregut, komponenti i rrezikut të jetë i identifikueshëm veç dhe besueshëm i matshëm (shih paragrafët AG257–AG264). Komponentët e rrezikut përfshijnë një përcaktim të vetëm ndryshimeve në flukset monetare

ose në vlerën e drejtë të një elementi të mbrojtur mbi ose nën një çmim të caktuar ose një variabël tjetër (një rrezik i njëanshëm).

- (b) Një ose më shumë flukse monetare kontraktuale të zgjedhur.
- (c) Komponentët e një shume nominale, d.m.th., një pjesë e caktuar e shumës së një elementi (shih paragrafët AG265–AG269).

### Kriteret Kualifikues për Kontabilitetin Mbrojtës

129. **Një marrëdhënie mbrojtëse kualifikohet për kontabilitet mbrojtës vetëm nëse plotësohen të gjitha kriteret e mëposhtme:**

- (a) **Marrëdhënia mbrojtëse përbëhet vetëm nga instrumente mbrojtës dhe elementë të mbrojtur që përmbushin kriteret për të qenë të tillë.**
- (b) **Në fillim të marrëdhënies mbrojtëse ka përcaktim dhe dokumentacion zyrtar të marrëdhënies mbrojtëse dhe objektivit dhe strategjisë së menaxhimit të rrezikut të njësisë për ndërmarrjen e mbrojtjes. Ky dokumentacion do të përfshijë identifikimin e instrumentit mbrojtës, elementin e mbrojtur, natyrën e rrezikut nga i cili mbrohet dhe mënyrën se si njësia do të vlerësojë nëse marrëdhënia mbrojtëse plotëson kërkesat e efektivitetit të mbrojtjes (përfshirë analizën e saj të burimeve të mosefektivitetit të mbrojtjes dhe mënyrën se si ajo përcakton *raportin e mbrojtjes*).**
- (c) **Marrëdhënia mbrojtëse plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme të efektivitetit të mbrojtjes:**

- (i) **Ekziston një marrëdhënie ekonomike midis elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës (shih paragrafët AG278–AG280);**
- (ii) **Efkti i rrezikut të kreditit nuk dominon ndryshimet e vlerës që rezultojnë nga ajo marrëdhënie ekonomike (shih paragrafët AG281–AG282); dhe**
- (iii) **Raporti mbrojtës i marrëdhënies mbrojtëse është i njëjtë me atë që rezulton nga sasia e elementit të mbrojtur që njësia mbron në të vërtetë dhe sasia e instrumentit mbrojtës që njësia përdor aktualisht për të mbrojtur atë sasi të elementit të mbrojtur.**

Megjithatë, ky përcaktim nuk duhet të pasqyrojë një çekuilibër midis peshave të elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës që do të krijonte mosefektivitet mbrojtës (pavarësisht nëse njihet apo jo) që mund të rezultojë në një rezultat kontabël që nuk do të ishte në përputhje me qëllimin e kontabilitetit mbrojtës. (shih

**paragrafët AG283–AG285).**

**Kontabiliteti për Marrëdhëniet Mbrojtëse Kualifikuese**

130. **Një njësi zbaton kontabilitetin mbrojtës për marrëdhëniet mbrojtëse që plotësojnë kriteret kualifikuese në paragrafin 129 (të cilët përfshijnë vendimin e njësisë për të përcaktuar marrëdhënien mbrojtëse).**
131. **Ka tre lloje të marrëdhënieve mbrojtëse:**
- (a) **Mbrojtja e vlerës së drejtë: një mbrojtje e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e drejtë të një aktivi ose detyrimi të njohur ose të një angazhimi të vendosur të paregjistruar, ose një komponenti të një elementi të tillë, që i atribuohet një rreziku të veçantë dhe mund të ndikojë në sufiçit ose defiçit.**
  - (b) **Mbrojtja e flukseve monetare: një mbrojtje e ekspozimit ndaj ndryshueshmërisë në flukset monetare që i atribuohet një rreziku të veçantë të shoqëruar me të gjithë, ose një komponenti të një aktivi ose detyrimi të njohur (të tilla si të gjitha ose disa pagesa të ardhshme të interesit për borxhin me normë të ndryshueshme) ose një transaksioni parashikues me shumë probabilitet dhe mund të ndikojë në sufiçit ose defiçit.**
  - (c) **Mbrojtja e një investimi neto në një operacion të huaj siç përcaktohet në SNKSP 4.**
132. Nëse elementi i mbrojtur është një instrument kapitali për të cilin një njësi ka zgjedhur të prezantojë ndryshime në vlerën e drejtë në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 106, ekspozimi i mbrojtur i përmendur në paragrafin 131(a) duhet të jetë ai që mund të ndikojë në aktivet/kapitalin neto. Në atë rast, dhe vetëm në atë rast, mosefektiviteti i njohur i mbrojtjes prezantohet në aktivet/kapitalin neto.
133. Një mbrojtje e rrezikut të monedhës së huaj të një angazhimi të palëkundur mund të kontabilizohet si një mbrojtje me vlerën e drejtë ose një mbrojtje e fluksit monetar.
134. **Nëse një marrëdhënie mbrojtëse ndalon së përmbushuri kërkesat e efektivitetit të mbrojtjes në lidhje me raportin e mbrojtjes (shih paragrafin 129(c)(iii)) por objektivi i menaxhimit të rrezikut për atë marrëdhënie mbrojtëse të përcaktuar mbetet i njëjtë, një njësi do të rregullojë raportin e mbrojtjes së marrëdhënies mbrojtëse në mënyrë që të plotësojë sërish kriteret kualifikuese (kësaj i referohemi në këtë Standard si 'ribalancim'—shih paragrafët AG300–AG314).**
135. **Një njësi do të ndërpresë kontabilitetin mbrojtës në mënyrë**



prospektive vetëm kur marrëdhënia mbrojtëse (ose një pjesë e një marrëdhënieje mbrojtëse) ndalon së përbushuri kriteret kualifikuese (pasi të merret parasysh çdo ribalancim i marrëdhënies mbrojtëse, nëse është e aplikueshme). Kjo përfshin rastet kur instrumenti mbrojtës skadon ose shitet, ndërpritet ose ushtrohet. Për këtë qëllim, zëvendësimi ose kalimi i një instrumenti mbrojtës në një instrument tjetër mbrojtës nuk është një skadim ose ndërprerje nëse një zëvendësim ose kalim të tillë është pjesë e, dhe në përputhje me, objektivin e dokumentuar të menaxhimit të rrezikut të njësisë. Për më tepër, për këtë qëllim nuk ka një skadim ose ndërprerje të instrumentit mbrojtës nëse:

- (a) Si pasojë e ligjeve ose rregulloreve ose hyrjes në fuqi të ligjeve ose rregulloreve, palët në instrumentin mbrojtës bien dakord që një ose më shumë kundërpalë kleringu të zëvendësojnë kundërpalën e tyre origjinale për t'u bërë kundërpalë e re për secilën nga palët. Për këtë qëllim, një kundërpalë kleringu është një kundërpalë qendrore (nganjëherë quhet 'organizatë kleringu' ose 'agjensi kleringu') ose një njësi ose disa njësi, për shembull, një anëtar kleringu i një organizate kleringu ose një klient i një anëtari kleringu të një organizate kleringu, të cilët veprojnë si kundërpalë për të kryer klerimin nga një kundërpalë qendrore. Megjithatë, kur palët në instrumentin mbrojtës zëvendësojnë palët e tyre origjinale me kundërpalë të ndryshme, kërkesa në këtë nënparagraf plotësohet vetëm nëse secila prej këtyre palëve kryen klerim me të njëjtën palë qendrore.
- (b) Ndryshime të tjera, nëse ka, në instrumentin mbrojtës janë të kufizuara në ato që janë të nevojshme për të realizuar një zëvendësim të tillë të kundërpalës. Ndryshime të tilla janë të kufizuara në ato që janë në përputhje me kushtet që do të priten nëse instrumentit mbrojtës do t'i hiqen pengesat fillimisht me kundërpalën e kleringut. Këta ndryshime përfshijnë ndryshime në kërkesat e kolateralit, të drejtat për të kompensuar balancat e të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve, dhe tarifatat e vendosura.

Ndërprerja e kontabilitetit mbrojtës mund të ndikojë ose një marrëdhënie mbrojtëse në tërësinë e saj ose vetëm një pjesë të saj (në këtë rast kontabiliteti mbrojtës vazhdon për pjesën e mbetur të marrëdhënies mbrojtëse).

136. Një njësi do të zbatohet:

- (a) Paragrafi 139 kur ai ndërpret kontabilitetin mbrojtës për një mbrojtje me vlerë të drejtë, për të cilën elementi i mbrojtur është

(ose është një përbërës i) një instrument financiar i matur me koston e amortizuar; dhe

- (b) Paragrafi 141 kur ai ndërpret kontabilitetin mbrojtës për mbrojtjen e flukseve monetare.

*Mbrojtjet e Vlerës së Drejtë*

137. **Për sa kohë që një mbrojtje me vlerë të drejtë plotëson kriteret kualifikuese në paragrafin 129, marrëdhënia mbrojtëse do të kontabilizohet si më poshtë:**

- (a) **Fitimi ose humbja për instrumentin mbrojtës do të njihet në sufiçit ose defiçit (ose aktive/kapital neto, nëse instrumenti mbrojtës mbron një instrument të kapitalit për të cilin një njësi ka zgjedhur të prezantojë ndryshime në vlerën e drejtë në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 106).**
- (b) **Fitimi ose humbja e mbrojtjes për elementin e mbrojtur do të rregullojë vlerën e mbartur të elementit të mbrojtur (nëse është e aplikueshme) dhe do të njihet në sufiçit ose defiçit. Nëse elementi i mbrojtur është një aktiv financiar (ose një përbërës i tij) që matet me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41, fitimi ose humbja e mbrojtur për elementin e mbrojtur do të njihet në sufiçit ose defiçit. Megjithatë, nëse elementi i mbrojtur është një instrument kapitali për të cilin një njësi ka zgjedhur të prezantojë ndryshime në vlerën e drejtë në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 106, ato shuma do të mbeten në aktivet/kapitalin neto. Kur një element i mbrojtur është një angazhim i vendosur i paregjistruar (ose një komponent i tij), ndryshimi kumulativ në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur pas përcaktimit të tij njihet si një aktiv ose një detyrim me një fitim ose humbje korresponduese të njohur në sufiçit ose defiçit.**

138. Kur një element i mbrojtur në një mbrojtje me vlerë të drejtë është një angazhim i vendosur (ose një komponent i tij) për të blerë një aktiv ose për të ndërmarrë një detyrim, vlera e mbartur fillestare e aktivit ose detyrimit që rezulton nga përmbushja e angazhimit të vendosur nga njësia rregullohet për të përfshirë ndryshimin kumulativ në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur që u njoh në pasqyrën e pozicionit financiar.

139. Çdo rregullim që vjen nga paragrafi 137(b) do të amortizohet në sufiçit ose defiçit nëse elementi i mbrojtur është një instrument financiar (ose një komponent i tij) i matur me koston e amortizuar. Amortizimi mund të fillojë sapo të ekzistojë një rregullim dhe do të fillojë jo më vonë se kur elementi i mbrojtur të ndalojë së qëni i rregulluar për fitimet dhe humbjet

mbrojtëse. Amortizimi bazohet në një normë interesi efektiv të rilogaritur në datën që fillon amortizimi. Në rastin e një aktivi financiar (ose një komponenti të tij) që është një element i mbrojtur dhe që matet me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41, amortizimi zbatohet në të njëjtën mënyrë, por për shumën që përfaqëson fitimin ose humbjen kumulative e njohur më parë në përputhje me paragrafin 137(b) në vend të rregullimit të vlerës kontabël.

*Mbrojtjet e Flukseve Monetare*

140. **Për sa kohë që një mbrojtje e flukseve monetare plotëson kriteret kualifikuese në paragrafin 129, marrëdhënia mbrojtëse do të kontabilizohet si më poshtë:**
- (a) **Elementi i veçantë i aktiveve/kapitalit neto i shoqëruar me elementin e mbrojtur (rezerva mbrojtëse e flukseve monetare) rregullohet në më të ulëtën nga sa vijon (në shuma absolute):**
    - (i) **Fitimi ose humbja e akumuluar e instrumentit mbrojtës që nga fillimi i mbrojtjes; dhe**
    - (ii) **Ndryshimi kumulativ në vlerën e drejtë (vlera aktuale) e elementit të mbrojtur (d.m.th., vlera aktuale e ndryshimit kumulativ në flukset monetare të ardhshëm të mbrojtur) që nga fillimi i mbrojtjes.**
  - (b) **Pjesa e fitimit ose humbjes nga instrumenti mbrojtës që përcaktohet të jetë një mbrojtje efektive (d.m.th, pjesa që kompensohet nga ndryshimi në rezervën mbrojtëse të flukseve monetare e llogaritur në përputhje me (a)) do të njihet në aktivet/kapitalin neto.**
  - (c) **Çdo fitim ose humbje e mbetur për instrumentin mbrojtës (ose çdo fitim ose humbje e nevojshme për të balancuar ndryshimin në rezervën mbrojtëse të flukseve monetare e llogaritur në përputhje me (a)) është mungesë efektiviteti mbrojtjes që do të njihet në sufiçit ose defiçit.**
  - (d) **Shuma që është akumuluar në rezervën mbrojtëse të flukseve monetare në përputhje me (a) do të kontabilizohet si më poshtë:**
    - (i) **Nëse një transaksion i parashikuar i mbrojtur rezulton më pas në njohjen e një aktivi ose detyrimi jofinanciar, ose një transaksion të parashikuar të mbrojtur për një aktiv jofinanciar ose një detyrim jofinanciar bëhet një angazhim i palëkundur për të cilin kontabiliteti mbrojtës me vlerën e drejtë është zbatuar, njësia do ta heqë atë shumë nga rezerva e mbrojtjes së flukseve monetare**

dhe do ta përfshijë atë drejtpërdrejt në koston fillestare ose në vlerën tjetër të mbartur të aktivitetit ose detyrimit. Ky nuk është një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1) dhe për rrjedhojë nuk ndikon në aktivet/kapitalin neto.

- (ii) Për mbrojtjet e flukseve monetare të ndryshme nga ato të mbuluara nga (i), ajo shumë do të riklasifikohet nga rezerva e mbrojtjes së fluksit monetar në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi (shih paragrafët 125A–125C të SNKSP 1) në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave fluksitet monetare të ardhshëm të pritshëm të mbrojtur ndikojnë në sufiçit ose defiçit (për shembull, në periudhat kur të ardhurat nga interesi ose shpenzimet e interesit njihen ose kur ndodh një shitje e parashikuar).
- (iii) Megjithatë, nëse kjo shumë është një humbje dhe një njësi pret që e gjitha ose një pjesë e asaj humbjeje nuk do të rikuperohet në një ose më shumë periudha të ardhshme, ajo do të riklasifikojë menjëherë shumën që nuk pritet të rikuperohet në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi (shih paragrafët 125A–125C të SNKSP 1).

141. Kur një njësi ndërpret kontabilitetin mbrojtës për një mbrojtje të fluksit monetar (shih paragrafët 135 dhe 136(b)), ajo do të kontabilizojë shumën që është akumuluar në rezervën e mbrojtjes së fluksit monetar në përputhje me paragrafin 140(a) si më poshtë:

- (a) Nëse fluksitet e ardhshëm monetare të mbrojtur ende pritet të ndodhin, kjo shumë do të mbetet në rezervën e mbrojtjes së fluksit monetar derisa të ndodhin fluksitet e ardhshëm monetare ose derisa të zbatohet paragrafi 140(d)(iii). Kur ndodhin fluksitet monetare të ardhshme, zbatohet paragrafi 140(d).
- (b) Nëse fluksitet e ardhshëm monetare të mbrojtur nuk pritet të ndodhin më, ajo shumë do të riklasifikohet menjëherë nga rezerva mbrojtëse e fluksit monetar në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1). Mund të pritet ende të ndodhë një fluks monetar i mbrojtur në të ardhmen, i cili nuk ka më shumë probabilitet të ndodhë.

*Mbrojtjet e një Investimi Neto në Një Operacion të Huaj*

142. **Mbrojtjet e një investimi neto në një operacion të huaj, duke përfshirë një mbrojtje të një elementi monetar që kontabilizohet si pjesë e investimit neto (shih SNKSP 4), do të kontabilizohen në mënyrë të ngjashme me mbrojtjen e flukseve monetare:**

- (a) **Pjesa e fitimit ose humbjes nga instrumenti mbrojtës që përcaktohet të jetë një mbrojtje efektive do të njihet në aktivet/kapitalin neto (shih paragrafin 140); dhe**
- (b) **Pjesa joefektive do të njihet në sufiçit ose defiçit.**

143. **Fitimi ose humbja kumulative në instrumentin mbrojtës që lidhet me pjesën efektive të mbrojtjes që është akumuluar në rezervën e konvertimit në monedhë të huaj do të riklasifikohet nga aktivet/kapitali neto në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1) në përputhje me paragrafët 57–58 të SNKSP 4 mbi shitjen ose shitjen e pjesshme të operacionit të huaj.**

*Kontabiliteti për Vlerën në Kohë të Opsioneve*

144. Kur një njësi ekonomike ndan vlerën e brendshme dhe vlerën kohore të një kontrate opsi dhe cakton si instrument mbrojtës vetëm ndryshimin në vlerën e brendshme të opsi (shih paragrafin 119(a)), ajo do të kontabilizojë vlerën në kohë të opsi si më poshtë (shih paragrafët AG322–AG326):

- (a) Një njësi duhet të dallojë vlerën në kohë të opsioneve sipas llojit të elementit të mbrojtur që opsi mbron (shih paragrafin AG322):
  - (i) Një element i mbrojtur i lidhur me transaksionin; ose
  - (ii) Një element i mbrojtur i lidhur me periudhën kohore.
- (b) Ndryshimi në vlerën e drejtë të vlerës në kohë të një opsi që mbron një element të mbrojtur të lidhur me transaksionin do të njihet në aktivet/kapitalin neto në masën që lidhet me elementin e mbrojtur dhe do të akumulohet në një komponent të veçantë të aktiveve/kapitalit neto. Ndryshimi kumulativ në vlerën e drejtë që vjen nga vlera në kohë e opsi që është akumuluar në një komponent të veçantë të aktiveve/kapitalit neto ("shuma") do të kontabilizohet si më poshtë:
  - (i) Nëse elementi i mbrojtur rezulton më pas në njohjen e një aktivi jofinanciar ose një pasivi jofinanciar, ose një angazhim i vendosur për një aktiv jofinanciar ose një detyrim jofinanciar për të cilin zbatohet kontabiliteti mbrojtës me vlerën e drejtë, njësia do ta heqë shumën nga komponenti i veçantë i aktiveve/kapitalit neto dhe do ta përfshijë atë drejtpërdrejt në koston fillestare ose shumën tjetër të mbartur të aktivitetit ose detyrimit. Ky nuk është një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1) dhe për rrjedhojë nuk ndikon në aktivet/kapitalin neto.
  - (ii) Për marrëdhëniet mbrojtëse të ndryshme nga ato të

- mbuluara nga (i), shuma do të riklasifikohet nga komponenti i veçantë i aktiveve/kapitalit neto në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1) në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë së cilave flukset e ardhshëm të pritur të mbrojtur monetare ndikojnë në sufiçit ose defiçiti (për shembull, kur ndodh një shitje e parashikuar).
- (iii) Megjithatë, nëse e gjithë ose një pjesë e asaj shume nuk pritet të rikuperohet në një ose më shumë periudha të ardhshme, shuma që nuk pritet të rikuperohet do të riklasifikohet menjëherë në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1).
- (c) Ndryshimi në vlerën e drejtë të vlerës në kohë të një opsioni që mbron një element të mbrojtur të lidhur me periudhën kohore do të njihet në aktivet/kapitalin neto në masën që lidhet me elementin e mbrojtur dhe do të akumulohet në një komponent të veçantë të aktiveve/kapitalit neto. Vlera kohore në datën e përcaktimit të opsionit si një instrument mbrojtës, në masën që lidhet me elementin e mbrojtur, do të amortizohet në një bazë sistematike dhe racionale gjatë periudhës gjatë së cilës rregullimi mbrojtës për vlerën e brendshme të opsionit mund të ndikojnë në sufiçit ose defiçit (ose aktivet/kapitalin neto, nëse elementi i mbrojtur është një instrument kapitali për të cilin një njësi ka zgjedhur të prezantojë ndryshime në vlerën e drejtë në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 106). Prandaj, në çdo periudhë raportimi, shuma e amortizimit do të riklasifikohet nga komponenti i veçantë i aktiveve/kapitalit neto në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1). Megjithatë, nëse kontabiliteti mbrojtës ndërpritet për marrëdhënien mbrojtëse që përfshin ndryshimin në vlerën e brendshme të opsionit si instrument mbrojtës, shuma neto (d.m.th., duke përfshirë amortizimin kumulativ) që është akumuluar në komponentin e veçantë të aktiveve/kapitalit neto do të të riklasifikohet menjëherë në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1).

*Kontabiliteti për Elementin e Ardhshëm të Kontratave të Ardhshme dhe Shpërndarjet me Bazë Monedhat e Huaja të Instrumenteve Financiare*

145. Kur një njësi ndan elementin e ardhshëm dhe elementin spot (të çastit) të një kontrate të ardhshme dhe cakton si instrument mbrojtës vetëm ndryshimin në vlerën e elementit spot të kontratës së ardhshme, ose kur një njësi ndan diferencën e bazës në monedhë të huaj nga një instrument financiar dhe e përjashton atë nga përcaktimi i atij instrumenti financiar si instrument mbrojtës (shih paragrafin 119(b)), njësia mund të zbatojë paragrafin 144 për elementin e ardhshëm të kontratës së

ardhshme ose për përhapjen e bazës së monedhës së huaj në të njëjtën mënyrë si zbatohet në vlerën kohore të një opsi. Në atë rast, njëzia do të zbatohet udhëzimin e aplikimit në paragrafët AG327–AG332.

### **Mbrojtjet e një Grupi Elementësh**

*Klasifikimi i një Grupi Elementësh si Elementi i Mbrojtur*

146. **Një grup elementësh (duke përfshirë një grup elementësh që përbëjnë një pozicion neto; shih paragrafët AG333–AG340) është një element i mbrojtur që plotëson kriteret vetëm nëse:**
- (a) **Ai përbëhet nga elementë (përfshirë dhe zërat) që janë, individualisht, zëra të mbrojtur që përmbushin kriteret;**
  - (b) **Elementët në grup menaxhohen së bashku në bazë grupi për qëllime të menaxhimit të rrezikut; dhe**
  - (c) **Në rastin e një mbrojtjeje të flukseve monetare të një grupi elementësh, ndryshueshmëritë e të cilëve në flukset monetare nuk pritet të jenë afërsisht proporcionalë me ndryshueshmërinë e përgjithshme në flukset monetare të grupit, në mënyrë që të krijohen pozicione të rrezikut kompensues:**
    - (i) **Është një mbrojtje e rrezikut të monedhës së huaj; dhe**
    - (ii) **Përcaktimi i atij pozicioni neto specifikon periudhën e raportimit në të cilën transaksionet e parashikuara pritet të ndikojnë te sufiçiti ose defiçiti, si dhe natyrën dhe volumin e tyre (shih paragrafët AG339–AG340).**

*Përcaktimi i një Përbërësi të një Shume Nominale*

147. Një komponent që është një pjesë e një grupi elementësh që përmbushin kriteret është një element i mbrojtur i kualifikuar me kusht që përcaktimi të jetë në përputhje me objektivin e menaxhimit të rrezikut të njësisë.
148. Një përbërës shtrese e një grupi të përgjithshëm zërash (për shembull, një shtresë e poshtme) përmbush kriteret për kontabilitetin mbrojtës vetëm nëse:
- (a) **Është i identifikueshëm veç dhe i matshëm në mënyrë të besueshme;**
  - (b) **Objektivi i menaxhimit të rrezikut është mbrojtja e një komponenti të shtresës;**
  - (c) **Artikujt në grupin e përgjithshëm nga i cili është identifikuar shtresa janë ekspozuar ndaj të njëjtit rrezik të mbrojtur (në mënyrë që**

matja e shtresës së mbrojtur të mos ndikohet ndjeshëm nga cilët elementë të veçantë nga grupi i përgjithshëm janë pjesë e shtresës së mbrojtur);

- (d) Për një mbrojtje të elementëve ekzistues (për shembull, një angazhim i vendosur i panjohur ose një aktiv i njohur) një njësi mund të identifikojë dhe gjurmojë grupin e përgjithshëm të elementëve nga i cili është përcaktuar shtresa e mbrojtur (në mënyrë që njësia të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat për kontabilitetin për marrëdhëniet mbrojtëse të kualifikuara); dhe
- (e) Çdo element në grup që përmban opsione parapagimi plotëson kërkesat për komponentët e një shume nominale (shih paragrafin AG269).

### *Paraqitja*

149. Për një mbrojtje të një grupi elementësh me pozicione rreziku kompensues (dmth. në një mbrojtje të një pozicioni neto), rreziku i mbrojtur i të cilit ndikon në zëra të ndryshëm në pasqyrën e performancës financiare dhe pasqyrën e ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto, çdo fitim ose humbje mbrojtëse në atë pasqyrë do të prezantohen në një zë të veçantë nga ata të ndikuar nga elementët e mbrojtur. Prandaj, në atë pasqyrë shuma në zërin përkatës që lidhet me vetë elementin e mbrojtur (për shembull, të ardhurat ose shpenzimet) mbetet e pandikuar.
150. Për aktivet dhe detyrimet që janë të mbrojtura së bashku si një grup në një mbrojtje me vlerë të drejtë, fitimi ose humbja në pasqyrën e pozicionit financiar mbi aktivet dhe detyrimet individuale do të njihet si një rregullim i vlerës së mbartur të zërave individuale përkatës që përbëjnë grupin në përputhje me paragrafin 137(b).

### *Pozicione Neto Zero*

151. Kur elementi i mbrojtur është një grup që është një pozicion neto zero (d.m.th, artikujt e mbrojtur ndërmjet tyre kompensojnë plotësisht rrezikun që menaxhohet në bazë grupi), një njësi lejohet ta përcaktojë atë në një marrëdhënie mbrojtëse që nuk përfshin një instrument mbrojtës, me kusht që:
- (a) Mbrojtja të jetë pjesë e një strategjie të mbrojtjes të rrezikut neto, ku njësia mbron në mënyrë rutinore pozicione të reja të të njëjtit lloj me kalimin e kohës (për shembull, kur transaksionet kalojnë në horizontin kohor për të cilin njësia mbron);
  - (b) Pozicioni neto i mbrojtur ndryshon në madhësi gjatë jetës së strategjisë së mbrojtjes së rrezikut neto dhe njësia përdor instrumente mbrojtëse të kualifikuara për të mbrojtur rrezikun neto



- (d.m.th., kur pozicioni neto nuk është zero);
- (c) Kontabiliteti mbrojtës zakonisht zbatohet për pozicione të tilla neto kur pozicioni neto nuk është zero dhe është i mbrojtur me instrumente mbrojtës të pranueshëm; dhe
  - (d) Moszbatimi i kontabilitetit mbrojtës në pozicionin neto zero do të shkaktoje rezultate kontabël të paqëndrueshëm, sepse kontabiliteti nuk do të njihje pozicionet e rrezikut kompensues që përndryshe do të njiheshin në një mbrojtje të një pozicioni neto.

**Opsioni për të Përcaktuar një Ekspozim Krediti të Matur me Vlerën e Drejtë përmes Suficitit ose Deficitit**

*Kriteret e Ekspozimeve të Kreditit për Përcaktimin me Vlerë të Drejtë përmes Suficitit ose Deficitit*

152. Nëse një njësi përdor një derivativ krediti që matet me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit për të menaxhuar rrezikun e kreditit të të gjithë, ose një pjesë të, një instrumenti financiar (ekspozimi i kreditit), ai mund ta përcaktojë atë instrument financiar në masën që është menaxhuar në mënyrë të tillë (d.m.th., e gjithë ose një pjesë e tij) e matur me vlerën e drejtë përmes suficitit ose deficitit nëse:

- (a) Emri i ekspozimit të kreditit (për shembull, huamarrësi ose mbajtësi i një angazhimi kredie) përputhet me njësinë e referuar të derivativit të kreditit ('përputhja e emrit'); dhe
- (b) Vjetërsia e instrumentit financiar përputhet me atë të instrumenteve që mund të jepën në përputhje me derivativin e kreditit.

Një njësi mund ta bëjë këtë përcaktim pavarësisht nëse instrumenti financiar që menaxhohet për rrezikun e kreditit është brenda fushëveprimit të këtij Standardi (për shembull, një njësi mund të përcaktojë angazhime kredie që janë jashtë fushëveprimit të këtij Standardi). Njësia mund ta përcaktojë atë instrument financiar në ose pas njohjes fillestare, ose ndërkohë që nuk njihet. Njësia do të dokumentojë përcaktimin njëkohësisht.

*Kontabiliteti për Ekspozimet e Kreditit të Përcaktuar me Vlerë të Drejtë përmes Suficitit ose Deficitit*

153. Nëse një instrument financiar përcaktohet në përputhje me paragrafin 152 si i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit pas njohjes fillestare të tij, ose nuk ishte njohur më parë, diferenca në kohën e përcaktimit midis vlerës së mbartur, nëse ka, dhe vlerës së drejtë do të njihet menjëherë në suficit ose deficit. Për aktivet financiare të matur me

vlërën e drejtë përmes aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në aktivet/kapitalin neto do të riklasifikohet menjëherë nga aktivet/kapitali neto në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1).

154. Një njësi do të ndërpresë matjen e instrumentit financiar që shkaktoi rrezikun e kreditit, ose një pjesë të atij instrumenti financiar, me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit nëse:
- (a) Kriteret kualifikuese në paragrafin 152 nuk plotësohen më, për shembull:
    - (i) Derivativi i kreditit ose instrumenti financiar shoqërues që shkakton rrezikun e kreditit skadon ose shitet, përfundon/ndërpritet ose shlyhet; ose
    - (ii) Rreziku i kreditit i instrumentit financiar nuk menaxhohet më duke përdorur derivativët e kreditit. Për shembull, kjo mund të ndodhë për shkak të përmirësimeve në cilësinë e kreditit të huamarrësit ose mbajtësit të angazhimit të kredisë ose ndryshimeve në kërkesat e kapitalit të vendosura/imponuara mbi një njësi; dhe
  - (b) Instrumenti financiar që krijon rrezikun e kreditit nuk kërkohet ndryshe të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit (d.m.th., modeli i menaxhimit të njësisë nuk ka ndryshuar ndërkohë, që të kërkohet një riklasifikim në përputhje me paragrafin 54).
155. Kur një njësi ndërpret matjen e instrumentit financiar që krijon rrezikun e kreditit, ose një pjesë të atij instrumenti financiar, me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit, vlera e drejtë e atij instrumenti financiar në datën e ndërprerjes bëhet vlera e re e mbartur e tij. Më pas, do të zbatohet e njëjta matje që ishte përdorur përpara përcaktimit të instrumentit financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit (përfshirë amortizimin që rezulton nga vlera e re e mbartur). Për shembull, një aktiv financiar që fillimisht ishte klasifikuar si i matur me koston e amortizuar do t'i rikthehet asaj matjeje dhe norma e tij efektive e interesit do të rillogaritet bazuar në vlerën e re të mbartur bruto në datën e ndërprerjes së matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit.

## **Data Efektive dhe Periudha Kalimtare**

### **Data Efektive**

156. **Një njësi do të zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2022. Aplikimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi zgjedh ta zbatojë këtë Standard më herët, ajo**

duhet të paraqesë këtë fakt dhe të zbatojë të gjitha kërkesat e këtij Standardi në të njëjtën kohë (por shih gjithashtu paragrafin 179). Ajo do të zbatojë gjithashtu, në të njëjtën kohë, ndryshimet në Shtojcën D.

- 156A. *Interesat Afatgjata në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41)*, botuar në janar 2019, shtuan paragrafët 185–190 dhe AG74A dhe ndryshuan paragrafët AG73(b) dhe AG74(b). Një njësi duhet t'i zbatojë këta ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2022. Aplikimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi i zbaton këta ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të paraqesë informacion për këtë fakt.
157. Kur një njësi adopton SNKSP-të e kontabilitetit sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, siç përkufizohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të Drejtave dhe Detyrime të konstatuara* për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të SNKSP-ve.

### Periudha Kalimtare

158. Një njësi do ta zbatojë këtë Standard në mënyrë retrospektive, në përputhje me SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, përveç siç specifikohet në paragrafët 161–184. Ky Standard nuk do të zbatohet për zëra që tashmë janë çregjistruar në datën e aplikimit fillestar.
159. Për qëllimet e dispozitave të tranzicionit në paragrafët 158, 160-184, data e zbatimit fillestar është data kur një njësi zbaton për herë të parë këto kërkesa të këtij Standardi dhe duhet të jetë fillimi i një periudhe raportimi pas publikimit së këtij Standardi.

### Periudha Kalimtare për Klasifikimin dhe Matjen

160. Në datën e aplikimit fillestar, një njësi do të vlerësojë nëse një aktiv financiar plotëson kushtin në paragrafët 40(a) ose 41(a) në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë datë. Klasifikimi që rezulton do të zbatohet në mënyrë retrospektive, pavarësisht nga modeli i menaxhimit të njësisë në periudhat e mëparshme të raportimit.
161. Nëse, në datën e aplikimit fillestar, është e papraktikueshme (siç përcaktohet në SNKSP 3) që një njësi të vlerësojë një element të modifikuar të vlerës kohore të parasë në përputhje me paragrafët AG68-AG70 mbi bazën e fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në njohjen

fillestare të aktivitetit financiar, një njësi do të vlerësojë karakteristikat kontraktuale të flukseve monetare të atij aktivitetit financiar në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në njohjen fillestare të aktivitetit financiar pa marrë parasysh kërkesat që lidhen me modifikimin e elementit të vlerës në kohë të parasë në paragrafët AG68–AG70. (Shih gjithashtu paragrafin 49R të SNKSP 30.)

162. Nëse, në datën e aplikimit fillestar, është e papraktikueshme (siç përcaktohet në SNKSP 3) që një njësi të vlerësojë nëse vlera e drejtë e një karakteristike të parapagimit ishte jodomethënese në përputhje me paragrafin AG74(c) në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në njohjen fillestare të aktivitetit financiar, një njësi do të vlerësojë karakteristikat kontraktuale të fluksit monetar të atij aktivitetit financiar në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në njohjen fillestare të aktivitetit financiar pa marrë parasysh përjashtimin për karakteristikat e parapagimit në paragrafin AG74. (Shih gjithashtu paragrafin 49S të SNKSP 30.)
163. Nëse një njësi mat një kontratë hibride me vlerën e drejtë në përputhje me paragrafët 41, 43 ose 44, por vlera e drejtë e kontratës hibride nuk ishte matur në periudhat krahasuese të raportimit, vlera e drejtë e kontratës hibride në periudhat krahasuese të raportimit do të jetë shuma e vlerave të drejta të komponentëve (dmth., mbartësi joderivativ dhe derivativi i përfshirë) në fund të çdo periudhe krahasuese të raportimit, nëse njësia rideklaron periudhat e mëparshme (shih paragrafin 173).
164. Nëse një njësi ka zbatuar paragrafin 163, atëherë në datën e aplikimit fillestar, njësia do të njohë çdo diferencë midis vlerës së drejtë të të gjithë kontratës hibride në datën e aplikimit fillestar dhe shumës së vlerave të drejta të komponentëve të kontratës hibride në datën e aplikimit fillestar në sufiçitin ose defiçitin e akumuluar fillestar (ose komponent tjetër të aktiveve/kapitalit neto, sipas rastit) të periudhës së raportimit që përfshin datën e aplikimit fillestar.
165. Në datën e aplikimit fillestar, një njësi ekonomike mund të caktojë:
- (a) Një aktiv financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me paragrafin 44; ose
  - (b) Një investim në një instrument kapitali me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 106.
- Një përcaktim i tillë do të bëhet në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.
166. Në datën e aplikimit fillestar, një njësi:
- (a) Do të revokojë përcaktimin e saj të mëparshëm të një aktiviteti

financiar të matur me vlerën e drejtë përmes sufiçitit ose defiçitit nëse ai aktiv financiar nuk plotëson kushtin në paragrafin 44.

- (b) Mund të revokojë përcaktimin e mëparshëm të një aktivi financiar të matur me vlerën e drejtë përmes sufiçitit ose defiçitit nëse ai aktiv financiar plotëson kushtin në paragrafin 44.

Një revokim i tillë do të bëhet në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

167. Në datën e aplikimit fillestar, një njësi:

- (a) Mund të përcaktojë një detyrim financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me paragrafin 46(a).
- (b) Do të revokojë përcaktimin e saj të mëparshëm të një detyrimi financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit nëse një përcaktim i tillë është bërë në njohjen fillestare në përputhje me kushtin tani në paragrafin 46(a) dhe një përcaktim i tillë nuk e plotëson atë kusht në datën e aplikimit fillestar.
- (c) Mund të revokojë përcaktimin e saj të mëparshëm të një detyrimi financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit nëse një përcaktim i tillë është bërë në njohjen fillestare në përputhje me kushtin tani në paragrafin 46(a) dhe një përcaktim i tillë e plotëson atë kusht në datën e aplikimit fillestar.

Një përcaktim dhe revokim i tillë do të bëhet në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

168. Nëse është e papraktikueshme (siç përcaktohet në SNKSP 3) që një njësi të zbatojë në mënyrë retrospektive metodën e interesit efektiv, njësia duhet të trajtojë:

- (a) Vlerën e drejtë e aktivitetit financiar ose të detyrimit financiar në fund të çdo periudhe krahasuese të prezantuar si vlerën e mbartur bruto të atij aktivi financiar ose koston e amortizuar të atij detyrimi financiar nëse njësia riparaqet periudhat e mëparshme; dhe
- (b) Vlerën e drejtë të aktivitetit financiar ose të detyrimit financiar në datën e zbatimit fillestar si vlerën e re të mbartur bruto të atij aktivi financiar ose koston e re të amortizuar të atij detyrimi financiar në datën e zbatimit fillestar të këtij Standardi.

169. Nëse një njësi ka kontabilizuar më parë me kosto (në përputhje me SNKSP 29), për një investim në një instrument kapitali që nuk ka një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një instrument identik (d.m.th., një e

dhënë hyrëse e Nivelit 1) (ose për një aktivi derivativ që lidhet dhe duhet të shlyhet me dhënien e një instrumenti të tillë të kapitalit) ajo do ta masë atë instrument me vlerën e drejtë në datën e zbatimit fillestar. Çdo diferencë ndërmjet vlerës së mbartur të mëparshme dhe vlerës së drejtë do të njihet në sufiçitin ose defiçitin e akumuluar fillestar (ose komponent tjetër të aktiveve/kapitalit neto, sipas rastit) të periudhës së raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar.

170. Nëse një njësi ka kontabilizuar më parë një detyrim derivativ që është i lidhur me, dhe duhet të shlyhet nga, dhënia e një instrumenti të kapitalit që nuk ka një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një instrument identik (dmth., një e dhënë hyrëse e Nivelit 1) me kosto në përputhje me SNKSP 29, ajo do të masë atë detyrim derivativ me vlerën e drejtë në datën e zbatimit fillestar. Çdo diferencë ndërmjet vlerës së mbartur të mëparshme dhe vlerës së drejtë do të njihet në aktivet/kapitalin neto të fillimit të periudhës së raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar.
171. Në datën e zbatimit fillestar, një njësi do të përcaktojë nëse trajtimi në paragrafin 108 do të krijonte ose do të zgjeronte një mospërputhje kontabël në sufiçit ose defiçit në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit fillestar. Ky Standard do të zbatohet në mënyrë retrospektive në bazë të atij përcaktimi.
172. Në datën e zbatimit fillestar, një njësi i lejohet të bëjë përcaktimin në paragrafin 6 për kontratat që ekzistojnë tashmë në datën, por vetëm nëse përcakton të gjitha kontratat e ngjashme. Ndryshimi në aktivet neto që rezultojnë nga këto përcaktime do të njihet në aktivet/kapitalin neto në datën e zbatimit fillestar.
173. Pavarësisht nga kërkesa në paragrafin 158, një njësi që adopton kërkesat e klasifikimit dhe matjes të këtij Standardi (të cilat përfshijnë kërkesat në lidhje me matjen e kostos së amortizuar për aktivet financiare dhe zhvlerësimin në paragrafët 69-72 dhe paragrafët 73-93) do të japë informacionin e përcaktuar në paragrafët 49L–49O të SNKSP 30, por nuk është e nevojshme të riparaqesë/rideklarojë periudhat e mëparshme. Njësia mund të rideklarojë periudhat e mëparshme nëse, dhe vetëm nëse, është e mundur pa përdorimin e një shikimi në retrospektivë. Nëse një njësi nuk rideklaroi periudhat e mëparshme, njësia do të njohë çdo diferencë midis vlerës së mbartur të mëparshme dhe vlerës së mbartur në fillim të periudhës vjetore të raportimit që përfshin datën e aplikimit fillestar në sufiçitin ose defiçitin e akumuluar fillestar (ose komponent tjetër të aktiveve/kapitalit neto, sipas rastit) të periudhës vjetore të raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar. Megjithatë, nëse një njësi rideklaroi periudhat e mëparshme, pasqyrat financiare të rideklaruara duhet të pasqyrojnë të gjitha kërkesat e këtij Standardi.

174. Nëse një njësi pregatit raporte financiare të ndërmjetme, nuk është e nevojshme që njësia të zbatojë kërkesat e këtij Standardi për periudhat e ndërmjetme përpara datës së zbatimit fillestar, nëse është e papraktikueshme (siç përcaktohet në SNKSP 3).

#### *Zhvlerësimi*

175. Një njësi do të zbatojë kërkesat për zhvlerësim në paragrafët 73-93 në mënyrë retrospektive në përputhje me SNKSP 3, subjekt i paragrafëve 173 dhe 176-178.

176. Në datën e aplikimit fillestar, një njësi do të përdorë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështshëm që është i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të panevojshme për të përcaktuar rrezikun e kreditit në datën që një instrument financiar është njohur fillimisht (ose për angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare në datën që njësia u bë palë në angazhimin e pakthyeshëm në përputhje me paragrafin 78) dhe do ta krahasojë atë me rrezikun e kreditit në datën e zbatimit fillestar të këtij Standardi.

177. Kur përcaktohet nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kreditit që nga njohja fillestare, një njësi mund të zbatojë:

(a) Kërkesat në paragrafët 82 dhe AG186–AG188; dhe

(b) Presupozimin e kundërshtueshëm në paragrafin 83 për pagesat kontraktuale që janë më shumë se 30 ditë të vonuara nëse një njësi do të zbatojë kërkesat e zhvlerësimit duke identifikuar rritje të konsiderueshme në rrezikun e kreditit që nga njohja fillestare për këto instrumente financiare në bazë të informacionit të vonuar.

178. Nëse, në datën e zbatimit fillestar, përcaktimi nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kreditit që nga njohja fillestare do të kërkonte kosto ose përpjekje të panevojshme, një njësi do të njohë një provizion (shumë të lejuar për akomodimin e) humbjeje në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës në çdo datë raportimi derisa ai instrument financiar të çregjistrohet (përveç rastit kur ai instrument financiar është me rrezik të ulët krediti në një datë raportimi, rast në të cilin zbatohet paragrafi 177(a)).

#### *Periudha Kalimtare për Kontabilitetin Mbrojtës*

179. Kur një njësi zbaton për herë të parë këtë Standard, ajo mund të zgjedhë si politikë kontabël të vazhdojë të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës të SNKSP 29 në vend të kërkesave në paragrafët 113-155 të këtij Standardi. Një njësi duhet ta zbatojë atë politikë për të gjitha marrëdhëniet e saj mbrojtëse. Një njësi që zgjedh atë politikë do të zbatojë gjithashtu Shtojcën C të SNKSP 29.

180. Me përjashtim të rasteve të dhëna në paragrafin 184, një njësi do të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës të këtij Standardi në mënyrë prospektive.
181. Për të zbatuar kontabilitetin mbrojtës nga data e zbatimit fillestar të kërkesave të kontabilitetit mbrojtës të këtij Standardi, të gjithë kriteret kualifikues duhet të plotësohen në atë datë.
182. Marrëdhëniet mbrojtëse që kualifikohen për kontabilitetin mbrojtës në përputhje me SNKSP 29, të cilat gjithashtu kualifikohen për kontabilitet mbrojtës në përputhje me kriteret e këtij Standardi (shih paragrafin 129), pasi të merret parasysh çdo ribalancim i marrëdhënies mbrojtëse në tranzicion (shih paragrafin 183(b))), do të konsiderohen si marrëdhënie mbrojtëse të vazhdueshme.
183. Në zbatimin fillestar të kërkesave të kontabilitetit mbrojtës të këtij Standardi, një njësi:
- (a) Mund të fillojë t'i zbatojë ato kërkesa nga e njëjta pikë kohore kur ndalon së zbatuari kërkesat e kontabilitetit mbrojtës të SNKSP 29; dhe
  - (b) Do të konsiderojë raportin e mbrojtjes në përputhje me SNKSP 29 si pikënisje për ribalancimin e raportit mbrojtës të një marrëdhënieje mbrojtëse të vazhdueshme, nëse është e aplikueshme. Çdo fitim ose humbje nga një ribalancim i tillë do të njihet në sufiçit ose defiçit.
184. Si përjashtim nga zbatimi prospektiv i kërkesave të kontabilitetit mbrojtës të këtij Standardi, një njësi:
- (a) Do të zbatojë kontabilitetin për vlerën kohore të opsioneve në përputhje me paragrafin 144 në mënyrë retrospektive nëse, në përputhje me SNKSP 29, vetëm ndryshimi në vlerën e brendshme të një opsioni është përcaktuar si një instrument mbrojtës në një marrëdhënie mbrojtëse. Ky aplikim retrospektiv zbatohet vetëm për ato marrëdhënie mbrojtëse që ekzistojnë në fillim të periudhës më të hershme krahasuese ose ishin përcaktuar më pas.
  - (b) Mund të zbatojë kontabilizimin për elementin e ardhshëm të kontratave të ardhshme në përputhje me paragrafin 145 në mënyrë retrospektive nëse, në përputhje me SNKSP 29, vetëm ndryshimi në elementin spot të një kontrate të ardhshme ishte përcaktuar si një instrument mbrojtës në një marrëdhënie mbrojtëse. Ky aplikim retrospektiv zbatohet vetëm për ato marrëdhënie mbrojtëse që ekzistojnë në fillim të periudhës më të hershme krahasuese ose ishin përcaktuar më pas. Krahas kësaj, nëse një njësi zgjedh zbatimin retrospektiv të këtij kontabiliteti, ai do të zbatohet për të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse që kualifikohen për këtë zgjedhje



(d.m.th., në periudhën kalimtare, kjo zgjedhje nuk është e disponueshme mbi bazën sipas marrëdhënieve mbrojtëse). Kontabilizimi për shpërndarjet e bazës së monedhës së huaj (shih paragrafin 145) mund të zbatohet në mënyrë retrospektive për ato marrëdhënie mbrojtëse që ekzistojnë në fillimin e periudhës më të hershme krahasuese ose ishin përcaktuar më pas.

- (c) Do të zbatohet në mënyrë retrospektive kërkesa e paragrafit 135 që nuk ka një skadim ose përfundim të instrumentit mbrojtës nëse:
- (i) Si pasojë e ligjeve ose rregulloreve, ose hyrjes në fuqi e ligjeve ose rregulloreve, palët në instrumentin mbrojtës bien dakord se një ose më shumë kundërpalë kleringu të zëvendësojnë kundërpalën e tyre fillestare për t'u bërë kundërpalë e re për secilën nga palët; dhe
  - (ii) Ndryshime të tjera, nëse ka, në instrumentin mbrojtës janë të kufizuara në ato që janë të nevojshme për të realizuar një zëvendësim të tillë të kundërpalës tjetër.

*Periudha Kalimtare për Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ*

185. **Një njësi do të zbatojë *Interesat Afatgjata në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41)* në mënyrë retrospektive në përputhje me SNKSP 3, përveç siç specifikohet në paragrafët 186–190.**
186. **Një njësi që i zbaton për herë të parë ata ndryshime në të njëjtën kohë kur zbaton për herë të parë këtë Standard, do të zbatojë paragrafët 157-183 në vend të paragrafëve 187-190.**
187. **Një njësi që i zbaton për herë të parë këta ndryshime pasi të zbatojë për herë të parë këtë Standard, do të zbatojë paragrafët 188–190. Njësia do të zbatojë gjithashtu kërkesat e tjera të tranzicionit në këtë Standard të nevojshme për zbatimin e këtyre ndryshimeve. Për këtë qëllim, referencat ndaj datës së aplikimit fillestar do të lexohen sikur i referohen fillimit të periudhës raportuese në të cilën një njësi i zbaton për herë të parë këta ndryshime (data e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve).**
188. **Në lidhje me përcaktimin e një aktivi ose detyrimi financiar si të matur me vlerën e drejtë përmes suficitit ose deficitit, një njësi:**
- (a) **Do të revokojë përcaktimin e saj të mëparshëm të një aktivi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit, nëse ky përcaktim është bërë më parë në përputhje me kushtin në paragrafin 44, por ai kusht nuk është më i plotësuar si rezultat i zbatimit të këtyre ndryshimeve;**

- (b) Mund të përcaktojë një aktiv financiar si të matur me vlerën e drejtë përmes sufiçitetit ose defiçitetit, nëse ky përcaktim nuk do të kishte përbushur më parë kushtin në paragrafin 44, por ai kusht është përbushur tani si rezultat i zbatimit të këtyre ndryshimeve;
- (c) Do të revokojë përcaktimin e saj të mëparshëm të një detyrimi financiar si të matur me vlerën e drejtë përmes sufiçitetit ose defiçitetit nëse ky përcaktim është bërë më parë në përputhje me kushtin në paragrafin 46(a), por ai kusht nuk është më i plotësuar si rezultat i zbatimit të këtyre ndryshimeve; dhe
- (d) Mund të përcaktojë një detyrim financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitetit ose defiçitetit nëse ky përcaktim nuk do të kishte përbushur më parë kushtin në paragrafin 46(a), por ai kusht është përbushur tani si rezultat i zbatimit të këtyre ndryshimeve.

Një përcaktim dhe revokim i tillë do të bëhet në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

189. Një njësia nuk i kërkohet të riparaqesë periudhat e mëparshme për të pasqyruar zbatimin e këtyre ndryshimeve. Njësia mund të riparaqesë periudhat e mëparshme nëse, dhe vetëm nëse, është e mundur pa përdorimin e një shikimi retrospektiv dhe pasqyrat financiare të riparaqitura pasqyrojnë të gjitha kërkesat e këtij Standardi. Nëse një njësi nuk i riparaqet periudhat e mëparshme, njësia do të njohë çdo diferencë midis vlerës së mbartur të mëparshme dhe vlerës së mbartur në fillim të periudhës së raportimit vjetor që përfshin datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve në sufiçitetin ose defiçitetin e akumuluar fillestar ose komponentin tjetër të aktiveve/kapitalit neto, sipas rastit) të periudhës vjetore të raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve.
190. Në periudhën e raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve, njësia duhet të japë informacionin e mëposhtëm në atë datë të zbatimit fillestar për secilën klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare që ishin ndikuar nga këta ndryshime:
- (a) Kategorinë e mëparshme të matjes dhe vlerën e mbartur të përcaktuar menjëherë përpara zbatimit të këtyre ndryshimeve;
  - (b) Kategorinë e re të matjes dhe vlerën e mbartur të përcaktuar pas aplikimit të këtyre ndryshimeve;

- (c) **Vlerën e mbartur të çdo aktivi dhe detyrimi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar që më parë ishin përcaktuar si të matura me vlerën e drejtë përmes sufiçitit ose defiçitit, por nuk janë më të përcaktuar në këtë mënyrë; dhe**
- (d) **Arsyet për çdo përcaktim ose mospërcaktim të aktiveve ose detyrimeve financiare si të matura me vlerën e drejtë përmes sufiçitit ose defiçitit.**

## **SNKSP 42 – PËRFITIMET SOCIALE**

### **Historia e SNKSP**

*Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e publikuara deri në 31 janar, 2019.*

SNKSP 42, *Përfitimet Sociale* u publikua në janar 2019.

**SNKSP 42, PËRFITIMET SOCIALE**  
**PËRMBAJTJA**

---

|                                                                          | Paragrafi |
|--------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Objektivi.....                                                           | 1–2       |
| Objekti .....                                                            | 3–4       |
| Përkufizime.....                                                         | 5         |
| Trajtimi i Përgjithshëm.....                                             | 6–25      |
| Njohja e një Detyrimi për një Skemë të Përfitimeve Sociale ...           | 6–9       |
| Njohja e një Shpenzimi për një Skemë të Përfitimeve Sociale              | 10–11     |
| Matja e një Detyrimi për një Skemë të Përfitimeve Sociale.....           | 12–20     |
| Matja e një Shpenzimi për një Skemë të Përfitimeve Sociale .             | 21        |
| Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.....                                  | 22–25     |
| Trajtimi si Kontratat e Siguracionit .....                               | 26–31     |
| Njohja dhe Matja.....                                                    | 26–28     |
| Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.....                                  | 29–31     |
| Raportimi mbi Qëndrueshmërinë Afatgjatë të Financave të një Njësie<br>32 |           |
| Dispozitat Kalimtare .....                                               | 33–34     |
| Trajtimi i Përgjithshëm .....                                            | 33        |
| Trajtimi si Kontratat e Siguracionit.....                                | 34        |
| Data Efektive .....                                                      | 35–36     |

---

## Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të përmirësojë përshtatshmërinë, përfaqësimin besnik dhe krahasueshmërinë e informacionit që një njësi (ekonomike) raportuese ofron në pasqyrat e saj financiare për përfitimet sociale siç përcaktohet në këtë Standard. Informacioni i dhënë duhet të ndihmojë përdoruesit e pasqyrave financiare dhe raporteve financiare me qëllim të përgjithshëm të vlerësojnë:
  - (a) Natyrën e përfitimeve të tilla sociale të ofruara nga njësia;
  - (b) Karakteristikat kryesore të funksionimit të atyre skemave të përfitimeve sociale; dhe
  - (c) Ndikimin e përfitimeve të tilla sociale të dhëna në performancën financiare, pozicionin financiar dhe flukset monetare të njësisë.
2. Për ta arritur këtë, ky SNKSP vendos parime dhe kërkesa për:
  - (a) Njohjen e shpenzimeve dhe detyrimeve për përfitime sociale;
  - (b) Matjen e shpenzimeve dhe detyrimeve për përfitime sociale;
  - (c) Prezantimin e informacionit për përfitimet sociale në pasqyrat financiare; dhe
  - (d) Përcaktimin e informacionit të që duhet paraqitur për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë natyrën dhe efektet financiare të përfitimeve sociale të dhëna nga njësia raportuese.

## Objekti

3. **Një njësi që përgatit dhe paraqet pasqyrat financiare sipas kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara do të zbatojë këtë Standard në kontabilitetin për përfitimet sociale.**
4. **Ky Standard zbatohet për një transaksion që plotëson përkufizimin e një përfitimi social. Ky Standard nuk zbatohet për transfertat e mjeteve monetare që kontabilizohen në përputhje me Standarde të tjera:**
  - (a) **Instrumentet financiare që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* (ose SNKSP 29, *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja* përpara se një njësi të adoptojë SNKSP 41);**
  - (b) **Përfitimet e punonjësve që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve*; dhe**
  - (c) **Kontratat e sigurimit të cilat janë brenda fushëveprimit të**

standardit përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton kontratat e sigurimit.

Paragrafët AG1–AG3 ofrojnë udhëzime shtesë mbi fushëveprimin e këtij Standardi.

## Përkufizime

5. Termat e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuar:

**Përfitimet sociale** janë transfera në mjete monetare të ofruara për:

- (a) Individë të veçantë dhe/ose familje që plotësojnë kriteret kualifikuese;
- (b) Zbutjen e efektit të rreziqeve sociale; dhe
- (c) Adresojnë nevojat e shoqërisë në tërësi.

Paragrafët AG4–AG8 ofrojnë udhëzime shtesë për këtë përkufizim.

**Rreziqet sociale** janë ngjarje ose rrethana që:

- (a) Lidhen me karakteristikat e individëve dhe/ose familjeve – për shembull, moshën, shëndetin, varfërinë dhe statusin e punësimit; dhe
- (b) Mund të ndikojë negativisht në mirëqenien e individëve dhe/ose familjeve, qoftë duke imponuar kërkesa shtesë për burimet e tyre ose duke ulur të ardhurat e tyre.

Paragrafët AG9–AG10 ofrojnë udhëzime shtesë për atë që përfshihet në rreziqet sociale.

## Qasja e Përgjithshme

Njohja e një Detyrimi për një Skemë të Përfitimeve Sociale

6. Një njësi (ekonomike) duhet të njohë një detyrim për një skemë përfitimesh sociale kur:

- (a) Njësia ka një detyrim aktual për një fluks dalës burimesh që rezulton nga një ngjarje e kaluar; dhe
- (b) Detyrimi aktual mund të matet në një mënyrë që arrin karakteristikat cilësore dhe merr parasysh kufizimet mbi informacionin në raportet financiare me qëllim të përgjithshëm siç përcaktohet në *Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*.

*Fluks Dalës i Burimeve*

7. Një detyrim duhet të përfshijë një fluks dalës burimesh nga njësia që ai të shlyhet. Një obligim që mund të shlyhet pa një dalje burimesh nga njësia nuk është një detyrim.
8. Mund të ketë pasiguri të shoqëruar me matjen e detyrimit. Përdorimi i vlerësimeve është një pjesë thelbësore e kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Pasiguria në lidhje me fluksin dalës të burimeve nuk e pengon njohjen e një detyrimi, përveç nëse niveli i pasigurisë është aq i madh sa nuk mund të përmbushen karakteristikat cilësore të përshtatshmërisë dhe përfaqësimit besnik. Kur niveli i pasigurisë nuk pengon njohjen e një detyrimi, ai merret parasysh kur matet detyrimi.

*Ngjarje e Kaluar*

9. Ngjarja e kaluar që krijon një detyrim për një skemë përfitimesh sociale është përmbushja nga secili përfitues i të gjitha kriterëve kualifikuese për të marrë një pagesë të përfitimit social. Përmbushja e kriterëve kualifikuese për çdo pagesë të përfitimit social është një ngjarje e veçantë e kaluar.

Paragrafët AG11–AG14 ofrojnë udhëzime shtesë për njohjen e një detyrimi.

**Njohja e një Shpenzimi për një Skemë të Përfitimeve Sociale**

10. **Një njësi do të njohë një shpenzim për një skemë përfitimesh shoqërore në të njëjtën moment që njeh një detyrim.**
11. Një njësi nuk do të njohë një shpenzim për një skemë përfitimesh sociale ku pagesa e përfitimit social bëhet përpara se të plotësohen të gjitha kriteret e kualifikimit për pagesën e ardhshme. Përkundrazi, një njësi do të njohë një pagesë paraprakisht si një aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, përveç rastit kur shuma bëhet e parikuperueshme, rast në të cilin ajo do të njohë një shpenzim.

**Matja e një Detyrimi për një Skemë të Përfitimeve Sociale**

*Matja Fillestare e një Detyrimi*

12. **Një njësi do të masë detyrimin për një skemë përfitimesh sociale me vlerësimin më të mirë të kostove (d.m.th., pagesave të përfitimeve sociale) që njësia do të shkaktojë në përmbushjen e obligimeve aktuale të përfaqësuar nga detyrimi.**
13. Vlerësimi më i mirë i një njësie për kostot (d.m.th., pagesat e përfitimeve sociale) që do të bëjë njësia merr parasysh efektin e mundshëm të ngjarjeve të mëvonshme në këto pagesa të përfitimeve sociale.



14. Kur detyrimi në lidhje me një skemë të përfitimeve sociale nuk pritet të shlyhet përpara dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës së raportimit në të cilën është njohur detyrimi (d.m.th., pagesa e ardhshme e përfitimit social nuk do të bëhet për më shumë se dymbëdhjetë muaj), detyrimi do të skontohet duke përdorur normën e zbritjes të specifikuar në paragrafin 19.
15. Paragrafët AG15–AG18 ofrojnë udhëzime shtesë për matjen e detyrimit.

*Matja Pasardhëse*

16. **Detyrimi për një skemë të përfitimeve sociale do të reduktohet me kryerjen e pagesave të përfitimeve sociale. Çdo diferencë midis kostos së pagesës së përfitimeve sociale dhe vlerës kontabël të mbartur të detyrimit në lidhje me skemën e përfitimeve sociale njihet në sufiçit ose defičit në periudhën në të cilën shlyhet detyrimi.**
17. Kur një detyrim zbritet në përputhje me paragrafin 14, detyrimi rritet dhe shpenzimet e interesit njihen në çdo periudhë të raportimit derisa detyrimi të shlyhet, për të reflektuar lehtësimin e skontimit.
18. Kur një detyrim duhet ende të shlyhet, detyrimi do të rishikohet në çdo datë raportimi, dhe do të rregullohet për të pasqyruar vlerësimin më të mirë aktual të kostove (d.m.th. pagesave të përfitimeve sociale) që njësia ekonomike do të shkaktojë në përmbushjen e obligimeve aktuale të përfaqësuar nga detyrimi.

*Norma e Skontimit*

19. Norma e përdorur për të skontuar një detyrim në lidhje me një skemë të përfitimeve sociale do të pasqyrojë vlerën në kohë të parasë. Monedha dhe kohëzgjatja e instrumentit financiar të zgjedhur për të pasqyruar vlerën në kohë të mjeteve monetare duhet të jetë në përputhje me monedhën dhe kohëzgjatjen e vlerësuar të detyrimit të përfitimit social.
20. Paragrafi AG18 jep udhëzime shtesë mbi normën e zbritjes që do të përdoret.

**Matja e një Shpenzimi për një Skemë të Përfitimeve Sociale**

21. Një njësi do të masë fillimisht shpenzimet për një skemë përfitimesh sociale me një shumë të barabartë me shumën e detyrimit të matur në përputhje me paragrafin 12. Kur njësia bën një pagesë të përfitimit social përpara se të plotësohen të gjitha kriteret e kualifikimit për pagesën e ardhshme, ajo do të masë pagesën në paradhënie ose shpenzimin e njohur në përputhje me paragrafin 11 me shumën e mjeteve monetare të transferuar.

**Dhënia e Informacioneve Shpjeguese**

22. **Objektivi i dhënies së informacioneve shpjeguese sipas qasjes së përgjithshme, së bashku me informacionin e dhënë në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve monetare, është që njësitë t'u japin përdoruesve të pasqyrave financiare një bazë për të vlerësuar efektin që përfitimet sociale mund të kenë në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë. Paragrafët 23–25 specifikojnë kërkesat se si të arrihet ky objektivi.**
23. **Një njësi do të japë informacion që**
- (a) **Shpjegon karakteristikat e skemave të përfitimeve sociale; dhe**
  - (b) **Shpjegon faktorët demografikë, ekonomikë dhe faktorë të tjerë të jashtëm që mund të ndikojnë në skemat e përfitimeve sociale.**
24. **Për të përmbushur kërkesat e paragrafit 23, një njësi do paraqesë:**
- (a) **Informacion për karakteristikat e skemave të përfitimeve sociale, duke përfshirë:**
    - (i) **Natyren e përfitimeve sociale të ofruara nga skemat (për shembull, përfitimet e pensionit, përfitimet e papunësisë, përfitimet e fëmijëve).**
    - (ii) **Karakteristikat kryesore të skemave të përfitimeve sociale, të tilla si një përshkrim i kuadrit legjislativ që rregullon skemat, një përmbledhje e kriterëve kryesore të kualifikimit që duhet të plotësohen për të marrë përfitimet sociale, dhe një deklaratë se si mund të merret informacion shtesë rreth skemës.**
    - (iii) **Një përshkrim se si financohen skemat, duke përfshirë nëse financimi për skemat sigurohet me anë të një ndarje buxhetore, një transfertë nga një njësi tjetër e sektorit publik ose me mjete të tjera. Nëse një skemë financohet (qoftë plotësisht ose pjesërisht) nga kontributet sociale, njësia do të japë:**
      - a. **Një referencë për vendndodhjen e informacionit për këta kontribute sociale dhe çdo aktiv të dedikuar (ku ky informacion përfshihet në pasqyrat financiare të njësisë); ose**
      - b. **Një deklaratë për disponueshmërinë e informacionit mbi ata kontribute sociale dhe çdo aktiv të dedikuar në**

pasqyrat financiare të një njësie tjetër dhe se si mund të merret ai informacion.

- (iv) Një përshkrim të faktorëve kryesorë demografikë, ekonomikë dhe faktorëve të tjerë të jashtëm që ndikojnë në nivelin e shpenzimeve sipas skemave të përfitimeve sociale. Ky përshkrim mund të prezantohet në mënyrë të përmbledhur kur të njëjtët faktorë demografikë, ekonomikë dhe faktorë të tjerë të jashtëm ndikojnë në një sërë skemash të përfitimeve sociale në mënyrë të ngjashme.
- (b) Shpenzimet totale për përfitimet sociale të njohura në pasqyrën e performancës financiare, të analizuar sipas skemës së përfitimeve sociale.
- (c) Një përshkrim të çdo ndryshimi të rëndësishëm në skemat e përfitimeve sociale të bërë gjatë periudhës së raportimit, së bashku me një përshkrim të efektit të pritshëm të ndryshimeve. Ndryshimet në një skemë të përfitimeve sociale përfshijnë, por nuk kufizohen në:
  - (i) Ndryshimet në nivelin e përfitimeve sociale të dhëna; dhe
  - (ii) Ndryshimet në kriteret e përshtatshmërisë/kualifikimit, duke përfshirë individët dhe/ose familjet e mbuluara nga skema e përfitimeve sociale.

Gjatë dhënies së informacioneve të kërkuara nga ky paragraf, një njësi do të ketë parasysh kërkesat e paragrafëve 45-47 të SNKSP 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*, të cilat ofrojnë udhëzime mbi materialitetin dhe mënyrën e grupimin.

25. Nëse një skemë e përfitimeve sociale plotëson kriteret në paragrafin 28 për të lejuar përdorimin e metodës së siguracionit, një deklaratë për këtë qëllim.

### Trajtimi si Siguracionet

#### Njohja dhe Matja

26. **Kur një skemë e përfitimeve sociale plotëson kriteret në paragrafin 28, një njësie i lejohe, por nuk i kërkohet, të njohë dhe të masë aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e shoqëruara me atë skemë përfitimesh sociale duke zbatuar, për analogji, kërkesat e standardeve përkatëse ndërkombëtare ose kombëtare të kontabilitetit që trajtojnë kontratat e sigurimit..**

**Paragrafi AG19 jep udhëzime shtesë mbi standardet e kontabilitetit që kanë të bëjnë me kontratat e sigurimit që mund të zbatohen, për analogji, në kontabilizimin e përfitimeve sociale.**

27. Kur një njësi zgjedh të mos zbatojë në mënyrë analogjike kërkesat e standardit përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton kontratat e sigurimit, njësia do të njohë dhe të masë detyrimet dhe shpenzimet që shoqërohen me atë skemë përfitimesh sociale, dhe të përfshijë informacione shpjeguese në pasqyrat financiare, në në përputhje me paragrafët 6-25 të këtij Standardi.
28. Një njësi mund të njohë dhe të masë aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet që shoqërohen me një skemë përfitimesh sociale duke zbatuar, për analogji, kërkesat e standardit përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton kontratat e sigurimit kur:
- (a) Skema e përfitimeve sociale synohet të financohet plotësisht nga kontributet; dhe
  - (b) Ka evidencë se njësia e menaxhon skemën në të njëjtën mënyrë si një ofrues i kontratave të sigurimit, duke përfshirë vlerësimin e performancës financiare dhe pozicionit financiar të skemës në baza të rregullta.

Paragrafët AG20–AG25 ofrojnë udhëzime shtesë për përcaktimin nëse këta kritere janë përmbushur.

### **Dhënia e Informacioneve Shpjeguese**

29. **Objekivi i dhënies së informacioneve sipas metodës së siguracionit, së bashku me informacionin e dhënë në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve monetare, është që njësitë t'u japin përdoruesve të pasqyrave financiare një bazë për të vlerësuar efektin që përfitimet sociale mund të kenë në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë. Paragrafët 30 dhe 31 specifikojnë kërkesat se si të arrihet ky objektivi.**
30. Kur një njësi jeh dhe mat aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet që shoqërohen me një skemë përfitimesh sociale duke zbatuar, për analogji, kërkesat e standardit përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton kontratat e sigurimit, njësia do të paraqesë:
- (a) **Bazën për të përcaktuar se trajtimi si siguracionet është e përshtatshme;**
  - (b) **Informacionin të kërkuar nga standardet përkatëse ndërkombëtare ose kombëtare të kontabilitetit që trajtojnë kontratat e sigurimit; dhe**
  - (c) **Çdo informacion shtesë të kërkuar nga paragrafi 31 i këtij Standardi.**

31. Për të përmbushur kërkesat e paragrafit 30(c) të këtij Standardi, një njësi do të paraqesë:
- (a) Informacion për karakteristikat e skemave të përfitimeve sociale, duke përfshirë:
    - (i) Natyrën e përfitimeve sociale të dhëna nga skemat (për shembull, përfitimet e pensionit, përfitimet e papunësisë, përfitimet e fëmijëve); dhe
    - (ii) Karakteristikat kryesore të skemave të përfitimeve sociale, të tilla si një përshkrim i kuadrit legjislativ që rregullon skemën, një përmbledhje të kriterëve kryesore të përshtatshmërisë/kualifikimit që duhet të plotësohen për të marrë përfitimin social, dhe një deklaratë se si mund të merret informacion shtesë rreth skemës; dhe
  - (b) Një përshkrim të çdo ndryshimi të rëndësishëm në skemat e përfitimeve sociale të bërë gjatë periudhës së raportimit, së bashku me një përshkrim të efektit të pritshëm të ndryshimeve. Ndryshimet në një skemë të përfitimeve sociale përfshijnë, por nuk kufizohen në:
    - (i) Ndryshimet në nivelin e përfitimeve sociale të dhëna; dhe
    - (ii) Ndryshimet në kriteret e kualifikimit, duke përfshirë individët dhe/ose familjet e mbuluara nga skema e përfitimeve sociale.

Gjatë dhënies së informacioneve të kërkuara nga ky paragraf, një njësi do të ketë parasysh kërkesat e paragrafëve 45-47 të SNKSP 1, të cilat ofrojnë udhëzime mbi materialitetin dhe mënyrën e grupimit.

## **Raportimi mbi Qëndrueshmërinë Afatgjatë të Financave të një Njësie**

32. Njësitë me përfitime sociale inkurajohen, por nuk u kërkohet, të përgatisin raporte financiare me qëllim të përgjithshëm që japin informacion mbi qëndrueshmërinë afatgjatë të financave të njësisë. Udhëzuesi i praktikës së rekomanduar (UPR) 1, *Raportimi mbi Qëndrueshmërinë Afatgjatë të Financave të Njësiesë*, ofron udhëzime për përgatitjen e raporteve të tilla.

## **Dispozitat Kalimtare**

### **Trajtimi i Përgjithshëm**

33. **Në kontabilizimin për një skemë përfitimesh sociale që njihet dhe matet, dhe për të cilën jepen informacione, në përputhje me qasjen**

e përgjithshme (shih paragrafët 6-25), një njësi do të zbatojë këtë Standard në mënyrë retrospektive, në përputhje me SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*.

#### Trajtimi si Siguracionet

34. Një njësi do të zbatojë dispozitat kalimtare në standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton kontratat e siguracionit në kontabilitetin për një skemë përfitimesh sociale që njihet dhe matet, dhe për të cilën jepen informacione, në përputhje me trajtimin si siguracionet (shih paragrafët 26-31).

#### Data Efektive

35. Një njësi do të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2022. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të paraqesë informacion për këtë fakt.
36. Kur një njësi adopton SNKSP-të e kontabilitetit sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, siç përkufizohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të Drejtave dhe detyrimeve të Konstatuara për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive*, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së zbatimit të SNKSP.

## FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

Ky fjalor përmban të gjithë termat e përkufizuar të 42 Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP), të miratuara deri në datën 31 janar 2019. Një listë e këtyre SNKSP-ve gjendet brenda kapakut të pasmë të Fjalorit. Ky Fjalor nuk përmban termat e përcaktuar në SNKSP-ë sipas Kontabilitetit të bazuar në metodën e Arkëtimeve dhe Pagesave: *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në metodën e Arkëtimeve dhe Pagesave*. Për këta terma, përdoruesit duhet t'i referohen SNKSP-ve përkatëse të metodës së Arkëtimeve dhe Pagesave.

### **Përkufizimet**

Referencat për NKSP-të sipas kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara jepen me numër Standardi dhe numër paragrafi. Për shembull, 1.7 i referon përdoruesit tek SNKSP 1, *Prezantimi i Pasqyrave Financiare*, paragrafi 7. Referencat e dhëna në kllapa tregojnë një ndryshim të vogël në formulim.

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| <b>Termi</b>                         | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | <b>Vendndodhja</b> |
|--------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| afati i qirasë                       | Periudha e pa-anullueshme për të cilën qiramarrësi ka rënë dakord të marrë aktivin me qira së bashku me ndonjë kusht të mëtejshëm për të cilat qiramarrësi ka mundësi që të vazhdojë të mbajë aktivin më qira, me ose pa pagesa të mëtejshme, kur në fillim të marrëveshjes së qirasë ka arsye të sigurta se qiramarrësi do ta marrë në konsideratë këtë mundësi. | 13.8               |
| aktiv afatgjatë material i investuar | Prona (toka apo ndërtesa, një pjesë ndërtese apo të dyja) e mbajtura për përfitim nga shumat e qirasë ose për vlerësim kapital, ose për të dyja, më tepër sesa:                                                                                                                                                                                                   | 16.7               |
|                                      | (a) Për përdorim në prodhimin apo furnizimin me mallra dhe shërbime, ose për qëllime administrative; ose                                                                                                                                                                                                                                                          |                    |
|                                      | (b) Për shitje në rrjedhën e zakonshme të aktivitetit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                    |
| aktiv biologjik                      | Një kafshë apo bimë e gjallë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 27.9               |
| aktiv financiar                      | Çdo aktiv që është:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | 28.9               |
|                                      | (a) Mjete monetare;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                    |
|                                      | (b) Një instrument i kapitalit neto i një njësie tjetër ekonomike;                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                    |
|                                      | (c) Një e drejtë kontraktuale:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                    |
|                                      | (i) Për të marrë mjete monetare apo një aktiv tjetër financiar nga një njësi tjetër ekonomike; ose                                                                                                                                                                                                                                                                |                    |
|                                      | (ii) Për të shkëmbyer aktive financiare ose detyrime financiare me një njësi tjetër ekonomike sipas kushteve që janë potencialisht të pafavorshme për njësinë ekonomike; ose                                                                                                                                                                                      |                    |
|                                      | (d) Një kontratë që do të shlyhet ose mund të shlyhet me instrumentet e kapitalit të vet të njësisë ekonomike dhe është:                                                                                                                                                                                                                                          |                    |
|                                      | (i) Një kontratë jo-derivative, për të cilin njësia ekonomike është ose mund të jetë e detyruar të marrë një numër të ndryshueshëm të instrumenteve të kapitalit neto të vetë njësisë ekonomike; ose                                                                                                                                                              |                    |



FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                           | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Vendndodhja |
|-------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                                 | (ii) Një kontratë derivative që do të shlyhet ose mund të shlyhet në një mënyrë tjetër dhe jo nga këmbimi i një shume fikse të mjeteve monetare, ose një aktivi tjetër financiar për një numër të caktuar të instrumenteve të kapitalit neto të vetë nënjësisë ekonomike. Për këtë qëllim, instrumentet e kapitalit zero të vetë nënjësisë ekonomike nuk përfshijnë instrumentet financiare të kthimit të aksionit, të klasifikuara si instrumente të kapitalit zero, në përputhje me paragrafët 15 dhe 16, instrumente, të cilët krijojnë për njësinë ekonomike një detyrim për të lëvruar tek pala tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të nënjësisë ekonomike vetëm gjatë likuidimit dhe që janë klasifikuar si instrumente të kapitalit zero, në përputhje me paragrafët 17 dhe 18, ose instrumente që janë kontrata për marrjen ose lëvrimin e ardhshëm të instrumenteve të kapitalit neto të vetë nënjësisë ekonomike. |             |
| aktiv i kualifikuar                             | Një aktiv që kërkon patjetër një periudhë të gjatë kohe gjatë për të qenë gati për qëllim përdorimi apo shitjeje.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 5.5         |
| aktiv i marrëveshjes së shërbimeve koncesionare | Është një aktiv që përdoret për të dhënë shërbime publike në një marrëveshje koncesionare shërbimesh, e cila:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 32.8        |
|                                                 | (a) Ofrohet nga operatori që:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |             |
|                                                 | (i) Operatori ndërton, zhvillon apo blen nga një palë e tretë, ose                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |             |
|                                                 | (ii) Është aktiv ekzistues i operatorit; ose                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |             |
|                                                 | (b) Ofrohet nga koncesioni dhënës, i cili                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |             |
|                                                 | (i) Është aktiv ekzistues i koncesionit dhënës; ose                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |             |
|                                                 | (ii) Është një aktiv i përmirësuar ekzistues i koncesionit dhënës:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |             |
| aktiv jo-material                               | Një aktiv i identifikueshëm, jo-monetar pa përmbajtje fizike.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 31.16       |
| aktiv që krijon (gjeneron) mjete monetare       | Aktivet që mbahen me qëllim kryesor kthimin e investimit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | 21.14       |
| aktive afatgjata                                | Zëra materialë që:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 17.13       |

**FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA**

| <b>Termi</b>                          | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                           | <b>Vendndodhja</b> |
|---------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| materiale                             |                                                                                                                                                                                                                              |                    |
|                                       | (a) Mbahen për përdorim në prodhimin apo furnizimin e mallrave apo shërbimeve, për qira t'u dhënë me qira tek të tjerët, ose për qëllime administrative; dhe                                                                 |                    |
|                                       | (b) Pritet të përdoren gjatë më shumë se një periudhe raportimi.                                                                                                                                                             |                    |
| aktive që nuk krijojnë mjete monetare | Aktive ndryshe nga aktivet që krijojnë mjete monetare.                                                                                                                                                                       | 21.14              |
| aktive/kapital neto                   | Kapitali neto është interesi i mbetur në aktivet e njësisë ekonomike pas zbritjes së të gjitha detyrimeve.                                                                                                                   | 1.7                |
|                                       | Përbërësit e aktiveve/kapitalit zero janë kapitali i kontribuar, suficitet apo deficitet e akumuluar, rezervat dhe interesat e pakicës. Llojet e rezervave përfshijnë:                                                       |                    |
|                                       | (a) Ndryshime në tepricën e rivlerësimit (shih SNKSP 17, Aktivet Afatgjata Materiale dhe SNKSP 31, Aktivet Jo-materiale);                                                                                                    |                    |
|                                       | (b) Ri-matjet e skemave me përfitime të përcaktuara (SNKSP 39, Përfitimet e Punëmarrësit);                                                                                                                                   |                    |
|                                       | (c) Fitime dhe humbje neto që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një operacioni të kryer jashtë vendit (shih SNKSP 4, Efektet e Ndryshimeve në Normat e Këmbimit Valutor);                                     |                    |
|                                       | (d) Fitimet dhe humbjet nga investimet në instrumentet e kapitalit neto të përcaktuar në vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të aktiveve/kapitalit neto, në përputhje me paragrafin 106 të SNKSP 41, Instrumentet Financiare; |                    |
|                                       | (e) Fitimet dhe humbjet nga instrumentet financiare, të matur me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së Aktiveve/kapitalit neto, në përputhje me paragrafin 41 të SNKSP 41;                                                      |                    |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                 | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Vendndodhja |
|-----------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                       | (f) Pjesën efektive të fitimeve dhe humbjeve në instrumentët mbrojtës në mbrojtjen e flukseve të mjeteve monetare dhe fitimet e humbjet në instrumentet mbrojtës që mbrojnë investimet në instrumente të kapitalit neto, të matura në vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 106 të SNKSP 41 (shih paragrafët 113-155 të SNKSP 41);                                                                   |             |
|                       | (g) për detyrime të veçanta të përcaktuara si me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, shumë e ndryshimit në vlerën e drejtë që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë të detyrimit (shih paragrafin 108 të SNKSP 41).                                                                                                                                                                                                             |             |
|                       | (h) ndryshimet në vlerën e vlerës së kohës së opsioneve kur bëhet ndarja e vlerës së perceptuar dhe vlerës së kohës të një kontrate opsioni dhe përcaktimi si instrument mbulues vetëm i ndryshimeve në vlerën e perceptuar (shih paragrafët 113–155 të SNKSP 41); dhe                                                                                                                                                                      |             |
|                       | (i) ndryshimet në vlerë të elementeve të ardhshëm të një kontrate të ardhshme kur ndahet elementi i ardhshëm dhe elementi i çastit dhe përcaktimi si instrument mbrojtës vetëm i ndryshimeve në elementin e çastit dhe ndryshimet në përhapjen e bazës së monedhës së huaj të një instrumenti financiar kur ky është përjashtuar nga përcaktimi i këtij instrumenti financiar si instrument mbrojtës (shih paragrafët 113–155 të SNKSP 41); |             |
| aktivet               | Burimet e kontrolluara nga një njësi ekonomike si rezultat i ngjarjeve të shkuara dhe nga të cilat parashikohen që të futen në njësinë ekonomike përfitime ekonomike të ardhshme ose potencial shërbimi                                                                                                                                                                                                                                     | 1.7         |
| aktivet e kushtëzuara | Një aktiv i mundshëm që rrjedh nga ngjarje të kaluara dhe ekzistenca e të cilave do të konfirmohet vetëm nga ndodhja ose mosndodhja e një ose më shumë ngjarjeve të pasigurta të ardhshme që nuk janë tërësisht nën kontrollin e njësisë ekonomike.                                                                                                                                                                                         | 19.18       |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| <b>Termi</b>                                                         | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | <b>Vendndodhja</b> |
|----------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| aktivet e segmentit                                                  | Janë ato aktive që përdoren nga një segment në aktivitetet e tij operative dhe që ose i atribuohen direkt segmentit, ose mund t'i shpërndahen segmentit mbi një bazë të arsyeshme.                                                                                                                                                                                                                                                                  | 18.27              |
|                                                                      | Nëse të ardhurat e një segmenti përfshijnë të ardhura nga interesi ose dividendi, aktivet e segmentit të tij përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, huatë, investimet, ose aktive të tjera që krijojnë të ardhura.                                                                                                                                                                                                                                     |                    |
|                                                                      | Aktivitetet e segmentit nuk përfshijnë tatimin mbi fitim apo aktivet ekuivalente me tatimin mbi fitim që njihen në përputhje me standardet e kontabilitetit që kanë të bëjnë me detyrimet për të paguar tatimin mbi fitim apo ekuivalentët e tatimit mbi fitim.                                                                                                                                                                                     |                    |
|                                                                      | Aktivitetet e segmentit përfshijnë investime të llogaritura sipas metodës së kapitalit vetëm nëse sufiçiti (defiçiti) neto nga investime të tilla përfshihet në të ardhurat e segmentit. Aktivitetet e segmentit përfshijnë pjesën e një sipërmarrësi të përbashkët të të ardhurave të një njësie ekonomike të kontrolluar bashkërisht që llogaritet nga konsolidimi proporcional në përputhje me SNKSP 8, Interesat në Sipërmarrje të Përbashkëta. |                    |
|                                                                      | Aktivitetet e segmentit përcaktohen pas zbritjes së lejimeve përkatëse që raportohen si kompensime të drejtpërdrejta në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike.                                                                                                                                                                                                                                                                       |                    |
| aktivet e skemës                                                     | Përbajnë:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 39.8               |
|                                                                      | (a) Aktivitetet e mbajtura nga një fond afatgjatë për përfitimet e punonjësve; dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                    |
|                                                                      | (b) Policat kualifikuese të sigurimit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                    |
| aktivet financiare me kredit të zhvlerësuar të blera apo të krijuara | Kredit i zhvlerësuar në njohjen fillestare.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 41.9               |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                                               | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Vendndodhja |
|---------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| aktivet financiare me kreditit të zhvlerësuar                       | Një aktiv financiar është me kredit të zhvlerësuar kur kanë ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset e mjeteve monetare të ardhshme të vlerësuara të atij aktivi financiar. Dëshmia që një aktiv financiar është me kredit të dëmtuar përfshin të dhëna të vëzhgueshme në lidhje me ngjarjet e mëposhtme: | 41.9        |
|                                                                     | (a) Vështirësi financiare domethënëse të emetuesit ose huamarrësit;                                                                                                                                                                                                                                                                        |             |
|                                                                     | (b) Një shkelje e kontratës, siç janë një ngjarje të mospagimit apo vonesës në pagesë;                                                                                                                                                                                                                                                     |             |
|                                                                     | (c) Huadhënësi(t) e huamarrësit, për arsye ekonomike ose ligjore që lidhen me vështirësinë financiare të huamarrësit që i kanë dhënë huamarrësit një ose disa koncesione që huadhënësi(t) në kushte të tjera nuk do ka merrnin në konsideratë;                                                                                             |             |
|                                                                     | (d) Po bëhet e mundur që huamarrësi të hyjë në proces falimentimi ose në ndonjë riorganizim tjetër financiar;                                                                                                                                                                                                                              |             |
|                                                                     | (e) Zhdukja e një tregu aktiv për atë aktiv financiar për shkak të vështirësive financiare;                                                                                                                                                                                                                                                |             |
|                                                                     | (f) Blerja ose krijimi i një aktivi financiar me një skontim të thellë që pasqyron humbjet e pësuar të kredisë.                                                                                                                                                                                                                            |             |
|                                                                     | Mund të mos jetë e mundur të identifikohet një ngjarje e vetme e veçantë-përkundrazi, efekti i kombinuar i një sërë ngjarjesh mund të ketë shkaktuar kthimin e aktiveve financiare në aktive me kredit të zhvlerësuar.                                                                                                                     |             |
| aktivet që mbahen në një fond afatgjatë përfitimesh për punonjësit; | Aktivet (përveç instrumenteve financiare të pa-transferueshëm të emtuar nga njësia raportuese) që:                                                                                                                                                                                                                                         | 39.8        |
|                                                                     | (a) Mbahen nga njësia ekonomike (një fond) që është ligjorisht i ndarë nga njësia ekonomike raportuese dhe ekziston vetëm për të paguar ose financuar përfitimet e punonjësve; dhe                                                                                                                                                         |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                        | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                               | Vendndodhja |
|----------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                              | (b) Janë të disponueshëm vetëm për të paguar apo financuar përfitimet e punonjësve, nuk janë të disponueshëm për kreditorët e vetë nënjësisë raportuese (edhe në rast falimentimi), si dhe nuk mund t'i kthehen nënjësisë raportuese, përveç rasteve kur: |             |
|                                              | (i) aktivet e mbetura të fondit janë të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha detyrimet që lidhen me përfitimet e punonjësve të skemës ose të njësisë raportuese; ose                                                                                   |             |
|                                              | (ii) Aktivet janë kthyer tek njësi raportuese për ta rimbursuar atë për përfitimet e punonjësve që janë paguar tashmë.                                                                                                                                    |             |
| aktivitet bujqësor                           | Menaxhimi nga një njësi ekonomike i transformimit biologjik dhe shkëputjes së prodhimeve bujqësore nga një aktiv biologjik për:                                                                                                                           | 27.9        |
|                                              | Shitje;                                                                                                                                                                                                                                                   |             |
|                                              | Shpërndarje pa tarifë apo për një tarifë nominale; ose                                                                                                                                                                                                    |             |
|                                              | Konvertim në prodhime bujqësore apo në aktive biologjike shtesë për shitje apo për shpërndarje pa tarifë apo për një tarifë nominale.                                                                                                                     |             |
| amortizimi                                   | Shpërndarja sistematike e shumës së amortizueshme të një aktivi gjatë jetës së tij të dobishme.                                                                                                                                                           | 17.13       |
| amortizimi                                   | Shpërndarja sistematike e shumës së amortizueshme të një aktivi jomaterial gjatë jetës së tij të dobishme.                                                                                                                                                | 31.16       |
| anëtarët e afërt të familjes së një individi | Të afërm ose anëtarë të familjes së individit, të cilët pritet të kenë ndikim apo të ndikohen nga ai individ në marrëdhëniet e tyre tregtare me njësinë ekonomike.                                                                                        | 20.4        |
| angazhim i vendosur                          | Një marrëveshje detyruese për shkëmbimin e një sasive të caktuar burimesh, me një çmim të caktuar, në një datë apo datave të caktuara në të ardhmen.                                                                                                      | 41.9        |
| bashkim                                      | Krijon një njësi ekonomike dhe është, ose:                                                                                                                                                                                                                | 40.5        |
|                                              | (a) Kombinim i sektorit publik ku asnjëra nga palët e kombinimit nuk merr kontrollin e një apo më shumë operacioneve; ose                                                                                                                                 |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi               | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                               | Vendndodhja |
|---------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                     | (b) Kombinim i sektorit publik në të cilin një nga palët e kombinimit merr kontrollin e një apo më shumë operacioneve dhe në të cilin ka prova se kombinimi ka përmbajtje ekonomike të një bashkimi.                      |             |
| bazë buxhetore      | Baza e kontabilitetit sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, sipas arkëtimeve dhe pagesave të mjeteve monetare apo një bazë tjetër kontabiliteti e miratuar në buxhet që është miratuar nga organi legjislativ. | 24.7        |
| bazë e krahasueshme | Shumat aktuale të paraqitura në të njëjtën bazë kontabiliteti, të njëjtën bazë klasifikimi, për të njëjtat njësi ekonomike dhe për të njëjtën periudhë si dhe buxheti i miratuar.                                         | 24.7        |
| bimë bartëse.       | Bimë e gjallë që:                                                                                                                                                                                                         | 17.13, 27.9 |
|                     | (a) Përdoret në prodhimin ose furnizimin e produkteve bujqësore;                                                                                                                                                          |             |
|                     | (b) Pritet të ketë prodhim për më shumë se sa një periudhë: dhe                                                                                                                                                           |             |
|                     | (c) Ka pak gjasa të shitet si prodhim bujqësor, përveç se si shitje e rastësishme të mbetjeve.                                                                                                                            |             |
| blerës              | Njësia ekonomike që merr kontrollin e një a më shumë operacioneve në një blerje.                                                                                                                                          | 40.5        |
| blerje              | Një kombinim i sektorit publik ku njëra palë e kombinimit merr kontrollin e një a më shumë operacioneve dhe ka prova që kombinimi nuk është një bashkim.                                                                  | 40.5        |
| buxhet i miratuar   | Autoriteti për shpenzime që rrjedh nga legjislatiioni, projektligji për fondin rezervë, urdhrat e qeverisë dhe vendime të tjera që lidhen me të ardhurat apo faturat e parashikuara për periudhën buxhetore.              | 24.7        |
| buxhet shumëvjeçar  | Buxhet i miratuar për më shumë se një vit. Nuk përfshin vlerësimet apo projeksionet e ardhshme të botuara për periudha përtej periudhës buxhetore.                                                                        | 24.7        |
| buxhet vjetor       | Buxhet i miratuar për një vit. Nuk përfshin vlerësimet apo projeksionet e ardhshme të botuara për periudha përtej periudhës buxhetore.                                                                                    | 24.7        |
| buxheti fillestar   | Buxheti fillestar i miratuar për periudhën e buxhetit.                                                                                                                                                                    | 24.7        |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                        | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Vendndodhja |
|------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| buxheti përfundimtar         | Buxheti fillestar i rregulluar për gjithë rezervat, shumat e mbartura, transferimet, shpërndarjet, ndarjet buxhetore shtesë dhe ndryshime të tjera të autorizuara nga legjislativi, apo nga një autoritet i ngjashëm, i zbatueshëm për periudhën e buxhetit                                                                                                                                    | 24.7        |
| çregjistrimi                 | Çregjistrimi i një aktivi financiar ose detyrimi financiar të njohur më parë nga pasqyra e pozicionit financiar të një njësie ekonomike.                                                                                                                                                                                                                                                       | 41.9        |
| data e bashkimit             | Data në të cilën njësi ekonomike rezultuese merr kontrollin e operacioneve të kombinuara.                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 40.5        |
| data e blerjes               | Data në të cilën blerësi fiton kontrollin e operacionit të blerë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | 40.5        |
| data e miratimit të SNKSP-ve | Data në të cilën njësi ekonomike zbaton SNKSP-të e bazës së të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për herë të parë dhe është nisja e periudhës së raportimit gjatë së cilës zbatuesi për herë të parë miraton SNKSP-të e bazës së të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara data në të cilën njësi paraqet SNKSP-të e para kalimtare apo pasqyrat e saj të para financiare sipas SNKSP-ve. | 33.9        |
| data e raportimit            | Data e ditës së fundit të periudhës së raportimit me të cilën lidhen pasqyrat financiare në lidhje.                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 2.8         |
| data e ri-klasifikimit       | Dita e parë e periudhës së parë të raportimit pas ndryshimit në modelin e biznesit që çon në ri-klasifikimin e aktiveve financiare në një njësi ekonomike.                                                                                                                                                                                                                                     | 41.9        |
| defiçit ose sufiçit          | Është:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 39.8        |
|                              | (a) Vlera aktuale e detyrimit të përfitimit të përcaktuar, minus                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |             |
|                              | (b) Vlerën e drejtë të aktiveve të skemës (nëse ka).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |             |
| dëftesa                      | Përmbajnë informacion shtesë krahasuar me atë të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalit/aktiveve neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare. Dëftesat ofrojnë përshkrime narrative ose shpërndarje të zërave të paraqitur në këto                                                                         | 1.7         |



FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                          | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Vendndodhja |
|------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                                | pasqyra dhe informacion mbi zërat që nuk kualifikohen për njohje në këto pasqyra.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |             |
| derivativ                                      | Një instrument financiar ose kontratë tjetër brenda objektit të këtij Standardi që i ka të tre karakteristikat e mëposhtme.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 41.9        |
|                                                | (a) Vlera e tij ndryshon si reagim ndaj ndryshimit në një normë interesi të caktuar, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të mallrave, kursit të këmbimit të monedhës së huaj, indeksit të çmimeve ose të normave, klasifikimit të kredisë ose indeksit të kredisë, ose të variablave të tjerë, siç është rasti i një variabli jo-financiar ku variabli nuk është specifik për një palë të kontratës (që ndonjëherë quhet 'variabël bazë'). |             |
|                                                | (b) Nuk kërkon investim fillestar neto apo një investim fillestar neto që është më i vogël se sa do të ishte e nevojshme për llojet e tjera të kontratave që pritet të reagojnë në një mënyrë të ngjashme ndaj faktorëve të tregut.                                                                                                                                                                                                             |             |
|                                                | (c) Shlyhet në një datë në të ardhmen.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |             |
| detyrim (aktiv) neto për përfitime të caktuara | Deficiti ose sufiçiti, i rregulluar për çdo efekt që kufizon një aktiv neto për përfitime të caktuara tek tavan i aktivitetit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 39.8        |
| detyrim financiar                              | Çdo detyrim që është:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 28.9        |
|                                                | (a) Detyrim kontraktual:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |             |
|                                                | (i) Për të lëvruar mjetet monetare ose një aktiv tjetër financiar tek një njësi tjetër ekonomike; ose                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |             |
|                                                | (ii) Për të shkëmbyer aktive financiare ose detyrime financiare me një njësi tjetër ekonomike, sipas kushteve që janë potencialisht të pafavorshme për njësinë ekonomike; ose                                                                                                                                                                                                                                                                   |             |
|                                                | (b) Një kontratë që do të shlyhet, ose mund të shlyhet, me instrumentet e kapitalit neto të vetë njësisë ekonomike dhe është:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Vendndodhja |
|-------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|       | (i) Një kontratë jo-derivative, për të cilën njësia ekonomike është, ose mund të jetë, e detyruar të lëvrojë një numër të ndryshueshëm të instrumenteve të kapitalit neto të vetë nënjësisë ekonomike; ose                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |             |
|       | (ii) Një kontratë derivative që do të shlyhet ose mund të shlyhet në një mënyrë tjetër dhe jo nga këmbimi i një shume fikse të mjeteve monetare, ose një aktivi tjetër financiar për një numër të caktuar të instrumenteve të kapitalit neto të vetë nënjësisë ekonomike. Për këtë qëllim, të drejtat, alternativat ose garancitë për të blerë një numër të caktuar të instrumenteve të kapitalit të një njësie ekonomike, për një shumë të caktuar parash të çdo monedhe, quhen instrumente të kapitalit në qoftë se njësia ekonomike ofron këto të drejta, alternativa apo                                                                                                                                                                                                                                     |             |
|       | garanci proporcionale për të gjithë zotëruesit aktualë të aksioneve të së njëjtës kategori instrumentesh jo-derivativë të kapitalit të saj. Gjithashtu, për këto qëllime, instrumentet e kapitalit neto të vetë të njësisë ekonomike nuk përfshijnë instrumentet financiare të kthyeshëm, të klasifikuar si instrumentë të kapitalit neto, në përputhje me [SNKSP 28] paragrafët 15 dhe 16, instrumentë të cilët krijojnë për njësinë ekonomike një detyrim për të lëvruar tek pala tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim dhe që janë klasifikuar si instrumentë të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 17 dhe 18, ose instrumentë që janë kontrata për marrjen ose lëvrimin e ardhshëm të instrumenteve të kapitalit neto të vetë nënjësisë ekonomike. |             |
|       | Përgjashtimisht, një instrument që plotëson përkufizimin e një detyrimi financiar, klasifikohet si një instrument i kapitalit neto nëse ka të gjitha tiparet dhe plotëson kushtet që jepen në paragrafët 15 dhe 16, ose në paragrafët 17 dhe 18.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                                                  | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                             | Vendndodhja |
|------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit | Një detyrim financiar që plotëson një nga kushtet e mëposhtme:                                                                                                                                                                                          | 41.9        |
|                                                                        | (a) Përmbush përkufizimin e mbajtur për tregtim.                                                                                                                                                                                                        |             |
|                                                                        | (b) Pas njohjes fillestare, është caktuar nga njësia ekonomike si instrument financiar me vlerë të drejtë, nëpërmjet suficitit ose deficitit, në përputhje me [SNKSP 41], paragrafi 46 ose 51.                                                          |             |
|                                                                        | (c) Është i caktuar ose në njohje fillestare ose më pas, me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit, në përputhje me [SNKSP 41], paragrafin 152.                                                                                              |             |
| detyrim i kushtëzuar                                                   | (a) Një detyrim i mundshëm që rrjedh nga ngjarje të shkuara dhe ekzistenca e të cilave konfirmohet vetëm nga ndodhja ose mos-ndodhja e një ose më shumë ngjarjeve të pasigurta të ardhshme që nuk janë tërësisht nën kontrollin e njësisë ekonomike;ose | 19.18       |
|                                                                        | (b) Një detyrim aktual që rrjedh nga ngjarje të shkuara por që nuk është njohur, sepse:                                                                                                                                                                 |             |
|                                                                        | (i) Nuk është e mundur që të kërkohet një dalje e burimeve                                                                                                                                                                                              |             |
|                                                                        | që mishëron përfitime ekonomike apo potencial shërbimesh për të shlyer detyrimin; ose                                                                                                                                                                   |             |
|                                                                        | (ii) Shuma e detyrimit nuk mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme.                                                                                                                                                                                 |             |
| detyrim i pashlyer që i kalon afati                                    | Një aktiv financiar është i pashlyer dhe i ka kaluar afati kur pala tjetër ka dështuar në bërjen e një pagese të kërkuar sipas kontratës.                                                                                                               | 41.9        |
| detyrim konstruktiv                                                    | Një detyrim që rrjedh nga veprimet e një njësie ekonomik, kur:                                                                                                                                                                                          | 19.18       |
|                                                                        | (a) Nga një model i vendosur i praktikave të kaluara, politikave të botuara ose një deklaram aktual mjaftueshëm specifik, njësia u ka treguar palëve të tjera që ajo do të pranojë përgjegjësi të caktuara; dhe                                         |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                   | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                   | Vendndodhja |
|-------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                         | (a) Për rrjedhojë, njësia ekonomike ka krijuar një pritshmëri të arsyeshme nga ana e këtyre palëve të tjera se do t'i shlyejë këto përgjegjësi.                                                                                                               |             |
| detyrim ligjor          | Një detyrim që rrjedh nga:                                                                                                                                                                                                                                    | 19.18       |
|                         | (a) Një kontratë (përmes kushteve të shprehura ose të nënkuptuara);                                                                                                                                                                                           |             |
|                         | (b) Legjislacioni; ose                                                                                                                                                                                                                                        |             |
|                         | (c) Veprime të tjera ligjore.                                                                                                                                                                                                                                 |             |
| detyrimet               | Detyrimet aktuale të njësisë ekonomike që lindin nga ngjarje të kaluara, shlyerja e të cilit pritet të çojë në një dalje të burimeve mbartëse të përfitimeve ekonomike nga njësia ekonomike.                                                                  | 1.7         |
| detyrimet e segmentit   | Ato detyrime operative që rrjedhin nga aktivitetet e një segmenti dhe që ose i atribuohen direkt segmentit, ose mund t'i shpërndahen segmentit mbi një bazë të arsyeshme.                                                                                     | 18.27       |
|                         | Nëse shpenzimi i segmentit për një segment përfshin shpenzim interesi, detyrimet e segmentit për të përfshijnë detyrimet fitimprurëse të lidhura me të.                                                                                                       |             |
|                         | Detyrimet e segmentit përfshijnë pjesën e një sipërmarrësi të përbashkët tek detyrimet e një njësie ekonomike të kontrolluar bashkërisht që llogaritet nga konsolidimi proporcional në përputhje me SNKSP 8.                                                  |             |
|                         | Detyrimet e segmentit nuk përfshijnë tatimin mbi fitim apo aktivet ekuivalente të tatimit mbi fitim që njihen në përputhje me standardet e kontabilitetit që kanë të bëjnë me detyrimet për të paguar tatimin mbi fitim apo ekuivalentët e tatimit mbi fitim. |             |
| diferencë këmbimi       | Diferenca që rrjedh nga konvertimi i një numri të dhënë njësisish të një monedhe në një monedhë tjetër, në bazë të kurseve të ndryshme të këmbimit.                                                                                                           | 4.1         |
| dispozita e të drejtave | Të drejtat e përcaktuara për të mbrojtur interesat e palës që i zotëron këto të drejta, pa i dhënë kësaj pale fuqi mbi njësinë ekonomike me të cilën lidhen këto të drejta.                                                                                   | 35.14       |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| <b>Termi</b>                           | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | <b>Vendndodhja</b> |
|----------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| dividentët apo shpërndarje të ngjashme | Shpërndarja tek mbajtësit e instrumenteve të kapitalit neto në përputhje me kuotat përkatëse të kategorive të caktuara të kapitalit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 41.9               |
| e ardhurat financiare e porealizuar    | Diferenca ndërmjet:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 13.8               |
|                                        | (a) Investimit bruto në qira; dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                    |
|                                        | (b) Investimit neto në qira.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |                    |
| ekuivalentë të mjeteve monetare        | Investime afatshkurtra, shumë likuide që janë gatshme për t'u konvertuar në shuma të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.                                                                                                                                                                                                                                                       | 2.8                |
| element i mbrojtur                     | Një aktiv, detyrim, angazhim i përcaktuar, transaksion i parashikueshëm me një probabilitet të lartë, ose investimi neto në një operacion të huaj që (a) e ekspozon njësinë ekonomike ndaj rrezikut të ndryshimeve në vlerën e drejtë ose flukset e ardhshme të mjeteve monetare dhe (b) është përcaktuar që të jetë i mbrojtur ([SNKSP 29] paragrafët 87–94 dhe Shtojca A, paragrafët AG131-AG141 thellohen mbi përkufizimin e zërave të mbrojtur). | 29.1               |
| emri i mirë                            | Një aktiv që përfaqëson përfitimet ekonomike të ardhshme që rrjedhin nga aktivet e tjera të përfutuara nga një blerje, të cilat nuk mund të identifikohen individualisht dhe të njihen më vete.                                                                                                                                                                                                                                                      | 40.5               |
| fillimi i qirasë                       | Data më e hershme e marrëveshjes së qirasë dhe data e angazhimit të palëve ndaj dispozitave parësore të qirasë. Në këtë datë:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 13.8               |
|                                        | (a) Qiraja është klasifikuar ose si qira e zakonshme ose si qira financiare; dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                    |
|                                        | (b) Në rastin e qirasë financiare, shumat të cilat duhet të njihen në momentin e fillimit të afatit të qirasë janë përcaktuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                    |
| fitime dhe humbje neto aktuariale      | Ndryshime në vlerën aktuale të detyrimit të detyrimit të përfitimit të përcaktuar që rrjedh nga:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 39.8               |
|                                        | (a) Rregullimet nga përvoja (efektet e ndryshimeve ndërmjet supozimeve të mëparshme aktuariale dhe asaj çfarë ka                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                    |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                              | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Vendndodhja |
|------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                    | ndodhur në të vërtetë); dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |             |
|                                    | (b) Efektet e ndryshimeve në supozimet aktuariale.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |             |
| fitimet ose humbjet nga modifikimi | Shuma që rrjedh nga rregullimi i vlerës kontabël bruto të aktivitetit financiar për të pasqyruar flukset monetare kontraktuale të ri-negociuara ose të modifikuara. Njësia ekonomike rillogarit vlerën kontabël bruto të aktivitetit financiar si vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të parashikuara të mjeteve monetare, ose si vlerën e të ardhurave përgjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar të ri-negociuar ose të modifikuar që skontohehen me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar (ose me normën fillestare të interesit të rregulluar të kredisë për aktivitetin financiar të blera apo të krijuara me kreditin të zhvlerësuar) ose, kur është e zbatueshme, me normën e rishikuar të interesit efektiv, të llogaritur në përputhje me [SNKSP 41] paragrafin 139. Kur bën vlerësimin e flukseve monetare të pritshme të një aktiviteti financiar, një njësi ekonomike duhet të marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar (për shembull shlyerjen, blerjen, dhe alternativat e ngjashme të blerjes), por nuk merr parasysh humbjet e pritshme të kredisë, përveç rastit kur aktiviteti financiar është blerë ose krijuar si aktiviteti financiar me kreditin të zhvlerësuar, rast në të cilin një njësi ekonomike duhet gjithashtu të marrë në konsideratë humbjet fillestare të kredisë që janë shqyrtuar kur është llogaritur norma fillestare e interesit efektiv të kredisë së rregulluar. | 41.9        |
| fitimet ose humbjet nga zhlerësimi | Të njohura sufiçit apo defiçit në përputhje me [SNKSP 41] paragrafi 80 dhe që lindin nga zbatimi i kërkesave të zhverësimit tek [SNKSP 41] paragrafi 73–93.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 41.9        |
| flukse monetare                    | Hyrjet dhe daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 2.8         |
| fuqia                              | Konsiston në të drejtat ekzistuese që japin aftësinë aktuale për të drejtuar aktivitetet e                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 35.14       |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                             | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Vendndodhja |
|-----------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                   | përshtatshme të një njësie tjetër ekonomike.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |             |
| gabime të periudhave të mëparshme | Lënia jashtë nga pasqyrat financiare të njësisë ekonomike dhe gabimet në to e një apo më shumë periudhave paraardhëse që rrjedh nga moszbatimi, apo keqpërdorimi i informacionit të përfaqësuar besnikërisht, i cili:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 3.7         |
|                                   | (a) Ishte i disponueshëm kur pasqyrat financiare të asaj periudhe u autorizuan për botim; dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |             |
|                                   | (b) Mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të jenë marrë dhe mbajtur parasysh në përgatitjen dhe paraqitjen e këtyre pasqyrave financiare.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |             |
|                                   | Gabime të tilla përfshijnë efektet e gabimeve matematikore, gabimeve në zbatimin e politikave kontabël, anashkalim ose keqinterpretim i fakteve dhe mashtrim.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |             |
| gjoba                             | Përfitime ekonomike ose potencial shërbimi të përfituara ose të përfitueshme nga njësi ekonomike të sektorit publik, siç është vendosur nga një gjykatë apo një tjetër organ ligjzbatues, si pasojë e shkeljes së ligjeve ose rregulloreve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 23.7        |
| grup aktivesh biologjikë          | Tërësia e të mbjellave dhe gjësë së gjallë të ngjashme.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 27.9        |
| hua të pagueshme                  | Detyrime financiare të ndryshme nga llogaritë e pagueshme afatshkurtra në kushte normale kredie.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 30.8        |
| humbja e kredisë                  | Diferenca midis të gjithë flukseve monetare kontraktuale që janë për t'iu paguar një njësie ekonomike, në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukset e mjeteve monetare që pret të marrë njësia ekonomike (pra, të gjitha mungesat në para), të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv (ose me normën e interesit efektiv të rregulluar të kredisë për aktivet e blera apo krijuara si aktive me kreditit të zhvlerësuar). Një njësi ekonomike do të çmojë flukset e mjeteve monetare duke shqyrtuar të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (për shembull, | 41.9        |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                                                    | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Vendndodhja |
|--------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                                                          | parapagimin, zgjatjen, thirrjen dhe alternativa të ngjashme) përmes jetës së pritshme të atij instrumenti financiar. Flukset e mjeteve monetare që janë shqyrtuar duhet të përfshijë flukset e mjeteve monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose aktiveve të tjera të mbajtura si garanci për kredinë e dhënë të cilat janë pjesë integrale kushteve kontraktuale. Ekziston një supozim se jeta e pritshme e një instrumenti financiar mund të matet në mënyrë të besueshme. Megjithatë, në ato raste të rralla kur nuk është e mundur të vlerësohet në mënyrë të besueshme jeta e pritshme e një instrumenti financiar, njësia ekonomike do të përdorë afatin kontraktual të mbetur të instrumentit financiar. |             |
| humbja për arsye zhvlerësimi e një aktivi që krijon mjete monetare       | Shuma me të cilën vlera kontabël (neto) e një aktivi tejkalon shumën e tij të rikuperueshme.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 17.13       |
| humbja për arsye zhvlerësimi e një aktivi që nuk krijon mjete - monetare | Shuma me të cilën vlera kontabël (neto) e një aktivi tejkalon shumën e tij të rikuperueshme të shërbimit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | 17.13       |
| humbje e pritshme e kredisë përgjatë jetës                               | Humbjet e pritshme të kredisë që janë rezultat i të gjitha ngjarjeve të mundshme gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | 41.9        |
| Humbjet 12-mujore të kredisë të parashikuara                             | Ajo pjesë e humbjeve të parashikuara të kredisë përgjatë gjithë jetës që përfaqëson humbjet e parashikuara të kredisë që rrjedhin nga mospagesa në kohë për një instrument financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 41.9        |
| humbjet e pritshme të kredisë                                            | Mesatarja e ponderuar e humbjeve të kredisë me rreziqet përkatëse të mospagesës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 41.9        |
| i identifikueshëm                                                        | Një aktiv është i identifikueshëm nëse:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 40.5        |



FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                 | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Vendndodhja |
|-----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                       | (a) Është i ndashëm, pra, është e mundur të ndahet apo të veçohet nga njësia ekonomike dhe të shitet, transferohet, licençohet, jepet me qira dhe këmbehet, qoftë individualisht apo së bashku me një kontratë, aktiv ose detyrim të lidhur, pavarësisht nëse njësia ekonomike e ka për qëllim apo jo;                                                     |             |
|                       | (b) Rrjedh nga marrëveshje detyruese (përfshirë të drejtat nga kontratat apo të drejta të tjera ligjore), pavarësisht nëse këto të drejta janë të transferueshme apo të ndashme nga njësia ekonomike ose nga të drejta apo detyrime të tjera.                                                                                                              |             |
| i mbajtur për tregtim | Një aktiv financiar ose detyrim financiar, i cili:                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 41.9        |
|                       | (a) është blerë apo krijuar kryesisht për qëllime të shitjes ose të riblerjes në afat të afërt kohor;                                                                                                                                                                                                                                                      |             |
|                       | (b) Në njohjen fillestare është pjesë e portofolit të instrumenteve financiare të identifikueshëm që menaxhohen së bashku dhe për të cilat ka prova të një modeli aktual të kohëve të fundit për realizimin e fitimeve afatshkurtra; ose                                                                                                                   |             |
|                       | (c) është një derivativ (me përjashtim të një derivativi që është një kontratë e garancisë financiare ose një instrument mbrojtës i caktuar dhe efektiv).                                                                                                                                                                                                  |             |
| i pazbatueshëm (1)    | Një kërkesë është e pazbatueshme kur njësia ekonomike nuk mund ta zbatojë atë, edhe pas bërjes së të gjithë përpjekjeve të arsyeshme për ta zbatuar.                                                                                                                                                                                                       | 1.7         |
| i pazbatueshëm (2)    | Një kërkesë është e pazbatueshme kur njësia ekonomike nuk mund ta zbatojë atë, edhe pas bërjes së të gjithë përpjekjeve të arsyeshme për ta zbatuar. Për një periudhë paraardhëse të caktuar, një ndryshim në politikën kontabël në mënyrë retrospektive apo bërja e një ri-deklarimi retrospektiv për të korrigjuar një gabim është i pazbatueshëm, nëse: | 3.7         |
|                       | (a) Efektet e zbatimit retrospektiv ose rideklarimit retrospektiv nuk janë të përcaktueshme;                                                                                                                                                                                                                                                               |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                                                   | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | Vendndodhja |
|-------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                                                         | (b) Zbatimi retrospektiv ose ri-deklarimi retrospektiv kërkojnë supozime rreth synimeve që duhet të kenë patur në atë periudhë drejtuesit; ose                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |             |
|                                                                         | (c) Zbatimi retrospektiv ose ri-deklarimi retrospektiv kërkojnë vlerësime të rëndësishme të shumave dhe është e pamundur të dallohet objektivisht informacioni mbi këto vlerësimeve, të cilat:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |             |
|                                                                         | (i) Ofrojnë prova të rrethanave që kanë ekzistuar në datën (datat) në të cilat këto shuma do të kontabilizohen, maten, apo për të cilat do të jepet informacion shpjegues; dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |             |
|                                                                         | (ii) Do të ishin vënë në dispozicion kur pasqyrat financiare, për atë periudhë të mëparshme, ishin autorizuar për publikim; nga informacione të tjera.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |             |
| influcë e konsiderueshme (që lidhet me transaksionet e palës së lidhur) | Fuqia për të marrë pjesë në vendimet e politikës financiare dhe operative të një njësie ekonomike, por për të mos i kontrolluar këto politika. Ndikim i rëndësishëm mund të ushtrohet në disa mënyra, zakonisht me anë të përfaqësimit në bordin e drejtorëve apo organin ekuivalent të drejtimit, por edhe, për shembull, me anë të pjesëmarrjes në (a) procesin vendimmarrës, (b) transaksionet materiale ndërmjet njësisë ekonomike brenda një njësie ekonomike, (c) shkëmbim të personelit drejtues, ose (d) varësi në informacionin teknik Ndikim i rëndësishëm mund të përfitohet nga një interes, statut apo marrëveshje pronësie. Përsa i përket interesit të pronësisë, ndikimi i rëndësishëm supozohet në lidhje me përkufizimin që përmbahet në SNKSP 7. | 20.4        |
| instrument financiar                                                    | Çdo kontratë që sjell lindjen e një aktivi financiar të një njësie ekonomike dhe një detyrimi financiar ose një instrument të kapitalit neto të një njësie tjetër ekonomike.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 28.9        |
| instrument i kapitalit neto                                             | Një kontratë që tregon një interes të mbetur në aktivet e një njësie ekonomike pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 28.9        |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                 | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Vendndodhja |
|---------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| Instrument i kthyeshëm                | Një instrument financiar i kthyeshëm është një instrument financiar që i jep mbajtësit të drejtën ta kthejë instrumentin tek botuesi kundrejt mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar, ose që është automatikisht i kthyeshëm tek botuesi me ndodhjen e një ngjarjeje të ardhshme të pasigurt ose me vdekjen apo daljen në pension të mbajtësit të instrumentit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | 28.9        |
| instrument mbrojtës                   | Një derivativ i përcaktuar ose (për mbrojtjen vetëm nga rreziku i ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhës) një aktiv financiar jo-derivativ, ose një detyrim financiar jo-derivativ, vlera e drejtë, ose flukset e mjeteve monetare të të cilit pritet të kompensojnë ndryshimet në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të një zëri të mbrojtur të përcaktuar ([SNKSP 29] paragrafët 81–86 dhe Shtojca A, paragrafët AG127–AG130 thellohen më tej në përkufizimin e një instrumenti mbrojtës).                                                                                                                                                                               | 29.1        |
| interes jo kontrollues                | Aktivet/kapitali neto në një njësi ekonomike të kontrolluar që nuk i atribuohen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, një njësie ekonomike kontrolluese.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 35.14       |
| interes në një njësi tjetër ekonomike | I referohet përfshirjes kontraktuale dhe jo-kontraktuale që e ekspozon një njësi ekonomike ndaj ndryshueshmërisë së përfitimeve nga performanca e njësisë tjetër ekonomike. Një interes në një njësi tjetër ekonomike mund të evidentohet, por jo vetëm, nga mbajtja e instrumenteve të kapitalit neto apo të borxhit, si dhe format e tjera të përfshirjes, të tilla si sigurimi i fondeve, mbështetje për likuiditetin, mbajtja e aktivitetit si garanci kredie dhe garancitë. Ai përfshin mjetet me të cilat një njësi ekonomike ka kontroll ose kontroll të përbashkët apo ndikim të konsiderueshëm mbi një njësi tjetër ekonomike. Nuk është e thënë që një njësi ekonomike të ketë një | 37.7        |
|                                       | interes në një njësi tjetër ekonomike vetëm për shkak të një marrëdhënieje tipike furnitor - klient.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |             |

**FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA**

| <b>Termi</b>                                                           | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                   | <b>Vendndodhja</b> |
|------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| interesa të kapitalit                                                  | Për qëllim të këtij Standardi, është përdorur kryesisht në kuptimin e interesave të pronësisë së investitorëve që zotërojnë njësinë ekonomike dhe interesave të përbashkëta të pronarit, anëtarit ose pjesëmarrësit. | 40.5               |
| interesi neto mbi detyrimin (aktivin) neto me përfitime të përcaktuara | Ndryshimi gjatë periudhës i detyrimit (aktivit) neto për përfitime të caktuara që rrjedh nga kalimi i kohës.                                                                                                         | 39.8               |
| inventarët                                                             | Aktivet:                                                                                                                                                                                                             | 12.9               |
|                                                                        | (a) Në formën e materialeve apo furnizimeve që do konsumohen gjatë procesit të prodhimit;                                                                                                                            |                    |
|                                                                        | (b) Në formën e materialeve apo furnizimeve që do konsumohen gjatë procesit të prodhimit ose ofrimit të shërbimeve;                                                                                                  |                    |
|                                                                        | (c) E mbajtura për shitje ose shpërndarje në rrjedhën normale të operacioneve; ose                                                                                                                                   |                    |
|                                                                        | (d) Në procesin e prodhimit për shitje ose shpërndarje.                                                                                                                                                              |                    |
| Investimet neto në një njësi ekonomike të huaj                         | Shuma e interesit të njësisë raportuese në aktivet/kapitalin neto të këtij operacioni.                                                                                                                               | 4.1                |
| investimi bruto në qira                                                | Tërësia e:                                                                                                                                                                                                           | 13.8               |
|                                                                        | (a) Pagesave minimale të qirasë, të arkëtueshme nga qiradhënësi sipas një kontrate qiraje; dhe                                                                                                                       |                    |
|                                                                        | (b) Çdo vlerë të pa garantuar, të mbetur që i takon qiradhënësit                                                                                                                                                     |                    |
| investimi neto në qira                                                 | Investimi bruto në qira i skontuar me përqindjen e normës së interesit të përcaktuar të qirasë.                                                                                                                      | 13.8               |
| jeta e dobishme (e një qiraje)                                         | Periudha e mbetur e parashikuar, që nga nisja e afatit të qirasë, pa kufizime në marrëveshje, gjatë së cilës përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivit pritet të konsumohen nga subjekti.                         | 13.8               |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                                                          | Përkufizimi                                                                                                                                                                                             | Vendndodhja |
|--------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| jetë e dobishme (e një aktivi që nuk krijon mjete monetare)                    | Ose:                                                                                                                                                                                                    | 21.14       |
|                                                                                | (a) Periudha e kohës gjatë së cilës një aktiv pritet të përdoret nga njësi ekonomike; ose                                                                                                               |             |
|                                                                                | (b) Sasia e prodhimit apo njësi të ngjashme që priten të merren prej aktivit nga njësi ekonomike.                                                                                                       |             |
| jetë e dobishme (e tokës, ndërtesës dhe pajisjeve, apo një aktivi jo material) | Ose:                                                                                                                                                                                                    | 17.13       |
|                                                                                | (a) Periudha gjatë së cilës një aktiv pritet të jetë i disponueshëm për përdorim nga një njësi ekonomike; ose                                                                                           |             |
|                                                                                | (b) Sasia e prodhimit apo njësitë e ngjashme që priten të merren prej aktivit nga njësi ekonomike.                                                                                                      |             |
| jetë ekonomike                                                                 | Ose:                                                                                                                                                                                                    | 13.8        |
|                                                                                | (a) Periudha gjatë së cilës një aktiv parashikohet të sjellë përfitime ekonomike apo potencial shërbimesh tek një apo më shumë përfitues; ose                                                           |             |
|                                                                                | (b) Numri i njësive të prodhimit apo njësive të ngjashme që parashikohet të merren nga ky aktiv për një ose më shumë përdorues.                                                                         |             |
| kategori e aktiveve afatgjata materiale                                        | Grupim aktivesh të natyrës apo funksionit të ngjashëm në operacionet e një njësie ekonomike që duket si një element i vetëm për qëllime të dhënies së informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare. | 17.13       |
| kërkimi                                                                        | Kërkimi është hulumtim i planifikuar i ndërmarrë me perspektivën e përfitimit të kuptimit dhe të njohurive të reja shkencore apo teknike.                                                               | 31.16       |
| kombinim i sektorit publik                                                     | Bërja bashkë, në një njësi ekonomike të sektorit publik, i operacioneve të veçanta.                                                                                                                     | 40.5        |
| kombinim i sektorit publik nën kontrollin e                                    | Është një kombinim i sektorit publik ku të gjitha njësitë ekonomike apo operacionet e përfshira përfundimisht kontrollohen nga e                                                                        | 40.5        |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| <b>Termi</b>                                                  | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | <b>Vendndodhja</b> |
|---------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| përbashkët                                                    | njëta palë ose të njëjtat palë para dhe pas kombinimit të sektorit publik.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                    |
| koncesion (në një marrëveshje koncesionare shërbimi)          | Është njësia ekonomike që i jep operatorit të drejtën e përdorimit të aktivitetit të koncesionit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 32.8               |
| Kontabiliteti sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara | Një bazë kontabiliteti sipas së cilës transaksionet dhe ngjarje të tjera pranohen kur ndodhin (dhe jo vetëm kur arkëtohen apo paguhen mjetet monetare apo ekuivalenti i tyre). Kështu, transaksionet dhe ngjarjet regjistrohen në regjistrat kontabël dhe njihen në pasqyrat financiare të periudhave me të cilat lidhen. Elementët e pranuar në kontabilitetin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara janë aktivet, detyrimet, aktivet neto/ kapitali neto, të ardhurat si dhe shpenzimet. | 1.7                |
| kontraktor                                                    | Një njësi që kryen punë ndërtimi në përputhje me një kontratë ndërtimi.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | 11.4               |
| kontrata përmbarese                                           | Kontrata, sipas të cilave asnjëra nga palët nuk kanë kryer asnjë nga detyrimet, ose të dyja palët kanë përmbushur në mënyrë të pjesshme detyrimet në nivel të njëjtë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 19.18              |
| kontratat me kushte rënduese                                  | Një kontratë për këmbim të aktiveve apo shërbimeve në të cilat kostot e pashmangshme të plotësimit të detyrimeve sipas kontratës tejkalojnë përfitimet ekonomike apo potencialin për shërbime që pritet të përfitohen nëpërmjet saj.                                                                                                                                                                                                                                                             | 19.18              |
| kontratë e garancisë financiare                               | Një kontratë, sipas së cilës i kërkohet lëshuesit të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që pëson, për shkak se një debitor i caktuar nuk i bën pagesat në kohën e duhur, në përputhje me termat fillestarë ose të modifikuar, të një instrumenti borxhi.                                                                                                                                                                                                         | 41.9               |
| kontratë me çmim të fiksuar                                   | Një kontratë ndërtimi, në të cilën kontraktuesi bie dakord me një çmim kontrate të fiksuar, ose një                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | 11.4               |
|                                                               | çmim të fiksuar për njësi prodhimi, i cili në disa raste është objekt i përshkallëzimit në rritje të kostos.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                    |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                        | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Vendndodhja |
|----------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| kontratë me kosto plus apo e bazuar në kosto | Kontratë ndërtimi në të cilën kontraktori rimburohet për kostot e lejuara, apo ndryshe kostot e përcaktuara dhe, në rastin e një kontrate me bazë tregtare, me një përqindje shtesë të këtyre kostove ose një tarifë fikse, nëse ka.                                                                                                                                       | 11.4        |
| kontratë ndërtimi                            | Një kontratë, apo marrëveshje e ngjashme detyruese, e negociuar posaçërisht për ndërtimin e                                                                                                                                                                                                                                                                                | 11.4        |
|                                              | një aktivi ose një kombinimi aktivesh që janë të ndërlidhura apo të ndërvarura ngushtë për sa i përket skicës, teknologjisë dhe funksionit apo qëllimit përdorimit të tyre përfundimtar.                                                                                                                                                                                   |             |
| kontribute nga pronarët                      | Përfitimet ekonomike apo potenciali për shërbime të ardhshme që i është dhënë si kontribut njësisë ekonomike nga palët e jashtme të njësisë ekonomike, përveç atyre që rezultojnë në detyrime të njësisë ekonomike, që krijojnë një interes financiar tek aktivet/kapitali neto i njësisë, i cili:                                                                         | 1.7         |
|                                              | (a) Përçon të drejta si ndaj (i) shpërndarjes së përfitimeve ekonomike apo potencialit të shërbimit në të ardhmen nga njësia ekonomike gjatë jetës së saj dhe shpërndarje të tilla bëhen sipas gjykimit të pronarëve apo përfaqësuesve të tyre, si dhe ndaj (ii) shpërndarjeve e çdo teprice të aktiveve ndaj detyrimeve në rast të mbylljes së njësisë ekonomike; dhe/ose |             |
|                                              | (b) Mund të shitet, të këmbehet, të transferohet ose të tërhiqet.                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |             |
| kontroll                                     | Një njësi ekonomike e kontrollon një njësi tjetër kur njësia është ekspozuar, ose ka të drejta mbi përfitimet e ndryshueshme nga përfshirja e saj me njësinë tjetër ekonomike dhe ka aftësinë të ndikojë në natyrën apo shumën e atyre përfitimeve përmes fuqisë së saj mbi njësinë tjetër ekonomike.                                                                      | 2.8         |
| kontroll i përbashkët                        | Ndarje e miratuar e kontrollit të një marrëveshjeje me anë të një marrëveshjeje detyruese, e cili ekziston vetëm kur vendimet në lidhje me veprimtaritë përkatëse kërkojnë pëlqimin unanim të                                                                                                                                                                              | 36.8        |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                                              | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Vendndodhja |
|--------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                                                    | palëve që kontrollojnë marrëveshjen.                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |             |
| kontrolli i një aktivi                                             | Lind kur njësia ekonomike mund të përdorë apo të përfitojë në një mënyrë tjetër nga aktivi, duke zbatuar objektivat e saj dhe mund të përjashtojë apo përndryshe rregullojë qasjen e të tjerëve tek ai përfitim.                                                                                                                         | 23.7        |
| kosto                                                              | Shuma e mjeteve monetare apo ekuivalentëve të mjeteve monetare që është paguar apo vlera e drejtë e një vlerësimi tjetër të dhënë për blerjen e një aktivi, në kohën e blerjes apo ndërtimi të tij.                                                                                                                                      | 16.7        |
| kosto e supozuar                                                   | Një shumë që përdoret si një zëvendësuese për koston, ose koston e amortizuar, në një datë të caktuar.                                                                                                                                                                                                                                   | 33.9        |
| kosto fillestare e drejtpërdrejtë                                  | Kosto shtesë, të cilat u atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë negocimit dhe nënshkrimit të qirasë, përveç atyre kostove që pësohen nga prodhuesit ose qiradhënësit profesionistë.                                                                                                                                                      | 13.8        |
| kostoja aktuale e zëvendësimit                                     | Kostoja që do të kishte njësia ekonomike për blerjen e aktivitetit datën e raportimit.                                                                                                                                                                                                                                                   | 12.9        |
| kostoja e amortizuar e një aktivi financiar apo detyrimi financiar | Shuma në të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference mes shumës fillestare dhe vlerës në maturim dhe, për aktivet financiare, rregullimin për çdo humbje të zbritshme. | 41.9        |
| kostoja e shërbimit                                                | Përmban:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 39.8        |
|                                                                    | (a) Koston e shërbimit aktual që është rritja e vlerës aktuale të detyrimit të përcaktuar të përfitimit që rrjedh nga shërbimi i punonjësve në periudhën aktuale;                                                                                                                                                                        |             |
|                                                                    | (b) koston e shërbimit të kryer në të shkuarën, që është ndryshimi në vlerën aktuale të detyrimit për përfitime të përcaktuara për shërbimin e punonjësve në periudhat e mëparshme, i cili vjen nga një ndryshim skeme (hyrja ose tërheqja, ose                                                                                          |             |



FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Vendndodhja |
|--------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                      | ndryshimet në një skemë përfitimesh të përcaktuara) ose një shkurtim (pakësim i rëndësishëm nga njësia ekonomike i numrit të punonjësve të mbuluar nga një skemë); dhe                                                                                                                                                       |             |
|                                      | (c) Çdo fitim ose humbje nga shlyerja.                                                                                                                                                                                                                                                                                       |             |
| kostot e huamarrjes                  | Interesi dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara nga një njësi ekonomike në lidhje me huazimin e fondeve.                                                                                                                                                                                                                       | 5.5         |
| kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit | Kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt nxjerrjes jashtë përdorimi të një aktivi, duke përjashtuar kostot financiare dhe shpenzimin e tatimit mbi të ardhurat.                                                                                                                                                           | 21.14       |
| kostot e transaksionit               | Kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, emetimin ose likuidimin e një aktivi financiar ose detyrimi financiar (shih [SNKSP 41] paragrafin AG163). Një kosto shtesë është ajo kosto e cila nuk ndodh nëse njësia ekonomike nuk ka kryer blerjen, emetimin ose nxjerrjen nga përdorimi të një instrumenti financiar. | 41.9        |
| kostot për shitje                    | Kostot shtesë që i atribuohen direkt shitjes së një aktivi, duke përjashtuar kostot financiare dhe tatimin mbi të ardhurat. Nxjerrja jashtë përdorimit mund të ndodhë nëpërmjet shitjes apo nëpërmjet shpërndarjes pa tarifë ose me një tarifë nominale.                                                                     | 27.9        |
| kthimi nga aktivet e skemës          | Interesi, dividendët apo shpërndarjet e tjera të ngjashme, si dhe të ardhura të tjera që rrjedhin nga aktivet e skemës, së bashku me fitimet e realizuara dhe të porealizuara, apo humbjet në aktivet e skemës, minus:                                                                                                       | 39.8        |
|                                      | (a) Çdo kosto të administrimit të aktiveve të skemës, si dhe                                                                                                                                                                                                                                                                 |             |
|                                      | (b) Çdo tatim të pagueshëm nga vetë skema, të ndryshëm nga taksat e përfshira në hipotezat                                                                                                                                                                                                                                   |             |
|                                      | aktuariale të përdorura për të matur vlerën aktuale të detyrimit për përfitime të përcaktuara.                                                                                                                                                                                                                               |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| <b>Termi</b>                                                        | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                          | <b>Vendndodhja</b> |
|---------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| kufizime mbi aktivet e transferuara                                 | Kushtet që kufizojnë ose drejtojnë qëllimet për të cilat mund të përdoret një aktiv i transferuar, por nuk specifikojnë që përfitimet e ardhshme ekonomike apo potenciali i shërbimit kërkohet t'i kthehen transferuesit nëse nuk shpërndahen sipas përcaktimit.            | 23.7               |
| kurs këmbimi i çastit                                               | Kursi i këmbimit për një transaksion të menjëhershëm.                                                                                                                                                                                                                       | 4.1                |
| kursi i këmbimit                                                    | Kursi i këmbimit për dy monedha.                                                                                                                                                                                                                                            | 4.1                |
| kursi i mbylljes                                                    | Kursi i këmbimit i çastit në datën e raportimit.                                                                                                                                                                                                                            | 4.1                |
| kushtet për aktive të transferuara                                  | Përcaktime që specifikojnë se përfitimet e ardhshme ekonomike apo potenciali i shërbimit materializuar në aktiv kërkohet të përdoret nga marrësi sipas përcaktimit, përndryshe përfitimet ekonomike të ardhshme apo potenciali i shërbimit duhet t'i kthehen transferuesit. | 23.7               |
| kushtet për aktivet e transferuara                                  | Kushtet në ligje apo rregullore, ose në një marrëveshje të detyrueshme, të detyruara për përdorimin e një aktivi të transferuar nga njësi ekonomike të jashtme tek njësi ekonomike raportuese.                                                                              | 23.7               |
| marrëveshje detyruese (për një marrëveshje koncesioni për shërbime) | Përshkruan kontratat dhe marrëveshjet që u japin palëve të njëjtat të drejta dhe detyrime si të ishin në formën e një kontrate.                                                                                                                                             | 32.8               |
| marrëveshje detyruese (për një marrëveshje të përbashkët)           | Një marrëveshje që u jep palëve të drejta dhe detyrime të zbatueshme si të ishin në formën e një kontrate. Përfshin të drejta nga kontratat dhe të drejta të tjera ligjore.                                                                                                 | 35.14              |
| marrëveshje e përbashkët                                            | Një marrëveshje nga e cila dy ose më shumë palë kanë kontroll të përbashkët.                                                                                                                                                                                                | 36.8               |
| marrëveshje koncesionare të shërbimeve                              | Është një marrëveshje detyruese ndërmjet një koncesioni dhënës dhe një operatori, në të cilën:                                                                                                                                                                              | 32.8               |
|                                                                     | (a) Operatori përdor aktivin e marrëveshjes së shërbimeve koncesionare për të ofruar një shërbim publik në emër të koncesionit dhënës për një periudhë të caktuar kohe; dhe                                                                                                 |                    |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                   | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Vendndodhja |
|-----------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                         | (b) Operatori kompensohet për shërbimet gjatë periudhës së marrëveshjes koncesionare të shërbimeve.                                                                                                                                                                                                                                                                                          |             |
| materiale (e rëndësishme)               | Mangësitë apo anomalitë e elementëve janë materiale nëse ato mund të ndikojnë, në mënyrë individuale ose në grup, në vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e pasqyrave financiare. Materialiteti varet nga natyra dhe përmasa e mangësive ose anomalive të gjykuara nga rrethanat përreth. Natyra dhe përmasa e një elementi, ose kombinimi i të dyjave, mund të jetë faktor përcaktues. | 1.7         |
| mbikëqyrje                              | Mbikëqyrja e veprimtarive të një njësie me autoritetin dhe përgjegjshmërinë për të kontrolluar, apo për të ushtruar ndikim të rëndësishëm mbi vendimet e financimit dhe ato operuese të një njësie ekonomike.                                                                                                                                                                                | 20.4        |
| mbrojtje efektive                       | Shkalla në të cilën ndryshimet në vlerën e drejtë ose rrjedhën e parave të zërit të mbrojtur që i atribuohen rrezikut të mbrojtur kompensohen nga ndryshimet në vlerën e drejtë ose rrjedhën e parave të instrumentit mbrojtës. (shih [SNKSP 29] Shtojca A paragrafi AG145–AG156).                                                                                                           | 29.1        |
| mekanizëm financiar i veçantë           | Një strukturë financiare e identifikueshme veças, përfshirë njësi ekonomike ligjore të veçanta ose njësi ekonomike të njohura me statut, pavarësisht nga fakti nëse këto njësi ekonomike kanë një personalitet ligjor.                                                                                                                                                                       | 37.7        |
| mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje | Një blerje ose shitje e një aktivi financiar sipas një kontrate, kushtet e së cilës kërkojnë dorëzimin e aktivitetit brenda kuadrit kohor të përcaktuar në përgjithësi nga rregullorja ose konventa në tregun përkatës.                                                                                                                                                                      | 41.9        |
| metoda e interesit efektiv              | Metoda që është përdorur në llogaritjen e kostos së amortizuar të një aktivi financiar ose një detyrimi financiar dhe në shpërndarjen dhe njohjen e të ardhurave nga interesat ose shpenzimeve të interesave, me fitim ose humbje, gjatë periudhës përkatëse.                                                                                                                                | 41.9        |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| <b>Termi</b>                                                                 | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | <b>Vendndodhja</b> |
|------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| metodë e kapitalit neto (në lidhje me interesat në njësi të tjera ekonomike) | Metodë kontabilitetit, sipas së cilës investimi njihet fillimisht në kosto dhe më pas rregullohet për ndryshimet pas blerjes të pjesës që i përket investitorit tek aktivet neto të të investuarit/kapitalit në pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkëta. Teprica ose deficioni i investitorit përfshin pjesën e tij të tepricës ose të deficionit të investitorit dhe aktivet/kapitali neto i investitorit përfshin pjesën e tij të ndryshimeve në aktive/kapitalin neto të të investuarit që nuk janë njohur në sufiçitn ose deficionin e të investuarit. | 36.8               |
| mjete monetare                                                               | Përbëhet nga mjete monetare të zotëruara dhe depozita të arkëtueshme pa kusht.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 2.8                |
| monedha funksionale                                                          | Monedha e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin vepron njësi ekonomike.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 4.1                |
| monedha raportuese                                                           | Monedha në të cilën paraqiten pasqyrat financiare.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 4.1                |
| monedhë e huaj                                                               | Monedhë, e cila që është ndryshe nga monedha funksionale e njësisë ekonomike.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 4.1                |
| ndikim i rëndësishëm (në lidhje me interesat në njësi ekonomike të tjera)    | Fuqia për të marrë pjesë në vendimet për politikat financiare dhe operative të një njësie tjetër, por nuk është kontroll ose kontroll i përbashkët i këtyre politikave.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 36.8               |
| ndryshimi në vlerësimin kontabël                                             | Një rregullim i vlerës kontabël të një aktivi ose një detyrimi, ose i shumës së konsumimit periodik të një aktivi, që rezulton nga vlerësimi i statusit aktual të aktiveve dhe detyrimeve dhe i përfitimeve të ardhshme ekonomike dhe detyrimeve të lidhura me to. Ndryshimet në vlerësimet kontabël vijnë nga informacioni i ri apo zhvillimet e reja dhe prandaj nuk janë korrigjim gabimesh.                                                                                                                                                               | 3.7                |
| ngjarje detyruese                                                            | Një ngjarje që krijon një detyrim ligjor ose konstruktiv që e bën një njësi ekonomike të mos ketë asnjë mundësi tjetër alternative për shlyerjen e këtij detyrimi.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 19.18              |
| ngjarje e tatueshme                                                          | Ngjarja për të cilën qeveria, legjislatura, apo një autoritet tjetër ka vendosur që të jetë objekt taksimi.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 23.7               |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                         | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Vendndodhja |
|-------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| ngjarje pas datës raportuese  | Ato ngjarje, si të favorshme, ashtu edhe të pafavorshme, që ndodhin ndërmjet datës së raportimit dhe datës kur pasqyrat financiare autorizohen për t'u paraqitur. Mund të evidentohen dy lloje ngjarjesh:                                                                                                                                                                                                                 | 14.5        |
|                               | (a) Ato që dëshmojnë për kushtet që ekzistonin në fund të datës së raportimit (korrigjimi i ngjarjeve pas datës së raportimit); dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                       |             |
|                               | (b) Ato që tregojnë kushtet e krijuara pas datës së raportimit (mos-korrigjimi i ngjarjeve pas datës së raportimit).                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |             |
| nisja e afatit të qirasë      | Data prej së cilës qiramarrësi ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e tij për të përdorur aktivin e marrë me qira. Është data e njohjes fillestare të qirasë (pra. njohja e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave ose shpenzimeve që vijnë si rezultat i qirasë, sipas rastit).                                                                                                                                               | 13.8        |
| njësi ekonomike               | Njësi ekonomike kontrolluese dhe njësitë ekonomike të kontrolluara prej saj.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | 1.7, 35.14  |
| njësi ekonomike e kontrolluar | Një njësi ekonomike që kontrollohet nga një njësi tjetër ekonomike.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 35.14       |
| njësi ekonomike e përbashkët  | Një njësi ekonomike, përveç një njësie ekonomike që zotërohet nga investitorët, që u ofron pronarëve, anëtarëve ose sipërmarrësve dividendë, kosto më të ulëta ose përfitime të tjera ekonomike në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për shembull, një kompani e sigurimit të përbashkët, një bashkim kreditimi dhe një njësi ekonomike e përbashkët tip kooperativë, janë të gjithë shembuj të njësive ekonomike të përbashkëta. | 40.5        |
| njësi ekonomike e strukturuar | Është:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | 38.7        |
|                               | (a) Në rastin e njësive ekonomike ku marrëveshjet apo legjislacioni administrativ zakonisht janë faktorët dominues për të vendosur se kush ka kontrollin e një njësie ekonomike, njësia ekonomike që është ngritur në mënyrë që marrëveshjet apo legjislacioni administrativ të mos jenë faktorët dominues për të vendosur se kush e kontrollon njësinë ekonomike, si në rastet                                           |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                     | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Vendndodhja |
|-------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                           | kur marrëveshjet detyruese janë të rëndësishme për përcaktimin e kontrollit të njësisë ekonomike dhe aktivitetet përkatëse drejtohen me anë të marrëveshjeve detyruese; ose                                                                                                                                                                                              |             |
|                                           | (b) Në rastin e një njësie ekonomike ku e drejta e votës ose të drejtat e ngjashme me to nuk janë faktor dominues për të përcaktuar se kush e kontrollon njësinë ekonomike, të tilla si në rastin kur të gjitha të drejtat e votës kanë të bëjnë vetëm me detyrat administrative, ndërsa aktivitetet përkatëse janë të drejtuara me anën e marrëveshjeve të detyrueshme. |             |
| njësi ekonomike investuese                | Një njësi ekonomike që:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 35.14       |
|                                           | (a) Merr fonde nga një ose më shumë investitorë me qëllim që t'u ofrojë këtyre investitorëve shërbime të menaxhimit të investimeve;                                                                                                                                                                                                                                      |             |
|                                           | (b) Ka për qëllim investimin e fondeve vetëm për rritjen e vlerës së kapitalit, të ardhurat nga investimi ose të dyja; si dhe                                                                                                                                                                                                                                            |             |
|                                           | (c) Mat dhe vlerëson performancën e pothuaj të gjithë investimeve të tij në bazë të vlerës së drejtë.                                                                                                                                                                                                                                                                    |             |
| njësi që krijon (gjeneron) mjete monetare | Grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që mbahet për qëllimin kryesor të krijimit të kthimit të investimit, i cili krijon hyrje të mjeteve monetare nga përdorimi i vazhdueshëm e që janë kryesisht të pavarura nga hyrjet e mjeteve monetare nga aktive apo grupe aktivesh të tjera.                                                                             | 26.13       |
| njësia ekonomike rezultuese               | Njësia ekonomike që është rezultati i dy a më shumë operacionesh të kombinuara në një shkrirje                                                                                                                                                                                                                                                                           | 40.5        |
| njësie ekonomike kontrolluese             | Një njësi ekonomike që kontrollon një a më shumë njësi.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 35.14       |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                     | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Vendndodhja |
|---------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| norma e interesit efektiv | <p>Norma që skanton pagesat e ardhshme monetare ose arkëtimet gjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar ose detyrimit financiar për të arritur tek vlera bruto kontabël e një aktivi financiar ose tek kostoja e amortizuar e një detyrimi financiar. Kur llogaritet norma efektive e interesit, njëسيا ekonomike çmon flukset e pritshme të mjeteve monetare duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar (për shembull, parapagimin, zgjatjen, thirrjen dhe alternativat e ngjashme) por nuk merr në konsideratë humbjet pritshme të kredisë. Llogaritja përfshin komisione dhe shpenzime të tjera proporcionale, të paguara ose të arkëtuara ndërmjet palëve në kontratë, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv (shih [SNKSP 41], paragrafët AG156–AG158), të kostove të transaksionit dhe të gjithë primeve apo zbritjeve të tjera. Ekziston një supozim se flukset e mjeteve monetare dhe jeta e pritshme e një grupi instrumentesh financiare të ngjashëm mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Megjithatë, në ato raste të rralla kur nuk është e mundur për të vlerësuar në mënyrë të besueshme flukset e mjeteve monetare ose jetën e pritshme të një instrumenti financiar (ose grupi instrumentesh financiare), njëسيا ekonomike do të përdorë flukset kontraktuale të mjeteve monetare gjatë afatit të plotë kontraktual të instrumentit financiar (ose grupi instrumentesh financiare).</p> | 41.9        |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                              | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Vendndodhja |
|----------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| norma e interesit efektiv të kredisë së rregulluar | Norma që skanton pagesat ose arkëtimet monetare të ardhshme të vlerësuar gjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar për të arritur tek kostoja e amortizuar e një aktiviteti financiar që është një aktivitet financiar i blerë ose i krijuar me kredit të zhvlerësuar. Kur llogaritet norma efektive e interesit të kredisë së rregulluar, njësi ekonomike çmon flukset e pritshme të mjeteve monetare duke shqyrtuar të gjitha kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar (për shembull, parapagimin, zgjatjen, thirrjen dhe alternativat e ngjashme) dhe humbjet e pritshme të kredisë. Llogaritja përfshin të gjitha komisionet dhe shpenzimet e tjera proporcionale të paguara ose të arkëtuara ndërmjet palëve në kontratë, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv (shih [SNKSP 41], paragrafët AG156–AG158), të kostove të transaksionit dhe të gjithë primeve apo zbritjeve të tjera. Ekziston një supozim se flukset e mjeteve monetare dhe jeta e pritshme e një grupi instrumentesh financiare të ngjashëm mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Megjithatë, në ato raste të rralla kur nuk është e mundur për të vlerësuar në mënyrë të besueshme flukset e mjeteve monetare ose jetën e mbetur të një instrumenti financiar (ose grup të instrumenteve financiare), njësi ekonomike do të përdorë flukset kontraktuale të mjeteve monetare gjatë afatit të plotë kontraktual të instrumentit financiar (ose grupit të instrumenteve financiare). | 41.9        |
| normë interesi e përcaktuar e qirasë               | Norma e skontimit, e cila, në fillimin e qirasë, e cila bën që vlera aktuale totale e:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 13.8        |
|                                                    | (a) Pagesave minimale të qirasë; dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |             |
|                                                    | (b) Vlerës së mbetur të pa garantuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |             |
|                                                    | të jenë të barabartë me shumën e (i) vlerës së drejtë të aktivitetit të dhënë me qira dhe (ii) çdo kosto fillestare direkte të huadhënësit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |             |



FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| <b>Termi</b>                                         | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                          | <b>Vendndodhja</b> |
|------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| normë interesi shtesë e huamarrjes per qirramarrësin | Norma e interesit që huamarrësi do të paguante në një qira të ngjashme, ose, nëse kjo nuk është e përcaktueshme, norma që, në fillim të qirasë, qiramarrësi do të merrte hua, me një afat të ngjashëm dhe me një siguri të ngjashme, fondet e nevojshme për të blerë aktivin.                               | 13.8               |
| operacion                                            | Një grup i integruar i aktiviteteve dhe/ose detyrimeve të lidhura me të që është i aftë për t'u kryer dhe për t'u menaxhuar me qëllime të arritjes së objektivave të njësisë ekonomike, duke ofruar mallra dhe/ose shërbime.                                                                                | 40.5               |
| operacion i blerë                                    | Operacioni, kontrollin e të cilit e fiton blerësi në një blerje.                                                                                                                                                                                                                                            | 40.5               |
| operacion i huaj                                     | Njësi ekonomike që është një njësi ekonomike e kontrolluar bashkërisht ose pjesëmarrje, sipërmarrjeje e përbashkët ose liri e kontrolluar, ose degë e njësisë raportuese, aktivitet të e së cilës janë të bazuara, ose kryhen, në vend të huaj ose në një monedhë të ndryshme nga ajo e njësisë raportuese. | 4.1                |
| operacion i përbashkët                               | Një marrëveshje e përbashkët ku palët, të cilat kanë kontrollin e përbashkët të marrëveshjes, kanë të drejta tek aktivet dhe detyrime tek detyrimet, në lidhje me marrëveshjen.                                                                                                                             | 37.7               |
| operacion kombinues                                  | Një operacion që kombinohet me një a më shumë operacione për të formuar entin rezultues gjatë një bashkimi.                                                                                                                                                                                                 | 40.5               |
| operator (në një marrëveshje koncesionare shërbimi)  | Është njësia ekonomike që përdor aktivin e koncesionit të shërbimit për të ofruar shërbime publike që janë objekt i kontrollit të koncesionit dhënës të aktivit.                                                                                                                                            | 32.8               |
| operator i përbashkët                                | Një palë në një operacion të përbashkët që ka kontroll të përbashkët të këtij operacioni të përbashkët.                                                                                                                                                                                                     | 37.7               |
| pagesat minimale të qirasë                           | Pagesat që qiramarrësi do të kryejë, ose mund t'i kërkohet të kryejë gjatë afatit të qirasë, duke përjashtuar qiratë e kushtëzuara, kostot për shërbimet dhe aty ku është e përshtatshme, tatimet që do të paguhet nga qiradhënësi dhe do t'i                                                               | 13.8               |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi         | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Vendndodhja |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|               | rimburohen atij, së bashku me:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |             |
|               | (a) Për qiramarrësin, çdo shumë e garantuar nga qiramarrësi ose nga një palë tjetër e lidhur me qiramarrësin; ose                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |             |
|               | (b) Për qiradhënësin, çdo vlerë e mbetur që i është garantuar qiradhënësit nga:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |             |
|               | (i) qiramarrësi;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |             |
|               | (ii) Një palë e lidhur me qiramarrësin; ose                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |             |
|               | (iii) Një palë e tretë e pavarur që nuk ka lidhje me qiradhënësin dhe që është financiarisht në gjendje financiare të shlyejë detyrimet si palë në garanci.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |             |
|               | Megjithatë, nëse qiramarrësi e ka mundësinë e blerjes së aktivitetit me një çmim që parashikohet të jetë në mënyrë të konsiderueshme më i ulët se vlera e drejtë në datën kur do të alternava bëhet ushtruese, për të qenë të jetë e sigurt në mënyrë të arsyeshme që alternativa do të ushtrohet, në datën e fillimit të marrëveshjes së qirasë, shuma e pagesave minimale të qirasë përfshin pagesat minimale të pagueshme përgjatë afatit të qirasë deri në datën e pritshme të ushtrimit të kësaj alternative dhe pagesën e kërkuar për ta ushtruar atë. |             |
| palë e lidhur | Palët konsiderohen të lidhura nëse një palë ka aftësinë të (a) kontrollojë palën tjetër, ose (b) të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative, ose nëse njësi ekonomike e palës së lidhur dhe një njësi tjetër ekonomike janë objekt i kontrollit të përbashkët. Palët e lidhura përfshijnë:                                                                                                                                                                                                           | 20.4        |
|               | (a) Njësi ekonomike, të cilat drejtpërdrejt ose jo, përmes një a më shumë ndërmjetësish, kontrollojnë apo kontrollohen nga njësi ekonomike raportuese;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |             |
|               | (b) Ortakët (shih SNKSP 7, Investime tek Ortakët);                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                     | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Vendndodhja |
|-------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                           | (c) Individët që zotërojnë, drejtpërdrejt ose jo, një interes tek njësia ekonomike që u jep atyre ndikim të rëndësishëm mbi njësinë ekonomike, si dhe anëtarë të afërt të familjes së individëve të tillë;                                                                                                                                                                                                                                                                |             |
|                                           | (d) Personeli drejtues kyç, si dhe anëtarë të afërm të familjes së personelit drejtues kyç; dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |             |
|                                           | (e) Njësi ekonomike në të cilën zotërohet interes pronësie thelbësor nga çdo person i përshkruar tek (c) ose (d), ose mbi të cilën një person i tillë e ka të mundur të ushtrojë ndikim të rëndësishëm.                                                                                                                                                                                                                                                                   |             |
| palë në një marrëveshje të përbashkët     | Një njësi ekonomike që merr pjesë në një marrëveshje të përbashkët, pa marrë parasysh nëse njësia ekonomike ka kontrollin e përbashkët të marrëveshjes.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 37.7        |
| pasqyra financiare individuale            | Ato të paraqitura nga një njësi ekonomike, në të cilat njësia ekonomike mund të zgjedhë, në përputhje me kërkesat e këtij Standardi, të llogarisë investimet në njësi të ekonomike të kontrolluara, sipërmarrje të përbashkëta dhe me pjesëmarrje, ose në kosto, në përputhje me SNKSP 29, Instrumente Financiare: Njohja dhe Matja ose duke përdorur metodën e kapitalit neto sipas përshkrimit në SNKSP 36, Investime në Pjesëmarrje dhe në Sipërmarrjet e Përbashkëta. | 34.6        |
| pasqyra financiare të konsoliduara        | Pasqyrat financiare të një njësie ekonomike në të cilin aktivet, detyrimet, aktivet/kapitali neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare të shoqërisë njësie ekonomike kontrolluese dhe të njërive ekonomike të kontrolluara të saj janë paraqitur si të një njësie të vetme ekonomike.                                                                                                                                                                  | 34.6        |
| pasqyrat e para financiare sipas SNKSP-ve | Pasqyrat e para financiare vjetore, të cilat një njësi ekonomike i nxjerr në përputhje me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe mund të bëjë një deklaratë të qartë dhe të plotë të pajtueshmërisë me ato SNKSP, sepse ka miratuar një ose më shumë nga përjashtimet                                                                                                                                                                               | 33.9        |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                              | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                             | Vendndodhja |
|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                                    | kalimtare në këtë SNKSP, gjë që nuk ndikon në paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare dhe aftësinë e tij për të pohuar pajtueshmërinë me SNKSP-të e bazës së të drejtave dhe detyrimeve.                                                            |             |
| përfitime pas punësimit                            | Përfitimet e punonjësve (përfashtuar përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe përfitimet afatshkurtra të punonjësve) të cilat janë të pagueshme pas përfundimit të marrëdhënieve të punës.                                                | 39.8        |
| Përfitime të tjera afatgjata të punonjësve         | Të gjitha përfitimet e tjera të punonjësve, me përjashtim të përfitimeve afatshkurtra, përfitimeve pas marrjes në punë dhe përfitimeve nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës.                                                                         | 39.8        |
| përfitimet                                         | Avantazhet që përfiton një njësi ekonomike nga përfshirja e saj me njësi të tjera. Përfitimet mund të jenë financiare ose jo-financiare. Vetë ndikimi i përfshirjes së një njësie ekonomike me një njësi tjetër mund të ketë anë pozitive dhe negative. | 35.14       |
| përfitimet afatshkurtra të punonjësve;             | Përfitimet e punonjësve (përveç përfitimeve të ndërprerjes së përfitimit) që priten të shlyhen plotësisht brenda dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës së raportimit gjatë së cilës punonjësit kanë kryer shërbimet përkatëse.                | 39.8        |
| përfitimet e punonjësve                            | Të gjitha format e shpërblimeve që jep një njësi ekonomike në këmbim të shërbimit të kryer nga punonjësit ose të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.                                                                                                 | 39.8        |
| përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës | Përfitimet e punonjësve që jepen në këmbim të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, si rezultat i:                                                                                                                                                     | 39.8        |
|                                                    | (a) Një vendimi të njësisë ekonomike për t'i dhënë fund punësimit të një punonjësi para datës normale të daljes në pension; ose                                                                                                                         |             |
|                                                    | (b) Vendimit të një punonjësi për të pranuar të largohet vullnetarisht nga vendi i punës në këmbim të këtyre përfitimeve.                                                                                                                               |             |
| përfitimet                                         | Janë transfertat të mjeteve monetare që u                                                                                                                                                                                                               | 42.5        |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Vendndodhja |
|--------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| sociale                              | sigurohen:<br>(a) Individëve të veçantë dhe/ose familjeve që plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë;<br>(b) Zbusin efektin e rreziqeve sociale; dhe<br>(c) Trajtojnë nevojat e shoqërisë si e tërë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |             |
| personeli drejtues kryesor           | (a) Të gjithë drejtorët apo anëtarët e bordit drejtues të njësisë ekonomike; dhe<br>(b) Persona të tjerë që kanë autoritet dhe përgjegjësi për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë ekonomike. Aty ku përmbushet kjo kërkesë, personeli drejtues kryesor përfshin:<br>(i) Kur ka një anëtar të organit drejtues të një njësie të tërë drejtuese që ka autoritetin dhe përgjegjësinë për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë raportuese, atë anëtar;<br>(ii) Çdo këshilltar kyç të atij anëtari; dhe<br>(iii) Përveç rasteve kur është përfshirë në (a) grupin e lartë drejtues të njësisë ekonomike raportuese, përfshirë drejtorin ekzekutiv ose kryetarin e përhershëm të njësisë ekonomike raportuese.                                       | 20.4        |
| policat e kualifikuara të sigurimit. | Një policë sigurimi <sup>1</sup> e publikuar nga një emetues, i cili nuk është palë e lidhur (sipas përkufizimit të SNKSP 20) e njësisë raportuese, nëse të ardhurat nga policat:<br>(a) Mund të përdoret vetëm për të paguar ose financuar përfitimet e punonjësve sipas një skeme të përfitimeve të përcaktuara; dhe<br>(b) Nuk janë në dispozicion të kreditorëve të vetë njësisë ekonomike raportuese (edhe në falimentim) dhe nuk mund të paguhet për njësinë ekonomike raportuese, përveçse kur:<br>(i) Të ardhurat përfaqësojnë aktive të tepërta, të cilat nuk i nevojiten policës për të përmbushur të gjitha detyrimet e përfitimeve të punonjësve, që lidhen me të; ose<br>(ii) Të ardhurat i kthehen njësisë raportuese për ta rimbursuar atë për përfitimet e punonjësve tashmë të paguara. | 39.8        |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| <b>Termi</b>                     | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | <b>Vendndodhja</b> |
|----------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| politikat kontabël               | Parimet specifike, bazat, konventat, rregullat dhe praktikat e zbatuara nga një njësi në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare.                                                                                                                                                                                                                 | 3.7                |
| politikat kontabël të segmentit  | Politika kontabël të përshtatura për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të grupit apo njësisë ekonomike të konsoliduar, si dhe ato politika kontabël që lidhen posaçërisht me raportimin e segmentit.                                                                                                                                        | 18.27              |
| prodhim bujqësor                 | Prodhimi bujqësor është produkti i të vjelave/korrave të aktiveve biologjike të njësisë ekonomike.                                                                                                                                                                                                                                                          | 27.9               |
| pronarët                         | Për qëllim të këtij Standardi, përdoret gjerësisht për të përfshirë çdo palë që ka interesa të matshme pronësore në një operacion. Përfshihen, por nuk është i kufizuar tek, mbajtësit e interesave të kapitalit të njësisë ekonomike të zotëruara nga investitorët dhe pronarët apo anëtarët, ose pjesëmarrësit në njësitë ekonomike të përbashkëta.       | 40.5               |
| pronë e zotëruar nga pronari     | Pasuria e zotëruar (nga pronari ose qiramarrësi sipas qirasë financiare) që përdoret për prodhimin ose furnizimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve, ose për qëllime administrative.                                                                                                                                                                        | 16.7               |
| provizion                        | Një detyrim i pasigurt për kohën dhe shumën.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 19.18              |
| provizion për humbje të pritshme | Kompensimi për humbje të pritshme të kredisë nga aktivet financiare të matura në përputhje me paragrafin 40, qiratë e arkëtueshme, shuma e akumuluar nga zhvlerësimi për aktivet financiare të matura në përputhje me [SNKSP 41] paragrafin 41 dhe dispozita për humbjet e pritshme të kredisë nga angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. | 41.9               |
| qira                             | Një marrëveshje, sipas së cilës qiradhënësi i kalon qiramarrësit në këmbim të një pagese, ose të një serie pagesash, të drejtën e përdorimit të aktivit për një periudhë kohe të miratuar nga të dyja palëve.                                                                                                                                               | 13.8               |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                                                | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Vendndodhja |
|----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| qira e kushtëzuar                                                    | Ajo pjesë e pagesave të qirasë që nuk është fikse, por bazohet në vlerën e ardhshme të një faktori i cili ndryshon për arsye të tjera përveç kalimit të kohës (p.sh.: përqindja e shitjeve në të ardhmen, intensiteti i përdorimit të aktivitetit në të ardhmen, indeksi i çmimeve në të ardhmen, përqindja e interesit në treg në të ardhmen). | 13.8        |
| qira e pa-anullueshme                                                | Një qira që është e pa-anullueshme, vetëm:                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 13.8        |
|                                                                      | (a) Nëse ndodhin eventualitete të paparashikuara;                                                                                                                                                                                                                                                                                               |             |
|                                                                      | (b) Me lejen e qiradhënësit;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |             |
|                                                                      | (c) Nëse qiramarrësi hyn në një marrëveshje të re qiraje me të njëjtin qiradhënësit, për të njëjtin aktiv, apo ekuivalentin e tij; ose                                                                                                                                                                                                          |             |
|                                                                      | Me kryerjen e një pagese shtesë nga qiramarrësi të një shumë të tillë shtesë, vazhdueshmëria e marrëveshjes së qirasë së të cilës është e sigurt në mënyrë të arsyeshme në momentin e fillimit të qirasë.                                                                                                                                       |             |
| qira e zakonshme                                                     | Çdo marrëveshje qiraje përveç qirasë financiare.                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 13.8        |
| qira financiare                                                      | Një qira që i transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet rastësore tek pronësia e një aktivi. Titulli mundet të transferohet, ose jo.                                                                                                                                                                                    | 13.8        |
| raporti i mbulimit (mbrojtjes)                                       | Marrëdhënia ndërmjet sasisë së instrumentit mbulues dhe sasisë së elementit të mbrojtur në aspektin e peshës së tyre relative.                                                                                                                                                                                                                  | 41.9        |
| rezervë                                                              | Autorizim i miratuar nga një organ legjislativ për shpërndarjen e fondeve për qëllime të specifikuar nga organi ligjvënës apo një autoritet i ngjashëm                                                                                                                                                                                          | 24.7        |
| ri-matje të përgjegjësive së përfitimeve të përcaktuara neto (aktiv) | Përmbajnë:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 39.8        |
|                                                                      | (a) Fitimet dhe humbjet aktuariale neto;                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |             |
|                                                                      | (b) Kthimin e investimit në aktivet e planit, përjashtuar shumat e përfshira në interesin neto mbi detyrimin (aktivin) neto me                                                                                                                                                                                                                  |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                        | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Vendndodhja |
|------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                              | përfitime të përcaktuara; dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |             |
|                              | (c) Çdo ndryshim në efektin e tavanit të aktivitetit, me përjashtim të shumave të përfshira në interesin neto mbi detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |             |
| riparaqitja në retrospektivë | Korrigjimi i njohjes, matjes dhe dhënies së informacionit shpjegues të për shumën e elementëve të pasqyrave financiare sikur gabimi i periudhës paraardhëse të mos kishte ndodhur kurrë.                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 3.7         |
| ristrukturimi                | Një program i planifikuar dhe i kontrolluar nga drejtuesit dhe që ndryshon materialisht, ose:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 19.18       |
|                              | (a) Fushën e veprimit të aktiviteteve të njësisë ekonomike; ose                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |             |
|                              | (b) Mënyrën sipas së cilës kryhen këto aktivitete.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |             |
| rrezik tjetër i çmimit       | Rreziku që vlera e drejtë ose flukset e ardhshme të mjeteve monetare një instrumenti financiar të luhaten për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut (përveç atyre që rrjedhin nga rreziku i normës së interesit, ose nga rreziku i valutës), nëse këto ndryshime janë shkaktuar nga faktorë të veçantë për instrumentin individual financiar ose publikuesi i tij, ose nga faktorët që ndikojnë në të gjitha instrumentet financiare të ngjashme që tregtohen në treg. | 30.8        |
| rreziku i kredisë            | Rreziku që një palë në një instrument financiar do të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 30.8        |
| rreziku i likuiditetit       | Rreziku që një njësi ekonomike të ndeshë vështirësi në plotësimin e detyrimeve që lidhen me detyrimet financiare që duhet të shlyhen nëpërmjet lëvrimit të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar.                                                                                                                                                                                                                                                             | 30.8        |
| rreziku i monedhës           | Rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 30.8        |



FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| <b>Termi</b>                                 | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | <b>Vendndodhja</b> |
|----------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| rrreziku i normave të interesit              | Rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut.                                                                                                                                                                                                                | 30.8               |
| rrreziku i tregut                            | Rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Rrezik i tregut përfshin tre lloje rreziqesh: rrezikun e monedhës, rrezikun e normave të interesit dhe rrezikun tjetër të çmimit.                                                                                           | 30.8               |
| rrzeiqe sociale                              | Janë ngjarje apo rrethana që:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 42.5               |
|                                              | (a) Lidhen me karakteristikat e individëve dhe/ose familjeve – për shembull: mosha, shëndeti, varfëria apo statusi i punësimit; si dhe                                                                                                                                                                                                                                         |                    |
|                                              | (b) Mund të ndikojnë negativisht në mirëqenien e individëve dhe/ose familjeve të tyre, ose duke iu imponuar kërkesa shtesë për burimet ose duke ulur të ardhurat e tyre.                                                                                                                                                                                                       |                    |
| segmenti                                     | Një aktivitet apo grup aktivitetesh të dallueshëm të një njësie ekonomike, për të cilat është e përshtatshme të raportohet informacioni financiar për qëllim të (a) vlerësimit të performancës së shkuar në arritjen e objektivave dhe (b) marrjen e vendimeve rreth shpërndarjes së burimeve.                                                                                 | 18.9               |
| sektori i përgjithshëm qeveritar             | Përfshin të gjitha njësitë ekonomike organizative të qeverisjes së përgjithshme, sipas përkufizimit në bazat statistikore të raportimit financiar                                                                                                                                                                                                                              | 22.15              |
| shkallët e vlerësimit të rrezikut të kredisë | Vlerësimi i rrezikut të kredisë të bazuar në rrezikun e mospagimit në kohë për instrumentin financiar.                                                                                                                                                                                                                                                                         | 30.8               |
| shlyerje                                     | Shlyerja është një transaksion që eliminon të gjithë detyrimet e mëtejshëm ligjorë ose konstruktive për një pjesë ose për të gjitha përfitimet e siguruara nga një skemë e përfitimeve të përcaktuara, përveç pagesës së përfitimeve punonjësve, ose personave të tjerë për llogari të tyre, e cila është vendosur në kushtet e skemës dhe përfshihet në hipotezat aktuariale. | 39.8               |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| <b>Termi</b>                                        | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | <b>Vendndodhja</b> |
|-----------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| shpenzime                                           | Zvogëlimet në përfitimet ekonomike apo potencialin e shërbimit gjatë periudhës raportuese në formën e daljeve të mjeteve monetare, pakësimit të aktiveve, ose shtimit të detyrimeve që rezultojnë në rënie të aktiveve/kapitalit neto, të ndryshme nga ato që lidhen me shpërndarjet e bëra tek pronarët.                                                                                  | 1.7                |
| shpenzimet e paguara nëpërmjet sistemit të tatimeve | Shumat që janë të disponueshme për përfituesit, pavarësisht nëse paguajnë apo jo taksa.                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | 23.7               |
| shpenzimet tatimore                                 | Dispozita preferenciale të legjislacionit tatimor që u ofrojnë tatimpaguesve të caktuar koncesione që nuk janë të disponueshme për të tjerët.                                                                                                                                                                                                                                              | 23.7               |
| shpenzimi i segmentit                               | Një shpenzim që rrjedh nga aktivitetet e një segmenti që i atribuohet drejtpërdrejt segmentit dhe pjesa përkatëse e një shpenzimi që mund t'i shpërndahet në bazë të arsyeshme segmentit, përfshirë shpenzimet në lidhje me sigurimin e mallrave dhe shërbimeve tek palët e jashtme që lidhen me transaksione me segmente të tjerë të së njëjtës njësi. Shpenzimi i segmentit nuk përshin: | 18.27              |
|                                                     | (a) Interesin, përfshirë interesin e shkaktuar nga paradhëniet ose huatë e segmenteve të tjerë, përveç nëse operacionet e segmentit janë kryesisht të natyrës financiare;                                                                                                                                                                                                                  |                    |
|                                                     | (b) Humbjet nga shitjet e investimeve apo humbjet nga shuarja e borxhit, përveç nëse operacionet e segmentit janë kryesisht të natyrës financiare;                                                                                                                                                                                                                                         |                    |
|                                                     | (c) Pjesa e një njësie ekonomike të defiçitit neto ose humbjes së pjesëmarrjeve, ndërmarrjeve të përbashkëta ose investimeve të tjera të llogaritura sipas metodës së kapitalit;                                                                                                                                                                                                           |                    |
|                                                     | (d) Tatimi mbi fitimin apo aktivet ekuivalente të tatimit mbi fitim që njihen në përputhje me standardet e kontabilitetit që kanë të bëjnë me detyrimet për të paguar tatimin mbi fitim                                                                                                                                                                                                    |                    |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Vendndodhja |
|--------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                      | apo ekuivalentët e tatimit mbi fitim; ose                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |             |
|                                      | (e) Shpenzime të përgjithshme administrative, shpenzimet e selisë, si dhe shpenzime të tjera që lindin në nivelin e njësisë ekonomike dhe lidhen me njësinë ekonomike në tërësi. Megjithatë, ndonjëherë kostot ndodhin në nivelin e njësisë ekonomike në emër të një segmenti. Kosto të tilla janë shpenzime të segmentit nëse lidhen me aktivitetet operative të segmentit dhe mund t'i atribuohen ose të shpërndahen direkt tek segmenti në bazë të arsyeshme. |             |
|                                      | Shpenzimi i segmentit përfshin pjesën e një sipërmarrësi të përbashkët në shpenzimet e një njësie ekonomike të kontrolluar bashkërisht që llogaritet nga konsolidimi proporcional në përputhje me SNKSP 8.                                                                                                                                                                                                                                                       |             |
|                                      | Për operacionet e një segmenti që janë kryesisht të natyrës financiare, të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit mund të raportohen si një shumë e vetme neto për qëllime raportimi të segmentit vetëm nëse ata zëra neto janë në pasqyrat financiare të konsoliduara ose të njësisë ekonomike.                                                                                                                                                       |             |
| shpërblimi i personelit kyç drejtues | Çdo shpërblim ose përfitim i marrë direkt ose indirekt nga personeli drejtues kyç i njësisë raportuese për shërbimet e ofruara në cilësinë e tyre si anëtarë të organit drejtues, ose ndryshe si punonjës të njësisë raportuese.                                                                                                                                                                                                                                 | 20.4        |
| shpërndarjet tek pronarët            | Përfitimet ekonomike apo potenciali për shërbime në të ardhmen të shpërndara nga njësia ekonomike tek të gjithë apo disa nga pronarët e saj, si kthim nga investim, ose si kthim i vetë investimit.                                                                                                                                                                                                                                                              | 1.7         |
| shuma e amortizueshme                | Kostoja e një aktivi, ose një shumë tjetër zëvendësuese e koston, minus vlerën e saj të mbetur.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 17.13       |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                                                                  | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Vendndodhja |
|----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| shumë e kushtëzuar                                                                     | Zakonisht, një detyrim i blerësit për të transferuar aktive shtesë apo interesat e kapitalit neto tek ish-pronarët e shoqërisë së blerë, si pjesë e shkëmbimit për kontrollin e operacionit të blerit, nëse ndodhin ngjarje të caktuara në të ardhmen ose plotësohen kushtet. Megjithatë, shumat e kushtëzuara gjithashtu mund t'i japin blerësit të drejtën për të kthyer shumën e transferuar më parë, nëse plotësohen kushtet e specifikuar. | 40.5        |
| shumë e rikuperueshme (e aktiveve afatgjata materiale)                                 | Vlera më e lartë e drejtë e një aktivi që krijon para minus kostot për shitje dhe vlerën e tij në përdorim.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 17.13       |
| shumë e rikuperueshme (e një aktivi apo një njësie ekonomike që krijon mjete monetare) | Vlera më e lartë e drejtë e një aktivi apo njësie që krijon para minus kostot për shitje dhe vlerën e tij në përdorim.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | 26.13       |
| shumë e rikuperueshme shërbimi                                                         | Vlera më e lartë e drejtë e një aktivi që nuk krijon mjete monetare minus kostot për shitje dhe vlerën e tij në përdorim.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 21.14       |
| sipërmarrës i përbashkët                                                               | Një palë në një sipërmarrje të përbashkët që ka kontrollin e përbashkët të kësaj sipërmarrjeje të përbashkët.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 36.8        |
| sipërmarrje e përbashkët                                                               | Një marrëveshje e përbashkët ku palët që kanë kontrollin e përbashkët të marrëveshjes kanë të drejta në aktivet neto të marrëveshjes.                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 36.8        |
| skemat e përfitimeve pas-punësimit                                                     | Marrëveshje zyrtare ose jo-zyrtare sipas së cilave njësi ekonomike siguron përfitime pas marrjes në punë të një ose më shumë punonjësve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 39.8        |
| Skemat me disa punëdhënës                                                              | Skema të përcaktuara kontributesh (të ndryshme nga skemat shtetërore), ose skema të përcaktuara përfitimi (të ndryshme nga skemat shtetërore), të cilat:                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 39.8        |
|                                                                                        | (a) Grumbullojnë aktivet e kontribuara nga njësi të ndryshme që nuk janë nën kontroll të përbashkët; dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                               | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | Vendndodhja |
|-------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                     | (b) I përdorin këto aktive për të ofruar përfitime për punonjësit e më shumë se një njësie ekonomike, bazuar në faktin se nivelet e kontributeve dhe të përfitimeve përcaktohen pa marrë në konsideratë identitetin e njësisë ekonomike në të cilën punojnë punonjësit në fjalë.                                                                                                                                                                    |             |
| skemat me kontribute të përcaktuara | Skemat e kontributeve të përcaktuara janë skemat e përfitimeve pas marrjes në punë, sipas të cilave një njësi ekonomike paguan kontribute fikse tek një njësi veçantë (një fond) dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo detyrim konstruktiv për të paguar kontribute të tjera nëse fondi nuk mban aktive të mjaftueshme për të paguar të gjitha përfitimet e punonjësve në lidhje me shërbimin e punonjësve në periudhat aktuale dhe ato të mëparshme. | 39.8        |
| skemat me përfitime të përcaktuara  | Skemat e përfitimit pas marrjes në punë që janë ndryshe nga skemat me kontribute të përcaktuara.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | 39.8        |
| skemat shtetërore                   | Planet (skemat) e krijuara me ligj që funksionojnë si të jenë skema me shumë punëdhënës për të gjitha njësitë ekonomike në kategoritë ekonomike të përcaktuara në ligj.                                                                                                                                                                                                                                                                             | 39.8        |
| tatime                              | Përfitimet ekonomike apo potenciali për shërbime që janë të detyrueshme për t'u paguar ose janë të pagueshme ndaj njërive të sektorit publik, në përputhje me ligjet dhe/ose rregulloret, të krijuara për të siguruar të ardhura për qeverinë. Tatimet nuk përfshijnë gjokat apo sanksione të tjera që vihen për shkelje të legjisllacionit.                                                                                                        | 23.7        |
| tavan i aktivitetit                 | Vlera aktuale e çdo përfitimi ekonomik të disponueshëm në formën e rimbursimeve nga skema ose të pakësimeve të kontributeve të ardhshme të skemës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 39.8        |
| të ardhurat                         | Hyrjet totale të përfitimeve ekonomike ose potencialit të shërbimit gjatë periudhës raportuese kur këto flukse hyrëse rezultojnë në një rritje të aktiveve/kapitalit neto, të ndryshme nga rritjet që lidhen me kontributet nga pronarët.                                                                                                                                                                                                           | 1.7         |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                             | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Vendndodhja |
|---------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| të ardhurat e segmentit                           | Janë të ardhurat që raportohen në pasqyrën e performancës financiare të njësisë ekonomike që i atribuohet direkt një segmenti si dhe pjesa përkatëse e të ardhurave të njësisë ekonomike që mund të shpërndahen në bazë të arsyeshme tek një segment, qoftë nga ndarjet buxhetore, qoftë nga grante, transferime, gjoba, tarifa, apo shitje të ngjashme tek klientë të jashtëm ose nga transaksione me segmentë | 18.27       |
|                                                   | të tjerë të së njëjtës njësi ekonomike. Të ardhurat e segmentit nuk përfshijnë:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |             |
|                                                   | (a) Të ardhurat nga interesi apo dividendi, përfshirë interesin e fituar nga paradhëniet ose huatë dhënë segmentëve të tjerë, përveç nëse operacionet e segmentit janë kryesisht të natyrës financiare; ose                                                                                                                                                                                                     |             |
|                                                   | (b) Fitimet nga shitjet e investimeve apo fitime nga shuarja e borxhit, përveç nëse operacionet e segmentit janë kryesisht të natyrës financiare;                                                                                                                                                                                                                                                               |             |
|                                                   | Të ardhurat nga segmenti përfshijnë të ardhura nga sufiçiti (defiçiti) neto e pjesës së pjesëmarrësve të investitorëve në një njësi ekonomike, ndërmarrjeve të përbashkëta ose investimeve të tjera të llogaritura sipas metodës së kapitalit, vetëm nëse ata zëra përfshihen në të ardhurat e konsoliduara apo të përgjithshme të njësisë ekonomike.                                                           |             |
|                                                   | Të ardhurat e segmentit përfshijnë pjesën e një sipërmarrësi të përbashkët të të ardhurave të një njësie ekonomike të kontrolluar bashkërisht që llogaritet nga konsolidimi proporcional në përputhje me SNKSP 8.                                                                                                                                                                                               |             |
| të ardhurat nga një njësi ekonomike e strukturuar | Përfshijnë, por nuk kufizohet tek tarifat periodike dhe jo periodike, interesa, dividendë apo shpërndarje të ngjashme, fitime apo humbje nga ri-matja ose çregjistrimi i interesave të njësisë ekonomike të strukturuar dhe fitimet ose humbjet nga transferimi i aktiveve dhe i detyrimeve në njësinë ekonomike të strukturuar.                                                                                | 38.7        |
| të drejtat e                                      | Të drejtat që e privojnë vendimmarrësin nga                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 35.14       |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                            | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Vendndodhja |
|----------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| heqjes                           | autoriteti i tij i vendimmarrjes.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |             |
| të drejtat e lidhura             | Aktivitetet e njësisë së mundshme të kontrolluar që ndikojnë në mënyrë të rëndësishme në natyrën apo madhësinë e përfitimeve që merr një njësi ekonomike nga përfshirja e saj me njësinë tjetër ekonomike.                                                                                                                                                             | 35.14       |
| të vjela                         | Shkëputja e produkteve prej një aktivi biologjik ose pushimi i proceseve të jetës të aktivitet biologjik.                                                                                                                                                                                                                                                              | 27.9        |
| Transaksion pa shkëmbim          | Transaksionet nuk janë transaksione këmbimi. Në një transaksion pa shkëmbim, njësia ekonomike ose merr vlerë nga një njësi tjetër pa dhënë drejtpërdrejt vlerë pothuajse të barabartë në këmbim, ose jep vlerë një njësie tjetër ekonomike pa marrë drejtpërdrejt vlerë të barabartë në këmbim.                                                                        | 9.11        |
| transaksion parashikues          | Një transaksion i paangazhuar, por i parashikuar për të ardhmen.                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 41.9        |
| transaksione këmbimi             | Transaksione në të cilat një njësi merr aktive apo shërbime, ose i shuhen                                                                                                                                                                                                                                                                                              | 9.11        |
|                                  | detyrimet dhe i jep një njësie tjetër ekonomike drejtpërdrejt, në këmbim, një vlerë afërsisht të barabartë (kryesisht në formën e parave, të mirave, shërbimeve ose përdorimit të aktiveve).                                                                                                                                                                           |             |
| transaksionet me palët e lidhura | Një transferim burimesh ose detyrimesh ndërmjet njësisë ekonomike raportuese dhe një pale të lidhur, pavarësisht nëse caktohet një çmim apo jo. Transaksionet me palët e lidhura përjashtojnë transaksionet me ndonjë njësi tjetër ekonomike që është një palë e lidhur vetëm për shkak të varësisë së saj ekonomike nga njësia raportuese apo drejtuese ku bën pjesë. | 20.4        |
| transferime                      | Flukse hyrëse të përfitimeve ekonomike të ardhshme ose potencialit të shërbimeve nga transaksione pa shkëmbim, përveç tatimeve.                                                                                                                                                                                                                                        | 23.7        |
| transformim biologjik            | Përbëhet nga proceset e rritjes, prishjes, prodhimit dhe rritjes që shkaktojnë ndryshime cilësore apo sasiore tek një aktiv biologjik.                                                                                                                                                                                                                                 | 27.9        |
| treg aktiv                       | Një treg në të cilin ekzistojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 21.14       |
|                                  | (a) Artikujt e tregtuar brenda tregut janë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |             |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                                                                             | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                                                      | Vendndodhja |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                                                                                   | homogjenë;                                                                                                                                                                                                                                                                       |             |
|                                                                                                   | (b) Blerës dhe shitës të gatshëm mund të gjenden normalisht në çdo kohë; dhe                                                                                                                                                                                                     |             |
|                                                                                                   | (c) Çmimet i janë vënë në dispozicion publikut.                                                                                                                                                                                                                                  |             |
| vendimmarrësi                                                                                     | Një njësi ekonomike me të drejta vendimmarrjeje që është ose njëسيا kryesore, ose një agjent për palët e tjera.                                                                                                                                                                  | 35.14       |
| veprimtari të shfrytëzimit                                                                        | Aktivitetet e një njësie ekonomike që nuk janë aktivitete financiare apo investimi.                                                                                                                                                                                              | 2.8         |
| veprimtaritë financiare                                                                           | Aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kombinuar dhe të huasë së njësisë ekonomike.                                                                                                                                                        | 2.8         |
| veprimtaritë investuese                                                                           | Blerja dhe nxjerrja jashtë përdorimi e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.                                                                                                                                           | 2.8         |
| vlera aktuale e një detyrimi për përfitime të përcaktuara                                         | Vlera aktuale, pa zbritur asnjë skemë aktivesh, e pagesave të ardhshme të pritshme, të kërkuara për të shlyer detyrimin që rezulton nga shërbimi i punonjësve në periudhën aktuale dhe periudhat e kaluara.                                                                      | 39.8        |
| vlera bruto kontabël e një aktivi financiar                                                       | Kosto e amortizuar e një aktivi financiar, përpara rregullimit për ndonjë kompensim humbjeje.                                                                                                                                                                                    | 41.9        |
| vlera e drejtë                                                                                    | Shuma për të cilën mund të shkëmbehet një aktiv, ose të shlyhet një detyrim, ndërmjet palëve të mirë-informuara, të vullnetshme, në një transaksion të lirë ndërmjet tyre.                                                                                                       | 9.11        |
| vlera e drejtë minus kostot për shitje                                                            | Shuma e përfitueshme nga shitja e një aktivi në një transaksion mes palëve të vullnetshme, me njohuri, minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit.                                                                                                                               | 21.14       |
| vlera e mbetur (e pronave të paluajtshme, makinerive dhe pajisjeve, ose e një aktivi jo material) | Shuma e vlerësuar që një njësi ekonomike mund të përftonte nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi, pas zbritjes së kostos së vlerësuar nga nxjerrja jashtë përdorimit, nëse aktivi do të ishte tashmë në moshën dhe kushtet e pritshme në fund të jetës së tij të dobishme. | 17.13       |
| vlera neto e realizueshme                                                                         | Çmimi i shitjes i vlerësuar me çmuarje në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara                                                                                                                                                  | 12.9        |



FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| Termi                                                                | Përkufizimi                                                                                                                                                                                                                                         | Vendndodhja |
|----------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                                                      | të nevojshme për realizimin e shitjes, shkëmbimit apo shpërndarjes.                                                                                                                                                                                 |             |
| vlera specifike për njësinë ekonomike                                | Vlera aktuale e flukseve monetare, të cilat njëzia ekonomike pret të vijjnë nga përdorimi në vazhdimësi i një aktivi dhe nga nxjerrja e tij jashtë përdorimit në fund të jetës së tij të dobishme, ose që pret të shkaktojë kur shlyen një detyrim. | 17.13       |
| vlerë e mbetur e garantuar                                           | (a) Për një qiramarrës, është ajo pjesë e vlerës së mbetur, e cila garantohet nga qiramarrësi ose nga një palë tjetër e lidhur me qiramarrësin (ku shuma e garancisë është shuma maksimale që mund të bëhet e pagueshme, në çdo rast);              | 13.8        |
|                                                                      | (b) Për një qiradhënës, është ajo pjesë e vlerës së mbetur, e cila është e garantuar nga qiramarrësit ose nga një palë e tretë, e cila nuk ka lidhje me qiradhënësin, por është në gjendje financiare të shlyejë detyrimet sipas garancisë.         |             |
| vlerë e mbetur e pa garantuar                                        | Pjesa e vlerës së mbetur të aktivit të dhënë me qira, realizimi i së cilës nga një qiradhënës nuk është i sigurt ose është i garantuar vetëm nga një palë tjetër e lidhur me qiradhënësin.                                                          | 13.8        |
| vlerë kontabël (e një aktivi të jo-material)                         | Shuma me të cilën një aktiv kontabilizohet pasi është zbritur ndonjë amortizim i akumuluar dhe ndonjë humbje e akumuluar nga zhvlerësimi.                                                                                                           | 31.16       |
| vlerë kontabël (e pasurive të paluajtshme, makinerive dhe pajisjeve) | Shuma me të cilën njihet një aktiv pasi është zbritur çdo amortizim i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga zhvlerësimi.                                                                                                                         | 17.13       |
| vlerë kontabël (e pronës së investimit)                              | Vlera me të cilën kontabilizohet një aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar.                                                                                                                                                                      | 16.7        |
| vlerë kontabël e një aktivi                                          | Shuma me të cilën njihet një aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, pasi zbritjes së ndonjë amortizimi të akumuluar dhe ndonjë humbjeje të akumuluar nga zhvlerësimi.                                                                            | 10.7        |
| vlerë kontabël e                                                     | Shuma me të cilën njihet një detyrim në                                                                                                                                                                                                             | 10.7        |

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

| <b>Termi</b>                                                | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                               | <b>Vendndodhja</b> |
|-------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| një detyrimi                                                | pasqyrën e pozicionit financiar.                                                                                                                                                                                                                 |                    |
| vlërë në përdorim e një aktivi që krijon mjete monetare     | Vlera aktuale e flukseve të mjeteve monetare të ardhshme të vlerësuara që pritet të rrjedhin nga përdorimi i vazhdueshëm i një aktivi dhe nga nxjerrja e tij jashtë përdorimi, në fund të jetës së tij të dobishme.                              | 26.13              |
| vlërë në përdorim e një aktivi që nuk krijon mjete monetare | Vlera aktuale e potencialit të mbetur të shërbimit të aktivitetit.                                                                                                                                                                               | 21.14              |
| zbatimi në prospektivë                                      | Zbatimi i mundshëm i një ndryshimi në politikën kontabël dhe i njohjes së efektit të një ndryshimi në një vlerësim kontabël, përkatësisht, janë:                                                                                                 | 3.7                |
|                                                             | (a) Zbatimi i politikave të reja kontabël për transaksionet, ngjarje dhe kushte të tjera që ndodhin pas datës në të cilën ndryshohet politika; dhe                                                                                               |                    |
|                                                             | (b) Njohja e efektit të ndryshimit në vlerësimin kontabël në periudhën aktuale dhe ato të ardhshme që ndikohen nga ndryshimi                                                                                                                     |                    |
| zbatimi retrospektiv                                        | Zbatimi i një politike të re kontabël për transaksionet, ngjarjet, dhe kushtet e tjera sikur kjo politikë të ishte zbatuar gjithmonë.                                                                                                            | 3.7                |
| zbatues për herë të parë                                    | Një njësi ekonomike që miraton një bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për herë të parë dhe paraqet pasqyrat e para financiare kalimtare ose pasqyrat e para financiare SNKSP.                                                     | 33.9               |
| zërat jo-monetarë                                           | Zëra që nuk janë zëra monetarë.                                                                                                                                                                                                                  | 10.7               |
| zërat monetarë                                              | Njësitë e monedhës së mbajtura, si dhe aktivet dhe detyrimet për t'u arkëtuar ose për t'u paguar me një numër fiks ose të përcaktuar njësisish monedhe.                                                                                          | 4.1                |
| zhvillim                                                    | Zbatimi i gjetjeve kërkimore ose njohurive të një plani ose skeme për prodhimin e materialeve, pajisjeve, produkteve, proceseve, sistemeve ose shërbimeve të reja ose të përmirësuara në mënyrë thelbësore përpara fillimit të prodhimit tregtar | 31.16              |

---

FJALORI I TERMAVE TË PËRCAKTUARA

---

| <b>Termi</b> | <b>Përkufizimi</b>                                                                                                                                                                                                                    | <b>Vendndodhja</b> |
|--------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
|              | apo përdorimit.                                                                                                                                                                                                                       |                    |
| zhvlerësim   | Humbje në përfitimet e ardhshme ekonomike apo në potencialin e shërbimit të një aktivi, veç njohjes sistematike të humbjes, nëpërmjet zhvlerësimit, të përfitimeve ekonomike apo potencialit të shërbimit të ardhshëm të aktivitetit. | 21.14              |

**Faleminderit,**